



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec



01 Nr. 12/23

Rahovec, 18.12.2023

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal që të marrin pjesë në mbledhjen e dymbëdhjetë (12), e cila do të mbahet më **27 dhjetor 2023 (Mërkure)**, me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi i Raportit të punës së ekzekutivit (Kryetarit) për vitin 2023;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), për vitin 2024;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2024;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit lokal të Veprimit për Biodiversitetit (2023-2027);
9. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit (2023-2024);
10. Shqyrtimi Raportit për zbatimin e Planit të Integritetit për vitin 2023;
11. Shqyrtimi dhe miratimi i Shfuqizimit të vendimit 01 Nr. 303/22, i datës 29.04.2022 për miratimin e Planit Komunal për Integritet (2022-2026);
12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për caktim të lokacionit për vendosjen e trafos elektrike P- 01015-44 ZK-Xërxë;
13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit në shfrytëzim të personave fizik dhe juridik deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite P- 08152-0;
14. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për Zbatimin e procedurave dhe Vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës P- 08152-0; , sipas vendimit 01 Nr.____/23, i datës 00.12.2023;
15. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2024;
16. Shqyrtimi i Raportit mbi realizimin e Planit të punës së zyrës prokurimit për vitin 2023, dhe informatë mbi Planin vjetor të Prokurimit publik 2024;
17. Shqyrtimi i Raportit i “Grantit të Performancës Komunale” për Komunën e Rahovecit për vitin 2022;

KRYESUES I KUVENDIT

Arbër Zenuni



P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.11.2023**, me fillim në orën **11:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **zt. Arbër Zenuni**. Në fillim kryesuesi konstatoi kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston.

Kryesuesi: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **zt. Smajl Latifi**, Nënkryetar **zt. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit. Për këtë mbledhje se bashku edhe me Zyrën e Kryetarit, kemi vendosur për këtë rend dite:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet ne pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim paraprak të pronës së paluajtshme komunale, P-01057-2, ZK-Xërxë, personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër 1-15 vjet;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-71510057-01728-1, ZK-Rahovec;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-71510057-02240-1, ZK-Rahovec;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-71510057-01422-1, ZK-Rahovec;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-71510033-00550-2, ZK-Xërxë;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-00386-1, ZK-Pastaselë;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për caktimin e normës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për miratimin e Raportit të Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera;

Shtesë:

11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

Kryesuesi – Të nderuar anëtarë të kuvendit, i nderuar Kryetar i Komunës zt. Smajl Latifi, i nderuar nënkryetar i komunës, drejtorë të drejtorive, medie, përfaqësues të KFOR-it dhe gjithë ju të pranishëm. Para se të fillojmë me mbledhjen e kuvendit, dëshiroj t’ju informoj që do të bëjmë një përkujtim për një psikolog gjerman, Ulrike Ruse që komuna jonë e ka shpallur Qytetar Nderi në vitin 2009 dhe i cili ka vdekur para disa dite. Ne, në shenjë respekti dhe falënderimi nga kuvendi dhe komuna e Rahovecit ju ftojmë që të përkujtojmë me një minutë heshtje në shenjë respekti... Lavdi!

Të nderuar të pranishëm, për t’ju informuar më shumë për biografinë e humanistit gjerman Ulrike Ruse, para vetes kemi një biografi që do t’ju prezantoj. Humanisti gjerman, Ulrike Ruse, lindi me 32 Gusht 1946 në Flensburg, respektivisht në Republikën Schlesvik Hollshtajn të Gjermanisë. Profesioni i tij ishte psikolog-psikoterapist me përvojë mbi 40 vjeqare, që ndikoi në formimin e personalitetit të tij si humanist. Aktivitetet humanitare i ka zhvilluar në Portugali, Estoni, Hungari dhe së fundi në Kosovë nga viti 1999 e tutje. E nisi në kampin e refugjatëve në Preshtinë, Tetovë, Çegran e Gostivar për të vazhduar në Kosovë respektivisht në Rahovec. Në komunën tonë duke vlerësuar se kishte nevojën për ndihmën humanitare, psikologjike e psikoterapoetike pasi që Rahoveci me rrethinë doli shumë i shkatërruar nga lufta. Nëse shumë shoqata erdhën dhe u larguan pas përfundimit të misionit të tyre, Ulrik Ruse dhe organizata gjermane “Diakonia” qëndruan me gjatë, i cili u lidh emocionalisht dhe shpirtërisht me banorët të kësaj ane, duke deklaruar se zoti me ka thënë të vij në Kosovë e mbi të gjitha në Rahovec, për ta ndihmuar popullin e shumëvuahtur të Kosovës duke shtuar se deri para luftës nuk kam ditur shumë për Kosovën, por kur në media i pashë skenat e dhunës dhe të shkatërrimit, atëherë vendosa të vij dhe ta ndihmoj këtë popull - deklaroi Kruse. Ai erdhi me projektin e Diakonisë, ndihmë psikologjike për fëmijët dhe të rinjtë të traumatizuar nga lufta. Fillimisht vizitoi fshatrat Zoqisht, Opterushë, Retijë duke organizuar sigurinë dhe shpërndarjen e ndihmave materiale në vlerën nga 10,000€ në ndërtimin e 350 shtëpive të kategorisë 3,4 dhe 5. Për të vazhduar me pas me sigurimin e ndihmave ushqimore dhe medikamente për njerzit me nevojë e ndihmuar edhe nga bashkëshortja e tij Renate Veber pedagoge, që kanë ofruar ndihmë dhe këshilla pedagogjike me fëmijë me nevoja të veçanta në përgjithësi. Pra, fokusi i tij ishin fëmijët me nevoja të veçanta dhe prindërit e tyre duke bashkëpunuar me shoqatën OPFAKOS, organizata e prindërve me nevoja të veçanta të Kosovës, e më pas OPFAK në Rahovec. Në koordinimin me drejtuesit e kësaj organizate respektivisht doktorin Lulzim Krasniqi, Agim Morina i cili vdiq para disa ditëve, Bedrush Hoti e shumë të tjerë janë marrë edhe me renovimin dhe pajisjet e ambulancave shëndetësore në Opterushë dhe Ratkoc. Kruze ka ndihmuar edhe në ndërtimin e objektit të shoqatës “Hareja” me një shumë prej 30,000€, pastaj shoqata Amica, Handikos, pastaj shoqatën „Nëna dhe FËMIJA. Poashtu ka ndihmuar projektin Menza për ushqim ditor për 100 fëmijëve skamnor, kubin e të rinjve Nirvana e plotë kontribute të tjera humanitare. Për shkak të këtyre kontributeve humanitare me propozimin e OJQ-së OPFAKOS, tani Opfak në Rahovec me 29 mars 2009, Kuvendi i Komunës së Rahovecit i ndau dekoratën “Qytetar Nderi” dekoratën ia dorëzoi ish-kryetari i atëhershëm i komunës zt.Qazim Qeska. Ulrike Ruse vdiq me 6 nëntor të vitit 2023 dhe në shenjë nderimi dhe respekti për kontributin e tij humanitar, kryetari i komunës së Rahovecit i ka dërguar telegram ngushëllimi familjes dhe miqëve të tij nga Kosova, e në veçanti komuna jonë janë falënderues e mirënjohës këtij humanisti të madh. Vlen të theksohet se në letrën e informacionit për vdekjen e tij dërguar tek miqët, ka lënë edhe këtë porosi se atyre që dëshirojnë të marrin pjesë në vorrimin e tij të hollat që planifikojnë për lulet pranë arkivolit, t’i leni në konto për fëmijët e Kosovës. U kujtoftë e u nderoftë personaliteti dhe kontributi e shëmbëlltyra e tij humaniste. Qoftë i paharruar kujtimi ynë për humanistin, qytetarin tonë nderuar, Ulrike Ruse.

Të nderuar anëtarë të kuvendit, tani vazhdojmë me mbledhjen e seancës së sotme. Të nderuar anëtarë të kuvendit veçmas ketyre pikëve, poashtu kemi edhe një pike shtesë që ka të bëjë me **formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlersimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**. Kjo pikë ndërlidhet me pikën e tretë të rendit të ditës. Tani këtë pike shtesë e vendosim në votim së bashku me të edhe rendin e ditës. Me shumicë të votave të anëtareve të kuvendit aprovohet rendi i ditës me pikën shtesë.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - Ateherë nëse nuk kemi ndonjë diskutim lidhur me procesverbalin nga mbledhja e kaluar, e vendosim në votim. Me shumicë të votave të anëtareve të kuvendit aprovohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;

Edona Kryeziu – I nderuar kryesues, kryetari i komunës, drejtues të drejtorive, monitorues, kolegë asamblistë dhe gjithë ju të pranishëm. Unë do të parashtroj dy pyetje, njëra i përket drejtorisë së Shendetësisë, tjetra drejtorisë së Shërbimeve Publike. E nderuara drejtoreshë, Sarandë Sallteku, a jeni në dijeni se ka më shumë se dy javë që e keni jashtë funksionimit aparatin e biokimisë? Sepse jeni këtu për t’u lehtësuar jetën qytetarëve e jo për t’ia vështirësuar. Qytetarët e Komunës së Rahovecit janë të detyruar që shërbimet laboratorike t’i kryejnë jashtë Komunës së Rahovecit, ose t’i kryejnë në laboratore private dhe dihet që kostoja e tyre është shumë e lartë dhe ne të shumtën e rasteve edhe e papërbalueshme. Në stinën e dimrit kur dihet që numri i pacientëve është gjithmonë me i madh dhe qytetarët tanë nuk mund t’i kryejnë as shërbimet me të vogla përbrenda komunës. Për drejtorinë e Shërbimeve Publike: Edhe pse Komuna e Rahovecit, përkatësisht drejtoria e Shërbimeve Publike ka të kontrktuara kompani për mirëmbajtjen e rrugëve, nga terreni shohim se nuk respektohet kjo kontratë dhe si pasojë e kësaj, rrugët e lagjeve të qytetit dhe të fshatrave nuk po mirëmbahen sipas kontratës. Dua të fokusohem në fshatin Xërxë, si sanimi dhe rregullimi i rrugëve ekzistuese në fshat është një kërkesë emergjente e fshatit ku pothuajse shumica e rrugëve kanë nevojë për ndërhyrje sepse janë të pakalueshme, si rruga e cila është përballë firmës “Matreks” e cila është ende e patitulluar, vështirësi qarkullimi për automjete e poashtu edhe për këmbësorë, pastaj rruga “Ganimete Tërbeshi” përkatësisht prapa AMF-së në Xërxë, rruga “Flamuri” afër xhamisë, rruga “5 Maji” e plotë rruge të tjera brenda fshatit. Gjithashtu kërkesë e disa banorëve të fshatit Xërxë është të bëhet edhe zgjerimi i ndriçimit publik, në rrugën prej tregut deri në rrugën “Lidhja e Lezhës”. Kështuqë drejtor, kur mund të pritet një intervenim të këtyre rrugëve?

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, kolegë, medie, të pranishëm! Po ia nisi prej një përgjigje që e kemi pranuar nga drejtori i DKA-së rreth mungesave të nxënësve. Sipas raportit të dërguar janë rreth 9700 mungesa në shkolla të mesme të larta. A është menduar diçka në këtë drejtim dhe cili është vlerësimi juaj dhe i komunës në raport me këtë numër të mungesave? Te drejtoria e Urbanizmit ose te ajo e çështjeve publike, nuk e di sesi i kanë të koordinuara projektet në qytetin e Rahovecit. Drejtorin e Urbanizmit e kam edhe koleg të profesionit, megjithatë janë veprime të ngutshme në raport me intervenimet të ndërtimeve në shesh dhe projekteve tjera sepse sot, ish-parkingu përballë hotel Parkut është i mbyllur totalisht, parkingu të ish-tregu është i mbyllur për shkak të investimeve, të ish-gjimnazi është mbyllur parkingu për shkak të vënies të gurthemelit për ndërtimin e qendrës kulturore multifunksionale dhe sot për sot qyteti i Rahovecit i ka vetëm dy parkingje: Oborrin e komunës dhe atë të QKMF-së. Gjithashtu parkingu që është të palestra është i bllokuar me zhavorrin që është derdhur aty dhe me “tezgat” e tregut të vendosura aty. Ndoshta është dëshirë për realizimin e investimit, por është e papranueshme ngulfatja totale e qytetit sepse nuk shfaqet atraksioni për vizitë as prej banorëve të rrethinës, as jashtë Komunës së Rahovecit. Këtë e ka dëshmuar edhe fakti që për 28 Nëntor, sa vizitorë i ka pasur qyteti i Rahovecit? Zero! Drejtor, të kërkoj edhe profesionalisht që ta udhëzoni edhe kryetarin që të shikohet mundësia e krijimit të hapësirave për parkingje, të reduktohet hapësira e bllokuar të ish-gjimnazi, të hapet hapësira të palestra dhe sa më shpejt të vihet në funksion parkingu nëntokësor, ku

pjesa e epërme mund të shfrytëzohet. Në çoftëse në këtë situatë futemi në periudhën e dimrit, ju garantoj që edhe kurbetqarët që do të vinë, do të dalin në qytetet tjera dhe kjo nënkupton që shpenzimet e parave të bëhen jashtë Rahovecit. Te drejtorja e Arsimit dhe e Financave, e kam një shqetësim: Arsimitarët dalin në pension dhe nuk arrijnë t'i marrin tri pagat e tyre me arsyetimin që nuk ka buxhet, ose pritni në rend! Kush garanton që një i pensionuar mund të pres në rend, për faktin që është mbi 65 vjet! Kërkoj mirëkuptim dhe ta gjeni një formë, sepse pensionimi nuk është diçka që ndodh “ad hoc” dhe që pensionerat tanë mos të shkojnë me vite të tëra nëpër gjykata. Kërkoj mirëkuptim, përgjegjësi dhe shpjegim.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, drejtorë, anëtarë të kuvendit, medie, qytetarë të Komunës së Rahovecit. Fillimisht te drejtorja e Shërbimeve Publike, në vitin e kaluar dhe në fillim të këtij viti kam ngritur kërkesë apo shqetësim të qytetarëve të fshatrave: Hoçë e Vogël, Brestoc në lidhje me trotuaret, sidomos në kohë të dimrit ata e kërkojnë ndiçimin gjithashtu. Kërkesa tjera rreth ndriçimit publik vijnë nga lagjet “Krasniqi”, “Lezi,” “Berisha” sidomos në atë lagje ku është ndërprerë dhe nuk është intervenuar për t'u rikthyer. Në lagjen “Berisha” në Brestoc kemi kërkesë të qytetarit për zgjerim të ndriçimit publik. Te drejtori i bujqësisë kemi një çështje për kompenzimin e dëmeve, sidomos të atyre familjare të vitit 2018/2020. Te drejtori i Arsimit e kemi ngritur një shqetësim rreth sigurisë të nxënësve në seancën paraprahe dhe presim përgjigje. Menaxhmenti i shkollës të fshatit Hoçë e Vogël ka një kërkesë rreth kabinetit të informatikës dhe a pritët të intervenohet në këtë drejtim?

Kryesuesi – Faleminderit zt. Kastrati, por me rregullore keni të drejtë t'i bëni vetëm dy pyetje, faleminderit për mirëkuptim!

Vlora Vuçiterna – **Çmega** – Përshëndetje për të gjithë! Pyetja ime kësaj here shkon për drejtorinë e Urbanizmit dhe jo të Shëndetësisë. Dua ta adresoj shqetësimin tim dhe të banorëve të lagjes “Bekim Sylka”, konkretisht te Sheshi i Republikës. Nuk jam eksperte e kësaj fushe, por një gjë di ta them që nuk është punuar asgjë aty, përveç kubëzave dhe dritave. Jeni në dijeni që banorët e kësaj lagjeje kanë qenë kundër llojit të kubëzave të shkruara aty, për shkak të vështirësive që i hasim në stinën e dimrit. Kryetari dhe drejtori e dinë shumë mirë që janë mbledhur nënshkrimet e banorve të lagjes që janë kundër, megjithatë punimet kanë vazhduar sipas planit tuaj. Si banore e lagjes, përveç kësaj, kërkoj që të bëhet një zgjidhje edhe për parkingjet që bëhen aty dhe që na shkaktojnë një tollovi të madhe sepse më shumë ngjason si “shesh i parkingjeve” sesa i Republikës. Për fund, në emër të të gjithë banorëve aty, kërkoj që të bëhet zgjidhje edhe për kroit e lagjes, i cili ka kohë që nuk rrjedhë.

Ilir Pallqa – Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë, drejtorë, të pranishëm. Gjatë hapave të bëra në Rahovec e vërejmë se përvetësohet nga dikush, diçka që i takon dikujt tjetër. Rrjedhimisht parashtrohet pyetja, a merr dikush përgjegjësi? A merr dikush përgjegjësi kur një rrugë e sapo ndërtuar prishet për shkak të keqplanifikimit? A merr dikush përgjegjësi për një projekt 200.000€ për mbjelljen dekorativ, mungojnë më shumë se gjysma e tyre, e kur komisioni paraprahe e vlerëson negativisht, përjashtohet vetë komisioni. A merr përgjegjësi dikush kur projektet e afatizuara që është dashur të përfundojnë vitin e kaluar apo para dy viteve, janë ende në ndërtim. A merr përgjegjësi dikush, kur paguhet një avokat i jashtëm nga komuna me shifra dhjetra – mijëra € dhe paprakisht kontestet janë të humbura? A merr përgjegjësi dikush kur në rrugët më të qarkullueshme nga nxënësit nuk ka fare trotuar? A merr përgjegjësi dikush, kur tregtarëve të lodhur të pazarit nuk u krijohet një hapësirë me kushte minimale për tregti. Po përvetësohet haku i njerëzve punëtorë e të drejtë, duke u keqpërdorur paraja publike. Ka kohë që në Rahovec po bie një shi i madh, dikush ka çadër e nuk laget!

Valmir Gashi – Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, drejtorë, kolegë, medie. Së pari urime për festat e Nëntorit dhe lavdi dëshmorëve të kombit. Uroj atletin Erzen Zyberaj i cili ka bërë një vrapim multimaratonik nga sheshi “Skenderbeu” i Prishtinës deri te sheshi “Skenderbeu” në Tiranë (260km) për 28 orë. Gjithashtu i

inkurajoj bizneset e komunës dhe jashtë saj, që ta mbështesin atletin sepse e meriton. Në fshatin Xërxë të gjithë e dimë që ka shumë artistë dhe ndër më të shquarit janë Arshikët e Xërxës, andaj për kontributin e tyre të dhënë me këngë folklorike dhe patriotike, propozoj që të ndërtohet një lapidar artistik kushtur Arshikëve të Xërxës. (përballë qerdhës ku është një park i vogël, në mes të rrugës afër xhamisë dhe kullës).

Sejfullah Sejfullahu – Faleminderit kryesues! Përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, drejtorat, kolegë, medie, qytetarë të Rahovecit. E kam një kërkesë e gjysmë dhe në pyetje. Po ia filloj prej gjysmës për drejtorinë e Shërbimeve Publike. Afër shtëpisë së kryesuesit kemi probleme me kanalizim, mundësisht ta bëni një zgjidhje. E dyta, sa e di unë në Kuvendin e Kosovës është koha kur buxheti është në mes të dy dëgjimeve publike dhe mendova që ju LDK dhe VV i keni disa deputetë aty dhe përdoreni ndikimin e tyre që të paktën njërin projekt në Krushe ta realizoni, çoftë qendrën sportive ose stadiumin. E treta, për drejtorinë e Arsimit, me datë 06.11 në fshatin Krushe e kemi mbajtur një debat të madh dhe kam nevoj për një sqarim sepse prej aty kanë dalur disa kërkesa. Në 2022 ka qenë buxheti për shpenzime 16.250€, në 2023 është zvogëluar në 11.891€ dhe gjithmonë kemi biseduar në kuvend që shpenzimet janë rritur dhe për këtë duhet të jetë buxheti më i madh, këtu përkundrazi është zvogëluar. Kërkesa e menaxhmentit të shkollës është që të paktën për 2024 të dyfishohet buxheti.

Defrim Kafexhiu – Faleminderit kryesues! “Ili, nuk të kuptova mirë për çadër, a e pate për kryetarin që nuk laget”? I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit, përfaqësues të organizatave, përfaqësues të KFOR-it, medie, zyrtarë komunalë. Fillimisht e kam një propozim, në seancën e gushtit të këtij viti kemi diskutuar një temë e që është falja e tatimit në pronë në vlerën prej 100€ dhe rrjedhimisht këto ditë e kemi pranuar edhe aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese që i jep të drejtë propozimit të Ministrisë së Financave dhe plotësim-ndryshimit të ligjit të tatimit në pronë që realisht edhe kryetari është thirrur në cënueshmërinë e komunës dhe gjithashtu, Burimi si përfaqësues i LDK-së, kanë thënë që duhet ta presim një herë vendimin e gjykatës dhe më pas si komunë duhet ta marrim vendimin për faljen e tatimit në pronë në vlerë 100€. Përkundër që rendi i ditës është miratuar, si anëtar i kuvendit, propozoj pikën shtesë të rendit të ditës: Propozim-vendimi për faljen e tatimit në pronë për vitin 2023 dhe ju bëj thirrje e sidomos Aleancës – kryetarit të komunës që tani e ka mundësinë që këtu është për interes të qytetarëve dhe për t’ju zgjatur dorën e që rrallë herë e kanë parë. E shfrytëzoj rastin edhe për një thirrje, rrjedhimisht për anëtarët e kuvendit. Kritika i bën mirë qeverisjes, secili prej neve jemi dëshmitar që në raste të caktuara ose sa herë që e kemi ngritë zërin, ekzekutivi ka qenë më i përgjegjshëm. Këta kanë nevojë për këshilla dhe për t’iu treguar zgjidhje të caktuara për çështje të caktuara. Ju ftoj që secili prej nesh të jetë më i zëshëm kundrejt qeverisjes, që në anën tjetër këta të jenë më efektiv për qytetarët e komunës sonë. Ekskluzivisht ju bëj thirrje anëtarëve të kuvendit nga radhët e Aleancës dhe të gjithë të tjerëve që në kuvend “t’i rrahin” tavolinat më shumë dhe të diskutojnë tema të ndryshme në interes të banorëve të komunës sonë.

Burim Krasniqi – Defrim, sa për sqarim unë si asambleist mund të jap vetëm propozim, por jo vendim. Vendimin e merr asambleja komunale. Rreth faljes së borxheve kam propozuar të presim, meqenëse ka qenë në procedurë të Gjykatës Kushtetuese, asgjë më tepër.

Sinan Kryeziu – Faleminderit! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. Sa i përket propozimit të Defrimit për faljen e borxhit, konsideroj që është gabim dhe e kundërshtoj. Nëse pretendon ministria e linjës të falë borxhe dhe të bëj politikë të konsumit ditor, do të ishte mirë që ne t’i falim nga 100€ tatim, por në mënyrë direkte të na subvencionojë dhe jo të dëmtohem në buxhet si komunë. Mendoj që është gabim kjo çasje për falje të borxhit. Mendoj që duhet t’u falim jo 100, por 200 dhe atë direkt nga ministria në mënyrë direkte.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë! Disa herë e kam ngritur një çështje, është fjala për rrugën Fortesë – Krushë e Madhe e cila është shumë e dëmtuar, përkundër kësaj që kanë kaluar shumë vite dhe askush nuk merr hapa konkret rreth asaj rruge. Ajo tanimë nuk është rrugë që i shërben vetëm Fortesës, Celinës dhe Krushës,

por është një lloj tranziti që i shërben shumë fshatrave që qarkullojnë aty. Apeloj që qeverisja komunale të merr hapa konkret me intervenime në atë rrugë. E gjithë rruga nuk është e dëmtuar por janë disa pjesë të saj, ka nevojë për mure mbrojtëse për ta parandaluar rrëshqitjen e dheut. Qytetarët duke u treguar të papërgjegjshëm e marrin dheut dhe e vendosin anash rrugës. Besoj që është hera e fundit që po e ngrisë këtë çështje sepse mendoj që komuna do të merr hapa konkret.

Kryetari – I nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës zt. Arbër Zenuni, kolegë, bashkëpunorë, drejtorë, nënkryetar, anëtarë të kuvendit, mbikëqyrës të mbledhjes, të nderuar të pranishëm. Besoj që jam në përputhje me rregulloren e kuvendit të komunës. Do të përpiqem t'i jap disa shpjegime që lidhem me shqetësimet që u paraqitën këtu. Për mungesat e nxënësve do të përgjigjet me shkrim Avniu. Është një situatë sfiduese sidomos në shkollat e mesme edhe transferi i nxënësve prej një shkolle në një shkollë tjetër më shumë po bën dëm sesa dobi. Sa i përket kufizimeve në lëvizje në qytet edhe në mbledhjen e fundit të KKS-së e kam paralajmëruar një gjë të tillë. Do të përpiqemi që kufizimet mos të jenë bllokuese. Ju e dini që ka filluar ndërtimi i qendrës për inovacion dhe natyrisht e ka kufizuar një pjesë të hapësirës. Gjithashtu fondacioni “Ardian Orllati” ka filluar me punën për objektin që duhet të ndërtohet, natyrisht që edhe aty është bërë një kufizim i hapësirës. Sa i përket ndërtimeve në shesh, mbi tre muaj kemi qenë të bllokuar për zhvendosjen e trafos dhe përquesve të tensionit të lartë për shkak të një ankese që ka ndodhur në OSHP dhe pas 3-4 muaje ka arritur vendimi duke e zhbllokuar situatën. Problemi i shpronësimit të dy pikave, Veda Oil që menaxhohet nga AKP dhe objektet që kanë qenë poashtu në menaxhim të AKP-së, d.m.th vendimin preliminar e marrur Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe formalisht jemi zhbllokuar dhe punimet do të fillojnë në pranverë. Jemi detyruar të punojmë në Tregun e Gjelbër sepse i kemi pasur 700.000€ dhe nuk kemi dashur t'i lejomë që të shkojnë në suficit. Duhet të jemi korrekt dhe po ju prezantoj vetëm të vërtetën dhe gjithashtu më nuk do të jemi të bllokuar për t'i vazhduar punimet. Për shkak të punimeve, tregu i së shtunës mbahet te parkingu i palestrës, ndonëse në kushte jo të mira, por edhe te tregu i mëparshëm kanë qenë kushtet e njëjta. Kjo është një zgjidhje e përkohshme sepse nuk ka infrastrukturë askund tjetër. Pra, pakësimi i parkingjeve është evident, parkingje ka në oborr të komunës, në shumë vende të vogla dhe pranë stacionit të autobusëve. Parkingjet duhet t'i japim në menaxhim me një çmim të arsyeshëm në të ardhmen. Te pagat jubilarë: Ministria e Financave zakonisht tavanet buxhetore i vendos në të gjitha kategoritë ekonomike dhe zakonisht shumica e rasteve në këtë vit është zbatuar duke i marrur në kodin paga dhe mëditje. Ju e dini që një mendim juridik nga Gjykata Supreme ka ndryshuar që i jep të drejtë vendimit të ish Kryeministrit Hashim Thaqi të vitit 2009 dhe të gjitha që ato kanë qenë dikur padi dhe nuk kanë pasë vlerë, tani vlejnë dhe kanë filluar “bombardimet” me procedura përmbartimore. Kur kemi mjete financiare, pagat jubilarë i paguajmë nga kodi “paga dhe mëditje”, por zakonisht planifikimin e këtyre pagave e cakton Ministria e Financave dhe kemi pak vështirësi. Shumë prej tyre që janë pensionuar i kanë marrë nga tri paga jubilarë dhe plot janë në listë të pritjes. Shpresojmë të mos kemi situatë të vështira financiare për shkak të vendimeve gjyqësore që ekziston mundësia, që deri në fund të këtij viti të vijnë. Këtë çështje e kemi ngritur në takim me kryeministrin dhe ministrin e Financave, duke iu paraqitur këtë shqetësim. Pra, ne jemi të gatshëm që ta respektojmë të drejtën e secilit për ta realizuar të drejtën e kontratës kolektive, mirëpo kjo temë prej kuvendeve komunale nuk varet dhe është krejtësisht e lidhur me Ministrinë e Financave. Në Hoçë të Vogël kanë ndodhur disa investime dhe zgjerimi i ndriçimit publik po vazhdon duke u zgjeruar, si dhe ndërtimi i dritave digjitale efikiente mjaftë të mira dhe të certifikuara në BE. Te kompenzimi i dëmeve 2018-2020: Qeveria e Republikës së Kosovës në atë kohë nuk ka kompenzuar dëme në amvisëri, duhet të jemi të saktë. Dëmet në amvisëri janë kompenzuar ato të vitit 2022 (19 shtator, 1 063 000€) dhe po bëjmë presion edhe për kompenzimin e dëmeve në biznese me rreth 69.000€, por bizneset në këtë fazë nuk i kanë trajtuar dhe shpresojmë që do të gjendet ndonjë zgjidhje edhe për ta. Pra, dëmet e vitit 2018-2018 nuk kompenzohen sepse ka përfunduar ajo punë më. Më parë janë kompenzuar në bujqësi, por jo edhe në amvisëri, por tani janë

kompenzuar edhe në amvisëri dhe ekonomi familjare. Te siguria në shkolla: Në çdo takim të KKS-së i trajtojmë këtë probleme dhe probleme serioze me sigurinë në shkolla nuk kemi. Sfidë janë për momentin mungesat në shkolla të mesme, mirëpo në aspektin e sigurisë qëndrojmë mirë si komunë. Te kabineti i informatikës në shkollën “Heronjt e Kosovës” Hoçë e Vogël – Brestoc, besoj që disa punë kanë ndodhur, drejtori i shkollës për fat të mirë është shumë i motivuar me të gjithë nxënësit dhe janë duke bërë investime shtesë me donatorë. Te Vlora Vuçitërna: kam pasur takim me disa prej banorëve të lagjes. Projekti mbikëqyret nga drejtori i Urbanizmit, Albnori dhe kemi arritur në një përfundim që ka një pajtueshmëri të gurëve sepse janë marrur disa mostra, sipas projektit edhe rruga aty ka qenë e planifikuar të bëhet me gurë të tillë, por nuk ka pajtueshmëri. Në pajtim me ministrinë e kemi hequr prej projektit sepse duhet ta bëjmë një zgjidhje, ose duhet ta bëjmë asfalt ose një zgjidhje tjetër që përshtatet për qarkullim të automjeteve dhe sheshi të menaxhohet në mënyrën më të mirë të mundshme. Sa i përket mungesës së ujit te kroi, do të interesohemi pse po ndodh kjo gjë sepse dikush e ka bërë këtë dëm. Te Ilir Pallqa: ka rrugë në të cilat reciklohen punimet. Psh: në sheshin e qendrës jemi detyruar t'i përsërisim situatat për shkak të pozicionit që kanë operatorët tjerë, në këtë rast kedsi. Në këtë rast duhet t'i realizojmë zgjidhjet sipas kedsit sepse janë pëlqime energjetike me vulë. Pra, ndikim të madh ka edhe ndërlidhja e situatave me operatorë tjerë. Te drunjtë dekorues, e kemi një raport dhe është e vertetë që kanë prej tyre që nuk janë zhvilluar, por në masë të madhe janë zhvilluar ose janë “zënë”. Presim përsëri të kemi mjedise të gjelbëruara duke mbjellur fidane të reja. Avokati i komunës ka një marrëdhënie kontraktuale me komunën e Rahovecit që janë të përcaktuara në çmimore. Shumica e komuave të Republikës së Kosovës nuk kanë kapacitete të zyra ligjore për përfaqësim dhe është mirë që e kemi avokatin. Punën e avokatit duhet ta shohim nga pikëpamja e pozitivitetit sepse ka shumë raste që i fitojmë në favor të komunës. Së fundi, nga Gjykata Supreme i kemi fituar 84.000€, punëtorët e QKMF-së që komunës ia kanë marrur me përmbarues, tani do t'i kthejnë, falë punës së avokatit. Tregu në Rahovec, është e vërtetë që ka probleme mirëpo edhe po të ishte tregu që ka qenë, nuk është që kanë qenë kushtet më të mira higjienike. Tregu përkohësisht edhe zhvendosur te palestra. Lapidar artistik në Xërxë për Arshikët, gjithashtu edhe unë i uroj shumë suksese kampionit Erzen Zyberaj për 260km vrap. Erzenin e kam ftuar me qenë në zyre, dua t'ia ndaj një dekoratë dhe një subvencion për fundvit. Sa i përket lapidarit artistik në Xërxë, ajo është shoqëri e njohur kulturo-artistike dhe duhet të diskutojmë në të ardhmen sepse nuk e kemi të planifikuar në buxhet dhe nuk kemi përvojë me praktika të tilla edhe pse unë jam “për”. Me datën 17 dhe brenda afatit, Komisionit Parlamentari për Buxhet, Punë dhe Transfere ia kemi dërguar 27 kërkesa, për mbi 27 projekte kapitale. Nuk e kam harruar stadiumin dhe palestrën në Krushë dhe stadiumin në Ratkoc. Iu kemi drejtuar atyre sepse financiarisht komuna nuk ka mundësi buxhetore dhe nëse komisioni do të ketë mundësi për ndonjë amandamentim të projekt ligjit për buxhet që ka kaluar në lexim të parë, shpresojmë që radari ta zë edhe Rahovecin me ndonjë projekt. Sëfë, buxheti i shkollave për vitin 2024 është zvogëluar sepse është zvogëluar granti për arsim. Unë njoh shkolla që nuk e kanë shpenzuar buxhetin aq sa e kanë pasur dhe mos të ishte ndërhyrja e drejtorisë së Financave, plot prej mjeteve financiare do të na shkonin në suficit, për shkak të mungesës së planit të qartë të drejtorive përkatëse të disa shkollave. Arsimin ne e kemi prioritet dhe do ta përkrahim në cdo kohë në cdo aspekt. Dua të dal te propozimi i Defrimit, po, është e vërtetë që këtu kemi folur për masën e sigurisë që e ka aplikuar Gjykata Kushtetuese deri në fund të nëntorit. E para, e kemi një rend dite të miratuar, në të cilin është edhe ndryshim plotësimi i rregullores mbi tatimin në pronë. Do të flitet për norma tatimore dhe aty do të shihet që ne jemi në zbatim të plotë të ligjit të ri për faljen e tatimit në pronë. Pra, në zbatim të ligjit të ndryshuar e plotësuar në Kuvend të Kosovës e të sponsorizuar nga Ministria e Financave. Rendi i ditës ka kaluar, por, në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, neni 5 iu thotë komunave që falja ose jo, është në diskrecionin e tyre. Komuna jonë do ta akceptonte më mirë, në çoftëse Ministria e Financave do të na rimbursonte mjetet. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ka miratuar buxhetin për vitin 2024, parafytyroni në

çoftëse në 650.000€ do t'i propozonim për falje, atëherë çka do të bëhet me projektet e komunës dhe me strukturën e buxhetit të miratuar nga ky kuvend? Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë së Financave ka thënë që “mund” t’iu falni dhe jo domosdoshmërisht. Nëse ne i falim këto 100€ të gjitha kodet buxhetore preket, përveç kodit të pagave. Preken projektet dhe dëmtohet struktura e buxhetit. Janë 7808 vetë që në vitin 2024 kanë zero ngarkesë për tatim në pronë, 8202 vetë që janë tatim pagues me ngarkesë, nga të cilët nga 00.1€ - 1€ janë 334 persona, nga 1€ - 5€ janë 1094 tatimpagues, nga 5€ - 10€ janë 902 pagues, nga 10€ - 20€ janë 1562, mbi 20€ janë 4240 tatimpagues. Cila është logjika që 650.000€ t’ia humbim komunës, kur edhe ligji thotë që është në diskrecionin e komunës dhe kuvendit komunal. Unë dua komunë të fortë dhe të zhvilluar, nuk dua komunë që në emër të një pozicioni të mëshiruesit t’i humbim këto mjete. Ju e dini që subvencionet bëhen nga të hyrat dhe të hyrat kryesore me vlerë prej 890.000€, vijnë nga tatimi në pronë. Nëse minusohen 650.000€, atëherë më tregoni çka të bëjmë në vitin e ardhshëm? “E mbaj në mend kur më ka lagë shiu e jam bërë qull” e shumë prej shokëve të mi kanë vdekur nëpër burxhe e janë vrarë nëpër beteja, në mënyrë që qytetari të ketë “qadër”. Pra, nuk duhet të bëjmë gjestikulacione sikur po i dalim në ndihmë qytetarit për 5 ose 10€ dhe që mrenda vitit do t’i paguaj e në anën tjetër ta dëmtojmë strukturën e buxhetit dhe planet e komunës. Nuk e bëra për replikë dhe kjo nuk besoj që duhet të futet në rend të ditës, sepse kuvendi ka rregullore dhe tanimë rendi i ditës është miratuar. Për tatimin në pronë kur të doni ju, e mbajmë një seancë të jashtëzakonshme sepse jam i përgatitur “on top”, por jo të bëjmë kalkulime të ngushta zgjedhore në emër të qytetarëve.

Drilon Mustafa – Faleminderit kryesues! Përsëritet për Kryetarin Smajl Latifi, përsëritet drejtorët, kolegët, të gjithë të pranishëm. Në emër të fshatit Guri Kuq, e falenderoj kryetarin për investimet që po ndodhin atje, në infrastrukturë. Iliri më ka premtuar që do ta bëjë një video, duke menduar që nuk do të ndodhin ato investime, e ftoj që tani ta bëjë një gjë të tillë sepse është një pasqyrë e mirë për komunën edhe për të gjithë ne. Tjetër, e kam një kërkesë nga nxënësit e shkollave të mesme që vijnë në Gjakovë, për transportin që iu siguron komuna, por jo plotësisht. Kërkoj nga drejtori që ta rishikoj këtë kontratë në mënyrë që të gjithë nxënësit t’i sigurohet udhëtimi për në shkollë.

Burim Krasniqi – Një kërkesë për drejtorin e Financave! Drejtor, nëse ekziston mundësia, a mund ta kem një informatë të plotë mbi numrin e pensionerëve që presin për realizimin e tri pagave jubilarë? Sa është numri i tyre? Sa është vlera financiare dhe sa pritet të jetë në 2024?

Sinan Kryeziu – Faleminderit kryesues për mundësinë e fjalës! Në fshatin tim në Xërxë kam pasur një kërkesë emergjente. Banorët që e kanë parë parashikimin e motit dhe rreziku ka qenë i lartë për vërshime të mundshme, duke i përfshirë edhe shtëpiat banuese. Iu kam drejtorit Berat Duraku, i cili menjëherë më është përgjigjur në kërkesën time dhe publikisht dua ta falenderoj. Kërkoj nga kolegët e tij që ta marrin si model. Faleminderit Berat.

Defrim Kafexhiu – Faleminderit kryesues, edhe një herë të lutem që ta zbatoni rregulloren e kuvendit që gjithashtu ka dalur nga ky kuvend. Më pëlqen fakti dhe mënyra sesi po e udhëheq seancën, mirëpo, mënyrsa sesi ndikohesh nga kryetari është e padrejtë dhe raporti me anëtarët e kuvendit në këtë formë është i patolerueshëm! Kryetari foli shumë dhe gjatë, është gjëja më e mirë që kryetari po e bën, gjithashtu do të dëshiroja që kryetari të jetë i sqartë në atë që e thotë. Vetë fakti që foli shumë me të gjitha arsyetimet e tij, duke e fajësuar çdo operator dhe asnjëherë nuk e merr përgjegjësinë e një problemi që ndodh në komunë për projektet të cilat i udhëheq komuna. Përndryshe, kryetari po e jep arsyetimin e tij, duke thënë që 600.000€ po i humb komuna? Pse ky arsyetim kryetar? 600.000€ po i fitojnë qytetarët e komunës dhe vetë fakti që planifikimi i të hyrave është dyfish më i madh këtë vit kalendarik 2023, kurrfarë problemi nuk bën në të hyrat e komunës, por është vetëm një gjë që ti nuk dëshiron ta bësh dhe këtu qëndron problemi që po jep arsye jo të duhura dhe jo të nevojshme. Po ashtu, te çështja e Ilirit rreth “qadrës”, për këtë krenari unë ta zgjas dorën, besa edhe të përqafoj pak! Por, çdo kritikë që po e pranon si kryetar i komunës dhe si bartës i proceseve, po e

kthen te koha e luftës. Gjithashtu edhe une ndihem krenar që keni luftuar, por pasluftës si kryetari i komunës a keni krenari? Faleminderit!

Kryetari – Natyrisht unë vazhdimisht marr këshilla prej anëtarëve të kuvendit dhe për këtë arsye statusi i tyre është “këshilltar”. Relacionet ekzekutiv dhe kuvend i komunës, besoj janë të qarta. Asnjëherë nuk ushqehem me kranarinë e të kaluarës time, por, dikush është bërë si televizori i mëparshëm “bardh e zi” “që programi nuk iu hapke asnjëherë, e kur u mundonim ta hapnim ekranin, e dogosnim me grusht” dhe u detyrova t’i tregoj. Së pari unë jam krenar që jam shqiptar! Qytetari më ka veshur me mandat, më ka dhënë besim dhe përgjegjësi. Ai që i fiton zgjedhjet, e justifikon mandatin e vet, sa për arsyetime a jam duke e fajsuar apo jo dikë, të gjitha janë të ndërlidhura me operatorë. Unë nuk e akuzoj askënd, jam i detyruar të jap shpjegime anëtarëve të kuvendit, të gjithë atyre që pyesin, madje edhe atyre që i kanë nga 200 vota. A kam krenari pas luftës? Ndihej shumë mirë që, pas një lufte një vjeçare 1 063 000€ qeveria e Kosovës i ka ndarë për kompenzimin e dëmeve, në bujqësi 82% dhe ju e dini që shumë komuna janë tërhequr nga kërkesa për një kompenzim të tillë për shkak të komplikimeve që i kanë krijuar me udhëzime administrative. Unë jam krenar çdo ditë sepse çdo ditë punojmë dhe sepse çdo ditë ka sfida, gjithashtu çështjen e patriotizmit dhe të qeverisjes me etapa. Është mirë me qenë krenar për të kaluarën dhe është mirë që këtë krenari ta ushqejmë me veprime të përgjithshme deri sa të jemi gjallë. Ti e përmende luftën, por ka njerëz që më së paku kanë pasur lidhje me luftë, e dëshirojnë t’i përvetësojnë ato vlera. Kurrë nuk kam kërkuar besim të qytetarëve duke e përmendur luftën dhe as që do ta bëj. Ai që nuk ka të sotme edhe të ardhme, thirret në të kaluarën. Unë kam pasur krenari, kam edhe sot dhe do të kem edhe nesër kudo që jam. Në fund, nuk jam i interesuar të bëj eksperimente me qytetarë sepse ligji thotë që secila komunë e ka nën diskrecionin e saj. Nuk është mirë që askush të shet “tullum” e kinse dikush i donë qytetarët më shumë e dikush më pak, të gjithë jemi përfaqësues të qytetarëve me kapacitetet e tyre. Kërkoj që kjo foltore mos të shfrytëzohet për nevoja të konsumit ditor politik dhe e ftoj kryesuesit ta zbatojë rregulloren e punës ndaj meje dhe ndaj secilit.

Ilir Pallqa – Faleminderit! Për rrugët e sapo ndërtuara që po prishen, a jeni në kontakt me KRU Gjakovën, me Ipkon, Kedsin? Këto punë duhet të kryhen paraprakisht, përndryshe paratë hargjohen dëm. Te bimët e mbjellura, kryetar, ti the që 80% janë zhvilluar dhe 20 ndoshta janë tharë. Unë nuk fola për zhvillimin ose jo të bimëve, bimët 50% nuk janë mbjellur hiç dhe brenda atyre 50%, 30% janë zhvilluar dhe 20% jo. Te avokatura e komunës, unë nuk e di, por Sinani ka thënë që kontestet paraprakisht janë të humbura dhe cilat janë lëndët e fituara dhe ato lëndë a mund t’i fitojë edhe një zyrtar ligjor? Te tregu, e kam edhe një propozim, pse nuk e bëni tregun te stacioni i autobusëve sepse aty te ai parkingu “dorën në zemër” nuk e parkon veturën askush. Do të ishte mirë sepse gjithashtu të shtunën është ditë pushimi. Rreth mungesës së trotuareve te rr “Gëzim Hamza” nuk keni kthyer përgjigje? Te rendi i ditës the që mas miratimit nuk bën të bëjmë propozime, kjo është praktikë që ju vetë e keni bërë. Faleminderit shumë.

Kryetari – Faleminderit kryesues! 909.000€ janë shpëtuar në favor të komunës si rezultat i avokatit dhe ky është thelbi i angazhimit të avokatit nga jashtë. Kjo nuk do të ishte e mundur të realizohet nga zyrtarët ligjorë, për shkak të përditshmërisë që i kanë. Te trotuari në rrugën “Gëzim Hamza”, ne jemi duke punuar aty në një kanal të ujërave dhe gjatë procesit do të mundohemi të sigurojmë trotuar, është mjaftë vështirë sepse janë prona private. Te raporti i drunjve dekorues, e keni keqlexuar sepse të ofrojnë fakte rreth kësaj edhe Urbanizmi edhe drejtorja e Shërbimeve Publike. Sa i përket praktikave në kuvend, vetëm nëse është interesi i përgjithshëm duhet patjetër të thërras seanca urgjente dhe nuk vlerësoj që është interes i përgjithshëm që pas miratimit të rendi të ditës të futet në rend dite gjesti i kinse faljes të tatimit në pronë dej 100€ për një vit. Kur të dalim te pika e ndryshim plotësimin të rregullores së tatimit mbi pronën dhe normave tatimore, aty do ta shihni se si i ndihmohet qytetarëve!

Leonard Morina – Faleminderit kryesues! Përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, drejtorët, të pranishmit. Në seancën e kaluar i kam pasur dy pyetje për Drejtorinë e Arsimit, e para ka qenë se çka po ndodh me ndërtimin e çerdheve që lidhet me Ministrinë e Arsimit, sepse në qytet tjera kanë filluar të ndërtohen. E dyta, çka po bën Drejtoria e Arsimit për mungesën e kuadrove që e posedon në profile të ndryshme? E kam edhe një pyetje tjetër, Xhevahire Hajda po e akuzon Drejtorinë e Arsimit për mospagesë gjatë angazhimit të saj në kohën e pandemisë, rasti është në gjykatë, gjithashtu nëse ka mundësi një sqarim rreth kësaj. Nëse nuk do të ketë përgjigje për këto tri pyetje, në seancën e radhës do ta bëj një pyetje tjetër rreth e-mailave që drejtor i arsimit ia dërgon kandidatëve që aplikojnë nëpër konkurse. Jam shumë kureshtar të jem në dijeni se çka përmbajnë ato e-maila. Faleminderit!

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim paraprak të pronës së paluajtshme komunale, P-01057-2, ZK-Xërxë, personave fizikë dhe juridikë dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër 1-15 vjet;

Erhan Morina – Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit, medie dhe ju të pranishëm. Para jush keni propozim vendimin për dhënien në shfrytëzim të dy parcelave që gjenden në zonën kadastrale në Xërxë. Bëhet fjalë për P-01057-2, në vendin e quajtur “Skaja” me kulturë të klasit të dytë me sipërfaqe të përgjithshme 571m² (pronë e komunës). Parcela tjetër me nr. P-01043-1 në të njëjtin vend me kulturë të klasit të tretë me sipërfaqe 1000m të ndarë nga sipërfaqja e përgjithshme 5016m. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim është zhvillimi i aktivitetit biznesor.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! A kemi diskutim rreth kësaj pike? Nëse jo, atëherë kalojmë në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash votohet kjo pikë e rendit të ditës. Me lejen tuaj, vazhdojmë me pikën e fundit që e shtuam në rend dite si pikë shtesë, sepse lidhet me pikën paraprake.

11. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlersimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

Erhan Morina – Faleminderit kryesues! Kjo pikë ndërlidhet me pikën e tretë të rendit të ditës që e prezantova më parë. Ka të bëjë me ndjekjen e procedurave për dhënien në shfrytëzim, duke e formuar komisionin prej 5 anëtarëve, dy prej tyre nga ekzekutivi, dy nga legjislativi dhe një nga shoqëria civile.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! Atëherë në përberje duhet të kemi një komision prej pesë vetash. Fillimisht nga ekzekutivi i komunës janë përcaktuar Berat Duraku dhe Besmire Bytyqi, ftoj shefat e grupeve për propozime!

Hasan Përboqi – AAK, propozojmë asambleistin Feriz Thaqi!

Leonard Morina – LVV, nuk kemi propozim!

Burim Krasniqi – LDK, propozojmë Faton Ramadanin!

Sejfullah Sejfullahu – PDK, nuk kemi propozim!

Kryesuesi – Atëherë e kalojmë në votim këtë komision me përbërje Berat Duraku dhe Besmire Bytyqi nga ekzekutivi, ndërsa nga kuvendi Feriz Thaqi dhe Faton Ramadani! Kush është “për”? Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash votohet komisioni. Me lejen e anëtarëve të kuvendit që pika e 4,5,6,7,8 të prezantohen të njëjtën kohë nga drejtori për Gjeodezi dhe Kadastër zt. Afrim Oruqi.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-71510057-01728-1, ZK-Rahovec;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues! Të nderuar kuvendarë sipas ligjeve në fuqi, kryetari i komunës ju propozon vendimin për shpallje me interes të përgjithshëm P- 1728-1. Kërkoj prej Sekretariatit që ta bëjë një përmirësim në vendim sepse bëhet fjalë për 9m² jo për 12m² dhe gjithashtu të qëllimi i shpalljes ka të bëjë me shpronësim dhe jo këmbim. Qëllimi është vendosja e trafos elektrike në zonën kadastrale në Rahovec. Prona është private në emër të Agim Xhafer Kastratit.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-71510057-02240-1, ZK-Rahovec;

Afrim Oruqi – Kjo parcelë është në dalje të Rahovecit në rrugën Rahovec – Malishevë. Bëhet fjalë për tre hektarë në anën e djathtë të rrugës, ku aktualisht ajo hapësirë po gjelbërohet e që më herët është përdorur për mbeturina të ngurta. Qëllimi i këtij interesi të përgjithshëm është këmbimi i pronës komunale me pronën e institucionit qendror (Agjencioni Pyjor i Kosovës).

6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-71510057-01422-1, ZK-Rahovec;

Afrim Oruqi – Bëhet fjalë për parcelën me sipërfaqe të përgjithshme 6 ari e 79m² dhe ne kërkojmë që ta shpallim në interes të përgjithshëm vetëm 1 ari e 32m², konkretisht gjendet përrreth parcelave ku po zbatohet projekti i sheshit qendror të qytetit, me qëllim të funksionalizimit të projektit.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-71510033-00550-2, ZK-Xërxë;

Afrim Oruqi – Parcela me numër 550-2, sipas certifikatës së pronësisë 1 ari, mirëpo ne po shpallim me interes të përgjithshëm 42m² të kësaj sipërfaqe, e cila është në emër të familjes Sinani. Qëllimi është zgjerimi i rrugës publike.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik, pjesën e parcelës P-00386-1, ZK-Pastaselë;

Afrim Oruqi – Parcela është nën menaxhimin e Agjencionit Pyjor të Kosovës, ne po shpallim me interes të përgjithshëm 2ha, 20 ari e 5m² që aktualisht është shkolla fillore e mesme e ulët në Pastaselë. Qëllimi i këtij interesi të përgjithshëm është që t'i vazhdojmë procedurat për këmbim, pronën ta bëjmë komunale dhe ta kompletojmë projektin e shkollës që do të fillojë së shpejti në pronë komunale. Ju ftoj që t'i votoni pikat veç e veç!

Defrim Kafexhiu – Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë, drejtorë. Te pika e katërt për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-1728-1 në zonën kadastrale në Rahovec, për çështjen e trafos elektrike, e përgëzoj ekzekutivin për iniciativën dhe shpresoj që procedurat të finalizohen deri në fund sepse kjo lagje ka nevojë shumë për këtë trafo elektrike.

Hasan Përboqi – Përsëndetja kryesues, kryetar, nënkryetar, asambleistë, drejtorë, medie dhe qytetarë. Te pika e katërt që ka të bëjë rreth vendosjes së trafos elektrike në rrugën “Vëllezërit Frashëri”. Në emër të grupit të asambleistëve të aleancës e përsëndesim këtë iniciativë, ky është vetëm hapi i parë në drejtim të zgjidhjes të problemeve me energji elektrike në atë lagje. Ne si grup i themi kryetarit që vazhdo t'i qëndrosh afër banorëve, konkretisht të lagjes “Vëllezërit Frashëri” fillimisht me hapjen e rrugës, në rregullimin dhe zgjerimin e kanalizimit dhe tani me vendosjen e trafos. Gjithashtu dëshirojmë ta falenderojmë edhe zt. Agim Kastratin për vullnetin e shprehur që t'i ofrojë qytetarëve një zgjidhje përfundimtare për vendosje të trafës sepse dihet që një kohë e gjatë problemi i vetëm ka qenë mangesa e pronës. Gjithashtu, kërkojmë që edhe zyrtarët përgjegjës në KEDS të bëjnë zgjidhje sa më të shpejtë.

Kryesuesi – Faleminderit, nëse nuk kemi diskutime të tjera, atëherë pikën e 4 e kalojmë në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash votohet kjo pike e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e 5-të, nëse nuk kemi diskutim, e kalojmë në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash votohet edhe kjo pike. Vazhdojmë me pikën e 6-të, a kemi diskutim?...

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues! Drejtor, provova ta shoh përrocken në gjeoportali, mirëpo me këtë numër vërehet vetëm pjesa te shpija që është mbi rrugën e pazarit dhe jo pjesa tjetër që i bie nëpër shesh. Është gabim numri apo gjeoportali?

Afrim Oruqi – Numri është mirë, bëhet fjalë pikërisht për atë parcelë e cila shtrihet prej Raiffaisenit deri te hotel “Plaza”, mirëpo ne po e shpallim me inters të përgjithshëm gjysmën e këtij kanali prej objektit të familjes Bytyqi deri te hotel “Plaza” me sipërfaqe 1 ari e 2m. Pjesa tjetër prej paraluftës është e uzurpuar me banim privat. Një gjeodet për shkak të sistemit nëse është duke punuar në atë zonë, nuk e jep numrin e saktë sepse 24 orë i duhet sistemit për ta aprovuar ndryshimin e punës të bërë në atë zonë.

Kryesuesi – Faleminderit! Nëse nuk kemi diskutime më, e kalojmë në votim pikën e 6-të! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë me shumicë votash, votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e 7-të, nëse nuk kemi diskutim, atëherë kalojmë në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash, votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e 8-të, diskutimi është i hapur!

Burim Krasniqi – Shkolla fillore në Pastasel, a është tenderuar ndonjëherë po t’u ndërtuar, nëse po, ku ka mbetë si procedurë?

Avni Morina – Përshëndetje për të gjithë! Ju informoj që për shkollën në Pastasel është lidhur kontrata nga Ministria e Arsimit. Projektimi i projektit është bërë nga disa inxhinier të kompanisë që e kanë fituar projektin. Pas kësaj, i kanë bërë disa analiza të dheut (gjeomekanike) dhe presim që të fillojë gurëthemeli.

Ilir Pallqa – Faleminderit! Në Brestoc, rruga “Shotë Galica” ka probleme me kanalizim, duhet të merrni masa për këtë punë, apo?

Kryetari – Edhe kontrata për qerdhe edhe për shkollën fillore në Pastasel është nënshkruar, punimet ende nuk kanë filluar dhe shpresoj që edhe këto para të barten për vitin e ardhshëm dhe të fillojnë punimet.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar! Asambleistit Ilir Pallqa i kërkoj seriozitet në seancën! Nëse nuk kemi diskutime të tjera, kalojmë në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Pika e tetë e rendit të ditës votohet me një vote kundër dhe të tjerat pro.

9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për caktimin e normës tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2024;

Afrim Limani – Të nderuar kuvendarë edhe pse kryetari e elaborojë mjaftë mirë normën tatimore dhe efektin e tatimi në pronë në të hyrat vetanake të komunës, unë do t’i shtoj edhe analiza plotësuese që i kemi bërë si drejtori e Financave (Sektori i Tatimit në Pronë). Plotësim ndryshimi i ligjit të tatimit në pronë 06L 005 ka prodhuar edhe dy efekte në tatim, pse? Efekti i parë qëndron në atë që zbritet koeficienti më i ulët nga 0.15% në 0.10% dhe efekti i dytë është ngritja e vlerës për banim primar nga 15.000 në 30.000. Efekti i dytë i ka eliminuar edhe shumë tatim pagues me zero%. Para jush e keni një mostër, dy objekte me m², një objekt 150€, objekti i dytë 200€. Përveç zona e parë që e ka një ngritje simbolike 4.5%, të gjitha zonat tjera kanë zbritje, gjithmonë duke e krahasur me vitin 2022 dhe jo 2023. Efekti i kësaj zbritje të bërë në total është 230.000€ (40%). Sipas shënimeve të vitit 2023, ne i kemi 16.000 tatimpagues, prej tyre për vitin 2024, 7808 tatohen me zero 5% ngarkesë, nga 0.01-1€ i kemi 334, nga 1-5€ janë 1094, 5-10€ janë 992, 10-20€ 1562 dhe mbi 20€ janë 4220 tatimpagues. Defrim, të them të drejtën unë si drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, paksa jam në pozit të sikletshme sepse sikur ky propozimi yt të kishte dalur para planifikimit dhe votimit të buxhetit, do të isha më komod sepse do ta kishim pasur një orientim të qartë. Sipas ligjit pagesa e subvencioneve bëhet nga pjesa e të hyrave vetanake, e që ne i kemi 890.000€ vetëm nga nga tatimi në pronë. Për fund, ju lutem që t’i votoni këto norma tatimore në mënyrë që të kemi një stabilitet financiar për vitin e ardhshëm.

Kryetari – Prita prej drejtorit Afrim t’i spjegojë efektet e ndryshim plotësimeve të normës tatimore, e jo ta reciklojë debatin e hargjuar më herët. Më intereson p.sh. në zonën 1601 sa ka paguar dhe sa është rritja apo zbritja në 2022, sa 2023 dhe 2024? Po ashtu 1602 sa ka paguar në këtë tri vite, në zonën 1603, 1604, 1605, 1606. Në të gjitha këto zona të përmendura, përveç në zonën 1601 që për 4.5€ shtohen, në krahasim me vitin 2022, në të gjitha zonët tjera ka zvogëlim në pagesa ose ulje të pagësës mbi tatimin në pronë në krahasim me

vitin 2022 dhe 2023. Ky është shërbimi më i mirë që i bëhet qytetarëve të komunës përmes rregullimit, përkatësisht ndryshimit të normës tatimore dhe këtë shërbim kuvendi i komunës e ka në dorë.

Defrim Kafexhiu – Përshëndetje edhe një herë për të gjithë! Faleminderit drejtor për sqarimet, por te normat tatimore (për vendimin që e kemi marr si kuvend komunal në vitin e kaluar), ndryshojnë vetëm te njësitë rezidenciale të parcelave dhe te objektet, te objektet rritet 3%, te njësitë rezidenciale të parcelës ulët 0.3%. Edhe diçka tjetër, që ky plotësim ndryshim i ligjit për tatimin në pronë edhe i kuvendit të Kosovës dhe duhet të përshëndetet edhe prej kryetarit të komunës sepse së fundi i ka dhënë shumë kritika, që fillimisht duke menduar që tatimi për qytetarët po rritet dhe realisht tani po del që Ministria e Fiancave dhe Kuvendi i Kosovës po e zvogëlojnë tatimin në pronë për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Kryetari – E lus drejtorin e Financave për shpjegim dhe unë mbes prapa qëndrimeve që i kam thënë në kuvend. Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës nuk e kanë zvogëluar normën tatimore, komunat e kanë në diskrecion. Me ndryshimin e normës tatimore po e mundësojmë zvogëlimin e vlerës financiare për tatimpaguesit e tatimit mbi pronë. Atëherë kemi bërë zhurmë sepse me të vërtetë është rritur, duke u bërë rivlerësimi i pronës që është normale dhe ka qenë legjitime, mirëpo qytetarët e komunave kanë vrapuar t'i shlyejnë obligimet më shpejtë, duke u frikësuar për dyfishim të tatimit në pronë. Ne, me ndryshim plotësimin e rregullores e kemi rregulluar normën tatimore në atë mënyrë që qytetarëve t'ju bie më pak dhe gjithçka në pajtim me ligjin.

Burim Krasniqi – E kërkoj mirëkuptimin e ekzekutivit edhe të asamblesë që nuk jemi këtu ta luajmë rolin të pozitës ose opozitës të qeverisë, por jemi si asambleistë dhe mendoj që ekzekutivi duhet të jetë sa më shumë në harmoni me qeverinë për të thithur sa më shumë fonde që ekziston mundësia. Drejtor, dua të ndalem te norma tatimore, sipas plotësim ndryshimit të ligjit varion nga 0.1-1, ne jemi mbi minimumin varësisht prej pozicioneve dhe kjo nënkupton që Komuna e Rahovecit mund të shkojë edhe te 0.1% (minimumi i asaj që e lejon ligji). Fillimisht rekomandoj që norma tatimore të zbritet në minimumin e mundshëm 0.1%. E dyta, në bazë të tabelave të vlerësimit të parcelave të paraqitura, te pjesa e shtëpive të banimit, zona e parë ka një rritje te objektet 200kuadrat për 17€, 150 kuadrat 4€, rritjen gjithmonë e them duke u krahasuar me vitin 2022 sepse 2023-ta ka qenë specifike. D.m.th zona e parë që e përfshin qytetin e Rahovecit ka një rritje të tatimit në pronë për shtëpija. Te parcelat, te të gjitha zonat ka rritje. Te zona e parë te pllacet, te njësitë rezidenciale të parcelave që e ka 0.13%, te ato që janë 500m² në 2024 ka një rritje prej 21€ në raport me 2022, është fakt që ka një zbritje prej 15€ në raport me 2023, por 2022 në raport me 2024 kemi rritje prej 21€ te zona e parë, te zona e dytë rritje prej 20€, te zona e tretë 0.25cent, te zona e katërt rritja është 2.1€, te zona e pestë 5.25€ dhe te zona e gjashtë rritja është 1€. Kjo nënkupton që shtëpitë kanë një rritje prej 17€, ndërsa te parcelat rezidenciale, oborret kanë rritje të gjitha zonat. Rekomandoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e radhës, të shihet një formë variable e tatimit dhe e dyta, që tatimet në njësi rezidenciale të bie në atë % që ka qenë në vitin 2022. Ne si LDK propozojmë që norma tatimore të jetë 0.1% e bazës të pronave.

Afrim Limani – Në fillim thash që ky plotësim ndryshim i ligjit ka prodhuar dy efekte, efekti i parë qëndron në atë që zbritet koeficienti më i ulët nga 0.15% në 0.10% dhe efekti i dytë është ngritja e vlerës së zbritjes për banim primar nga 15.000 në 30.000. Efekti i dytë neve na ka detyruar të bëjmë analiza dhe të vijmë te një përfundim më i mirë për qytetarin. Në fillim nuk e prezantova këtë tabelar, duke menduar që ju e keni lexuar. Në krahasim me vitin 2023 ka zbritje në të gjitha zonat, që i bie 230.000€ zbritje.

Burim Krasniqi – Drejtor, konsideroj që është diskriminuese që në një zonë mos të rritet tatimi në pronë dhe në një zonë të hiqet total. Mendoj që tatimi në pronë mund të jetë variabil varësisht prej zonave.

Afrim Limani – Këtë gjë nuk e lejon ligji sepse një koeficient vlenë për të gjitha zonat.

Burim Krasniqi – Nuk ka logjikë që dikush të paguaj më shumë, e dikush hiq.

Afrim Limani – Ne e kemi bërë një analizë të mirë, një kohë të gjatë kemi punuar në këtë drejtim dhe kemi ardhur në përfundim që t'i caktojmë këto norma tatimore, që e bëjnë këtë zbritje të mjaftueshme. Propozoj t'i votoni këto norma.

Kryetari – E dëgjova Burimin që tha këtë pikë ta shtyejmë për një seancë tjetër. Zakonisht këto ndryshim plotësime janë bërë në tetor, ligji është në fuqi dhe ndoshta mund të jemi ndër komunat e para që i diskutojmë këto ndryshim plotësime mbi tatimin në pronë dhe të normës tatimore. Ata që e kanë deri në 100m² dhe nën kësaj, nuk paguajnë hiq sepse kështu ligji e thotë. Nga 16.000 tatimpagues, sipas ligjit, kanë mbetur vetëm 8202 tatimpagues që duhet ta paguajnë tatimin nga viti i ardhshëm, më lirë sesa në këtë vit. Këtu ka zbritje në të gjitha zonat, ne mund ta bëjmë edhe 0.1%, por të hyrat nga tatimi në pronë mbesin 200.000€, rrezikohet baza e të hyrave komunale. Është mirë mos të kalojmë në ekstreme sepse aty nuk fiton askush asgjë, humb vetëm qytetari. Burim, të kuptova me vëmendje për atë që fole dhe të ftoj për mirëkuptim.

Hasani Përboqi – Faleminderit kryesues! Drejtor, një falënderim të madh për raportin si material për këtë pikë. Ata që kanë dashur ta lexojnë, materiali është shumë i thjeshtëzuar. Te tabela e parë (parcelë individuale) – 2022/2023 ka qenë 0.16%, propozohet në asamble që në vitin 2024 të jetë 0.13%, d.m.th po zbritet! Te tabelare për 500m², vlera për m² ka qenë 55€, në 2023 për shkak të rivlerësimit nga Ministria e Financave, prej 55€ është bërë 100€. Në 2024 përsëri vazhdon 100€, d.m.th kjo nuk është shkaku i normës tatimore që ne po e votojmë si asamble, por, është shkaku i rivlerësimit që e ka bërë Ministria e Financave, duke e ngritur vlerën e metër katrorit (m²). Ne, me zvogëlimin e normës tatimore prej 0.16 në 0.13%, prapë ndikon që kjo ngritje prej 2022 të jetë më e butë, kurse në raport me 2023 ka zvogëlim. Tjetra, është e vertetë që mund të kërkonim që normën tatimore ta zvogëlojmë ende më shumë, prej 0.13% ta zbresim deri në 0.1%, por me çka t'i subvencionojmë klubet sportive, duke e ditur që subvencionet realizohen prej të hyrave vetanake. Nëse ndodh kjo, e di që çdo asambleist në 2024 do ta kritikojë kryetarin për subvencionimin e paktë në sport. Për këtë arsye, kërkoj nga asambleistat t'i përkrahni këto norma të ulta tatimore.

Ilir Pallqa – Faleminderit kryesues! Ministria e ka përcaktuar normën minimale a po?... Pastaj, ne mund ta rrisim normën sa e shohim të arsyeshme. Për derisa kemi inflacion, a nuk vjen si rrjedhojë rritja e normës? Përderisa është rritur edhe vlera e pronës? Apo jo? Sepse logjika ime e kupton kështu, a ka ndonjë ekonomist për elaborim? Ose unë jam shumë i padijshëm, ose po bëjmë shumë politikë!

Defrim Kafexhiu – Faleminderit kryesues! Dikush kërkon ta ulë, e dikush ta ngritë! Më pëlqen si mënyra e debatit sesi po bëhet. Prezantimin që e ka bërë fillimisht drejtori i Financave besoj që ka qenë më korrekti, Shefi i grupit të Aleancë, Hasani, e ka plotësuar pak. Kryetarit, nëse ka vullnet, ia propozoj që Afrim Limanin ta tërheq prej drejtorisë së Financave dhe ta vendosë Hasanin si drejtor.

Kryetari – Në mandatin e ardhshëm në qeveri, Hasani do të jetë Ministër i Financave!

Burim Krasniqi – Kryesues, kërkoj falje por ndoshta pa vullnetin tonë, ndonjëherë duhet ta shkelim rregulloren për shkak të qëllimit. Është fakt që rritja e bazës tatimore e ka rritë edhe vlerën e tatimit në pronë. Fakti i dytë është që me plotësim ndryshimin e ligjit, prej normës tatimore minimale që ka qenë 0.15% është bërë 0.1%. Ne po e votojmë sot, por sa është vlera e njësive bujqësore (në parcela bujqësore, objekte bujqësore) që nuk e kemi hiq askund. Sa do të jetë norma tatimore për pyje dhe ara? Sa është vlera e pronës për njësi komerciale dhe parcela komerciale, që sot, këtë informatë nuk e kemi këtu. Sa do të jetë norma për objekte industriale dhe parcela industriale? Kërkoj mirëkuptimin që këtë pikë ta shtyejmë dhe në seancën tjetër ta kemi materialin e plotë me të gjitha të dhënat edhe për këto 7 njësi të tjera që i përmenda.

Afrim Limani – Burim, në fillim e përmenda që plotësim ndryshimi i ligjit ka të bëjë me pronat rezidenciale, parcelat dhe pronat komerciale. Për pronat bujqësore ende nuk e kemi asnjë njoftim zyrtar nga Departamenti i Tatimit në Pronë. Për pronat tjera ende nuk është bërë vlerësimi, në momentin që bëhet, ne e vendosim përsëri. Sot po flasim për dy lloj pronash, pronat rezidenciale dhe parcelat!

Kryetari – The që LDK nuk voton verbërisht, as unë nuk votoj ashtu. Pra, ne po flasim sot për dy lloj pronash. Mund të tatimohen ose vlerësohen edhe pronat bujqësore, pyjore dhe të tjera, por, përsëri duhet të kalojnë në kuvend. Çdo vit kemi për detyrë ta bëjmë ndryshim plotësimin e Rregullores mbi Tatimin në Pronë dhe çdo vit kemi të drejtë ta bëjmë edhe ndryshim plotësimin e normave tatimore. Pra, sot votojmë për ndryshim plotësimin për dy lloj të pronave dhe është dokument mjaftë i rëndësishëm që duhet të hyj në fuqi nga janari 2024.

Sa i përket propozimit të mëhershëm të Burimit, e gjetëm një propozim me 0.12%. Le të vendoset në votim sepse kjo përqindje nuk krijon probleme sepse është në harmoni me kuvendin. Sa i përket Ilirit në pyetjen e tij, nëse i lejojmë që normat tatimore të jenë të larta, rritja e çmimeve dhe mosrritja e pagave ndikon në rritjen e pagesës. Me zbritjen e normave tatimore, kontribuojmë që qytetari jonë në këtë krizë ekonomike t'i perballojë më lehtë obligimet ndaj shtetit.

Kryesuesi – Atëherë, fillimisht propozimin e Burim Krasniqit për njësitë rezidenciale nga 0.13% në 0.12% e vendosim në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me 21 vota pro, 1 abstenim, asnjë kundër, kalon propozimi i Burim Krasniqit. Pikën e 9-të e kalojmë në votim, ! kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me 20 vota pro, një abstenim dhe asnjë kundër, kalon pika e nëntë e rendit të ditës.

10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për miratimin e Raportit të Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera;

Besmire Bytyqi – Faleminderit kryesues! Të nderuar kuvendarë, në e-maillet e juaja e keni pranuar raportin e përgatitur nga Komisioni Komunal për Vlerësimin e Dëmeve të shkaktuara si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera. Ky raport është për muajin qershor-korrik (16.06, 01.07 dhe 01.07.2023) ku komuna jonë është goditur nga fatkeqësitë natyrore. Në bazë të vendimit të kryetarit të komunës, komisioni i formuar për vlerësimin e dëmeve me nr. protokolli 178 të datës 15.02.2023, ka shqyrtuar të gjitha kërkesat e parashtruara nga qytetarët. Të parashtruara kanë qenë 427 kërkesa, 235 prej tyre janë të aprovuara me vlerë 661.000€ dhe 179 prej tyre janë refuzuar. Në fshatin Brestoc dëmet janë shkaktuar në amvisëri, ku si pasojë reshjeve të shumta dhe vërshimeve kanë parashtruar 8 persona kërkesa me vlerë 15.559€. Pas miratimit nga kuvendi komunal, i njejtë raport do t'i dërgohet komisionit të AME-së për procedurat tjera.

Burim Krasniqi – Meqenëse është raport që e don votën e asamblesë komunale, në KPF kemi kërkuar që ta kemi një informatë mbi refuzimin e 179 kërkesave, nuk e kemi pranuar një gjë të tillë.

Veton Mustafa - Përshëndetje për të gjithë! Kryetari i komunës e ka formuar një nënkomision për vlerësimet natyrore që janë shkaktuar nga breshëri, vërshimet dhe erërat e forta. Prej 427 kërkesave që i kemi pranuar në adresën e drejtorisë së Bujqësisë, 179 janë refuzuar, 235 kanë kaluar. Refuzimet kanë ardhur sepse te vreshtat para se të ndodh breshëri, së pari ka ndodhur vrugu (bastra në vreshta dhe lagështia te lloji i specit). Në bazë të vendimit, këta fermerë nuk kemi pasur mundësi për vlerësim, përpos atyre që kanë pasur vërshime të forta.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues! Po, unë edhe në seancën paraprake e kam ngritur një shqetësim të qytetarëve të fshatit Hoçë e Vogël. Nga drejtori kam kërkuar sqarime për dëmet e shkaktuara nga breshëri, për disa vreshtarë është aprovuar, për disa të tjerë jo! Për të njëjtin lokacion, njëri është vlerësuar që ka breshër, e tjetri jo! Kërkoj sqarime!

Veton Mustafa – Ne si komisioni kemi dalur në terren në Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagac, Krushë të Madhe dhe te të gjithë parashtruesit e kërkesave. E ceka edhe më herët, nëse një fermer është dëmtuar për shkak të vrugut, komisioni nuk ka pasur mundësi vlerësimi sepse aty nuk ka frut. Në komunën tonë së pari ka ndodhur sëmundja e bastrës, më pas ka ra breshër. Ka rastis edhe me ata fermerë që i kanë parcelat afër me njëra tjetër sepse ka prej tyre që e kanë trajtuar vreshtin me kohë për ta mbrojtur.

Lirigzon Kastrati – I nderuar anëtar i komisionit. Fruti i vreshtit ka qenë i punuar dhe ka qenë frut, prej breshërit fruti është dëmtuar gjithashtu edhe bujku. Kur të vjen në Hoçë mund të shkojmë për vizitë te bujku i dëmtuar, i cili me përkushtim i ka punuar vreshtat.

Veton Mustafa – Si frut, pothuajse 70% janë prish me bastër. Faleminderit.

Kryetari – Komisionin e kemi formuar me udhëzim administrativ. Sot kuvendi është karakterizuar nga një joseriozitet. E ftoj kryesuesin për të mbajtur më shumë disiplinë dhe ta zbatoj rregulloren. Sa i përket bastrës, njoh shumë pak vreshtar në Rahovec që kanë arritur t’i mbrojnë vreshtat nga kjo sëmundje. Ndoshta baca Isuf po, është rekord në komunën tonë. Plot janë zanatli në Zoqisht, por, as Mejdi Kabashi nuk ka mundur t’i ruaj. Pra, ju lutem, komisioni nuk bëjnë hile!

Burim Krasniqi – Është një fenomen që ndoshta nuk di t’i jap definicion, te rasti i tokave rreth Sillosit dhe te pjesa e Celinës në mes binarëve të trenit. Aty kur ka reshje ka gjithashtu përmbytje, nuk është vërshim! Nuk e di pse nuk janë trajtuar si të pëmbytura. Nuk e kontestoj askush punën e komisionit, por një anëtar i komisionit në foltore të thotë është e “pavërtetë”, nuk është logjike!

Kryesuesi – Faleminderit! Në qoftëse nuk kemi diskutime të tjera, atëherë e kalojmë në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht votohet pika edhe pika e fundit. Ju falimderit të gjithëve, shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

K R Y E S U E S I

Arbër Zenuni



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Raport për zbatimin e Planit të Integritetit në Komunën e Rahovecit

Rahovec, 2023

Përmbajtja:

HYRJE	3
I. Fushat e përgjithshme të rrezikut.....	4
1.1. Fusha e rrezikut: Menaxhimi	4
1.2. Fusha e rrezikut: Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve	5
1.3. Fusha e rrezikut: Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit dhe financave	7
1.4. Fusha e rrezikut: Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumentacionit	8
II. Fushat e veçanta të rrezikut	9
2.1. Fusha e rrezikut: Auditimi i Brendshëm.....	9
2.2. Fusha e rrezikut: Prokurimi Publik	10
2.3. Fusha e rrezikut: Zhvillimi Ekonomik Lokal	10
2.4. Fusha e rrezikut: Planifikimi Urban dhe Rural	11
2.5. Fusha e rrezikut: Standardet e Ndërtimit dhe Kontrolli	12
2.6. Fusha e rrezikut: Inspektimet	12
2.7. Fusha e rrezikut: Arsimi Publik.....	13
2.8. Fusha e rrezikut: Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	14
2.9. Fusha e rrezikut: Shërbimet Publike dhe Licencimi i Tyre	14
2.10. Fusha e rrezikut: Komunikimi me Palë të Jashtme të Interesit	15
2.11. Fusha e rrezikut: Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë	16
2.12. Fusha e rrezikut: Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport	16
2.13. Fusha e rrezikut: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	17

HYRJE

Komuna e Rahovecit, konform mandatit ligjor që ka dhe planit vjetor të punës për vitin 2023 ka paraparë që të harton edhe raportin për zbatimin e Planit të Integritetit të Komunës.

Plani i Integritetit është monitoruar nga koordinatori për monitorimin e zbatimit të tij dhe përfshinë të gjitha veprimet të cilat janë të pasqyruara në kuadër të këtij plani, si dhe informatat të cilat janë dhënë nga drejtorit, sektorët. Me qëllim të monitorimit të tij dhe analizës së zbatimit të masave/veprimeve, është hartuar raporti për periudhën janar - dhjetor 2023.

Raporti përfshinë periudhën janar - dhjetor, 2023 dhe përfshinë veprimet e ndërmarra në kuadër të fushave: **a).** fushave të përgjithshme të rrezikut dhe **b).** fushave të veçanta të rrezikut, të cilat janë vendosura në planin për Integritet. Andaj, edhe raporti është realizuar përmes informatave plotësuese nga ana e drejtorive. Mbi bazën e këtyre informatave, është arritur që të analizohet dhe vlerësohet gjendja aktuale e zbatimit të masave/veprimeve nga plani i veprimit.

Metodologjia e përdorur, gjatë monitorimit të planit të veprimit për Integritet në Komunën e Rahovecit, ka pasur një cikël të metodave:


1. Fillimisht është dërguar një email njoftues tek njësitë e komunës lidhur me veprimet dhe obligimet e tyre së bashku me planin e veprimit;
2. Janë dërguar edhe email-at rikujtues, në mënyrë që të plotësohet raporti për Planin e Integritetit;
3. Pas marrjes së planit të veprimit, janë analizuar masat/veprimet e raportuara, si dhe në fund është hartuar raporti për zbatimin e Planit të Integritetit të Komunës së Rahovecit për periudhën janar – dhjetor, 2023. Raporti është raport narrativ dhe statistikor.

Të gjeturat. Në bazë të informatave mbi zbatimin e Planit të Integritetit në Komunën e Rahovecit, në periudhën janar – dhjetor 2023 janë planifikuar: 2 fusha të rrezikut (1 fushë e përgjithshme dhe 1 fushë e veçantë), 17 nënfusha të rrezikut dhe 98 masa/veprime të propozuara për zbatim, nga të cilët janë zbatuar 95 masa ose 96.94%, dhe 3 masa/veprime ose 3.06% nuk janë zbatuar ose nuk janë ofruar informata adekuate, gjë që e kemi poentuar si të pazbatuara.

Sa i përket ndarjes së fushave, në kuadër të fushës së përgjithshme të rrezikut, janë 4 nënfusha të rrezikut dhe 34 masa të propozuara, ku edhe janë të zbatuar të gjitha. Ndërsa, sa i përket fushës së rrezikut të veçantë, janë gjithësej 13 nënfusha të rrezikut dhe 64 masa të propozuara, nga të cilat 61 janë zbatuar dhe 3 masa/veprime ende jo. Për të gjitha masat/veprimet dhe informatat tjera, më poshtë i kemi dhënë sqarimet e hollësishme.

I. Fushat e përgjithshme të rrezikut

Në kuadër të kësaj fushe janë gjithësej 4 nënfusha të rrezikut me gjithësej 34 masa të propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rrezeqeve, ku edhe janë të zbatuar të gjitha. Të gjitha këto të dhëna, i kemi pasqyruar si vijon:



Diagrami

1: Progresi i arritu në fushën e përgjithshme në kuadër të zbatimit të Planit për Integritet në Komunën e Rahovecit (janar – dhjetor, 2023).

1.1. Fusha e rrezikut: Menaxhimi

Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rrezeqeve

1. Zhvillimi i metodologjisë për hartimin e Planit Zhvillimor të komunës dhe zbatimin e saj;
2. Sigurimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesve të të gjitha fushave përkatëse si dhe qytetarëve në zhvillimin e Planit Zhvillimor të komunës;
3. Përditësimi i informatave në ueb faqen e Komunës për t'i informuar qytetarët dhe mediat për aktivitetet e komunës;
4. Informimi i vazhdueshëm i qytetarëve me procedurat për hartimin dhe miratimin e akteve me interes publik me qëllim të përfshirjes së tyre në vendimmarrje;
5. Rishikimi i organizimit të brendshëm të administratës përmes rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;
6. Të përcaktohen përgjegjësitë sa i përket monitorimit dhe raportimit për zbatimin e Planit të Integritetit;
7. Të monitorohet dhe raportohet rregullisht zbatimi i Planit të Integritetit;
8. Të rishikohet niveli i zbatimit dhe të përditësohen masat për përmirësime;
9. Miratimi i një akti të brendshëm për regjistrimin e raportimeve të korrupsionit brenda institucionit dhe trajtimin e tyre, si dhe mbrojtjen e identitetit të sinjalizuesëve;

Veprimet për zbatimin e masave në fushën e menaxhimit.

1. **Masa është zbatuar pas afatit.** Projekt Plani Zhvillimor Komunal 2023-2031, është miratuar, ky plan ka marr pëlqimin për miratim nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, po ashtu ka marr miratimin e Kuvendit Komunal.
2. **Masa është zbatuar pas afatit.** Plan i Zhvillimor Komunal 2023-2031 ka kaluar dy faza të hartimit, gjatë përgaditjes së draft Planit ku janë mbajtur 15 takime me qytetar në lokacione të ndryshme. Dhe faza pas marrjes së pëlqimit për shqyrtim publik nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës po ashtu ka marr miratimin e Kuvendit Komunal. Janë mbajtur 12 takime me qytetar, përfaqësues të bizneseve, OJQ-ve dhe asambleistve, ku janë informuar për përmbajtjen dhe mundësin që kanë për kërkesa, propozime dhe ankesa. Shqyrtimi publik është mbajtur prej datës 18.01.2023 deri 18.02.2023 ku janë pranuar gjithësej 51 kërkesa. Është formuar komisioni me vendim të kryetarit për shqyrtim të kërkesave. Kërkesat e aprovuar do përfshihen në Planin Zhvillimor Komunal 2023-2031.
3. **Masa është zbatuar në kohën e duhur.** Në baza ditore, bëhet përditësimi i informatave, aktiviteteve dhe lajmeve për ngjarjet që ndodhin në dhe për institucionin e komunës së Rahovecit. Transmetimi i mbledhjeve të Kuvendit bëhet online në Ueb faqen zyrtare, kanalën youtube dhe facebook.
4. **Masa është zbatuar në kohën e duhur.** Në të gjitha grupet punuese për hartimin e akteve, rregulloreve dhe planeve një anëtar i përket shoqërisë civile. Poashtu bazuar në Udhëzimin Administrativ për standardet minimale të konsultimeve publike publikohen me kohë (14 ditë para) aktet dhe rregulloret, si dhe njoftimet për konsultime publike, duke iu mundësuar secilit që të ketë mundësi të jap sugjerime dhe vërejtje dhe kështu të bëhet direkt pjesë e vendimmarrjes komunale.
5. **Masa është zbatuar në kohën e duhur.** Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve, analizojnë dhe rishikojnë detyrat e punës sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.
6. **Masa është zbatuar në kohën e duhur.** Me vendim të kryetarit është caktuar Koordinatori për Integritet, i cili së bashku me drejtorët e drejtorive përkatëse, bën monitorimin e zbatimit të Planit për Integritet, si dhe raportimin në lidhje me zbatimin e tij.
7. **Masa është zbatuar në mënyrë periodike.** Që nga caktimi i koordinators, janë marr masa për monitorimin dhe përditësimin e masave të zbatuara.
8. **Masa është zbatuar në mënyrë periodike.** Koordinator i së bashku me drejtorët e drejtorive përkatëse bën rishikimin e nivelit të zbatueshmërisë së masave të propozuara.
9. **Masa është zbatuar në mënyrë periodike.** Me vendim kryetari i komunës ka caktuar zyrtarin përgjegjës për regjistrimin e akteve të korrupsionit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

1.2. Fusha e rrezikut: Politika e burimeve njerëzore, sjellja etike dhe profesionale e të punësuarve

Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve

1. Zhvillimi, miratimi dhe zbatimi i Planit të Personelit;
2. Zbatimi i parimit të meritës gjatë procedurave të punësimit;
3. Të bëhet analiza e nevojave për trajnime;
4. Trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarve;
5. Të bëhet vlerësimi i ndikimit të trajnimeve të mbajtura;
6. Të bëhet rishikimi dhe standardizimi i detyrave të punës, si dhe harmonizimi i tyre me rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;
7. Të harmonizohen përshkrimet e vendeve të punës me proceset dhe procedurat përkatëse të punës;
8. Të ju ri-dorëzohet përshkrimi i vendit të punës të gjithë nënpunësve;

9. Raportimi i zbatimit të Kodit të Etikës për gjithë zyrtarët komunal përfshirë zyrtarët publik, të zgjedhurit dhe të emëruarit;
10. Shpërndarja e Kodit të Etikës për të gjithë zyrtarët komunal dhe organizimi i takimeve për informim me përmbajtjen e Kodit;
11. Njësia për Burime Njerëzore krijon një regjistër për regjistrimin e dhuratave të pranuar nga nëpunësit;
12. Të informohet stafit për rregullat e pranimi të dhuratave;
13. Të sigurohet mbajtja e takimeve të rregullta ndërmjet menaxhmentit dhe personelit për prezantimin dhe diskutimin për mekanizmat e raportimit të korrupsionit dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme;
14. Të gjithë nëpunësit publik të punësuar dhe ata të cilët do të rekrutohen, të nënshkruajnë deklaratën e integritetit në bazë të secilës nëpunësi do të merr përgjegjësinë përkatëse;

Veprimet për zbatimin e masave në fushën e politikës së burimeve njerëzore, sjelljes etike dhe profesionale të të punësuarve.

1. Masa është zbatuar në kohën e duhur. Në shtator çdo vit bëhet plani i personelit, miratimi dhe zbatimi i tij.
2. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Pranimi i zyrtarëve të ri, bëhet në bazë të kriterve të përcaktuara, në konkurse, sipas meritës;
3. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Bëhet analiza e nevojave për trajnim kohë pas kohe, në bazë të analizave, nevojës për trajnim, mbahen trajnime të kohë pas kohëshme.
4. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Të punësuarit në administratën komunale vazhdojnë të trajnohen varësisht sipas fushave. Për periudhën janar - dhjetor 2023, janë dërguar zyrtar në IKAP (Instituti i Kosovës për Administratë Publike) për trajnim.
5. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Bëhet vlersimi i ndikimeve të trajnimeve, efekti i tyre; IKAP është institucion i cili bënë vlerësimin e trajnimeve të mbajtura. Ndërsa, NJBNJ koordinon procesin e trajnimeve me IKAP. NJBNJ mbanë databazën në excel për të gjitha trajnimet e mbajtura nga IKAP, por nuk bënë vlerësim të trajnimeve pasi që kjo është në mandatin e IKAP-it. Çdo zyrtar që merr pjesë në trajnim pas përfundimit të trajnimit plotëson formularin e vlerësimit të trajnimit në IKAP.
6. Masa është zbatuar në kohën e duhur. Kryetari i Komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore, drejtuesit e drejtorive dhe udhëheqësit e sektorëve. analizojn dhe rishikojn detyrat e punës sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës.
7. Masa është zbatuar në kohën e duhur. Përshkrimi i vendeve të punës është realizuar dhe është harmonizuar sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe sipas Katalogut të vendeve të punës.
8. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Njësia e Burimeve Njerëzore, analizon dhe rishikon detyrat e punës sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës. Deri më tani është bërë rishikimi i detyrave të punës sipas Rregullores.
9. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Raportohet në vazhdimsi për zbatimin e Kodit të Etikës.
10. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Sipas të dhënave brenda NJBNJ-së, të gjithë zyrtarët janë të pajisur me Kodin e Etikës.
11. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. NJBNJ mban evidencë për dhuratat, si dhe e informon stafin për rregullat e pranimi të dhuratave.
12. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Zyrtarët rregullisht informohen për rregullat e pranimi të dhuratave.
13. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Mbahen takime të rregullta për prezantimin dhe diskutimin e raportimit të korrupsionit, dhe të aktiviteteve të tjera të paligjshme.
14. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Është nënshkruar deklarata për integritet nga ana e të gjithë nënpunësve publik, me të cilën marrin përgjegjësi lidhur masat që i parashe plani për integritet.

1.3. Fusha e rrezikut: Planifikimi dhe menaxhimi i buxhetit dhe financave

Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve

1. Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë planifikimit të buxhetit;
2. Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për planifikim të buxhetit;
3. Hartimi dhe miratimi i planit të shpenzimeve financiare;
4. Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore;
5. Publikimi i planit të shpenzimeve në ueb faqen e komunës;
6. Të sigurohet mbikëqyrja e jashtme mbi zbatimin e buxhetit duke krijuar një komision të përbërë nga përfaqësuesit e komunës dhe nga vëzhgues të OJQ-ve për të monitoruar zbatimin e buxhetit;
7. Raportim i rregullt për shpenzimet buxhetore dhe realizimin e buxhetit;
8. Të përditësohet regjistri i brendshëm i aseteve të komunës;

Veprimet për zbatimin e masave në fushën e planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit dhe financave

1. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Kryetari i Komunës së bashku me drejtorët e drejtorive relevante mban dëgjime buxhetore në bazë të ligjit, në të gjitha vendbanimet e Komunës, me OJQ, Sindikata, Biznese etj.
2. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Me vendim të ZKF (Zyrtari Kryesor Financiar) dhe ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) përzgjidhen punonjësit e Komunës që të ndjekin trajnimet në modulet: shpenzues, zotues, pranues etj.
3. Masa është zbatuar në kohën e duhur. Vazhdohet hartimi më i detajuar në mënyrë që miratimi i raporteve të shpenzimeve të kryhet ashtu siç është bërë planifikimi i buxhetit.
4. Masa është zbatuar në mënyrë periodike.. Drejtoria për Buxhet dhe Financa e bënë raportimin e rregullt të shpenzimeve buxhetore në bazë të raporteve periodike.
5. Këto raporte gjithmonë publikohen në ueb faqen e Komunës.
6. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Drejtoria për Buxhet dhe Financa përkatësisht zyrtari kryesor financiar i prezanton raportet financiare në secilin tremujor.
7. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Drejtoria për Buxhet dhe Financa përpilon dhe raporton, raporte financiare në baza mujore.
8. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Në vazhdimësi bëhet përditësimi i aseteve komunale nga zyrtari përgjegjës.

1.4. Fusha e rrezikut: Ruajtja dhe siguria e të dhënave dhe dokumentacionit

Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve


1. Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së punës për proceset që realizohen përmes sistemeve të teknologjisë informative;
2. Të sigurohet informimi për të gjithë të punësuarit lidhur me rrezikun nga mashtrimet dhe korrupsioni që kanë të bëjnë me sigurinë e informacionit dhe shfrytëzimin e të dhënave të kompjuterizuara;
3. Zhvillimi dhe miratimi i procedurës së brendshme mbi trajtimin e dokumentacionit dhe informacionit zyrtar;

Veprimet për zbatimin e masave në fushën e ruajtjes dhe sigurisë së të dhënave dhe dokumentacionit

1. **Masa është zbatuar në mënyrë periodike.** Në vazhdimësi përdoret sistemi i intranetit për krijimin e kërkesave, procesimin e kërkesës deri tek përfundimi i lëndës dhe njoftimin e palës për atë lëndë, pastaj është po ashtu platforma konkursi online (<https://konkursi.rks-gov.net>), ku zhvillohen procedurat për aplikim dhe njoftim, në platformën e-kosova ofrohen shërbime për nxjerrjen e faturës së tatimit në pronë, gjendjes civile, taksa komunale (<https://ekosova.rks-gov.net/Services>).
2. **Masa është zbatuar në mënyrë periodike.** Në vazhdimësi punonjësit informohen nga ASHI (Agjencioni Shtetror i Kosovës) dhe stafi i TIK-ut (Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit) kur ka tentime të mashtrimeve.
3. **Masa është zbatuar në mënyrë periodike.** Pikënisja e procedurës është qendra për shërbim të qytetarëve, ku fillon procedura e kërkesave nga personat zyrtarë apo juridik, zhvillohet procedura e brendëshme për realizimin e kërkesës (trajtohet nga departamenti përkatës) dhe pas përfundimit jepet informacioni mbi lëndën e trajtuar.

II. Fushat e veçanta të rrezikut

Në kuadër të kësaj fushe janë gjithsej 13 nënfusha të rrezikut me gjithësej 64 masa të propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve nga të cilat 61 janë të realizuara dhe në proces janë edhe 3 masa, si vijon:



2: Progresi i arritur fushën e veçantë në kuadër zbatimit të Planit për Integritet në Komunën e Rahovecit (janar – dhjetor 2023).

2.1. Fusha e rrezikut: Auditimi i Brendshëm

Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve

1. Të sigurohet planifikim efektiv i auditimit i bazuar në rezultatet e vlerësimit të rrezikut dhe të monitorohet zbatimi i këtij plani si dhe të planifikohen masa përmirësuese në rast nevojë;
2. Të sigurohen auditime rast pas rasti për të vërtetuar të gjeturat gjatë kontrollave;
3. Zhvillimi i një plani për zbatimin e rekomandimeve të auditimit;
4. Raportim i rregullt mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit;
5. Të përmirësohet sistemi i komunikimit mes njësisë së auditimit të brendshëm dhe organeve të tjera komunale;
6. Të caktohen auditime pas prokurimit dhe dhënies së kontratës për tenderë për të rishikuar respektimin e standardeve të specifikuar procedurale;

Veprimet për zbatimin e masave në fushën e auditimit

1. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Ekziston Plan i cili bazohet në vlerësimin e rrezikut. Me Planin e vitit 2023 janë realizuar të gjitha aktivitetet e parapara deri në këtë fazë dhe plani është monitoruar dhe realizuar në 100%.
2. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Bëhen auditime rast pas rasti.
3. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Ekziston plani për zbatimin e rekomandimeve.
4. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Raportim i rregullt në bazë të planit për implementimin e rekomandimeve të AB.

5. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Njësia e AB, Komiteti i Auditimit dhe Kryetari i Komunës kanë komunikim të rregullt.
6. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Auditimet bëhen sipas planit të punës së njësisë së auditimit të brendshëm dhe sipas rastit.

2.2. Fusha e rrezikut: Prokurimi Publik

Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve

1. Rritja e kapaciteteve për përgatitjen e specifikimeve të tenderit, duke marrë parasysh kriteret për mos-diskriminim dhe duke siguruar qasje të barabartë;
2. Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive përkatëse për personelin për prokurimin publik;
3. Publikimi i Planit të Prokurimit në ueb faqen e komunës;
4. Të kufizohen mundësitë për komunikim me ofertuesit duke krijuar protokoll të qartë për komunikimin me ofertuesit dhe duke krijuar pika të qarta të kontaktit;
5. Trajnimi i personelit për menaxhimin e kontratave/projektit;

Veprimet për zbatimin e masave në fushën e prokurimit publik

1. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Përmirësimi i dukshëm i specifikave teknike dhe jo favorizimi i specifikave, duke pasur qasje të barabart.
2. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Janë mbajtur trajnimet për personelin e prokurimit për vlerësimin e ofertave dhe tenderat ekonomikisht me të favorshëm në kuadër të USAID.
3. Masa është zbatuar në kohën e duhur. Në vazhdimësi publikohet plani, sipas datave të Ligjit të Prokurimit.
4. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Janë të caktuara pika të qarta të kontaktit, nëpërmjet sistemit të Prokurimit Elektronik.
5. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Janë mbajtur trajnime për menaxhert e kontratave.

2.3. Fusha e rrezikut: Zhvillimi Ekonomik Lokal

Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve

1. Hartimi, rishikimi, përditësimi si dhe miratimi i dokumenteve strategjike për zhvillim ekonomik të komunës;
2. Rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik të komunës;
3. Të sigurohet pjesëmarrja e të gjitha palëve relevante gjatë hartimit dhe caktimit të prioriteteve të zhvillimit komunal;
4. Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kriteret dhe procedura të qarta për ndarjen e subvencioneve dhe për të parandaluar vendime arbitrare dhe praktika korruptive;
5. Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve;
6. Të sigurohet personel adekuat profesional për zhvillimin ekonomik lokal;
7. Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e zhvillimit ekonomik lokal;
8. Kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal;

Veprimet për zbatimin e masave në fushën e zhvillimit ekonomik.

1. Masa është zbatuar në kohën e duhur. Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, ka të miratuar Strategjin e Zhvillimit, Ekonomik Lokal, e cila zbatohet në vazhdimësi.
2. Masa është zbatuar në kohën e duhur. Rishikimi i prioriteteve të zhvillimit ekonomik bëhet në vazhdimësi.
3. Masa është zbatuar në kohën e duhur. Poashtu gjatë hartimit dhe caktimit të prioriteteve të zhvillimit ekonomik komunal, marrin pjesë të gjitha palët relevante.
4. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Në bazë të rregullores së brendshme për ndarjen e subvencioneve. Në rregulloren Nr. 1427 të datës 28/04/2017, janë të përcaktuara kriteret dhe proceduarat për ndarjen e subvencioneve.
5. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Në të gjitha komisionet për vlerësimin e kërkesave merr pjesë një anëtar/e nga shoqëria civile.
6. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Në kuadër të drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, është zyrtari për zhvillim ekonomik.
7. Zyrtari për zhvillim ekonomik lokal, mban trajnime të vazhdueshme nga ministritë e linjës dhe organizatat të tjera vendore dhe ndërkombëtare.
8. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Kontrollimi dhe raportimi për zbatimin e aktiviteteve të zhvillimit ekonomik lokal bëhet në baza periodike, mujore, 6 mujore dhe vjetore.

2.4. Fusha e rrezikut: Planifikimi Urban dhe Rural

Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve

1. Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kriteret të qarta të duhura që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e planifikimit urban dhe rural dhe parandalojnë vendimet subjektive;
2. Të rritet mbikëqyrja e zbatimit të rregullativës së brendshme;
3. Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural;
4. Të sigurohet personel adekuat profesional për planifikim urban dhe rural;
5. Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural;
6. Kontrollimi dhe raportimi i rregullt për zbatimin e aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural;

Veprimet për zbatimin e masave në fushën e planifikimit urban dhe rural.

1. *Masa nuk është zbatuar për arsye të tjera.* Është në proces të miratimit PZHK (Plani Zhvillimor i Komunës) dhe HZK- (Harta Zonale e Komunës) të cilat do të rregullojnë procesin e dhënies së lejeve ndërtimore.
2. Masa është zbatuar në mënyrë periodike Me vendim të Kryetarit të datës 15.09.2022 janë emëruar zyrtarë përgjegjës për mbikëqyrjen e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje për rrënim.
3. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Për të gjithë zyrtarët sigurohet trajnim i nevojshëm.
4. Masa është zbatuar në kohën e duhur. Është siguruar personel adekuat dhe profesional për planifikimin urban dhe rural.
5. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Është bërë trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural.
6. Masa është zbatuar në mënyrë periodike Bëhet kontroll dhe raportim i rregullt për mënyrën e zbatimit të aktiviteteve të planifikimit urban dhe rural.

2.5. Fusha e rrezikut: Standardet e Ndërtimit dhe Kontrollit

Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve

1. Shtimi i kontrolleve në vendet e ndërtimit, me qëllim të ndalimit me kohë të ndërtimeve pa leje;
2. Të sigurohet personel adekuat profesional për planifikim urban dhe rural;
3. Të sigurohet trajnimi i stafit në fushën e planifikimit urban dhe rural;

Veprimet për zbatimin e masave në fushën e ndërtimit dhe kontrollit

1. Masa është zbatuar në mënyrë periodike Në bashkëpunim me drejtorinë e Inspektoratit janë duke u bërë kontrollat në teren.
2. Masa është zbatuar në kohën e duhur. Me vendim të Kryetarit të datës 15.09.2022 janë emëruar zyrtarët përgjegjës për mbikëqyrjen e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje për rrënim.
3. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Në bashkëpunim me Njësinë për Burime Njerëzore, organizohen trajnime të ndryshme, edhe këtë vit janë organizuar trajnime për stafin.

2.6. Fusha e rrezikut: Inspektimet

Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve

1. Të sigurohet plani vjetor i inspektimeve për çdo fushë duke u bazuar në vlerësimin e rrezikut;
2. Organizimi i trajnimeve profesionale për inspektorët;
3. Të sigurohet numër i mjaftueshëm i inspektorëve nga personeli i brendshëm i komunës ose punësime të reja;
4. Fuqizimi i sistemit të kontrolleve mbi funksionimin e operatorëve të biznesit. Të rriten gjobat për operatorët pa regjistrim dhe licenca valide të biznesit;
5. Ka nevojë që në D.I të publikojë në baza vjetore listën e bizneseve të inspektuara dhe shpeshtësinë e inspektimeve;

Veprimet për zbatimin e masave në fushën e inspektimit.

1. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Në faqen zyrtare është i paraqitur Plani Vjetor i Punës së Drejtorisë për Punë Inspektuese, për secilën fushë mirëpo, vlen të theksohet se DPI, inspektimet i realizon edhe pa planifikim, trajton rastet e paraqitura ad – hoc dhe kërkesa të ndryshme për dalje në terren të adresuara nga qytetarët.
2. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Nga USAID, kemi pranuar udhëzuesin përfundimtar dhe instrumentin për përcjelljen e protokoleve të inspektimit të ndërtimit, poashtu janë organizuar edhe trajnime për mënyrën e përdorimit të këtij instrumenti gjatë punës së përditshme të inspektorit të ndërtimit, poashtu inspektori i mjedisit dhe i çështjeve komunale kanë marrë pjesë në trajnime të ndryshme profesionale.
3. Masa është zbatuar në kohën e duhur. Është plotësuar numri, janë pranuar dy inspektorë në muajin qershor të vitit 2022 një në sektorin e ndërtimit dhe një për çështje komunale.
4. Masa është zbatuar në mënyrë periodike Në angazhimet tona për luftë ndaj ekonomisë informale, për këtë periudhë raportuese, është rrit numri i bizneseve të reja të cilat janë regjistruar në zyrën e ARBK-

së, pas urdhëresave nga shërbimi ynë, janë kryer inspektime intensive, ku inspektorët e tregut kanë konstatuar parregullësi, poashtu kanë marrë masa në përputhje me ligjin: gjoha si dhe masa të tjera administrative;

5. **Masa është zbatuar në mënyrë periodike** Për çdo biznes të inspektuar mbahet evidencë dhe më pastaj krijohet një listë me biznese të inspektuara dhe në fund të vitit do të bëhet publikimi në ueb faqen zyrtare të komunës së Rahovecit.

2.7. Fusha e rrezikut: Arsimi Publik

Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve

1. Të sigurohet planifikim i shërbimeve arsimore bazuar në nevojat dhe dinamikën e rritjes së numrit të nxënësve;
2. Të hartohet plani i inspektimeve dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij;
3. Rekrutimi i stafit të duhur arsimor, kujdesi i veçantë në marrjen e stafit për zonat ku ka nevojë; urgjente. Rishikimi i procedurave operacionale për rekrutimin e stafit në sektorin e edukimit për të siguruar kontrolle adekuatë të integritetit, p.sh. përfshirja e OJQ-ve, aktorëve të tjerë të jashtëm në panelet intervistuese, dhe rritja e transparencës së procesit të intervistimit, rritja e publicitetit të rezultateve të përzgjedhjes;
4. Përmirësimi i sigurisë fizike të shkollave me rekrutimin e stafit profesional të sigurisë;

Veprimet për zbatimin e masave në fushën e arsimit publik.

1. **Masa është zbatuar në kohën e duhur.** Ka filluar të implementohet gjatë vitit 2022 me punësimin e asistenteve për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore (që është bërë në muajin shtator të vitit 2022) dhe ka vazhduar me rekrutimet për shërbimet pedagogjiko-psikologjike për vitin shkollor 2023/2024. Më 08.02.2023 DKA ka hapur konkurs për rekrutimin e psikologëve dhe pedagogëve dhe nga ky konkurs janë pranuar 4 psikologë/e dhe 4 pedagogë/e të rinjë, të cilët kanë filluar të punojnë në shkollat e Komunës së Rahovecit. Gjatë vitit 2023 janë hapur 4 konkurse për asistentë/e për fëmijë me nevoja të veçanta.
2. **Masa është zbatuar në mënyrë periodike.** Në kuadër të përgjegjësi që ka, DKA në vazhdimësi inspekton dhe mbikëqyr procesin edukativo arsimor dhe ky proces i inspektimeve bëhet çdo javë, përmes vizitave sistematike që realizojnë zyrtarët e DKA-së në shkolla. Ndërkohë, inspektime të kohë pas kohshme bëhen edhe nga Zyrat Rajonale të Inspektoriatit të Arsimit në Gjakovë dhe Prizren.
3. **Masa është zbatuar në mënyrë periodike** DKA, në vazhdimësi, në mënyrë periodike hap konkurse dhe zhvillon procedurat e rekrutimeve adekuatë për plotësimin e vendeve të lira të punës, varësisht nga nevojat që ka. Procedurat e rekrutimeve zhvillohen në përputhje me Udhëzimet Administrative të MASHTI-t.
4. **Masa nuk është zbatuar për shkak të mungesës buxhetit.** Siguria fizike e objekteve shkollore nuk është e paraparë me buxhetin komunal, d.m.th, nuk ka të punësuar që ruajnë dhe kujdesen për objektet e shkollave, por nga 35 objekte shkollore që ka komuna jonë, deri në muajin dhjetor të vitit 2023, 32 objekte të shkollave janë pajisur me kamera të sigurisë, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejtë në përmirësimin e sigurisë fizike të shkollave. Domethënë vetëm 3 objekte arsimore, që janë paralele të ndara, akoma nuk kanë kamera të sigurisë.

2.8. Fusha e rrezikut: Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale

Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve

1. Rishikimi dhe revidimi i prioriteteve për përmirësime në infrastrukturë dhe sigurimin e hapësirave të nevojshme për shërbime shëndetësore;
2. Të rishikohet rregullativa e brendshme me qëllim të përmirësimit dhe plotësimit;
3. Të shtohet kontrolli i zbatimit të rregullativës;
4. Rritja e transparencës në punën e Qendrës për Punë Sociale, përmes mundësimit të qasjes në informata në ueb faqe të saj lidhur me aktivitetet e kryera me informata të plota;

Veprimet për zbatimin e masave në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale

1. Masa është zbatuar në kohën e duhur. Është përfunduar infrastruktura në Qendren Kryesore të Mjeksis Familjare ku edhe njëherit është siguruar hapsira e nevojshme për shërbime shëndetësore.
2. Masa është zbatuar në kohën e duhur. Është miratuar Statuti i QKMF-së me qëllim të përmirësimit dhe plotësimit, si dhe është zgjerura gama e shërbimeve shëndetësore.
4. Masa është zbatuar në mënyrë periodike Pas rekomandimeve të auditorit janë zbatuar rekomandimet dhe është shtuar kontrolli i zbatimit të rregullativës.
5. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Qendra për Punë Sociale është transparente në punën e saj dhe bënë raporte në vazhdimsi si dhe e lejon qasje në informata për palët që janë të interesuara për punën e saj.

2.9. Fusha e rrezikut: Shërbimet Publike dhe Licencimi i Tyre

Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve

1. Të zhvillohen aktet nënligjore si dhe qartësimi i procedurave për lejet për shërbimet përkatëse publike;
2. Të krijohen aplikacione elektronike për shërbimet publike që mund të ofrohen në mënyre elektronike;
3. Të zvogëlohet mundësia e kontakteve mes palëve të interesuara dhe zyrtarit që merr vendim (vendimi të merret nga zyrtari profesional, ndërsa pagesa dhe dërgimi i vendimit të bëhet në zyrat pritëse nga zyrtari tjetër);
4. Të rritet profesionalizmi i stafit përmes trajnimeve, shkëmbimit të përvojave, punëtorive;
5. Rritja e rrezikut në menaxhimin e mbeturinave; përmirësimi i kornizës strategjike me hartimin dhe miratimin e një rregulloreje komunale të Menaxhimit të Mbeturinave, sigurimi i kontrolleve strikte dhe i llogaridhënies së operatorëve;
6. Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere të qarta që adresojnë rreziqet kryesore në procesin e licencimit të cilat parandalojnë vendime subjektive;
7. Të sigurohet trajnimi i stafit për licencimin e shërbimeve;

Veprimet për zbatimin e masave në fushën e shërbimeve publike dhe licencimit të tyre.

1. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Janë zhvilluar akte nënligjore si dhe në vazhdimësi janë qartësuar procedurat për lejet për shërbimet përkatëse, janë lëshuar leje për shërbime sipas akteve dhe procedurave ligjore. Duke respektuar udhëzimet, dhe rregulloret komunale.
2. **Masa nuk është zbatuar për shkak të menaxhimit joadekuat të procesit..** Është duke u punuar në platformën e-komuna ku do të lanësohen shërbimet komunale (Në vazhdimësi).
3. Masa është zbatuar në mënyrë periodike Vazhdimisht zvogëlohet mundësia e kontakteve mes palve të interesuara dhe zyrtarit që merr vendime, kjo praktikë zbatohet në vazhdimësi, të gjitha shërbimet kryhen shpejtë dhe pa asnjë pengesë burokratike.
4. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Në çdo trajnim dhe në çdo shkëmbim përvojash marrin pjesë, përveç zyrtareve po ashtu edhe udhëheqësit e drejtorisë.
5. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Vazhdimisht komuna ka përcjell ecurinë e planeve komunale për menaxhim të mbeturinave. Po ashtu ka raportuar në baza mujore dhe vjetore në drejtori, dhe sipas kërkesave që kërkon MMPH. Komuna jonë ka të hartuar planin komunal për menaxhimin e mbeturinave si dhe dy plane të tjera për menaxhimin e mbeturinave.
6. Masa është zbatuar në kohën e duhur. Ka rregulla të qarta të cilat përcaktojnë kritere të qarta të cilat parandalojnë rreziqet në procesin e licencimit dhe vendimeve subjektive.
7. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Në vazhdimësi bëhet trajnimi i stafit në disa sektorë.

2.10. Fusha e rrezikut: Komunikimi me Palë të Jashtme të Interesit

Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve

1. Të rritet transparenca dhe të merren masa për konsultime me palë të jashtme të interesit gjatë zhvillimit të rregulloreve komunale dhe të buxhetit (postimi i projekt-rregulloreve në ueb-faqe, inicimi i diskutimeve publike, fokus grupe etj;
2. Të zhvillohen partneritete me shoqërinë civile në fushën e anti-korrupsionit duke themeluar grupe pune teknike për menaxhimin e riskut në fushat e ndjeshme dhe të brishta ndaj korrupsionit dhe të sigurohet përfshirja e OJQ-ve;
3. Të forcohen mekanizmat e konsultimeve me bizneset përmes takimeve periodike konsultative
4. Të rritet rrjedha e informacionit drejt medias dhe publikut lidhur me parandalimin e korrupsionit dhe të aktiviteteve të luftës kundër tij;

Veprimet për zbatimin e masave në fushën e komunikimit me palë të jashtme të interesit.

1. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Në të gjitha proceset e konsultimeve, takimeve dhe dëgjimeve publike për këtë vit u bë njoftimi me kohë ashtu siç parashihet në Udhëzimin Administrativ për Standartet Minimale të konsultimeve publike, 14 ditë para në ueb faqen zyrtare, në rrjetet sociale si dhe në Platformën për Konsultime Publike të Qeverisë. Gjithashtu vendoset njoftimi i afishuar në hyrje të objektit komunal. Të gjitha dokumentet që futen në konsultime publike publikohen në ueb faqen zyrtare të komunës duke qenë të qasshme për publikun, konsultohen palët e interesit si dhe kryhen procedurat në tërësi siç parashihen me gjithë, duke publikuar procesverbale dhe raporte nga proceset e konsultimeve, dëgjimeve dhe takimeve publike
2. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Në të gjitha grupet punuese dhe vendimet që merr kryetari i Komunës, një anëtar i përket shoqërisë civile duke i përfshirë direkt në proceset vendimmarrëse.
3. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Në të gjitha proceset e takimeve publike, dëgjimeve buxhetore, bizneset janë thirrur veçanërisht duke i konsultuar dhe duke marrë kërkesa nga ta. Dëshmi keni njoftimet dhe procesverbalet në <https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/degjime-buxhetore-al/>

4. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Për të gjitha aktivitetet janë të njoftuara mediat dhe publiku në tërësi në kohë reale.

2.11. Fusha e rrezikut: Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë

Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rrezeve

1. Rritja e përdorimit të e-shërbimit dhe monitorimi elektronik i dokumenteve, të rritet transparenca;
2. Rritja e zhvillimit profesional i stafit sipas nevojës. Ofrimi i trajnimeve rifreskuese/të vazhdueshme për rregullat e reja ose kornizat për matje kadastrale. Licencimi i KP për gjeodezi e ka lehtësuar punën e matjes në teren;
3. Ofrimi i trajnimeve rifreskuese/të vazhdueshme për rregullat e reja ose kornizat për matje kadastrale;
4. Licencimi i KP për gjeodezi e ka lehtësuar punën e matjes në teren;

Veprimet për zbatimin e masave në fushën e drejtorisë për gjeodezi, kadaster dhe Pronë.

1. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Kërkesat për përdorimin e e-shërbimeve janë të vazhdueshme, është rritë nr. i përdoruesve të shërbimeve të produkteve në e- kosova, është avancuar skenimi i dokumenteve të obligueshme, monitorimi i dokumenteve dhe skenimi bëhet në vazhdimësi nga ZKK-të (Zyra Kadastrale e Komunës) dhe AKK-të (Agjencioni Kadastral i Kosovës).
2. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Zhvillimi profesional i stafit është i vazhdueshëm dhe bëhet sipas nevojës në bashkupim me AKK.
3. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Trajnimet dhe rregullat e reja mbahen vazhdueshëm nga AKK për ZKK.
4. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. AKK përveç licencimit të kompanive private po organizon edhe trajnime për operator privat varësisht prej kornizave ligjore.

2.12. Fusha e rrezikut: Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport

Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rrezeve

1. Ndërmarrja e masave për përzgjedhjen e rregullt të OJQ-ve dhe organizatave sportive;
2. Përmirësimi i kornizës strategjike për Kulturë, Rini dhe Sport duke hartuar Planin e Veprimit Komunal për Rini, Kulturë dhe Sport. Të gjitha aktivitetet kulturore sportive dhe rinore, të planifikohen me buxhet për çdo vit nga DKRS-ja;
3. Krijimi i një programi specifik për forcimin e kapaciteteve për punëdhënësit sportiv, si dhe për personat përgjegjës për menaxhimin e zonave sportive. Të sigurohet se menaxhimi i integritetit të bëhet pjesë e saj. DKRS, siguron mjetet financiare nga kategoria e subvencioneve për klube sportive OJQ dhe nga aspekti infrastrukturor me objekte dhe hapësira për zhvillim të aktiviteteve;
4. Zbatimi i programeve të integritetit, etikës dhe pajtueshmërisë dhe fushat për të rinjtë;

Veprimet për zbatimin e masave në fushën e Drejtorisë për Kultur, Rini dhe Sport.

1. Masa është zbatuar në mënyrë periodike. Në mbështetje të nenit 4 lidhur me nenin 13 të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve për destinimin e mjeteve nga fondi për transfer dhe subvencione për OJQ-të, të cilat operojnë në territorin e Komunës së Rahovecit, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit, bënë: Ofrimin e mbështetjes

financiare publike për financimin e projekt propozimeve të Klubeve, Shoqatave dhe OJQ-ve, organizimin e aktiviteteve sportive në Komunën e Rahovecit. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit u bënë thirrje të gjitha, Klubeve, Shoqatave sportive të regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushat sportive, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin dhe masivizimin e sportit dhe organizimin rinor gjithnjë duke u bazuar në politikat programore të Drejtorisë për Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit.

2. **Masa është zbatuar në kohën e duhur.** Më 28.10.2022 në Kuvendin Komunal është aprovuar Plani për Trashëgimin Kulturorë 2022-2025, plani për Trashëgimin Kulturorë parasheh investimet në ruajtjen dhe promovimin e monumentëve kulturorë, me këtë planë janë parapara vizita dhe senzibilizim për të rinjtë e komunës sonë, ku organizohen vizita nëpër monumete kulturorë, si dhe parashihet mbështetje për aktivitetet kulturorë për të rinjtë.
3. **Masa është zbatuar në mënyrë periodike.** Me gjithë përpjekjet e reformës, ka ende një mungesë të theksuar, burimet (resurset) materiale më të rëndësishme në sport janë objektet sportive. Objekti sportiv është hapësirë në (mbi) të cilat kryhet aktiviteti sportiv. Ato me strukturën e tyre, përdorimin e caktuar, statusin funksional, të planifikimit dhe programimit në përgatitjen e programeve sportive në të gjitha nivelet që ka të bëjë me këto resurse. Në mesin e objekteve sportive vend të veçantë zënë qendrat sportive si komplekse për zhvillimin e aktiviteteve dhe shprehjen e talentit të të rinjve si (aktivitete sportive dhe arsimore, garuese-sportive sportive-rekreative, sportive shkollore) dhe për kategoritë e ndryshme të përdoruesve (fëmijët, adoleshentët, të rriturit, personat me nevojë të veçanta).
4. **Masa është zbatuar në mënyrë periodike.** Zbatimi i programeve të integritetit do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të Komunës.

2.13. Fusha e rrezikut: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve

1. Të zhvillohet rregullativa e brendshme duke përcaktuar kritere dhe procedura të qarta për ndarjen e subvencioneve dhe për të parandaluar vendime arbitrare dhe praktika korruptive;
2. Pjesëmarrja e shoqërisë civile në vlerësimin e kërkesave për ndarjen e subvencioneve;
3. Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve në lidhje me menaxhimin e rreziqeve specifike në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë dhe rreth burimeve alternative të ngrohjes;
4. Rritja e kontrollit mbi zbatimin e shërbimeve të zhvillimit dhe përdorimit të tokës;

Veprimet për zbatimin e masave në fushën e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

1. **Masa është zbatuar në mënyrë periodike.** Vazhdimisht pra çdo vit, zbatohet rregullorja për ndarjen e subvencioneve dhe asnjëherë nuk ka vend për praktika korruptive.

2. **Masa është zbatuar në mënyrë periodike.** Në secilin komision të shpërndarjes së subvencioneve përfshihet një anëtar i shoqërisë civile.
3. **Masa është zbatuar në mënyrë periodike.** Në kuadër të DBPZHR-se funksionon faqja në rrjetin social facebook përmes të cilës shpërndahet mesazh vetëdijesues për qytetaret e komunës tonë, si në këshillim të kultivimit të pemëve dhe perimeve e poashtu edhe në rastet e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore. Poashtu janë organizuar edhe takime të ndryshme për sektorët e përpunimit dhe konservimit të pemëve dhe perimeve.
Përpos kësaj çdo vit mbajn takime me IFC duke pasur qëllim vetëdijesim të fermerëve për sigurimin e kulturave bujqësore si nga ngricat por edhe nga temp e larta.
4. **Masa është zbatuar në mënyrë periodike.** Në bashkëpunim me MBPZHR çdo vit bëhet përzgjedhja e fermerëve që sigurojnë mostra për analiza të dheut dhe kjo përmes departamentit të shërbimeve këshillimore.

Koordinatori për integritet
Valmir Gashi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12, i paragrafit 2 të shkronjës (d), nenit 17 të shkronjës (a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008*), nenit 5, nenit 6 i paragrafit 1 të pikës 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 i paragrafi 1 të pikës 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 i paragrafit 1 dhe 2 të pikës 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt.27.12.2023 merr këtë:

V E N D I M
Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 02/3624/23 i datës 08.12.2023 dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim të personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij vendimi është në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur “Rimnik”, me kulturë bujqësore, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-08152-0, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2762m² (dymijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy metra katror) e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit, të jepen në shfrytëzim në sipërfaqe prej 2000 m² (dymijë metra katror).
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 1 të këtij propozimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë dhe dhënia e mundësisë së qytetarëve që të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
5. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t’i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
6. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga **Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies**

në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20 e datës 29.06.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.

7. Obligohen Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënie e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvillojë procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
8. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktojë me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
9. Procedura për dhënie e pronës së paluajtshme në pronësi të komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb faqen zyrtare të komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.171/23
Me datë:27.12.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.12.2023 merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 171/23 i datës 27.12.2023 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-71510057-08152-0.
2. Komisioni sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
 - 2.1. Berat Duraku, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
 - 2.2. Besmire Bytyqi, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
 - 2.3. Alban Bajraktari, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
 - 2.4. Faton Ramadani, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës
 - 2.5. Adelina Paqarizi, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktoj çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, ti zhvillojë procedurat e ankandit publikë dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo herë që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Anëtarëve të Komisionit,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së dhe***
- ***Arkivi***

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.173/23
Datë:27.12.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi Komunës Rahovec
Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assambly Rahovec



Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe

PLANI I PUNËS SË KËSHILLIT TË FSHATIT HOÇË E MADHE
JANAR – DHJETOR 2024

Dhjetor– 2023

HYRJE:

Këshilli për fshatin Hoçë e Madhe është këshill i themeluar nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit në bazë të Ligjit nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe, si dhe Udhëzimin Administrativ nr. 11/2014 për themelimin, zgjedhjen, përgjegjësitë dhe funksionimin e Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe.

Plani vjetor i punës:

Në planin vjetor të punës së Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe janë përcaktuar qëllimet dhe aktivitetet që do të kryejnë anëtarët e Këshillit për fshatin Hoçë të Madhe në përmbushjen e qëllimeve të funksionimit të këtij mekanizmi. Ky plan ka për qëllim identifikimin e qëllimeve, aktiviteteve dhe rezultateve, përkatësisht përcaktimin e përgjegjësiave për kryerjen e detyrave të përcaktuara me Ligjin dhe Udhëzimet Administrative të këshillit.

Roli i këshillit të fshatit Hoçë e Madhe:

Roli i Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe të komunës së Rahovecit është promovimi, mbrojtja dhe ruajtja e monumenteve kulturore dhe fetare në kuadër të zonës së veçantë të mbrojtur, e cila është përcaktuar me Ligjin nr. 03/L-039/2008 për zona të veçanta të mbrojtura. Në këtë drejtim, ne si anëtarë të zgjedhur të Këshillit për fshatin Hoçë të Madhe shprehim gatishmërinë tonë dhe jemi të hapur për bashkëpunim me të gjitha institucionet, qofshin ato lokale apo qendrore, duke ofruar të gjitha informacionet dhe rekomandimet e nevojshme për promovimin kulturor, historik dhe monumentet fetare, si dhe zhvillimi ekonomik dhe turistik në nivel komunal.

Objektivat e planit të punës:

Parashikimi dhe përcaktimi i aktiviteteve të caktuara vjetore për të arritur rezultatet më të mira të mundshme, përkatësisht:

1. Do të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme gjendjen e monumenteve kulturore në territorin e zonës së mbrojtur;
2. Do të zhvillojë takime me institucionet lokale dhe qendrore, qytetarë, grupe interesi, organizata joqeveritare (OJQ) që merren me çështjen e mbrojtjes së monumenteve kulturore dhe të trashëgimisë;
3. Do të merret me zgjidhjen e kërkesave të natyrës infrastrukturore dhe investimeve kapitale në zonën e mbrojtur të fshatit Hoçë e Madhe;
4. Do të mbajë shënime për punën e vazhdueshme dhe progresin e arritur në baza vjetore;

Rezultatet e pritura:

Duke vepruar siç u tha më sipër dhe duke u fokusuar në objektivat e mësipërme, mbrojtja e monumenteve kulturore dhe historike do të ndryshojë në të mirë të qytetarëve. Qytetarët dhe të gjithë vizitorët e interesuar do të prezantohen me një pasqyrë më të mirë të të gjitha monumenteve kulturore dhe historike.

Afati për zbatimin e planit të punës:

Ky plan pune është i vlefshëm për periudhën janar - dhjetor 2024.

Nr.	Muaji	Çështjet të cilat shqyrtohen	Përgatit	Shqyrton	Miraton
1	JANAR	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Informatë mbi Raportin e Punës Vjetore të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe 3. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve, 4. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit
2	SHKURT	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve, 3. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 4. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit
3	MARS	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve, 3. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 4. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit
4	PRILL	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve, 3. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 4. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit
5	MAJ	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Përpilimi i Raportit gjashtë mujorë të punës për vitin 2024, 3. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve, 4. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 5. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit
6	QERSOR	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Shqyrtimi i kornizës afatmesme buxhetore të parë për vitin 2025, 3. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve, 4. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 5. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit
7	KORRIK	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve, 3. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 4. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit

8	GUSHT	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Shqyrtimi i kornizës afatmesme buxhetore të dytë për vitin 2024, 3. Përpilimi i tabelarit të shpenzimeve të mjeteve të këshillit të fshatit për vitin 2024, 4. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve, 5. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 6. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit
9	SHTATOR	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve, 3. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 4. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit
10	TETOR	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve, 3. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 4. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit
11	NËNTOR	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve, 3. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 4. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit
12	DHJETOR	1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar, 2. Përpilimi i planit të punës për vitin 2025, 3. Përpilimi i Raportit të Punës Vjetore për vitin 2024, 4. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve, 5. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore, 6. Të ndryshme.	Kryesuesi i Këshillit Administratori.	Kryesuesi i Këshillit, Anëtarë të Këshillit,	Anëtarë të Këshillit



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Rahovecit




Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit 2023-2027

Rahovec, 2023

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit 2023-2027

Implementuar nga:



- 1. Hyrje**
 - 1.1. Baza ligjore për hartimin e PLVCA
 - 1.2. Qëllimi dhe objektivat e PLVCA
 - 1.3. Procesi dhe metodologjia për përgatitjen e PLVCA
- 2. Korniza institucionale, strategjike dhe ligjore për mbrojtje e ajrit nga ndotja**
 - 2.1. Përgjegjësitë institucionale
 - 2.2. Korniza strategjike dhe programore
 - 2.3. Korniza ligjore
- 3. Profili i komunës**
 - 3.1. Pozita gjeografike dhe relievi
 - 3.2. Kushtet klimatike
 - 3.3. Popullsia dhe vendbanimet
- 4. Ndikimet sektoriale në cilësinë e ajrit**
 - 4.1. Energjia dhe ngrohja
 - 4.2. Industria prodhuese dhe bizneset
 - 4.3. Sektori minerar
 - 4.4. Transporti
 - 4.5. Menaxhimi i mbeturinave
 - 4.6. Bujqësia
 - 4.7. Pylltaria
 - 4.8. Përmbledhje e burimeve kryesore të shkarkimeve në ajër
- 5. Ndotja e ajrit dhe ndikimi në shëndet**
 - 5.1. Parametrat e cilësisë së ajrit dhe ndikimi në shëndet
 - 5.2. Vlerësimi i ndikimit të cilësisë së ajrit në shëndetin publik
- 6. Cilësia e ajrit në territorin e komunës së Rahovecit**
- 7. Problemet kryesore që ndërlidhen me ndotjen e ajrit**
- 8. Prioritetet për mbrojtjen e ajrit nga ndotja për periudhën 2023-2027**
- 9. Plani i aktiviteteve dhe veprimeve për periudhën 2023-2027**
- 10. Plani i monitorimit për zbatimin e PLVCA**
- 11. Plani afatshkurtër i veprimit**
- 12. Referencat dhe burimet e informacionit**

Fjala e Kryetarit të Komunës

Të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit, të nderuar lexues!

Kam kënaqësinë që po ndajmë me ju Planin Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit 2023-2027 për Komunën e Rahovecit, si dokument planifikues - strategjik, që adreson zgjidhjen e problemeve në sektorin e ajrit në nivel lokal.

Ky plan ka për qëllim kryesor që të definojë veprimet për menaxhimin e cilësisë së ajrit përbrenda territorit të komunës së Rahovecit për periudhën pesë vjeçare.

Në kuadër të planit është bërë analiza e gjendjes ekzistuese dhe burimeve kryesore të ndotjes së ajrit, janë identifikuar problemet kryesore që ndërlidhen me menaxhimin e cilësisë së ajrit, janë përcaktuar prioritetet kryesore për përmirësimin e cilësisë së ajrit si dhe janë planifikuar afatet, veprimet, aktivitetet dhe projektet kryesore që do të ndërmerren për periudhën e ardhshme 5 vjeçare për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Hartimi dhe miratimi i këtij plani i cili është i një rëndësie të veçantë për komunën dhe është kërkesë ligjore që del nga Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja dhe po ashtu është pjesë e angazhimeve të komunës për përmbushjen e përgjegjësiave për fuqizimin e qeverisjes lokale. Hartimi i planit është si rezultat i punës së grupit punues të cilët gjatë punës së tyre ka bashkëpunuar ngushtë me të gjitha drejtoritë e komunës, me institucionet tjera relevante të nivelit lokal dhe qendror dhe me specialistë të fushës nga komuniteti dhe organizatat e shoqërisë civile. Hartimi i planit është mbështetur nga fomodet e Komunës së Rahovecit.

Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit është në harmoni me Planin Lokal të Veprimit në Mjedis, me Planin Zhvillimor Komunal dhe me dokumente tjera strategjike dhe zhvillimore të komunës. Ky dokument do të ndihmojë po ashtu edhe në përmbushjen dhe zbatimin e politikave nacionale për përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe plotësimin e kërkesave për realizmin e objektivave që dalin nga dokumentet strategjike për mbrojtjen e ajrit nga ndotja në nivelin qendror.

Për implementimin e këtij plani komuna ka bërë edhe planifikimin e nevojshëm buxhetor por njëkohësisht ky dokument do të shërbejë edhe për të adresuar kërkesat për mbështetje nga donatorët për implementimin e projekteve konkrete të këtij plani.

Me këtë rast shpreh falënderimin tim për të gjithë ata që kontribuan në mënyrë direkte dhe indirekte në finalizimin e këtij dokumenti.

Ju faleminderit,

Smajl Latifi, Kryetari i Komunës së Rahovecit

Grupi punues për hartimin e PLVCA

Përbërja e Grupit Punues për hartimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit, është përcaktuar me vendimin nr.2029, të datës 18.08.2023, të kryetarit të Komunës së Ravovecit. z.Smajl Latifi.

Grupi punues ka këtë përbërje:

- Albnor Mullabazi, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, kryesues;
- Bjondina Ramaj, zyrtare e lartë për Mbrojtje të Mjedisit, anëtare;
- Venhar Topalli, zyrtar i Shërbimeve Publike, anëtar;
- Iir Haxhijaha, zyrtar i lartë Ligjor, anëtar;
- Ilivi Durguti, zyrtar i Bujqësisë, anëtar;
- Jeton Kryeziu, zyrtar i Pylltarisë, anëtar;
- Ardian Rama, zyrtar i Shëndetësisë, anëtar;
- Lulzim Krasniqi, zyrtar i Arsimit, anëtar;
- Fidan Hoti, zyrtar i Zhvillimit Ekonomik, anëtar;
- Zyber Thaqi, zyrtar i Financave, anëtar;
- Alban Gashi, zyrtar i Barazisë Gjinore, anëtar;
- Valmir Gashi, zyrtar i Integrimeve, anëtar;
- Diellza Çanta, zyrtare për eficiencën e energjisë, anëtare;
- Vjollca Gurgule, përfaqësuese nga Shoqëria civile, anëtare;
- Bejtullah Shehu, Shoqata e Bujqve, anëtar.

Sipas vendimit, grupi punues ka për detyrë që të ndërmarrë veprime të orientuara në hartimin e Planit lokal për cilësinë e ajrit në territorin e Komunës Rahovecit, bazuar në legjislacionin në fuqi. Në vendim thuhet se përveç antëtarëve të grupit punues për zbatimin e vendimi do të kujdesen edhe drejtorët e drejtorive të Komunës së Rahovecit.

Grupi punues për hartimin e PLVCA në kuadër të angazhimeve për përgaditjen dhe finalizimin e dokumentit mes tjerash është angazhuar në:

- Sigurimin e të dhënave relevante nga drejtoria përkatëse e komunës për hartimin e planit;
- Pjesëmarrje në takimet e rregullta konsultative dhe në punëtorit e organizuara për hartimin e PLVCA;
- Shqyrtimin e dokumentit dhe plotesimin e tij me komente dhe të dhëna relevante.
- Pjesëmarrje në debatet publike me qytetarë në prezantimin e drafrit të PLVCA.

Indeksi i shkurtesave

AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DEZHT	Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
DUPMM	Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
DSHPK	Drejtoria për Shërbime Publike Komunale
DKRS	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
DPI	Drejtoria e Punëve Inspektuese
DBF	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
DA	Drejtoria për Arsim
FAO	Organizata për Ushqim dhe Bujqësi
GZK	Gazeta Zyrtare e Kosovës
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës
KRM	Komaponia Regjionale e Mbeturinave
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
ME	Ministria e Ekonomisë
MG	Mega Gram
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PLVCA	Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit
PLVM	Plani Lokal i Veprimit në Mjedis
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
VKE	Vlera Kufitare e Emisionit
VML	Vlera Maksimale e Lejuar
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor

Indeksi i tabelave

1. Hyrje

1.1. Baza ligjore për hartimin e PLVCA

Plani Lokal i Veprim për Cilësi të Ajrit (PLVCA) është dokument planifikues - strategjik, për të adresuar zgjidhjen e problemeve të cilësisë së ajrit në nivel lokal.

Hartimi dhe miratimi i tij është paraparë me Ligji Nr. 08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja. Ky ligj në nenin 28 të tij (paragrafi 1) kërkon hartimin e Planit Lokale të Veprimit për Cilësinë e Ajrit (PLVCA) dhe specifikon që: “Për zona dhe aglomerate ku vlerësohet se nivelet e ndotësve në ajër tejkalojnë vlerat kufitare ose të synuara, komuna përgjegjëse për atë zonë apo aglomerat harton Planin Lokal të Veprimit për Cilësinë e Ajrit, për periudhën pesë (5) vjeçare me qëllim të arritjes së vlerave kufitare ose të synuara”.

Sipas dispozitave të këtij neni Plani Lokal i Veprimit për Cilësinë e Ajrit mund të përfshijë edhe masa shtesë të duhura, me qëllim të mbrojtjes së grupeve të ndjeshme të popullatës.

Ky nen po ashtu përcakton edhe përmbajtjen e Planit dhe specifikon që Plani Lokal i Veprimit për Cilësinë e Ajrit duhet të përmban: *informatat e përgjithshme, analizën e gjendjes, llojin dhe vlerësimin e ndotjes, përcaktimin e vendit të ndotjes së lartë, prejardhjen e ndotjes, masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit, detajet e masave të përcaktuara, priorizimin e tyre, afatet e përmbushjes së masave dhe vlerësimin e resurseve financiare dhe autoritetet përgjegjëse për zbatimin e masave.*

Ligji përmes nenit 28 kërkon nga Komuna përkatëse që: *gjatë hartimit të Planit komuna ia dorëzon Ministrisë draftin për dhënie të komenteve (neni 28, paragrafi 4) dhe po ashtu pas miratimit të Planit komuna ia dorëzon atë Ministrisë (neni 28, paragrafi 5).*

Gjithashtu: *Komuna është e obliguar t'i zbatojë dhe financojë masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit të parapara në Planin Lokal të Veprimit për Cilësinë e Ajrit (neni 28, paragrafi 6) dhe ndotësit janë të obliguar t'i zbatojnë dhe financojnë masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit të parapara në Planin Lokal të Veprimit për Cilësinë e Ajrit (neni 28, paragrafi 7).*

Përveç, Planit Lokal të Veprim për Cilësi të Ajrit, sipas Ligji Nr. 08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, komunat duhet të hartojnë edhe Planet Afatshkurta të Veprimit (neni 29).

Në mënyrë më specifike në pikën 1 të nenit 29 thuhet se: *“nëse në një zonë ose aglomerat të caktuar ekziston rreziku nga tejkalimi i pragut të alarmit të ndotjes, komuna për atë zonë ose aglomerat harton Planin Afatshkurtër të Veprimit, i cili përmban masat që duhet të ndërmerren në afat të shkurtër, me qëllim të zvogëlimit të rrezikut dhe/ose uljes së ndotjes”*.

Plani Afatshkurtër i Veprimit varësisht nga rastet individuale, mund të parasheh masat efektive të kontrollit dhe ku është e nevojshme, të ndaloj veprimtaritë të cilat shkaktojnë rrezik të tejkalimit të vlerave kufitare, vlerave të synuara ose pragut të alarmit (neni 29, pika 2) dhe mund të përfshijë masa lidhur me: qarkullimin e mjeteve motorike, veprimtaritë ndërtimore, punën e stabilimenteve industriale, përdorimin e prodhimeve industriale, ngrohjen në amvisëri dhe t’i parasheh edhe veprimtaritë specifike, me qëllim të mbrojtjes së grupeve të ndjeshme të popullatës (neni 29, pika 3). Komuna obligohet që të informojë publikun, përfshirë palët e interesuara për rezultatet e kërkimeve të bëra, realizimin dhe përmbajtjen e Planit Afatshkurtër të Veprimit si dhe zbatimin e këtij plani (neni 29, paragrafi 5), ndërsa ndotësi është i obliguar t’i zbatoj dhe financoj masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit, të përcaktuara në Planin Afatshkurtër të Veprimit (neni 29, paragrafi 6).

1.2. Qëllimi dhe objektivat e PLVCA

Qëllimi i përgjithshëm i Planit Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit për komunën e Rahovecit është që të definojë veprimet për menaxhimin e cilësisë së ajrit përbrenda territorit të komunës për periudhën pesë vjeçare.

Objektivat specifike të planit janë:

- Të bëjë vlerësimin e gjendjes ekzistuese të cilësisë së ajrit, llojet dhe burimet kryesore të ndotjes së ajrit;
- Të identifikoj dhe përcaktoj problemet kryesore në menaxhimin e cilësisë së ajrit në territorin e komunës;
- Të identifikoj dhe përcaktoj prioritetet kryesore që do të adresohen në kuadër të PLVCA-së për periudhën 5 vjeçare;
- Të planifikoj dhe përcaktoj masat për zvogëlimin e ndotjes, afatet kohore, aktivitetet, projektet, burimet e financimit dhe autoritetet përgjegjëse për zbatimin e masave dhe prioritetëve.

1.3. Procesi dhe metodologjia e hartimit të PLVCA

Në kuadër të aktiviteteve për hartimin e këtij plani, në prill të vitit 2023 Komuna e Rahovecit ka lidhë kontratë me kompaninë “Albo Group” shpk për hartimin e PLVCA-së. Me 18.08. 2023, përmes vendimit nr.2029 është themeluar grupi punues për hartimin e PLVCA, që ka udhëhequr procesin e hartimit të planit.

Metodologjia e hartimit të planit dhe përcaktimit të prioritetëve të tij është orientuar duke u bazuar në:

- **Identifikimin e presioneve kryesore** në cilësinë e ajrit të komunës së Rahovecit, që vijnë nga sektorët e ndryshëm zhvillimor bazuar në të dhënat ekzistuese dhe trendet e tyre.
- **Analizën e gjendjes ekzistuese** të cilësisë së ajrit në Komunën e Rahovecit ku është bërë prezantimi i gjendjes aktuale të parametrave të cilësisë së ajrit bazuar në të dhënat nga monitoimi i cilësisë së ajrit që realizohet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Kjo analizë shërben për të pasur një ide më të qartë të problemeve kryesore në sektorin e ajrit që ka komuna.
- Identifikimi i **problemeve kryesore** që ndërlidhen me cilësinë e ajrit të cilat do të trajtohen për zgjidhje në kuadër të PLVCA duke marrë për bazë kapacitetet financiare dhe zhvillimore të komunës dhe mundësitë e zgjidhjes së tyre.
- Duke u bazuar në këto probleme mjedisore janë **përcaktuar prioritetet kryesore** për përmirësimin e cilësisë së ajrit për periudhën 5 vjeçare.
- Bazuar në prioritetet kryesore mjedisore është propozuar edhe **plani i veprimeve për përmbushjen e këtyre prioritetëve**, që do të shërbejnë komunës për të hartuar projektet konkrete të mbështetura nga buxheti i komunës apo nga sigurimi i fondeve nga donatorët.
- Për të siguruar një implementim më efikas të PLVCA është propozuar **Plani i monitorimit për zbatimin** e tij, ku janë përcaktuar edhe treguesit përkatës të monitorimit sipas prioritetëve.

2. Korniza institucionale, strategjike dhe ligjore për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

2.1. Përgjegjësitë institucionale

Ministria e Mjedisit, Planifikimit dhe Infrastrukturës (MMPHI)- është përgjegjëse për hartimin e politikave për menaxhimin e cilësisë së ajrit në Kosovë. Deri më sot ka përpiluar legjislacionin i cili bazohet në legjislacionin e BE-së dhe është i përshtatur me gjendjen socioekonomike të vendit. Korniza legjislative që rregullon mbrojtjen e ajrit nga ndotja është Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja (Nr. 08/L-025) i cili kategorizon burimet kryesore të ndotjes, vendos indikatorët dhe obligimet themelore për mbrojtjen e ajrit si dhe rekomandon miratimin e vlerave kufitare të emisioneve (VKE) dhe normat e cilësisë së ajrit, konform standardeve të BE-së dhe OBSH.

Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK)- Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës siguron informacionin e duhur për administratën, Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës për zbatimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit. Zhvillon dhe koordinon sistemin unik të informimit për mbrojtjen e mjedisit lidhur me sistemin e përcjelljes së gjendjes së mjedisit në Kosovë si dhe mbledhë të dhënat për mjedisin. Agjencioni është përgjegjës për monitorimin dhe mbledhjen e të dhënave për gjendjen e ajrit mjedisit në Kosovë në përgjithësi dhe cilësisë së ajrit në veçanti. Këtë Agjencioni e realizon përmes Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës dhe Drejtorisë për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit.

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) - Ndërton dhe mirëmban rrjetin themelor të stacioneve për monitorimin e cilësisë së ajrit. Bënë matjet dhe vrojtimet e elementeve dhe dukurive: hidrologjike, meteorologjike, biometeorologjike dhe hidrobiologjike, matjet dhe vrojtimet e elektricitetit atmosferik dhe ndotjes së ajrit, ujit, të reshurave. Sistematikisht përcjellë dhe konstaton gjendjen e cilësisë së ajrit.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT)- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është përgjegjës për monitorimin e cilësisë së karburanteve të lëngëta të naftës. Me UA Nr. 01/2020 për cilësinë e karburanteve të lëngëta dhe të naftës Ministria ka përcaktuar vlerat e lejuara të përbërësve dhe të treguesve të cilësisë së karburanteve të lëngëta të naftës, metodat për testim, mënyrën e mbikëqyrjes dhe monitorimit të cilësisë së karburanteve të lëngëta të naftës në pikat doganore dhe në treg të brendshëm. Inspektorati i tregut në kuadër të MTI-së është përgjegjës për zbatimin e

programit për numrin dhe shpeshtësinë e mostrimeve dhe testimeve, testet laboratorike të kërkuara për secilin derivat, shpeshtësinë e ritestimeve për rezultate krahasuese ndërmjet laboratoreve.

Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik (IKSHP) - Është përgjegjës për shëndetin publik në nivel të vendit dhe vlerësimin e ndikimeve në shëndetin publik përfshirë edhe ndikimet e mjedisit në shëndetin publik.

Pushteti Lokal (Komunat)- Bazën ligjore për mbrojtjen dhe monitorimin e cilësisë së ajrit komunat e kanë te kompetencat vetanake në mbrojtjen e mjedisit lokal, sipas Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetqeverisjen Lokale dhe Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja (Nr. 08/L-025), Komunat miratojnë Planet Lokale të Veprimit në Mjedis (PLVM) dhe programet për mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me Strategjinë e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Planin e Kosovës për Veprim në Mjedis sipas interesave specifike të saj.

Operatorët ekonomik- Po ashtu edhe operatorët ekonomik kanë obligime ligjore që të vetëorganizojnë monitorimin e cilësisë së ajrit dhe emisionet në ajër në zonën e veprimit të tyre.

2.2. Korniza strategjike dhe programore

Strategjia e Mbrojtjes së Mjedisit 2013-2022 (në proces të rishikimit) - Trajton obligimet për menaxhimin e mjedisit në nivel shtetëror dhe ndërkombëtar. Në kuadër të kësaj strategjie përfshihen edhe synimet strategjike për sektorin e ajrit.

Strategjia për Cilësinë e Ajrit për vitin 2013-2022 (në proces të rishikimit)- E aprovuar në Kuvend me datën 19.12. 2013, Nr. 04/V-741. Kjo strategji ka tri prioritet kryesore për përmirësimin dhe mbrojtjen e ajrit për dhjetë vitet e ardhshme: transpozimi i direktivave të BE, në legjislacionin e Kosovës dhe implementimi i tij, sigurimi i kornizës për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, në bashkëpunim me të gjithë komunitetet, promovimi i rëndësisë së cilësisë së ajrit si përcaktues i shëndetit dhe mirëqenies së popullatës.

Plani i Veprimit për Cilësi të Ajrit 2018-2020- Përcakton masat, veprimet dhe projektet për përmirësimin e cilësisë së ajrit për periudhën 2018-2020, dhe është në harmoni me objektivat dhe synimet e Strategjis për Cilësinë e Ajrit për vitin 2013-2022.

Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve- Dokumenti i referohet udhëzimeve për politika nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për sa i përket përgatitjes së Planeve Kombëtare për Zvogëlimin e Emisioneve ku kërkohet të arrijnë zvogëlime të konsiderueshme të emisioneve nga impiantet ekzistuese me djegie nga 1 janari i vitit 2018 deri më 31 dhjetor 2027 dhe përcaktimin e vlerave të kufirit të emisioneve për impiantet me djegie të mëdha.

Rezoluta e Kuvendit të Kosovës për Përmirësimin e Cilësisë së Ajrit - e miratuar me 1 shkurt 2018, paraqet një përmbledhje të masave, rekomandimeve dhe kërkesave për përmirësimin e cilësisë së ajrit në Kosovë.

Strategjia dhe Plan i Veprimit për Ndryshime Klimatike 2019-2028 dhe Plan i Veprimit - Synon zvogëlimin e rreziqeve dhe dëmeve nga ndikimet aktuale dhe të ardhshme të ndryshimeve klimatike me një kosto efektive dhe duke shfrytëzuar përfitimet të cilat mund të i sjellin ndryshimet klimatike.

Strategjia e Transportit Multimodal 2023-2030- Synon sigurimin e një transporti të sigurt dhe të qëndrueshëm për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe konkurrencën ekonomike. Mes tjerash objektivat e strategjisë synojnë edhe uljen e shkarkimeve në ajër nga sektori i transportit.

Plani Zhvillimor Komunal për Komunën e Rahovecit 2023-2031- është dokumenti kryesor që mbështetë planifikimin e qëndrueshëm, të barazpeshuar dhe afatgjatë të territorit të komunës, përmes të cilit racionalizohet dhe funksionalizohet shfrytëzimi hapësinor i saj, përmirësohet aspekti social, ekonomik dhe mjedisor. Në kuadër të kapitullit Mjedisi dhe Siperfaqet me Rrezikshmëri, në këtë dokument janë trajtuar edhe aspektet e menaxhimit të ndotjes së ajrit dhe janë përcaktuar kahjet zhvillimore të këtij sektori.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Rahovecit 2019-2024- është dokumenti kryesor planifikues në nivelin lokal për sektorin e mjedisit. PLVM përfshin zhvillimin e vizionit të komunitetit, vlerësimin e çështjeve mjedisore, përcaktimin e prioritetëve, identifikimin e strategjive më të përshtatshme për adresimin e problemeve kryesore dhe zbatimin e veprimeve me qëllim të arritjes së përmirësimeve reale mjedisore dhe shëndetësore. Në një kapitull të vecantë të këtij dokumenti janë trajtuar edhe aspektet e cilësisë së ajrit si dhe janë përcaktuar veprimet e nevojshme për përmirësimin e gjendjes për periudhën kohore 2019-2024.

Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave, Komuna Rahovec 2022-2027 - është dokumenti kryesor planifikues në nivelin lokal për sektorin e menaxhimit të mbeturinave. Ky dokument përfshin objektivat strategjike dhe planin e veprimit për menaxhimin e mbeturinave. Në mënyrë direkte disa nga aktivitetet e planifikuara të planit do të ndihmojnë në reduktimin e ndotjes së ajrit nga sektori i mbeturinave për periudhën kohore 2022-2027.

Plani i Mobilitetit Urban për Komunën e Rahovecit 2022-2027- është dokumenti kryesor planifikues në nivelin lokal për sektorin e mobilitetit. Ky dokument përfshin vizionin, objektivat strategjike dhe planin e veprimit për mobilitetin urban. Në mënyrë direkte disa nga aktivitetet e planifikuara të planit do të ndihmojnë në reduktimin e ndotjes së ajrit nga sektori i transportit për periudhën kohore 2022-2027.

Draft Plani Lokal për Energji dhe Klimë 2023-2033- është dokumenti kryesor planifikues në nivelin lokal për sektorin e energjisë dhe klimës. Ky dokument përfshin vizioni, objektivat strategjike dhe planin e veprimit për energjinë dhe klimën. Në mënyrë direkte aktivitetet e planifikuara të planit përveç që do të ndikojnë në rritjen e efikasitetit të energjisë dhe rritjen e shfrytëzimit të burimeve të ripërtrishme të energjisë do të ndikojnë edhe në reduktimin e emetimit të gazrave serra si dhe në reduktimin e ndotjes së ajrit nga sektori i energjisë dhe nga sektorët tjerë zhvillimorë 2023-2033.

2.3. Korniza ligjore

MMPHI si përgjegjëse për menaxhimin e cilësisë së ajrit ka kompletuar legjislacionin për këtë fushë, bazuar në legjislacionin e BE dhe përshtatur me gjendjen socio ekonomike të vendit. Dy ligjet bazike që rregullojnë çështjet që ndërlidhen me mbrojtjen e ajrit nga ndotja janë:

- ✓ Ligji i mjedisit Nr.03/L-025;
- ✓ Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025.

Aktet nënligjore që rregullojnë fusha specifike të menaxhimit të cilësisë së ajrit janë:

- ✓ Udhëzimi Administrativ (QRK)-Nr.07/2021 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;
- ✓ Udhëzimi Administrativ (QRK) Nr.02/2011 për normat e cilësisë së ajrit,
- ✓ Udhëzimi Administrativ- (MMPHI) Nr.09/2023 për mënyrën e monitorimit të cilësisë së ajrit, mbledhjen e të dhënave, kriteret dhe metodologjinë;
- ✓ Udhëzim Administrativ (QRK)-Nr.21/2013 për arsenin, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajër;
- ✓ Udhëzim Administrativ (QRK) - Nr.08/2016 për normat e lejuara të shkarkimeve në ajër nga burimet e lëvizshme të ndotjes.

Në mënyrë indirekte në cilësinë e ajrit ndikojnë edhe sektorë të tjerë andaj në raste të veçanta duhet të ndërmerren për bazë edhe ligje dhe udhëzime tjera administrative tjera sikurse janë:

- **Ligji i mbeturinave (Ligji 04/L-060)**, në rastet e parandalimit të djegies së mbeturinave në ambiente të hapura por edhe për ngrohje;
- **Ligji për performacën e energjisë në ndërtesa (Nr. 05/L-101)**, që rregullon kërkesat për izolimin e ndërtesave në shërbim të krusimit të energjisë dhe uljen e emisioneve në ajër;

- **Ligji nr. 08/L për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për automjete (Nr. 05/L-132),** që kufizon importin e veturave më të vjetra se 10 vite me qëllim të parandalimit të emetimeve në ajër nga automjetet jashtë standardeve të EURO.
- **Ligji për tregti me produkte të naftës dhe karburante të ripërtritshme (Ligji Nr. 08/L-018),** që regullon standardet dhe kualitetin e naftës dhe derivate të saj që importohet në Kosovë, me qëllim të parandalimit të emisioneve në ajër nga cilësia e dobët e naftës dhe derivateve të saj.
- **Udhëzimi Administrativ (Nr.10/2022) për kontrollin teknik të automjeteve-** që përcakton normat e lirimit të gazrave të motorëve në atmosferë gjatë kontrollimit teknik.
- **Udhëzimi Administrativ (Nr. 09/2020) për kontrollin dhe cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës–** që përcakton vlerat e lejueshme në cilësinë e karburanteve të lëngshme të derivuara nga nafta në përputhje me standardet e aplikueshme evropiane.

3. Profili i Komunës

3.1. Pozita gjeografike dhe relievi

Rahoveci është qytet dhe komunë në pjesën jug-perëndimore të Kosovës. Në veri kufizohet me Klinën, në lindje me Suharekën, në pjesën jugore gjendet komuna e Prizrenit, ndërsa në tërë pjesën perëndimore kufizohet me komunën e Gjakovës. Përafërsisht ka diku 276 km² dhe është vendbanim i 56,208 banorëve.

Territori i komunës së Rahovecit përfshihet në regjionin e Prizrenit dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Shtrihet në pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik dhe i takon Evropës juglindore.




Figura 1: Pozita gjeografike e komunës së Rahovecit

Ky territor përfshin pjesën qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit dhe është i ndarë në tri tërësi ose mikro regjione e këto janë: rafshirë-luginore, kodrinore dhe malore. Territori i komunës shtrihet në hemisferën veriore të Ekuadorit me shkallë 420 e

30' dhe 420 e 50' të gjërsisë veriore gjeografike dhe ndërmjet 200 e 21' dhe 200 e 55' të gjatësisë lindore gjeografike.

Vendbanimet në komunën e Rahovecit janë të koncentruara në lartësitë mbidetare prej 310 m. (Krusha e Madhe pjesa e re e vendbanimit pjesa lindore të bregut të lumit Drini i Bardhë) deri në 920 m. lartësi mbidetare që është i koncentruar vendbanimi i Zatriqit.

Për nga lartësia mbidetare këto vendbanime ndahen në luginore-rrafshirë, kodrinore dhe malore. Vendbanimet të cilat janë të përfshira në luginë ose rrafshirë janë këto : (310 – 350 m.) Xërxa, Fortesa, Gexha, Malësia e Vogël, Drinasi, Denji, Dabidoli, Çifllaku, Nagaci, Hoça e Vogël dhe Retia.

Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lartësitë mbidetare prej 350 – 600 m që i takojnë kategorisë së vendbanimeve kodrinore janë : Rahoveci, Drenoci, Senovci, Pastaselli, Palluzhë, Kramoviku, Mrasori, Hoça e Madhe, Apterushë, Zaçishti, Patoçani i Ulët, Patoçani i Epërm, Nashpalla, Bratotini, Vranjaka, Celina dhe Krusha e Madhe (edhe pse disa pjesë të reja të vendbanimeve të këtyre fshatrave u takojnë pjesës së kategorisë së luginave ose rrafshirave).

3.2. Kushtet klimatike

Pozita gjeografike e Rahovecit me rrethinë ka kushtëzuar që në këtë regjion të dominojë klima e mesme kontinentale me një ndikim të klimës mediterane, e cila depërton përmes luginës së Drinit të Bardhë. Komuna e Rahovecit karakterizohet me verë të nxehtë dhe me dimër të ftohtë, ku muaji më i nxehtë është muaji korrik dhe muaji më i ftohtë është muaji shkurt.

Në bazë të shënimeve shumë vjeçare klimatike, lokaliteti i Rahovecit karakterizohet me këto veçanti meteorologjike:

- Temperatura mesatare vjetore është +11.8 °C,
- Muaji më i ftohtë i vitit është shkurti me temperaturë minimale -0.14.5 °C,
- Muaji më i nxehtë i vitit është korriku me temperaturë maksimale +38.5 °C,
- Sasia e reshjeve vjetore është 765 mm.
- Më së shpeshti fryejnë erërat e veirut (11.8 %), veri-lindja, (62%), përendimi (50 %), jugu (17%), dhe jug-lindja (4%).

3.3. Popullsia dhe vendbanimet

Sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 2011 popullsia rezidente e Komunës është 56.208 banorë, të shpërndarë në 37 vendbanime me një numër total të amvisërive rezidente prej 8221 ekonomi familjare. Popullsia jeton në gjithsej 37 vendbanime, prej tyre 36 janë fshatra dhe vetë qyteti i Rahovecit. Këto vendbanime kanë dallime të theksuara sa i përket numrit të popullsisë. Në qytetin e Rahovecit jetojnë rreth 15892 banorë që do të

thotë se rreth 29 % e popullsisë së tërësishme jeton në këtë qytet, ndërsa në të gjitha vendbanimet tjera jetojnë rreth 40316 banor apo rreth 71 %.

Në tabelën në vijim është paraqitur popullsia e Komunës së Rahovecit sipas regjistrimit të vitit 2011.

Tabela 1: Popullsia e Komunës së Rahovecit

Nr. Popullsisë	Nr. Populls. Urbane	Nr. Populls. Rurale	Nr. Ek.familjare totale	Nr. Bisneseve	Nr. Institucione
56,208	15,892	40,316	9,927	3000	73

Tabela 2: Shpërndarja e popullsisë sipas vendbanimeve

Nr.	Vendbanimi	Nr. Banoreve	Nr.	Vendbanimi	Nr. Banoreve
1	Rahovec	15892	19	Nushpal	220
2	Bellacerkë	2270	20	Opterushë	1911
3	Bërnjak	40	21	Pastasellë	1011
4	Bratotin	396	22	Pataqan I Eperm	533
5	Brestovc	1288	23	Pataqan I poshtem	1077
6	Celinë	1903	24	Petkoviq	731
7	Çifllak	1292	25	Polluzhë	808
8	Dobidol	799	26	Radostë	2346
9	Dejnë + Baboc	1757	27	Ratkoc	3791
10	Drenoc	1587	28	Retijë e Ulet	234
11	Gexhë	660	29	Retijë	771
12	Hogë e Madhe	124	30	Sapniq	996
13	Hogë e Vogel	1166	31	Sarosh	6
14	Kaznik	164	32	Senoc	687
15	Kramovik	1125	33	Vrajakë	838
16	Krushe e Madhe	4473	34	Xërxë	3184
17	Mrasor	191	35	Zatriq	535
18	Nagavc	743	36	Zoqishtë	659
			TOTALI		56208

Pjesa më e madhe e vendbanimeve të komunës së Rahovecit kanë më tepër se 1000 banorë. Numër më të madh të popullsisë ka vet qyteti i Rahovecit (15892 b). Sa i përket vendbanimeve rurale, numër më të madh të banorëve kanë vendbanimet: Krushë e Madhe (4473 b), Ratkoc (3791 b), Xërxë (3184 b), Radost (2346 b), Bellacerka (2270 b), Opterush (1911 b). Ndërsa vendbanimet që kanë numër më të vogël të popullsisë janë: Bërnjak (40 b), Kaznik (164 b). Mrasor (191 b), Nashpall (220 b).

Komuna e Rahovecit karakterizohet me vendbanime sipas shumëllojshmërisë pa ndonjë standart të caktuar urbanistik, ku sipas të dhënave ndërtimi ka marrë vrull pas viteve 2000 dhe janë krijuar hapësira të reja me ndërtime banesore shumëkatëshe për

arsye të rritjes së numrit të popullatës (shkalla e lartë e natalitetit, migrimi). Kjo kërkesë theksohet sidomos me shkatërrimet e bëra gjatë luftës.

4. Ndikimet sektoriale në cilësinë e ajrit

4.1. Energjia dhe ngrohja

Qyteti i Rahovecit nuk ka ngrohje qendrore. Në komunën e Rahovecit janë rreth 70 ndërtesa publike dhe 10,532 ekonomi familjare (ndërtesa rezidenciale) dhe 2966 biznese aktive që përdorin burime të ndryshme të energjisë për ngrohje.

Në tabelën 3 janë prezantuar të dhënat për përdorimin e lëndëve djegëse në Komunën e Rahovecit sipas llojeve. Nga të dhënat shihet se lënda dominuese djegëse është druri dhe energjia elektrike.

Tabela 3: Përdorimi i lëndëve djegëse në komunën e Rahovecit (MWh)

	Energji elektrike	LPG	Dizel	Thëngjill	Biomasë drunore	Gjithsejt
Ndërtesat publike	761.8	0	974.2	109.3	4,262.9	6,108.2
Ndërtesat terciare (jo komunale), pajisjet dhe objektet	17,999.3	12,054.0	4,325.4	2289.1	43,112.1	79,779.9
Ndërtesat rezidenciale	54,594.3	11,327.7	0	1361.7	226,349.5	293,674.8

Sipas një hulumtimi të realizuar nga FAO, konsumi mesatar vjetor i drurit për djegje në komunën e Rahovecit në amvisëritë e zonave rurale është 9.34 m³. Ndërsa konsumi mesatar vjetor i drurit për djegje në amvisëritë urbane është 8.24 m³. Po sipas këtij vlerësimi numri i ekonomive familjare rurale që përdorin drurin si lëndë djegëse është 5777 me konsum prej 49,809 m³ dru në vit¹.

4.2. Industria prodhuese dhe bizneset

Ekonomia lokale në Komunën e Rahovecit, bazohet kryesisht në industrinë agro-industriale, përpunimin e rrushit dhe të grurit, industrinë e plastikës, ndërtimtarisë, teknologjinë përpunuese të metaleve, teknologjive për ngrohje dhe ftohje, artizanate ,tregëti, shërbime etj. Pjesëmarrja e veprimtarive prodhuese dhe shërbyese në krahasim

¹ Sektori i Biomassës Drunore në Kosovë, FAO 2015

me veprimtaritë tjera ekonomike është e konsiderueshme, duke treguar një pjesëmarrje më të madhe në biznesin privat.

Pas luftës, ndërmarrjet e vogla kanë shfaqur tendencën për shfrytëzimin dhe përpunimin e gurit, rërës, zhavorrit dhe argjilës, evidente me një shkatërim joselektiv të resurseve.

Sipas statistikave, në vitin 2011 janë 3215 biznese të regjistruara në zyrën për regjistrim të bizneseve, ndërsa gjatë periudhës 2000-2021 janë të regjistruara gjithsejtë 3390 biznese.

Nga këto biznese 2966 janë aktive, 249 biznese pasive dhe 384 biznese janë shuar. Në strukturën e bizneseve dominojnë ato të tregtisë me shumicë dhe pakicë pastaj ato të prodhimit dhe përpunimit, të ndërtimit dhe akomodimit dhe ushqimit.

Në aspektin mjedisor, në komunën e Rahovecit nuk ka ndonjë industri që veprimtarinë e saj e ka të bazuar në djegje të burimeve fosile dhe që karakterizohet me emetime të larta në ajër.

Tabela 4: Bizneset në Komunën e Rahovecit

Përshkrimi	Numri
Biznese të regjistruara 2000-2021	3390
Biznese aktive	2966
Biznese pasive	249
Biznese të shuara	384

4.3. Sektori minerar

Në territorin e Komunës së Rahovecit ka rezerva të gurit dekorativ dhe minerale si krom, azbest, nikel, kobalt, bakër dhe qymyr guri (thëngjilli). Gurët dekorative: gjendet në afërsi të fshatit Drenovc, në një largësi prej 5, 5 km nga qyteti i Rahovecit. Rezervat për këtë material ndërtimor dekorativ mendohet të jenë rreth 207.386 m³.

Në territorin e Komunës së Rahovecit, veprojnë disa operatorë që kanë si veprimtari shfrytëzimin e gurit, rërës dhe zhavorrit dhe disa të tjera që kanë si veprimtari hulumtimin e rezervave të gurit, rërës dhe zhavorrit (tabela 5). Disa nga këto veprimtari sidomos ato të shfrytëzimi të rërës dhe zhavorrit janë ilegale ose janë në procedurë në gjykatë. Këto veprimtari krahas dëmtimit estetik të peisazhit dhe shtretërëve të lumenjëve karakterizohen edhe me emetime të pluhurit në ajër.

Në veçanti operatorët e shfrytëzimit të gurit të fortë ndërtimorë gjatë procesit të thërmimit dhe bluarjes janë burim i emetimit të grimcave të pluhurit.

Tabela 5: Operatorët ekonomik në sektorin mineral në komunën e Rahovecit²

Operatorët sipas kategorive	Nr. i operatorëve
Shfrytëzimi i gurit të fortë ndërtimorë	3 operatorë
Hulumtim i rezervave të gurit të fortë ndërtimorë	2 operatorë
Shfrytëzim i rërës dhe zhavorrit	20 operatorë

4.4. Transporti

Pozita gjeografike e komunës së Rahovecit në të cilën kalojnë rrugë të rëndësishme i mundësojnë komunikim të mirë dhe mjaft efikas, ku në nivel të komunës administrative të komunës janë të shtrira gjithsejtë 297.6 km rrugë të të gjitha kategorive. Nëse analizohet niveli i mbulushmërisë së sipërfaqes së komunës me rrugë të të gjitha kategorive del se ato janë të shtrira në gjithsejtë 157.1 ha.

Komuna e Rahovecit karakterizohet me lidhje shumë të mira të komunikacionit rrugor të cilat ndihmojnë zhvillimin e transportit të udhëtareve dhe të mallrave. Shtrirja e rrugëve Regjionale kryesisht në pjesën qendrore dhe perëndimore të komunës ia ka shtuar rëndësinë kësaj hapësirë. Në komunën e Rahovecit ekziston niveli i katër kategorive të rrugëve (të klasifikuara në Kosovë), duke filluar prej rrugëve magjistrale e deri tek ato të pa kategorizuara.

Rrjeta e rrugëve në komunën e Rahovecit përbehet nga:

- Rrugët magjistrale – M9.1 (Gjakovë - Prishtinë)
- Rrugë regjionale - (R107 Prizren-Gjakovë, R117 Rahovec-Suharekë, R111 Xerxë Ratkoc-Kramovik, R204 Rahovec- Krushë e Madhe, R110 Malishevë- Rahovec – Xerxë
- Rrugë lokale (rrugët të cilat i lidhin 34 komuna kadastrale me gjithsej 37 vendbanime, duke përfshirë edhe rrugët që lidhin lagjet më të rëndësishme të vendbanimeve)
- Rrugë të pa kategorizuara (të cilat lidhin lagjet e fshatit si dhe i lidhin të gjitha hapësirat në të cilat zhvillohen aktivitete socio-ekonomike).

Nga totali i përgjithshëm i rrugëve 297.6 km, sa janë në komunën e Rahovecit sipas gjatësisë, rrugë magjistrale janë 6.2 km (2.1%), rrugë regjionale 64.3 km (21.6%), rrugë lokale 114 km (38.3%), rrugë urbane 30.6 km (10.3%) dhe rrugë të pa kategorizuara janë gjithsej 82.5 km (27.7%). Duke iu referuar analizave të bëra në nivel të komunës, janë

² <http://opendata.cohu.org/sq/degradimi-mjedisit>

nxjerr edhe sipërfaqet e mbuluara me rrugë dhe aktivitete të tjera përcjellëse sipas kategorisë së tyre (tabela 6).

Tabela 6: Rrjeta e rrugëve në komunën e Rahovecit

	Pershkrimi	Gjatësia në km	%
1	Rruge magjistrale	62	2.1
2	Rruge regjionale	64.3	12.6
3	Rruge urbane	30.6	10.3
4	Rruge lokale	114	38.3
5	Rruge e pakategorizuar	82.5	27.7
	Total	297.6	100

4.5. Menaxhimi i mbeturinave

Bazuar në Ligjin për mbeturina (Ligji 04/1-60), dhe Rregulloren Komunale për Menaxhim të Mbeturinave, komuna e ka të krijuar sistemin për menaxhim të mbeturinave për territorin e vet.

Në komunën e Rahovecit grumbullimin, bartjen dhe deponimin e mbeturinave e kryen Kompania Rajonale “Ekoregjioni”. Mbledhja e mbeturinave bëhet në dy mënyra: kryerja e shërbimit me kontejnerë 1,1 m³ dhe 7 m³ dhe kryerja e shërbimit derë me derë (shtëpi për shtëpi). Sipas të dhënave nga AMMK Komuna e Rahovecit, ka mbulueshmëri me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave për ekonomi familjare në shkallë prej 100%.

Mbeturinat e grumbulluara dërgohen në Deponinë sanitare të mbeturinave në Landovicë të Prizrenit. Sipas të dhënave nga KRM “Ekoregjioni”, sasia vjetore e mbeturinave që grumbullohet dhe dërgohet në deponi është 14,426.90 ton/vit. Gjenerimi për kokë banori ishte 200.35 kg/vit.

Deponitë ilegale të mbeturinave janë një ndër problemet kryesore të menaxhimit të mbeturinave në komunë. Në vitin 2021 janë evidentuar 10 deponi ilegale të mbeturinave, pjesa më e madhe e të cilave ishin deponi të mbeturinave komunale (20%), deponi të mbeturinave të ndërtimit dhe demolimit (30%) dhe deponi mikse (50%). Sipas madhësisë, 3 deponi ilegale janë kategorizuar si të mëdha, 3 deponi të mesme dhe 4 deponi të vogël.

Tabela 7: Treguesit e menaxhimit të mbeturinave në komunën e Rahovecit (2021)³

Numri i banorëve (ASK 2011)	56,208
Numri i ekonomive familjare (ASK 2011)	8,221
Numri i ekonomive familjarë të shërbyera (2021)	10,532
Shkalla e mbulimit me shërbim për ekonomi familjare (2021)	100 %
Numri i bizneseve që pranojnë shërbimin (2021)	1026
Numri i institucioneve që pranojnë shërbimin (2021)	57
Shkalla e mbulimit me shërbim për institucione (2021)	100%
Mbeturina të grumbulluara ton/vit	14,426.90
Mbeturina të grumbulluara kg/vit	14,426,900.00
Gjenerimi i mbeturinave komunale kg/vit	200.35
Gjenerimi i mbeturinave komunale kg/dit	0.55

Edhe në komunën e Rahovecit, sikurse në shumicat e komunave të Kosovës, djegja e hapur e mbeturinave apo edhe përdorimi i mbeturinave për ngrohje është një dukuri që ndodhë. Ky proces është burim i ndotjes së ajrit dhe shkarkimeve në ajër.

4.6. Bujqësia

Duke marrë parasysh kushtet e favorshme topografike⁸, klimatike dhe agro-ekologjike puna në bujqësi, vreshtari dhe verari përbën aktivitetin themelor ekonomik në Rahovec në të gjitha aspektet duke përfshirë prodhimin, burimin e të ardhurave dhe punësimin. Rreth 90% të tokës së komunës së Rahovecit përdoret si tokë punuese për bujqësi, e sidomos tokat kodrinore që përdoren si territore vreshtare. Toka e punueshme prej total cca 14000 Ha, është e mbuluar me sistem të ujitjes nga Drini i Bardhë në sipërfaqe prej 3500/Ha. Rreth 70% e popullsisë në qytet dhe fshat sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore si në vreshtari dhe perimtari, etj.

Tabela 8: Destinimi i shfrytëzimit të sipërfaqes së tokës

Destinim i sipërfaqes	%
Pyje (6932 ha)	25.2
Kullosa (3921 ha)	14.2
Livadhe (252ha)	0.9
Degradim (403 ha)	1.5
Sip_bujgesore (12020 ha)	43.6
Vreshtat (2415 ha)	8.8
Zonat e ndertuara (1310 ha)	4.8

³ Raporti i menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë për vitin 2020, AMMK 2021

Lumi (193 ha)	0.7
Varrezat (104 ha)	0.4

Numri i ekonomive familjare apo fermave mendohet të jetë rreth 4815. Sasia e sipërfaqes së tokës bujqësore në pronësi të një ferme sillet prej 0.5 -2 Ha, ku kemi të bëjmë me parcelizimin e tokës, të disfavorshme për zhvillimin e një bujqësie intensive. Duke llogaritur që një familje ka mesatarisht 7 anëtarë, numri i përgjithshëm i banorëve që jetojnë vetëm nga të ardhurat nga puna në bujqësi (ekonomi për ekzistencë) rezulton të jetë rreth 33,700 banorë.

Prodhimtaria e rrushit dhe produkteve të tij ka traditë mijëvjeqare. Këto të dhëna vërtetojnë ekzistencën e kësaj prodhimtarie që në shekullin e parë të erës së re.

Ndikimi në cilësinë e ajrit nga bujqësia vjen si rezultat i përdorimit të plehrave kimike dhe aktivitetëve bujqësore që ndërliken me përdorimin e lëndëve djegëse. Në tabelën vijuese është prezantuar sasia e vlerësuar e përdorimit të plehrave kimike në komunën e Rahovecit.

Tabela 9. Sasia e plehrave kimike të përdorura dhe përmbajtja e azotit

Lloji i plehut kimik	Sasia e përdorur kg/vit ⁴	Sipërfaqja e tokës se plehrosur	Sasia totale kg/vit
UREA	139 kg/ha	14687 ha	2,041,498
NPK	259 kg/ha	14687 ha	3,803,933
NAG	74 kg/ha	14687 ha	1,086,172

4.7. Pylltaria

Pyjet përbëjnë rreth 25% të sipërfaqes së përgjithshme ose rreth 6932 ha. Në pjesën kodrinore dominojnë pyjet me mjaft lloje dhe janë të përziera. Prej drunjve dallohen pyjet gjetherënëse si: qarri (*quercus cerris*), dhe bungu me rreth 80 %, ahu (*fagus sylvatica*), shkoza (*carpinus orientalis*). Përhapje më të kufizuar kanë llojet tjera që paraqiten si të vetmuara si: brekia, bliri (*tilia kordata*), frashri, dëllinja etj. Janë prezente edhe tipet tjera që janë të ulëta, lloji i shkurreve, si: thana (*cornus mas*), murrizi (*crataegus monogyna*), kaça (*rosa canina*), manaferra e egër (*rubus fruticosus*), shtogu (*sambucus nigra*), kulumbria (*prunus spicosa*), lajthia (*corylus avellana*), në vise të larta fieri shqiponje (*pteridium aquilinum*) etj.

Prerja e pakontrolluar e pyjeve ndikon në shfaqjen e shumë ndryshimeve mjedisore, si ndryshimet klimatike, vërshimet etj. Pyjet në Rahovecit paraqesin një resurs shumë të

⁴ ASK, Regjistrimi i Bujqësisë 2014

rëndësishëm. Mirëpo, si pasojë e menaxhimit jo adekuat të pyjeve në të kaluarën ka ardhur deri te degradimi i tyre. Nevojat Komuna e Rahovecit ka nevojë për studime lidhur me reitalizimin e pyjeve brenda teritorit të komunës.

Përvec përdorimit të drurit si lëndë djegëse për ngrohje, edhe djegja e sipërfaqeve të pyjeve është një nga burimet e emetimeve në ajër.

4.8. Përmbledhje e burimeve kryesore të shkarkimeve në ajër

Në tabelën 10 është prezantuar tabela përmbledhëse e burimeve kryesore të ndotjes në komunën e Rahovecit.

Tabela 10: Burimet e ndotjes së ajrit në Komunën e Rahovecit

Lloji i burimit të ndotësit	Numri i njësive	Aktiviteti i ndotjes	Ndotësit që shkarkohen në ajër
Objektet e ekonomive familjare (shtëpi dhe banesa kolektive)	10,532 njësi banimi (shtëpi dhe apartamente)	Përdorimi i lëndëve djegëse (thëngjill, dru, pellet etj) për ngrohje dhe gatim	Grimcat PM10 dhe PM2.5 Dyoksidi i Sulfurit SO ₂ Oksidet e Azotit NOX Monoksidi i Karbonit CO NMVOC
Objektet publike (administrata, shëndetësore, arsimore, kulturore, sportive dhe sociale)	70 ndërtesa publike	Përdorimi i lëndëve djegëse (thëngjill, dru, pellet, naftë etj) për ngrohje	Grimcat PM10 dhe PM2.5 Dyoksidi i Sulfurit SO ₂ Oksidet e Azotit NOX Monoksidi i Karbonit CO NMVOC
Objektet e bizneseve të vogla (furat e bukës, kafe-restaurante, hotele, dyqane, shërbime tjera)	2966 biznese aktive	Përdorimi i lëndëve djegëse për ngrohje dhe veprimtari (thëngjill, dru, pellet etj) për ngrohje dhe shërbime	Grimcat PM10 dhe PM2.5 Dyoksidi i Sulfurit SO ₂ Oksidet e Azotit NOX Monoksidi i Karbonit CO NMVOC
Guroret dhe shfrytëzuesit e resurseve minerare	Rreth 30 operatorë të shfrytëzimit të gurit, rërës dhe zhavorrit	Thërmimi dhe bluarja e gurit	Grimcat PM10 Grimcat PM2.5
Transporti - Numri i automjeteve	10,401 automjete motorike; 62 km rrugë magjistrale;	Përdorimi i produkteve të naftës për djegje Vjetërsia e	Grimcat PM10 dhe PM2.5 Dyoksidi i Sulfurit SO ₂ Oksidet e Azotit NOX Monoksidi i Karbonit CO

	64 km rrugë rajonale. 114 km rrugë lokale 30 km rrugë urbane	automjeteve	NMVOC
Deponitë ilegale të mbeturinave	10 deponi ilegale	Djegja dhe dekompozimi i mbeturinave	Grimcat PM10 Grimcat PM2.5
Bujqësisë intensive dhe pyjet	12020 ha tokë bujqësore; 2415 ha vreshta; 6932 ha pyje; 3921 ha kullosa dhe 252 ha livadhe.	Përdorimi i plehrave kimike dhe organike Djegja e pyjeve Emetimet natyrore	Grimcat PM10 dhe PM2.5 Dyoksidi i Sulfurit SO ₂ Oksidet e Azotit NOX Monoksidi i Karbonit CO NMVOC

5. Ndotja e ajrit dhe ndikimi në shëndet

5.1. Parametrat e cilësisë së ajrit dhe ndikimi i tyre në shëndet dhe mjedis

Hulumtimet shkencore kanë vërtetuar ndikimet në shëndetin publik nga ndotja e ajrit dhe në veçanti nga grimcat (PM). Efektet kryesore të PM në shëndetin publik janë sëmundjet respiratore dhe efektet kardiovaskulare. Efektet që i atribuohen ekspozimit afatgjatë përfshijnë mortalitetin për shkak të sëmundjeve kardiovaskulare dhe respiratore, sëmundjeve kronike respiratore (astma, sëmundjet kronike obstruktive të mushkërive, dhe ndryshimet kronike patologjike), kanceri i mushkërive, sëmundjet kronike kardiovaskulare, dhe pengesat në rritjen intrauterine sikur është për shembull pesha e ulët në lindjen normale.

Ndikimet në shëndet dhe mjedis nga Dioskidi i sulfurit (SO₂)- është gaz toksik me veti acidike, pangjyrë dhe erë të fortë. Burimet kryesore prej nga prodhohet ky gaz janë kapacitetet energjetike dhe ngrohtoret, të cilat shfrytëzojnë si emergjent naftën dhe thëngjillin me cilësi të dobët e të cilat përbëjnë sulfur. Janë të njohura efektet në zvogëlimin e volumit pulmonar, rritja e rezistencës së frymëmarrjes dhe simptome të tilla si pengesa në frymëmarrje, ngushtime në gjoks dhe zvogëlim të ritmit të frymëmarrjes. Mund të shkaktojë kokë dhimbje dhe irritime të hundës. Dyoksidi i sulfurit është ndër shkaktarët kryesor i të ashtuquajturave **shirat acidike**, të cilat përshpejtojnë korrozionin e objekteve të ndërtimit dhe acidifikimin e dheut, liqeneve dhe rrjedhave të lumenjve.

Ndikimet në shëndet dhe mjedis nga Monoksidi i karbonit (CO). Është gaz shumë helmues dhe i djegshëm. Kryesisht është produkt i djegies jo complete të karbonit në lëndët djegëse. Konsumimi i duhanit në objekte të banimit, në zyre, makina dhe restorante e rrit përqendrimin e monoksidit të karbonit. Qëndrimi i zgjatur në mjedis

ku është prezent CO mund të zvogëlojë sasinë e oksigjenit për frymëmarrje deri në masën sa njeriu humb vetëdijen si shkak i mungesës së oksigjenit. Monoksidi i karbonit kontribuon në efektin në Gazrat Serrë dhe ngrohjen globale.

Ndikimet në shëndet dhe mjedis Dioksidi i azotit (NO₂). NO₂ është gaz toksik, i cili kryesisht vjen nga djegia e karburanteve në makina, ngrohtore individuale e kolektive dhe nga termocentralet. Oksidet e azotit kanë efekte të theksuara në mushkëri por edhe në organet tjera si në mëlçi dhe shpretkë. Në gjak ka aftësi për krijim të meta hemoglobinës, e cila nuk lejon transportimin e oksigjenit. Gazrat nitroze në ajër mund të shndërrohen në shira acidike. Gjithashtu NO dhe NO₂ janë kontribues në hollimin e shtresës së ozonit.

Ndikimet në shëndet dhe mjedis nga Ozoni (O₃)- është substancë me toksicitet të lartë e veti korrozive të theksuara dhe njihet si ndotës i zakonshëm. Ozoni formohet në atmosferë nga reaksioni mes oksideve të azotit, hidrokarbureve dhe dritës së diellit. Shumë nga pajisjet elektrike, si për shembull, televizorët, fotokopjuesit dhe motorët elektrik (që shfrytëzojnë brushat), prodhojnë sasi të tilla të ozonit sa njeriu shumë lehtë mund t'i nuhas si aromë. Ndikimet akute përfshijnë simptomet në sistemin respirator, ndryshime në funksionimin e sistemit pulmonar, rritje e ndjeshmërisë respiratorë dhe inflamacione respiratore. Ozoni dëmton bimësinë dhe pyjet (efekti i foto-oksidimit), prishjen e pamjes së qyteteve, parqeve nacionale dhe hapësirat për rekreacion.

Ndikimet në shëndet dhe mjedis nga Grimcat e Pluhurit PM₁₀ dhe PM_{2.5}- Këto dy lloje të grimcave nuk janë komponime të veçanta, por përqendrimi i masës së suspenduar në ajër që kanë diametër më të vogël se 10 µm (PM₁₀) ose diametër më të vogël se 2.5 µm (PM_{2.5}). Posaçërisht në lokalitetet me trafik të dendur kur këta parametra tejkalojnë pragjet e lejuara apo VML, për publikun dhe popullsinë janë me rëndësi të veçantë.

Një numër i madh i studimeve tregojnë ndikime afatshkurta në sistemin kardiovaskular, të cilat ndërlidhen me PM, ndërsa ndikime direkt në një numër të sulmeve në zemër janë argumentuar se shkaktohen nga prezenca e PM në ajër. Efekte afatgjata konsiderohen grimcat e pluhurit PM, të cilat kanë përmbajtje toksikologjike e të cilat sulmojnë sistemin respirator dhe zvogëlim të imunitetit për shkak të depërtimit të PM në thellësi të mushkërive dhe në pjesët bronkiale.

Ndikimet në shëndet dhe mjedis nga Smogu- Smogu është fenomen i ajrit të ndotur. Fjala Smog vjen nga anglishtja Smoke = tym dhe Fog = mjegull. Smogu paraqitet në qytetet e mëdha, gjatë vjeshtës dhe dimrit, ku dominojnë ndotës të mëdhenj në një hapësirë të vogël (industria, nxemjet qendrore, gazrat e liruara nga djegiet e motorëve të automobilave, nxemjet individuale, etj.). Mungesa e erërave e shton edhe më shumë ndotjen.

Smogu posaçërisht është i dëmshëm për të sëmurit nga astma, për të moshuarit dhe fëmijët. Së voni është paraqitur edhe termi “**smogu elektronik**”. Me këtë nënkuptohet ndotje të ndryshme, të cilat kanë prejardhje nga aparatet elektrike dhe elektronike, si trafo stacionet, largpërçuesit, stacionet e telefonisë mobile, emetuesit radio dhe televiziv, por edhe gypat e neonit, tharëset për tharje të flokëve, mikrovalët, elektromotorët e ndryshëm, monitorët, etj.

5.2. Vlerësimi i ndikimit të cilësisë së ajrit në shëndetin e publik

Në komunën e Rahovecit nuk ka ndonjë mundësi reale për të vlerësuar efektet afatshkurtëra dhe afatgjata të ndotjes së ajrit në shëndet, meqenëse nuk ka të dhëna historikë për monitorimin e cilësisë së ajrit, për të bërë krahasimin e normave të cilësisë së ajrit dhe tejkalimve me tregues të shëndetit publik.

Megjithkëtë, në kuadër të vlerësimit të ndikimeve të gjendjes së mjedisit në shëndetin publik, janë analizuar shkaqet e vdekjes në komunën e Rahovecit për vitet 2018-2020. Nga të dhënat e prezantuara në tabelën 11, vërehet që shkaqet e vdekjes që kanë predispozita të ndërlidhen me gjendjen e mjedisit sikurse janë tumoret, sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes dhe sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut, kanë pasur trend të rritjes dhe janë të përfaqësuara me përqindje më të lartë se sa shkaqe tjera të vdekjes.

Tabela 11: Shkaqet e vdekjeve në komunën e Rahovecit (2018-2020)⁵

Diagnoza (shkaku i vdekjes)	2018		2019		2020	
	Numri	%	Numri	%	Numri	%
Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut	88	34	101	54.6	103	23.3
Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes	3	1.2	14	7.6	15	3.4
Tumoret	24	9.4	33	17.8	37	8.4
Sëmundjet e sistemit urogjenital	8	3.1	5	2.7	13	2.9
Sëmundjet endokrine, të ushqyshmërisë dhe metabolike	3	1.2	7	3.8	8	1.8
Simptomet, shenjat dhe rezultatet jonormale klinike dhe laboratorike të paklasifikuara gjetiu	116	45.7	5	2.7	95	21.5
Sëmundjet tjera	51	5.4	114	14	171	38.7
Gjithsej raste të vdekjeve	293	100	279	100	442	100

⁵ Shkaqet e vdekjeve në Kosovë 2018-2020, ASK

6. Cilësia e ajrit në komunën e Rahovecit

Ajri është një element mjaft i rëndësishëm për shëndetin e njeriut dhe në përgjithësi mjedisit që na rrethon. Ajri është vazhdimisht nën ndikim të ndotjes nga shumë burime. Edhe pse ndotja e ajrit vjen kryesisht nga aktivitetet njerëzore, ai gjithashtu mund të ndikohet edhe nga fenomenet natyrore. Ndotja e ajrit ndodh kur ajri përmban substanca në sasi që mund të dëmtojnë shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve ose mund të shkaktojnë dëme materiale. Normat e cilësisë së ajrit për territorin e Kosovës janë përcaktuar sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2011 (tabela 12).

Tabela 12: Normat e cilësisë së ajrit sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02/2011⁶

Parametri	Vlerat limite	Njësia matëse	Vlera limite (kufitare) $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Tejkalimet e lejuara brenda vitit
NO ₂	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	200	18
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	40	Nuk parashihet
	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e vegetacionit	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	30	Nuk parashihet
SO ₂	Vlera limite për 1 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	350	24
	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	125	3
CO	Vlera limite për mesataren ditore te maksimale 8-orëshe, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	mg/m^3	10	Nuk parashihet
PM ₁₀	Vlera limite për 24 orë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	$\mu\text{g}/\text{m}^3$	50	35

⁶ Raport Vjetor për Gjendjen e Ajrit 2021, AMMK 2022

	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m ³	40	Nuk parashihet
PM2.5	Vlera limite vjetore, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m ³	25	Nuk parashihet
O3	Objektivi afatgjatë, për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	µg/m ³	120	Nuk parashihet

Për cilësinë e ajrit në Komunën e Rahovecit nuk mund të nxirren konkluzione të plota, meqenëse në territorin e kësaj komune nuk ka stacion monitorues të cilësisë së ajrit në kuadër të rrjetit shtetëror të monitorimit të cilësisë së ajrit që realizohet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës.

Gjithashtu nuk ka ndonjë monitorim tjetër të cilësisë së ajrit të kontrolluar dhe të mirëmbajtur nga institucionet publike nacionale ose lokale. Ekzistojnë vetëm të dhëna për monitorim të koncentrimin në kohë reale të parametrin PM2.5, që realizohet me pajisje indikative. Një matës i tillë indikativë është ai nga kompania IPKO dhe një matës tjetër realizohet në kuadër të Fondacionit BONEVET dhe Kosova Makers League me mbështetjen e Millennium Foundation Kosova, të cilët kanë implementuar projektin “FRYMO”, i cili gërsheton edukimin, teknologjinë, inovacionin dhe ngritjen e vetëdijësimit mbi cilësinë e ajrit në vend. Projekti është dizajnuar për nxënësit e shkollave të mesme dhe qëllimi i tij ka qenë krijimi i një atmosfere të shëndetshme, ku të rinjtë janë edukuar rreth teknologjisë duke përdorur pajisjet teknologjike në mënyrë kreative. Pajisja monitoruese është e vendosur në Sh.M.L “Xhelal Hajda – Toni”.

Mirëpo nëse i referohemi të dhënave që janë rezultat i monitorimit të cilësisë së ajrit në stacionet monitoruese që janë realizuar në komunat më të afërta sikurse janë Prizreni dhe Peja, mundë të konkludohet që edhe në territorin e komunës së Rahovecit, ka tejkalime të normave të cilësisë së ajrit, sidomos për parametrat PM10 dhe PM2.5, dhe atë kryesisht gjatë sezonës Vjeshtë-Dimër, përkatësisht gjatë muajve nëntor, dhjetor, janar dhe shkurt.

Emisionet në ajër - Bazuar në studimin e realizuar në kuadër të projektit gjatë vitit 2021, është bërë edhe inventarizimi i burimeve të emetimeve në ajër për territorin e Komunës së Rahovecit. Burimi kryesor i emetimeve të grimcave të pluhurit PM10 dhe PM2.5 janë djegjet e vogla dhe transporti.

Djegjet e vogla janë burimi kryesor i emetimit edhe për CO. Burimi kryesor i emetimit të NOx, është transporti rrugor, industria dhe bujqësia, ndërsa burimi kryesor i SO2

është Industria. Sa i përket ndotësit NMVOC, burimi kryesor i emetimetit janë djegjet e vogla, pyjet dhe bujqësia (tabela 13).

Tabela 13: Emetimet në ajër për territorin e komunës së Rahovecit (g/vit)⁷

Parametri	Djegjet e vogla	Transporti rrugor	Industria	Bujqësia	Guroret	Pyjet	Total
PM10	613,17	58,25	0	47,31	0,95	0	719,66
PM 2.5	597,30	26,15	0	4,67	0,09	0	628,21
Nox	59,88	208,24	0,003	196,78	0	0	464,91
SO2	22,20	0,09	0	0,14	0	0	22,43
CO	3 308,16	99,93	0,002	15,74	0	0	3 423,83
NMVOC	494,18	18,16	0	12,88	0	129,50	654,73

Në kuadër të këtij projekti është bërë vlerësimi edhe për emetimet e metaleve të rënda në ajër për sektorin e djegieve të vogla për sektorin e djegieve të vogla dhe atë të transportit rrugor. Sikurse është prezantuar edhe në tabelën 13, emisionet më të larta janë vlerësuar për Plumbin (5.32 kg/vit) dhe Kadmiumin (12,53 kg/vit).

Tabela 14: Emetimet në ajër për territorin e komunës së Rahovecit për metalet e rënda (kg/vit)⁸

Metalet e rënda	Djegjet e vogla	Transporti rrugor	Total
Arseni (As)	0,226	0,002	0,227
Kadmiumi (Cd)	12,53	0,001	12,53
Merkuri (Hg)	0,615	0,084	0,699
Plumbi (Pb)	5,31	0,009	5,32

⁷ Projekti, Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Cilësinë e Ajrit, ndryshimit të sjelljes dhe shërbimet e komunikimit: Azhurnimi i inventarit të emisioneve, MFK & AMMK 2021

⁸ Projekti, Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Cilësinë e Ajrit, ndryshimit të sjelljes dhe shërbimet e komunikimit: Azhurnimi i inventarit të emisioneve, MFK & AMMK 2021

7. Problemet kryesore që ndërlidhen me ndotjen e ajrit në komunën e Rahovecit

Bazuar në të dhënat dhe të gjeturat kryesore të prezantuara më lartë mundë të kosntatohet se problemet kryesore që ndërlidhen me menaxhimin e cilësisë së ajrit dhe mbrojtjen e ajrit nga ndotja në komunën e Rahovecit janë:

- Mungesa e monitorimit të cilësisë së ajrit në territorin e komunës nga institucionet qendrore dhe lokale.
- Cilësia jo e mirë e ajrit në zonën urbane gjatë sezonës së dimrit;
- Tejkallimet e normave të cilësisë së ajrit kryesisht për parametrin PM10 dhe PM2.5.
- Djegjet e vogla janë burimi kryesor i emetimeve në ajër sa i përket parametrin PM10 dhe PM2.5.
- Mungese e një inventari të detajuar të ndotësve të ajrit për territorin e Komunës së Rahovecit;
- Komuna ka përgaditur një draft të Planit Lokal për Energji dhe Klimë, për territorin e saj por që ende nuk është aprovuar;
- Komuna e Rahovecit nuk e ka të organizuar transportin urban në zonën e qytetit;
- Zbatimi jo efikas i ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja;
- Të dhënat flasin për një trend në rritje të sëmundjeve që janë të ndërlidhura me ndotjen e ajrit.
- Mungesa e akteve nënligjore komunale për mbrojtjen e ajrit nga ndotja;
- Kapacitetet e kufizuara të komunës për menaxhimin e cilësisë së ajrit;
- Mungesa e planit të veprimit në rastet e emergjencave të tejkallimeve të normave të cilësisë së ajrit.
- Vetëdija e ulët për mënyrat e parandalimit të ndotjes së ajrit dhe mbrojtjes së shëndetit nga ndotja e ajrit.

8. Prioritetet kryesore për mbrojtjen e ajrit nga ndotja për periudhën 2023-2027

Për të përmirësuar cilësinë e ajrit në territorin e komunës për periudhën 5 vjecare janë përcaktuar këto prioritet:

- Fuqizimi i monitorimit të cilësisë së ajrit në territorin e komunës nga institucionet qendrore dhe lokale.
- Marrja e masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit në zonën urbane, dhe përmirësimin e normave të cilësisë së ajrit me theks të vecantë për gjatë sezonës së dimrit parametrin PM10 dhe PM2.5.
- Reduktimi i ndotjes së ajrit nga djegjet e vogla me theks të vecantë për parametrat PM10 dhe PM2.5.
- Zbatimi i projekteve nga Plani Lokal për Energji dhe Klimë në funksion të reduktimit të ndotjes nga sektori i amvisërisë;
- Hartimi i projektit për rrjetin e sistemit të ngrohjes qendrore për zonën urbane;
- Reduktimi i ndotjes së ajrit nga transporti me theks të vecantë për parametrin NOx.
- Përgaditja e inventari të detajuar të ndotësve të ajrit për territorin e Komunës së Rahovecit;
- Zbatimi i Planit të Mobilitetit për territorin e komunës me qëllim të fuqizimit të menaxhimit të transportit dhe uljes së ndotjes nga ky sektor.
- Fuqizimi i transportin urban në zonën e qytetit, përmes shtimit të linjave të transportit dhe riorganizimit të tyre.
- Fuqizimi i zbatimi të ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja;
- Mbledhja e të dhënëve më të detajuara për shkaqet e vdekjes me qëllim të vlerësimit të ndikimit të ndotjes së ajrit në shëndetin publik.
- Përgaditja e akteve nënligjore dhe rregulloreve komunale për mbrojtjen e ajrit nga ndotja;
- Fuqizimi i kapaciteteve të komunës për menaxhimin e cilësisë së ajrit;

- Hartimi i planit të veprimit për rastet e emergjencave të tejkalimeve të normave të cilësisë së ajrit.
- Ngritja e vetëdijës për mënyrat e parandalimit të ndotjes së ajrit dhe mbrojtjes së shëndetit nga ndotja e ajrit.
- Përmirësimi i informimit të publikut për mbrojtje nga ndotja e ajrit;

Përmbushja e këtyre prioteteve do të realizohet përmes 5 objektiva kryesore si vijon:

- Plotësimi i bazës rregullative dhe programore për menaxhimin e cilësisë së ajrit;
- Fuqizimi institucional për menaxhimin e ndotjes së ajrit dhe zbatimin e ligjit;
- Përmirësimi i cilësisë së ajrit përmes reduktimit të ndotjes;
- Përmirësimi i monitorimit dhe informimit për cilësinë e ajrit dhe për mbrojtje nga ndotja e ajrit;
- Ngritja e vetëdijës për parandalimin e ndotjes dhe për mbrojtje të shëndetit nga ndotja e ajrit.

9. Plani i aktiviteteve dhe veprimeve për periudhën 2023-2027

Tabela 15: Plani i aktiviteteve për periudhën 2023-2027 dhe përgjegjësit për implementim

Objektivi	Veprimi /Aktiviteti	Përgjegjësi për implementim	Shuma (Euro) dhe burimi i buxhetit	2024				2025				2026				2027				2028			
				1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4	1	2	3	4
1. Plotësimi i bazës rregullative dhe programore për menaxhimin e cilësisë së ajrit dhe reduktimin e ndotjes	Aprovimi i Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit	DUPMM	Komuna 30.000	x	x																		
	Hartimi i rregullores për menaxhimin e cilësisë së ajrit	DUPMM	Komuna (Kosto administrative)			x	x																
	Aprovimi i Planit lokal të Veprimit për Energji dhe Klimë	DUPMM, DSHPK	Komuna (Kosto administrative)			x				x													
	Rishikimi i Planit Lokal të Veprimit në Mjedis	DUPMM	Komuna & Donator (10.000)													x			x				
	Hartimi i Planit Afatshkurtër të Veprimit për përmirësimin e cilësisë së ajrit	DUPMM	Komuna (Kosto administrative)	x	x																		
2. Fuqizimi institucional për menaxhimin e ndotjes së ajrit dhe zbatimin e ligjit	Shtimi i numrit të inspektorëve të mjedisit;	DPI	Komuna (12.000)	x			x																
	Përmirësimi i kushteve të punës për inspektorët e mjedisit dhe zbatimin e simulimeve	DPI	Komuna (5.000)	x				x															
	Dizajnimi i planit të inspektimeve dhe mbikqyrjes së zbatimit të rregullativës ligjore dhe programore për përmirësimin e cilësisë së ajrit	DPI	Komuna (Kosto administrative)	x			x																
	Trajnimi i zyrtarëve të komunës nga sektori i mjedisit për menaxhimin e cilësisë së ajrit;	DUPMM, DPI	Komuna (5.000)	x																			x
	Zbatimi efikas i VNM në projektet e	DUPMM	Komuna (Kosto	x																			X

[illegible]

[illegible]

menaxhimin e ndotjes së ajrit dhe zbatimin e ligjit	punës për inspektorët dhe zbatimin e stimulimeve. • Dizajnimi i planit të inspektimeve dhe mbikqyrjes së zbatimit të rregullativës ligjore dhe programeve për përmirësimin e cilësisë së ajrit; • Trajnimi i zyrtarëve të komunës nga sektori i mjedisit për menaxhimin e cilësisë së ajrit • Zbatimi efikas i VNM në projektet e nivelit lokal që kanë ndikim në ndotjen e ajrit; • Zbatimi i VSM-së në kuadër të planeve, programeve në nivelin lokal që pritet të kenë ndikim në ndotjen e ajrit; • Themelimi i komitetit këshillëdhënës për përmirësimin e cilësisë së ajrit me pjesëmarrje nga grupet e ndryshme të interesit.	përmisuara; • Plani i inspektimeve dhe mbikqyrjes së zbatimit të rregullativës ligjore dhe programeve për përmirësimin e cilësisë së ajrit i përfunduar; • Numri i zyrtarëve të trajnuar/Numri i trajnimeve për zyrtarët të realizuara; • Numri i projekteve të VNM-së; • Numri i planeve të VSM-së; • Komiteti këshillëdhënës për përmirësimin e cilësisë së ajrit i themeluar;	• Vjetore • Vjetore • Vjetore • Vjetore • Vjetore	të fuqizuara.
3. Përmirësimi i cilësisë së ajrit përmes reduktimit të ndotjes	• Identifikimi i burimeve të ndotjes së ajrit përmes përgatitjes së inventarit të emisioneve në ajër; • Përgatitja e projektit për ngrohjen qendrore për zonën urbane; • Ndalimi i djegjes së hapur të mbeturinave, të hamullorëve	• Inventari i emisioneve në ajër i përgaditur dhe burimet e ndotjes në ajër të identifikuar; • Përgatitja e projektit;	• Vjetore • Vjetore	• Cilësia e ajrit e përmirësuar/ndotja e ajrit e reduktuar

	dhe i djegjeve të tjera të hapura; • Nxitja dhe mbështetja e ekonomive familjare për renovimin e objekteve dhe përmirësimin e izolimit termik; • Mbështetje për reduktimin e ndotjes së ajrit nga djegjet e vogla përmes zëvendësimit të shporetave ekzistuese me shporeta më të pastra dhe përmes ndryshimit të llojit të lëndëve djegëse; • Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbra në zonën urbane; • Ndalimi i përdorimit të thëngjillit për ngrohje në zonën urbane dhe në objekte të institucioneve publike; • Ndërtimi i shtigjeve të reja për biçikleta në zonën urbane të qytetit; • Fuqizimi i transportit publik në zonën urbane dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të tij; • Pastrimi i rregulltë i rrugëve në zonën urbane për të parandaluar krijimin dhe shpërndarjen e pluhurit; • Nxitja dhe mbështetja e ekonomive familjare për	• Nr. i gjobave; • Nr. i mbështetjeve të ekonomive familjare dhe objekteve; • Nr. i mbështetjeve; • Nr. i sipërfaqeve të gjelberta në m2; • Nr. i parandalimit të përdorimit dhe gjobave; • Gjatesia ose numri i shtigjeve të reja për biçikleta. • Fuqizimi i transportit publik; • Gjatesia (Sipërfaqet) e pastruara të rrugëve; • Numri i ekonomit familjare që kanë përfituar nga mbështetja.	• 6 mujore • 6 mujore • 6 mujore • Vjetore • Vjetore • Vjetore • Vjetore • 3 mujore • Vjetore	
--	--	---	---	--

	renovimin e objekteve dhe përmirësimin e izolimit termik; - Investimet në burimet e ripërteritshmit të energjisë (panelat solar dhe energjia e erës) - Reduktimi i qarkullimit të automjeteve në zonën urbane përmes riorganizimit të qarkullimit dhe vendosjes së tarifave diferenciale të parkimit.	- Kapaciteti i instalimeve të energjisë KW/h - Numri dhe dhe normat e tarifave;	- Vjetore - Vjetore	
4. Përmirësimi i monitorimit dhe informimit për cilësinë e ajrit dhe për mbrotje nga ndotja e ajrit;	- Blerja e pajisjeve për monitorimin e cilësisë së ajrit në territorin e Komunës së Rahovecit - Përmirësimi i informimit për cilësi të ajrit - Përmirësimi i mbledhjes dhe raportimit të të dhënave të morbiditetit sipas sëmundjeve specifike dhe grupmoshave në QKMF dhe në Spitalin rajonal dhe Mjekësin e punës; - Përgaditja e informatave, raporteve dhe njoftimeve për informimin e publikut për cilësinë e ajrit	- Pajisjet për cilësi të ajrit të blera. - Informimi për cilësi të ajrit i përmirësuar. - Numri i raporteve të përgaditura për morbiditetin dhe sëmundjet specifike. - Numri i raportimeve;	- Vjetore 6 mujore 6 mujore - Vjetore	Monitorimi dhe informimi për cilësinë e ajrit dhe për mbrotje nga ndotja e ajrit e përmirësuar
5.	Organizimi i fushatave vetëdijësuese për cilësi të ajrit	Numri i organizimeve/fushatave të realizuara;	Vjetore	Vetëdija për parandalimin e ndotjes

Ngritja e vetëdijes për parandalimin e ndotjes dhe për mbrojtje të shëndetit nga ndotja e ajrit;	në shkollat fillore; - Bashkëpunimi me OJQ dhe shoqërinë civile për menaxhimin e cilësisë së ajrit; - Organizimi i fushatave vetëdijesuese për reduktimin e ndotjes së ajrit nga djegjet e vogla; - Sensibilizimi i opinionit lidhur me përfitimet që krijohen me aplikimin e masave efikase në objektet e banimit;	- Numri i takimeve dhe aktiviteteve të realizuara; - Numri i organizimeve dhe aktiviteteve të realizuara; - Numri i aktiviteteve dhe takimeve;	- Vjetore - Vjetore - Vjetore	së ajrit e ngritur; Vetëdija për mbrojtjen e shëndetit nga ndotja e ajrit e ngritur.
---	--	--	---	---

11. Plani Afatshkurtër i Veprimit

Tabela 17: Plani Afatshkurtër i Veprimit – Aktivitetet në rastet e emergjencave të tejkalimeve të normave të cilësisë së ajrit

Kategoria e veprimeve	Aktivitetet/Veprimet
Veprimet që do të ndërmerren nga qytetarët	- Të mos përdoren automjetet pa nevojë; - Të shfrytëzohet transporti publik; - Për ngrohjen e shtëpive të mos përdoren materiale të mbeturinave, vaji i motorit të djegur, mbeturina të llakuara dhe të ngjyrosura të drurit, stiropor, PET ambalazhe, goma dhe çdo lloj tjetër i materialit sintetik; - Të përdoret dru i thatë dhe i pastër pa përmbajtje të dheut dhe mbeturinave; - Stufat e drurit të përdoren dhe mirëmbahen sipas udhëzimeve të prodhuesit; - Të behet pastrimi i rregullt i oxhaqeve. - Lartësia e oxhaqeve të ekonomive familjare ku lirohet tymi nga procesi i djegies të jetë sipas standardeve.
Veprimet që do të ndërmerren për mbrojtjen e shëndetit të njeriut	- Të mos përdoren automjetet pa nevojë; - Të shfrytëzohet transporti publik me qëllim të reduktimit të ndotjes dhe ndikimit në shëndet; - Të shmangët ekspozimin afatgjatë në ambient të hapur, veçanërisht gjatë orëve të vona të mbrëmjes ose herët në mëngjes, kur përqendrimet e PM10 dhe PM2.5 mund të arrijnë nivelin maksimal; - Të shmangët përdorimi i lëndëve djegëse gjatë periudhës kritike me përqendrime të larta të PM10 dhe PM2.5; - Të prolongohen, të gjitha aktivitetet publike në ambiente të hapura, vetëm në rast kur ato janë urgjente. - Sipas nevojës të mbyllen përkohësisht shkollat dhe institucionet e administratës.

Veprimet që do të ndërmerren nga institucionet dhe subjektet juridike	• Informimi i institucioneve shkollore dhe administrative për nivelin e ndotjes dhe masat emergjente; • Të stimulohet dhe subvencionohet përdorimi i transportit publik gjatë kohës së zbatimit të masave emergjente; • Të bëhet riorganizimi i transportit publik sipas nevojave dhe mundësive; • Të zbatohen ndalesat për hyrje të automjeteve në zonën urbane të qytetit gjatë kohës së zbatimit të masave emergjente; • Të shtohet kontrolli i inspeksioneve të instalimeve në kompetencë të komunës; • Inspektimi i lartësisë së oxhaqeve të ekonomive familjare dhe të bizneseve në zonën urbane të qytetit; • Të rritet kontrolli i inspeksioneve tek personat fizikë dhe juridikë që gjenerojnë mbeturinat (nga gomat dhe vajrat e përdorura); • Të zbatohen kontrolle të jashtëzakonshme inspektuese në vendet e ndërtimit në kompetencë të komunës; • Të zbatohen kontrolle të jashtëzakonshme inspektuese në lidhje me djegiet e hapura dhe të shqiptohen gjobat mandatore; • Të riorganizohet transporti i dërgimit të mallrave me automjete brenda komunës gjatë kohës së zbatimit të masave emergjente sipas nevojave dhe mundësive; • Të riorganizohet orari i trajnimit të auto shkollave brenda territorit të komunës sipas nevojave; • Të riorganizohet orari i punës së taxive brenda territorit të komunës sipas nevojave; • Të gjitha subjektet juridike (institucionet administrative dhe publike) të cilat për ngrohje përdorin pajisje për djegieje, me qëllim të reduktimit të ndotjes të kontrollojnë përdorimin e pajisjeve që të sigurojnë regjimin optimal të djegies, siç përcaktohet nga standardet; • Të anulohen ose shtyhen tubime të mëdha publike, ngjarje sportive dhe ngjarje kulturore në ambient të hapur që realizohen në territorin e komunës. • Sipas nevojës të mbyllen përkohësisht shkollat dhe institucionet e administratës.
---	--

12. Referencat dhe burimet e informacionit

1. Degradimi i mjedisit (<http://opendata.cohu.org/sq/degradimi-mjedisit>) Organizata Çohu.
2. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (<https://gzk.rks-gov.net/>)
3. Plani i masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit në Kosovë, MMPH
4. Plani i Veprimit për Cilësi të ajrit 2018-2020, MMPH
5. Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Cilësinë e Ajrit 2018-2022, MMPH
6. Plani Kombëtar për Zvogëlimin e Emisioneve, MMPH
7. Plani Komunal i Veprimit për Eficencë të Energjisë për Komunën e Rahovecit;
8. Plani Zhvillimor i Komunës së Rahovecit
9. Projekti, Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Cilësinë e Ajrit, ndryshimit të sjelljes dhe shërbimet e komunikimit: Azhurnimi i inventarit të emisioneve, MFK & AMMK 2021
10. Raport i monitorimit dhe vlerësimit të gjendjes mjedisore në deponit sanitare dhe stacionet e transferit të mbeturinave, AMMK.
11. Raport Vjetor për Gjendjen e Ajrit 2021, AMMK
12. Raporti i Gjendjes së Ajrit 2022, AMMK
13. Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2020, AMMK
14. Raporti i menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë për vitin 2021, AMMK
15. Regjistrimi i Popullsisë 2011, ASK
16. Rezoluta e Kuvendit të Kosovës për Përmirësimin e Cilësisë së Ajrit, MMPH
17. Sektori i Biomassës Drunore në Kosovë, FAO 2015
18. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Ndryshime Klimatike, MMPH
19. Strategjia e Mbrojtjes së Mjedisit 2013-2022, MMPH
20. Strategjia për Cilësinë e Ajrit 2013-2022, MMPH
21. Shkaqet e vdekjeve në Kosovë, ASK 2020
22. Të dhënat për popullsinë sipas komunave (<https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/>) ASK
23. Vlerësim, Popullsia e Kosovës, ASK 2020;

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.169/23
Datë: 27.12.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Rahovecit




**Plani Lokal i Veprimit
për Biodiversitet
2023-2027**

Rahovec, 2023

Plani Lokal i Veprimet për Biodiversitet 2023-2027

Implementuar nga:



Përmbajtja

- Fjala e kryetarit të komunës
- Falënderim
- Grupi punues
- Indeksi i shkurtesave
- Indeksi i tabelave
- 1. **Hyrje**
 - 1.1. Baza ligjore për hartimin e PLVB-së
 - 1.2. **Përgjegjësitë e komunës për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit**
 - 1.3. Qëllimi dhe objektivat e PLVB-së
 - 1.4. Procesi dhe metodologjia për përgatitjen e PLVB-së
- 2. **Profili i komunës**
 - 2.1. Pozita gjeografike dhe organizimi administrativ
 - 2.2. Kushtet klimatike dhe relievi
 - 2.3. Pedologjia dhe gjeologjia
 - 2.4. Trashëgimia kulturore
- 3. **Presionet në mjedis**
 - 3.1. Zhvillimi ekonomik dhe bizneset
 - 3.2. Sektori minerar
 - 3.3. Transporti
 - 3.4. Bujqësia
 - 3.5. Turizmi
- 4. **Gjendja e biodiversitetit**
 - 4.1. Resurset ujore dhe menaxhimi i tyre
 - 4.2. Shfrytëzimi i tokës dhe cilësia e dheut
 - 4.3. Natyra dhe biodiversiteti
 - 4.3.1. Zonat e mbrojtura
 - 4.3.2. Flora dhe vegjetacioni
 - 4.3.3. Fauna
 - 4.3.4. Pyjet dhe kullosat
- 5. **Problemet kryesore në mbrojtjen e biodiversitetit**
- 6. **Prioritetet për mbrojtjen e biodiversitetit për periudhën 2023-2027**
- 7. **Plani i aktiviteteve dhe veprimeve për periudhën 2023-2027**
- 8. **Plani i monitorimit për zbatimin e PLVB-së**
- 9. **Referencat dhe burimet e informatave**

Të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit, të nderuar lexues!

Kam kënaqësinë që po ndajmë me ju Planin Lokal të Veprimit për Biodiversitet 2024-2028 për Komunën e Biodiversitetit, si dokument planifikues - strategjik, që adreson zgjidhjen e problemeve në sektorin e biodiversitetit në nivel lokal.

Ky plan ka për qëllim kryesor përmirësimin e gjendjes së biodiversitetit në territorin e komunës. Në kuadër të planit është bërë vlerësimi i gjendjes ekzistuese, janë identifikuar problemet kryesore, janë përcaktuar prioritetet kryesore si dhe janë planifikuar afatet, veprimet, aktivitetet dhe projektet kryesore që do të ndërmerren për periudhën e ardhshme 5 vjeçare për natyrën dhe biodiversitetin e Rahovecit.

Hartimi dhe miratimi i këtij plani i cili është i një rëndësie të veçantë për komunën është kërkesë ligjore që del nga Ligji për Mbrojtjen e Natyrës dhe po ashtu është pjesë e angazhimeve të komunës për përmbushjen e përgjegjësiave për fuqizimin e qeverisjes lokale.

Hartimi i planit është si rezultat i punës së grupit punues përkatës komunal i cili gjatë punës së tij ka bashkëpunuar ngushtë me të gjitha drejtoritë e komunës, me institucionet tjera relevante të nivelit lokal dhe qendror dhe me specialistë të fushës nga komuniteti dhe organizatat e shoqërisë civile. Rezultat i këtij angazhimi është finalizimi i këtij dokument i cili pritet të përmirësojë gjendjen e natyrës dhe biodiversitetit në komunën tonë.

Plani Lokal i Veprimit për Biodiversitetit është na harmoni edhe me Planin Lokal të Veprimit në Mjedis, me Planin Zhvillimor Komunal dhe me dokumente tjera strategjike dhe zhvillimore të komunës, dhe përmban në vete synimin për ruajtjen e natyrës dhe biodiversitetit në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të komunës së Rahovecit. Për implementimin e këtij plani komuna ka bërë edhe planifikimin e nevojshëm buxhetor por njëkohësisht ky dokument do të shërbejë edhe për të adresuar kërkesat për mbështetje nga donatorët për implementimin e projekteve konkrete të këtij plani.

Me këtë rast shpreh falënderimin për të gjithë ata që kontribuan në finalizimin e këtij dokumenti, e veçanërisht për grupin punues për koordinimin e aktiviteteve për hartimin dhe finalizimin e këtij plani.

Smajl Latifi, Kryetari i Komunës së Rahovecit

Grupi punues

Grupit Punues për hartimin e Planit Lokal të Veprimit për Biodiversitet 2023-2027 për Komunën e Rahovecit është themeluar bazuar në vendimin nr. 2028, të datës 18.08.2023, të kryetarit të Komunës së Rahovecit, z.Smajl Latifi.

Përbërja e Grupit:

- Albnor Mullabazi, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, kryesues;
- Bjondina Ramaj, zyrtare e lartë për Mbrojtje të Mjedisit, anëtare;
- Venhar Topalli, zyrtar i Shërbimeve Publike, anëtar;
- Ilir Haxhijaha, zyrtar i lartë Ligjor, anëtar;
- Ilivi Durguti, zyrtar i Bujqësisë, anëtar;
- Jeton Kryeziu, zyrtar i Pylltarisë, anëtar;
- Ardian Rama, zyrtar i Shëndetësisë, anëtar;
- Lulzim Krasniqi, zyrtar i Arsimit, anëtar;
- Fidan Hoti, zyrtar i Zhvillimit Ekonomik, anëtar;
- Zyber Thaqi, zyrtar i Financave, anëtar;
- Alban Gashi, zyrtar i Barazisë Gjinore, anëtar;
- Valmir Gashi, zyrtar i Integrimeve, anëtar;
- Adelina Paçarizi, përfaqësuese nga Shoqëria civile, anëtare;
- Bejtullah Shehu, Shoqata e Bujqve, anëtar;
- Shani Kryeziu, Shoqata e Gjahtarëve, anëtar;
- Nazmi Bellaqa, përfaqësues nga OJQ, anëtar.

Sipas vendimit, grupi punues ka për detyrë që të ndërmarrë veprime të orientuara në hartimin e Planit Lokal për Biodiversitetin në territorin e Komunës Rahovecit, bazuar në legjislacionin në fuqi. Në vendim thuhet se përveç antëtarëve të grupit punues për zbatimin e vendimi do të kujdesen edhe drejtorët e drejtorive të Komunës së Rahovecit.

Grupi punues për hartimin e PLVB në kuadër të angazhimeve për përgaditjen dhe finalizimin e dokumentit mes tjerash është angazhuar të:

- Sigurojë të dhënat e nevojshme nga drejtoritë përkatëse për hartimin e programit;
- Marrë pjesë në takimet e rregullta, në punëtoritë dhe në debote publike ku do të dikutohet për hartimin e programit;
- Japë kontribut në hartimin e programit përmes dhënies së komenteve, plotësimeve dhe propozimeve;
- Informojë vendimmarrësit për procesin e hartimit të programit.

Indeksi i shkurtesave

AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
APK	Agjencia e Pyjeve të Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
DEZHT	Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
DUPMM	Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
DSHPK	Drejtoria për Shërbime Publike Komunale
DKRS	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
DPI	Drejtoria e Punëve Inspektuese
DBF	Drejtoria për Buxhet dhe Financa
DA	Drejtoria për Arsim
GIZ	Organizata Gjermane për Shoqëri të Hapur
GZK	Gazeta Zyrtare e Kosovës
IUCN	Unioni Ndërkombëtarë për Konservimin e Natyrës
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
IKMN	Instituti të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës
IMMK	Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës
KRU	Kompania Regjionale e Ujësjellësit
KDI	Kosovo Democratic Institute
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
OJQ	Organizata Joqeveritare
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PLVB	Plani Lokal i Veprimit në Biodiversitet
PLVM	Plani Lokal i Veprimit në Mjedis
PLMM	Plani Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave
PZHK	Plani Zhvillimor Komunal
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor

Indeksi i tabelave

Tabela 1:	Dokumentet strategjike dhe planifikuese të Komunës së Rahovecit
Tabela 2:	Klasat e bonitetit të tokës së Komunës së Rahovecit
Tabela 3:	Bizneset në Komunën e Rahovecit
Tabela 4:	Operatorët ekonomik në sektorin minerar në komunën e Rahovecit
Tabela 5:	Rrjeta e rrugëve në komunën e Rahovecit
Tabela 6:	Sasia e plehrave kimike të përdorura dhe përmbajtja e azotit
Tabela 7:	Burimet ujore në territorin e komunës së Rahovecit
Tabela 8:	Destinimi i shfrytëzimit të sipërfaqes së tokës
Tabela 9:	Shkalla e erozionit në komunën e Rahovecit sipas kategorive
Tabela 10:	Lista e zonave të mbrojtura në komunën e Rahovecit
Tabela 11:	Shpellat në territorin e komunës së Rahovecit
Tabela 12:	Llojet e florës vaskulare të evidentuara në territorin e Komunës së Rahovecit që janë të përfshira në Librin e Kuq të Florës vaskulare së Kosovës
Tabela 13:	Llojet e faunës së egër të evidentuara në territorin e Komunës së Rahovecit që janë të përfshira në Librin e Kuq të Faunës së Kosovës
Tabela 14:	Prioriteteve dhe aktiviteteve për përmbushjen e prioriteteve për PLVB për Komunën e Rahovecit
Tabela 15:	Plani i monitorimit për zbatimin e PLVB, indikatorët e suksesit dhe ndikimi i pritshëm

1. Hyrje

1.1. Baza ligjore për hartimin e PLVB-së

Plani Lokal i Veprimit për Biodiversitet (PLVB) është dokument planifikues - strategjik, për të adresuar zgjidhjen e problemeve në mbrojtjen e biodiversitetit në nivel lokal.

Baza ligjore për hartimin e koncept dokumentit për plane dhe programe për biodiversitetin e në nivelin lokal është në Ligjin për mbrojtjen e natyrës (Nr. 03/L-233) dhe në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale. Sipas Ligjit të Natyrës, dokumentet bazë për mbrojtjes e natyrës janë Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin - të cilën e nxjerr Qeveria e Republikës së Kosovës me propozim të Ministrisë dhe e aprovon Kuvendi i Republikës së Kosovës. **Komunat detyrohen që të nxjerrin programet lokale për mbrojtjen e natyrës për territorin e vet. Programet e komunave duhet të harmonizohen me Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Biodiversitetin të nivelit nacional.**

Në hartimin e dokumentit janë marrë në konsideratë edhe ligjet tjera që prekin interesat në nivelin lokal.

Ligji nr.03/l-137 për pyjet e Kosovës- Ky ligj i definon pyjet e Kosovës si resurse kombëtare, andaj ka për qëllim që ato të udhëhiqen në atë mënyrë që të ofrojnë rendimente me vlerë dhe në të njëjtën kohë të ruhet biodiversiteti për të mirën e gjeneratave të tashme dhe të ardhshme.

Ligji nr. 02/L-53 për gjuetinë- Me këtë ligj rregullohet menaxhimi i qëndrueshëm, kultivimi, mbrojtja, gjuetia dhe shfrytëzimi i faunës së egër si pasuri natyrore me interes të përgjithshëm të cilat gëzojnë mbrojtje të veçantë. Qëllimi i ligjit është ruajtja e tërësisë së ekosistemit dhe baraspeshës ekologjike, mbrojtja adekuate e kafshëve të egra, sigurimi i mirëqenies dhe kushteve për shfrytëzim ekonomik të resurseve, nevoja për siguri dhe standardin e etikës së gjahtarëve.

Ligji nr.04/l-147 për ujërat e Kosovës - Me këtë ligj rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin, planifikimin, mbrojtjen dhe përgjegjësitë institucionale në lidhje me ujërat dhe burimet ujore, duke përfshirë edhe kompetencat e komunave për ujërat.

Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale- Ky ligj përkufizon statusin ligjor të komunave, kompetencat dhe parimet e përgjithshme të financave komunale organizimin dhe funksionimin e organeve komunale, marrëdhëniet brenda komunale dhe bashkëpunimin ndër-komunal, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar dhe marrëdhëniet ndërmjet komunave dhe pushtetit qendror.

Gjatë hartimit të këtij Plani janë marrë për bazë edhe kërkesat e **Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2021**. E zhvilluar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, kjo strategji

paraqet bazën për orientimet strategjike dhe kornizën e veprimeve për mbrojtjen e biodiversitetit në nivel nacional.

Dokumentet tjera strategjike dhe programore që janë marrë për bazë gjatë hartimit të planeve dhe programe për biodiversitetin e në nivelin lokal janë:

- **Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2022-2030**- që ka si objektiv të përgjithshëm të ngritet kontributi i sektorit pyjor në ekonominë nacionale, nëpërmes shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve pyjore, duke marrë parasysh gjithmonë rolin shumëfunksional të pyjeve.
- **Lista e llojeve të mbrojtura të florës dhe faunës** – Është regjister i llojeve të florës dhe faunës të cilat kanë mbrojtje ligjore.
- **Libri i Kuq i Florës**- Është dokument i cili vlerëson shkallën e rrezikshmërisë së llojeve të florës vaskulare të Kosovës sipas kritereve të IUCN.
- **Libri i Kuq i Faunës**- Është dokument i cili vlerëson shkallën e rrezikshmërisë së llojeve të faunës së Kosovës sipas kritereve të IUCN.
- **Regjistri i Zonave të Mbrojtura**- Lista e të gjitha zonave të mbrojtura sipas kategorive në nivel nacional dhe lokal që mirëmbahet nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Hartimi i planit lokal për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit është në harmoni edhe me veprimet dhe masat në nivel lokal të përcaktuara në dokumente strategjike lokale si Plani Zhvillimor i Komunës së Rahovecit, Plani Lokal i Veprimit në Mjedis i komunës së Rahovecit dhe Planet tjera lokale të Komunës së Rahovecit.

Tabela 1: Dokumentet strategjike dhe planifikuese të Komunës së Rahovecit

Dokumenti	Qëllimi dhe fushëveprimi
Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Rahovecit 2019-2024	Dokument Strategjik Lokal që paraqet prioritetet dhe veprimet për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit të Komunës së Rahovecit për periudhën 2019-2024. Është dokumenti kryesor planifikues në nivelin lokal për sektorin e mjedisit. PLVM përfshin zhvillimin e vizionit të komunitetit, vlerësimin e çështjeve mjedisore, përcaktimin e prioritetëve, identifikimin e strategjive më të përshtatshme për adresimin e problemeve kryesore dhe zbatimin e veprimeve me qëllim të arritjes përmirësimeve reale mjedisore dhe shëndetësore. Në një kapitull të vecantë të këtij dokumenti janë trajtuar edhe aspektet e biodiversitetit si dhe janë përcaktuar veprimet e nevojshme për përmirësimin e gjendjes për periudhën kohore 2019-

	2024.
Plani Zhvillimor Komunal për Komunën e Rahovecit 2023-2031-	Është bazë për zhvillim të qëndrueshëm në komunën e Rahovecit, dhe synon ruajtjen e mjedisit, shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve për zhvillim ekonomik, për gjeneratat e ardhshme dhe balancimin e zhvillimeve hapësinore. Përmes këtij plani koordinohen kërkesat sociale dhe ekonomike për hapësirën me funksionet e saj kulturore dhe ekologjike. Është dokumenti kryesor që mbështetë planifikimin e qëndrueshëm, të barazpeshuar dhe afatgjatë të territorit të komunës, përmes të cilit racionalizohet dhe funksionalizohet shfrytëzimi hapësinor i saj, përmirësohet aspekti social, ekonomik dhe mjedisor. Në kuadër të kapitullit Mjedisi dhe Siperfaqet me Rrezikshmëri, në këtë dokument janë trajtuar edhe aspektet e menaxhimit të resurseve natyrore dhe biodiversitetit dhe janë përcaktuar kahjet zhvillimore të këtij sektori.

Kërkesat ligjore lidhur me përmbajtja e Planit Lokal të Veprimit për Biodiversitetin

Sipas kërkesave ligjore, praktikave të zbatueshme dhe kapaciteteve komunale programi/plani lokal për mbrojtjen e biodiversitetit mes tjerash duhet të përmbajë:

- Qëllimet dhe objektivat e përgjithshme;
- Veprimet për ruajtjen e natyrës dhe biodiversitetit;
- Veprimet për hulumtimet dhe përcjelljen e gjendjes të natyrës;
- Veprimet për përfshirjen e mbrojtjes së natyrës në sektorët tjerë;
- Veprimet për plotësimin e kornizës legjislative dhe institucionale;
- Veprimet për edukim, vetëdijesim dhe promovim të ruajtjes së larmisë biologjike dhe peizazhore;
- Veprimet për informimin e publikut dhe pjesëmarrjen e publikut në vendim marrje për natyrën;
- Prioritetet dhe burimet e mundshme financiare për implementimin e tyre;
- Masat për mbrojtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore dhe mbrojtjen e vlerave të natyrës.

1.2. Përgjegjësitë e komunës për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit

Përgjegjësitë e komunave për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit janë të përshkruara në Ligjin për mbrojtjen e natyrës ku mes tjerash komunat kanë përgjegjësi të:

- Kujdesen për ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore për territorin e vet;
- Shpallin zonat e mbrojtura për të cilat janë kompetente;
- Sigurojnë kushtet për mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura për të cilat janë kompetente;
- Marrin pjesë në procedurën e shpalljes të zonave të mbrojtura që shtrihen në territorin e tyre dhe të cilat i shpallë Qeveria ose Kuvendi;
- Marrin pjesë në hartimin e planeve të menaxhimit me zonat e mbrojtura për të cilat janë kompetente;
- Kujdesen për promovimin e mbrojtjes së natyrës dhe japin mbështetje dhe kujdesen për shoqatat, veprimtaria e të cilave është mbrojtja e natyrës;
- Përcjellin gjendjen e ruajtjes së natyrës dhe përgatisin raporte të cilat i a paraqesin organeve qendrore;
- Mbajnë regjistrat për shënimet të rëndësishme për mbrojtjen e natyrës;
- Informojnë publikun për gjendjen e natyrës në territorin e vetë për masat e ndërmarra për mbrojtjen dhe ruajtjen e sajë;

Detyra dhe përgjegjësi të tjera të komunës për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit përfshijnë:

Zbatimin e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit në nivel lokal përmes:

- Administrimit me vlerat e natyrës dhe me vlerat e mbrojtura të natyrës;
- Vlerësimit të gjendjes së natyrës dhe biodiversitetit;
- Zbatimin e masave të mbrojtjes së natyrës;
- Vendosjen e kushteve dhe masave të mbrojtjes së natyrës në dokumentet e planifikimit hapësinor dhe planet e menaxhimit në sektorët dhe veprimtaritë që kanë ndikim në natyrë;
- Hartimin e raporteve për gjendjen e natyrës,
- Hartimin dhe zbatimin e programeve, planeve të veprimit dhe planeve të menaxhimit;
- Identifikimin dhe përcaktimin e vlerave të natyrës dhe vlerave të mbrojtura të natyrës;
- Njoftimin e publikut me gjendjen e natyrës;
- Pjesëmarrjen e publikut në vendim marrje për mbrojtjen e natyrës;
- Inkurajimin dhe mbështetja e mbrojtjes së natyrës përmes ngritjes së vetëdijes së publikut.
- Inkurajimin e hulumtimeve shkencore në lëmin e mbrojtjes së natyrës;

Integrimi sektorial i çështjeve të mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit ku bëjnë pjesë:

- Vendosja e kushteve dhe masave të mbrojtjes së natyrës në dokumentet e planifikimit hapësinor sikurse janë: Planet Zhvillimore Komunale, Hartat Zonale, Planet Rregulluese;
- Vendosja e kushteve dhe masave të mbrojtjes së natyrës në planet e menaxhimit në sektorët dhe veprimtaritë e xehetarisë, bujqësisë, pylltarisë, gjuetisë, peshkatarisë e hidro-ekonomisë;
- Vendosja e kushteve dhe masave të mbrojtjes së natyrës në planet e veprimtarive tjera me ndikim në natyrë.

Hartimi i raporteve për gjendjen e natyrës dhe biodiversitetit për territorin e komunës të cilat duhet të përfshijnë informata për

- Gjendjen ekzistuese të natyrës dhe biodiversitetit;
- Rrezikshmëria e llojeve dhe arsyeve të rrezikshmërisë;
- Ndikimet nga shfrytëzimi i të mirave të natyrës në larminë biologjike dhe peizazhore;
- Ndërhyrjet në natyrë dhe ndikimi i tyre;
- Shqyrtimin e efektit të masave të ndërmarra në ruajtjen e larmisë biologjike dhe vlerave të natyrës;
- Zbatimi i dokumenteve të rëndësishme për mbrojtjen e natyrës;
- Shfrytëzimin e mjeteve financiare për mbrojtjen e natyrës dhe projektet;
- Vlerësimi i nevojave për hartimin e dokumenteve të reja ose plotësimi i atyre ekzistuese;
- Të dhëna tjera të rëndësishme për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës.

Në bashkëpunim me Institutin për Mbrojtjen e Natyrës, komunat duhet të bëjnë identifikimi i vlerave të natyrës bëhet përmes:

- Monitorimit dhe vëzhgimit të biodiversitetit dhe natyrës;
- Realizimit të hulumtimeve për biodiversitetin dhe natyrën;
- Inventarizimit të llojeve bimore, shtazore dhe habitateve;
- Analizave hartografike për gjendjen e natyrës dhe biodiversitetit dhe ndryshimet ndër vite.

Zbatimi i masave për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit bëhet përmes:

- Zbatimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për projektet që kanë ndikim në natyrë;
- Zbatimit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planet dhe Programet që kanë ndikim në natyrë;
- Masave zbutëse në rastet e ndërhyrjes në natyrë;
- Masave për kompensim në rastet e ndërhyrjes në natyrë;
- Masave për kthimin e natyrës në gjendjen e mëparshme;

- Masave nxitëse për mbrojtjen e biodiversitetit;

Informimi për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit realizohet përmes:

- Sigurimit të informimin të publikut për gjendjen e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit,
- Mbajtjen e evidencën për të dhënat për gjendjen e mbrojtjes së natyrës,
- Në rastet e dëmtimit të natyrës janë të detyruara ta informojnë publikun me udhëzimet për veprimet të cilat duhet të ndërmerren për mbrojtjen dhe ruajtjen e saj.
- Në rastet të çfarëdo kërcënimi për natyrën dhe shëndetin e popullatës, publiku informohet për masat e ndërmarra dhe veprimet e duhura me qëllim të pengimit ose zbutjes të dëmeve të cilat mund të dalin nga ai rrezik.
- Organi kompetent i komunës, drejtoritë të cilat menaxhojnë me zonat e mbrojtura, kanë detyrim që përmes mjeteve të informimit publik, kërkuesve t`ju ofrojnë informacione për gjendjen e mbrojtjes së natyrës, për kryerjen e punëve të mbrojtjes së natyrës dhe t`ju mundësojnë qasje në dokumentacionin përkatës.

Vetëdijesimi dhe edukimi për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit përmes:

- Inkurajimit dhe sensibilizimit të publikun për mbrojtjen e natyrës dhe ruajtjen e saj përmes: medimeve të ndryshme, ligjëratave dhe materialeve të ndryshme të shtypura.
- Promovimit të vlerave të natyrës më qëllim të vizitës së tyre, për qëllime arsimore dhe rekreative.
- Shënimit të ngjarjeve me rëndësi për natyrën.

1.3. Qëllimi dhe objektivat e PLVB-së

Qëllimi i hartimit të plan programit lokal për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit është përcaktimi i veprimeve dhe masave në nivel lokal.

Qëllimi i përgjithshëm i Planit Lokal të Veprimit në Biodiversitet për komunën e Rahovecit është që të identifikoj problemet kryesore për mbrojtjen e biodiversitetit, të përcaktojë prioritetet në sektorin e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit dhe të ofrojë zgjidhje për problemet e identifikuara, duke synuar një menaxhim më efektiv të tyre, duke i vendosur ato në agjendën e institucioneve përgjegjëse.

Objektivat specifike të planit janë:

- Të bëjë vlerësimin e gjendjes ekzistuese të biodiversitetit dhe ndikimeve në natyrë nga sektorët e ndryshëm zhvillimor;
- Të identifikoj dhe përcaktoj problemet kryesore për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit në territorin e komunës së Rahovecit;
- Të identifikoj dhe përcaktoj prioritetet kryesore që do të adresohen në kuadër të PLVB-së për periudhën 5 vjeçare;
- Të planifikohen dhe përcaktohen afatet, aktivitetet dhe projektet që do të ndërmerren për adresimin e prioriteteve të identifikuara.

1.4. Metodologjia e hartimit të PLVB-së

Në kuadër të aktiviteteve për hartimin e këtij plani, në prill të vitit 2023 Komuna e Rahovecit ka lidhë kontratë me kompaninë “Albo Group” shpk për hartimin e PLVCA-së. Me 18.08. 2023, përmes vendimit nr.2028 është themeluar grupi punues për hartimin e PLVB, që ka udhëhequr procesin e hartimit të planit.

Metodologjia e hartimit të planit dhe përcaktimit të prioritetëve të tij është orientuar duke u bazuar në:

- Mbledhja e informatave dhe hulumtimeve për gjendjen aktuale të natyrës dhe biodiversitetit në komunën e Rahovecit;
- Analizën e gjendjes ekzistuese të natyrës dhe biodiversitetit në Komunën e Rahovecit;
- Identifikimi i problemeve kryesore në sektorin e mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit;
- Organizimi i paneleve të diskutimit dhe punëtorive me përfaqësuesit e komunës dhe grupet e interesit për përcaktimin e prioritetëve kryesore në mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit për periudhën 5 vjeçare.
- Bazuar në prioritetet kryesore është propozuar edhe **plani i veprimeve për përmbushjen e këtyre prioritetëve**, që do ti shërbejnë komunës për të hartuar projektet konkrete duke marrë për bazë kapacitetet financiare dhe zhvillimore të komunës dhe mundësitë e zgjidhjes së tyre apo nga sigurimi i fondeve nga donatorët.
- Për të siguruar një implementim më efikas të PLVB është propozuar **Plani i monitorimit për zbatimin** e tij, ku janë përcaktuar edhe treguesit përkatës të monitorimit sipas prioritetëve.

2. Profili i Komunës

2.1. Pozita gjeografike dhe organizimi administrativ

Rahoveci është qytet dhe komunë në pjesën jug-perëndimore të Kosovës. Në veri kufizohet me Klinën, në lindje me Suharekën, në pjesën jugore gjendet komuna e Prizrenit, ndërsa në tërë pjesën perëndimore kufizohet me komunën e Gjakovës. Përafërsisht ka diku 276 km² dhe është vendbanim i 56,208 banorëve.

Territori i komunës së Rahovecit përfshihet në regionin e Prizrenit dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Shtrihet në pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik dhe i takon Evropës juglindore.




Figura 1: Pozita gjeografike e komunës së Rahovecit

Ky territor përfshin pjesën qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit dhe është i ndarë në tri tërësi ose mikro regjione e këto janë: rafshirë-luginore, kodrinore dhe malore. Territori i komunës shtrihet në hemisferën veriore të Ekuadorit me shkallë 420 e 30' dhe 420 e 50' të gjërsisë veriore gjeografike dhe ndërmjet 200 e 21' dhe 200 e 55' të gjatësisë lindore gjeografike.

Vendbanimet në komunën e Rahovecit janë të koncentruara në lartësitë mbidetare prej 310 m. (Krusha e Madhe pjesa e re e vendbanimit pjesa lindore të bregut të lumit Drini i Bardhë) deri në 920 m. lartësi mbidetare që është i koncentruar vendbanimi i Zatriqit. Për nga lartësia mbidetare këto vendbanime ndahen në luginore-rrafshirë, kodrinore dhe malore. Vendbanimet të cilat janë të përfshira në luginë ose rrafshirë janë këto : (310 – 350 m.) Xërxa, Fortesa, Gexha, Malësia e Vogël, Drinasi, Denji, Dabidoli, Çifllaku, Nagaci, Hoça e Vogël dhe Retia.

Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lartësitë mbidetare prej 350 – 600 m që i takojnë kategorisë së vendbanimeve kodrinore janë: Rahoveci, Drenoci, Senovci, Pastaselli, Palluzhë, Kramoviku, Mrasori, Hoça e Madhe, Apterushë, Zaçishti, Patoçani i Ulët, Patoçani i Epërm, Nashpalla, Bratotini, Vranjaka, Celina dhe Krusha e Madhe (edhe pse disa pjesë të reja të vendbanimeve të këtyre fshatrave u takojnë pjesës së kategorisë së luginave ose rrafshirave).

2.2. Kushtet klimatike dhe relievi

Pozita gjeografike e Rahovecit me rrethinë ka kushtëzuar që në këtë region të dominojë klima e mesme kontinentale me një ndikim të klimës mediterane, e cila depërton përmes luginës së Drinit të Bardhë. Komuna e Rahovecit karakterizohet me verë të nxehtë dhe me dimër të ftohtë, ku muaji më i nxehtë është muaji korrik dhe muaji më i ftohtë është muaji shkurt.

Faktoret me të rëndësishëm të cilët ndikojnë në klimën e kësaj hapësire janë: pozita e pershtatshme gjeografike, largësia e vogël e Rahovecit nga Deti Adriatik (102 km deri te gryka e derdhjes së lumit Drini të Bardhë në detin Adriatik), lartësia mesatare mbidetare (rreth 308 në luginën e lumit të Drinit të Bardhë të Krushës së Madhe dhe 1.039 në majën e Zatriqit, që do të thotë mesatarja 550 m në tërësi sipërfaqen e komunës), barriera e malit të Shkozës, Zatriqit dhe Koznikut, zhvillimi i mirë i botes bimë dhe shtazore (livadhet, kullosat, të mbjellurat dhe pyjet) etj.

Klima me tipare të mesme mesdhetare ndihet rreth lumit Drini i Bardhë si dhe në këto vendbanime: Krusha e Madhe, Celina, Fortesë, Xërxe, Gexhë, Ratkoc dhe Çifllak. Ndikimet vërehen gjithashtu edhe rreth luginave të lumenjve, teracave liqenore, lumore dhe të cilat kodrat i mbrojnë prej erërave dimrore të veriut, ndërsa këto vendbanime janë: Reti, Apterushë, Hoça e Madhe, Hoça e Vogël, Brestoc, Rahovec, Bratotin, Dejne, Patacani i Epërm dhe i Ulet. Këto janë edhe pjesët me të ngrohta të Anadrinit. Klima me ndikim kontinental ndikon në malet e Koznikut, Zatriqit dhe Shkozës.

Në bazë të shënimeve shumë vjeçare klimatike, lokaliteti i Rahovecit karakterizohet me këto veçanti meteorologjike:

- Temperatura mesatare vjetore është +11.8 °C,
- Muaji më i ftohtë i vitit është shkurti me temperaturë minimale -0.14.5 °C,
- Muaji më i nxehtë i vitit është korriku me temperaturë maksimale +38.5 °C,
- Sasia e reshjeve vjetore është 765 mm.
- Më së shpeshti fryejnë erërat e veirut (11.8 %), veri-lindja, (62%), përëndimi (50 %), jugu (17%), dhe jug-lindja (4%).

Territori i komunës së Rahovecit shtrihet ne pjesën qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit, në një lartësi mesatare mbidetare rreth 550 m, dhe është i ndarë në tre mikro-regjione : 80,6 km² (ose 29,17 %) rrafshire-luginore me lartësi mbidetare 310–350 m, 62,2 km² (58,7 %) terren kodrinor me një lartësi mbidetare nga 350 në 600 m dhe 33,5 km² (ose 12.13 %) terren malor me një lartësi mbidetare nga 600 m.

2.3. Pedologjia dhe gjeologjia

Territori i Komunes se Rahovecit ka llojllojshmerine e dukshme pedologjike e cila pasqyrohet me numer te madh te grupeve te llojeve te tokes, e ne perberjen e saj ka 8 lloje dhe 21 nenlloje, ne forme te nje mozaiku. Me perjashtim te tokave skeletore, tokat tjera jane nga supstratet e bartura. Ato jane formuar pjeserisht nga sedimentet liqenore dhe rrjedhjeve te ujerave.

Sa i përket bonitetit të tokave pjesa më e madhe e tokave (64.2%) i takojnë tokave të klasës së 2, 13.8 % i takojnë klasës së 1, dhe diku 13,9% klasës së 6 (tabela 2).

Tabela 2: Klasat e bonitetit të tokës së Komunës së Rahovecit

Klasa e bonitetit	Sipërfaqja ha	%
Klasa 1	3807	13.8
Klasa 2	17690	64.2
Klasa 3	1560	5.7
Klasa 4	485	1.7
Klasa 5	192	0.7
Klasa 6	3816	13.9

Territori i komunës së Rahovecit ka përbërje gjeologjike të ngjashme me pjesën tjetër të territorit të Kosovës. Kjo tregon se në historinë gjeologjike të territorin të Rahoveci ka qenë i përfshirë në ujë në të cilën me miliona vite janë formuar sedimentet detare-liqenore. Në ndërtimin gjeologjik marrëin pjesë këto formacione: Holocene, Plistocene, Pliocene, Kretake dhe Jurasiku.

Holocen-formacioni holocen ndërton fundin e luginës së Drinit Bardhë. Kjo përmban material lumor (rërë, zhavorr dhe lymë) duke krijuar rrafshje aluvijale përgjatë shtretërve të lumenjve.

Pliocene - Formacionet të pliocenit ndërtojnë pjesën periferike të maleve zatriq, kaznik dhe shkozë, ku përbëhen nga sedimentet liqenore (rërë, zhavorr dhe argjilë).

Kreta - Formacionet e kretakut ndërtojnë pjesën lindore dhe veriore të malit Zatriq si dhe masivi i shkozës që shtrihet në veri, verilindje të qytetit të Rahovecit në drejtim të këtyre fshatrave Hoçë e Mahe, Zaqisht si dhe Epterush. Ky formacion prezantohet me shkëmbit gëlqeror e si shembull është masivi te ura e fshejt (Gradish si dhe në qytetin e Rahovecit).

Jura - Prezantohen formacionet diabazike, serpentine, gabrot, ku shkalla e serpentinit sillet rreth 70-80 %. Ky formacion përfshin territor më të madh se formacione tjera, ku kanë shtrirje VVP-JJL.

2.4. Trashëgimia Kulturore

Komuna e Rahovecit është e njohur për trashëgiminë e saj fetare dhe i ka 23 xhami dhe 12 kisha dhe manastire në përdorim të cilat janë kryesisht të përqendruara në fshatin e Hoçës së Madhe. Gjithashtu njihet edhe si qyteti i vreshtave dhe verën e shijshme të cilësisë së mirë.

Në listën e trashëgimis materiale përfshihen këto monumente:

- Lokaliteti arkeologjik në Pozhigë, fshati Bellacerkë (romak)
- Banja termale në fshatin Çiflak (romak)
- Rrënojat e vendbanimit të fortifikuar në fshatin Zatriç (Epoka e hekurit/Antikitet i Vonë)
- Kështjella e urës së gurit, Rahovec (romak)
- Kështjella në fshatin Gexhë (Antikiteti i Vonë)
- Varrezat në fshatin Celinë (Mesjetare)
- Varrezat në fshatin Vranjak (Mesjetare) Kisha e Bërnjaçës (shek. 14)
- Kisha e Shën Nikollës në Hoçë të Madhe (shek. 14-16)
- Kisha e Shën Gjergjit në Hoçë të Madhe (shek. 13 dhe 14)
- Teqja Halvetie, qendra e Rahovecit (shek. 18)
- Fontana e vjetër, Rahovec (shek. 18 dhe 19)
- Teqja e Melamive (masxhid), Rahovec (1887, rindërtuar 1970)
- Xhamia e fshatit në Zatriq (shek. 18)
- Xhamia e fshatit në Pastasellë (shek. 18)
- Xhamia e fshatit në Drenoc (shek. 18)
- Xhamia e fshatit në Xërxe (shek. 18)
- Shtëpia e Qamil Vuçitërnës, Rahovec (shek. 19)

- Kulla e Hajrullah Çantës, Rahovec (shek. 19)
- Konaku i Manastirit të Deçanit, në Hoçën e Madhe (shek. 19)
- Shtëpia e familjes Spasiq në Hoçë të Madhe (shek. 19)
- Kulla e Ismet Çmegës (shek. 19) Xhamia e Kosumit, Rahovec (1826)
- Xhamia e Sokolit, Rahovec (1824)
- Manastiri i Zoçishtës, fshati Zoçishtë (Mesjetare/ shek. 19)

Ndërsa në kuadër trashëgimia jo materiale, Komuna e Rahovecit është e njohur për “Festivalin e verës”.

Trashëgimia materiale dhe jo materiale e komunës janë një mundësi e mirë për zhvillimin e turizmit, andaj për rekomandohen që të hartohen programe për të rritur vetëdijen dhe për të promovuar vlerat e trashëgimisë kulturore të kësaj komune.

Disa nga veprimet që mundë të ndërmerren në këtë drejtim janë:

- Të mbështeten aktivitetet shkollore për ngritje të vetëdijes për mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore të komunës;
- Të merren masat e nevojshme për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të komunës;
- Të hulumtohen dhe identifikohen praktikrat e veçanta të traditave, lojërave dhe trashëgimisë në Rahovec, në mënyrë që të dokumentohen ato sipas udhëzimeve.
- Të shënohen në harta të gjitha asetet e trashëgimisë së ndërtuar, të luajtshme, jo materiale dhe natyrore me informacionin përkatës dhe të përditësohen rregullisht autoritetet qendrore.
- Të përgatitet një listë e ndërtesave në rrezik në komunë dhe t’i raportohet QRTK-së në rajonin e Prizrenit dhe komunës.
- Të zhvillohet dhe të inkurajohet vlerësimi i plotë, dizajni i integruar i projektit dhe planifikimi i shëndoshë i menaxhimit të trashëgimisë në komunë;
- Të identifikohen standardet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve të turizmit kulturor dhe të ofrohen trajnime për ofruesit e shërbimeve.
- Të sigurohet shenjëzimi i duhur për lokalitetet e trashëgimisë kulturore dhe të futen ato në guidat turistike;
- Të mbështetet zhvillimi i kapaciteteve për menaxhimin e trashëgimisë, duke përfshirë udhërrëfyesit lokal.
- Të investohet në artikujt e produkteve kulturore duke u bazuar në praktikrat e trashëgimisë kulturore lokale, siç është festivali tradicional i verës.
- Të mbështeten nismat kulturore të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM).
- Të promovohet Rahoveci si një destinacion turistik që kombinon verën, turizmin fetar dhe natyrën

3. Ndikimet kryesore në biodiversitet

3.1. Zhvillimi ekonomik dhe bizneset

Ekonomia lokale në Komunën e Rahovecit, bazohet kryesisht në industrinë agro-industriale, përpunimin e rrushit dhe të grurit, industrinë e plastikës, ndërtimtarisë, teknologjinë përpunuese të metaleve, teknologjive për ngrohje dhe ftohje, artizanate, tregëti, shërbime etj. Pjesëmarrja e veprimtarive prodhuese dhe shërbyese në krahasim me veprimtaritë tjera ekonomike është e konsiderueshme, duke treguar një pjesëmarrje më të madhe në biznesin privat.

Pas luftës, ndërmarrjet e vogla kanë shfaqur tendencën për shfrytëzimin dhe përpunimin e gurit, rërës, zhavorit dhe argjilës, evidente me një shkatërim joselektiv të resurseve.

Sipas statistikave, në vitin 2011 janë 3215 biznese të regjistruara në zyrën për regjistrim të bizneseve, ndërsa gjatë periudhës 2000-2021 janë të regjistruara gjithsejtë 3390 biznese. Nga këto biznese 2966 janë aktive, 249 biznese pasive dhe 384 biznese janë shuar. Në strukturën e bizneseve dominojnë ato të tregtisë me shumicë dhe pakicëm pastaj ato të prodhimit dhe përpunimit, të ndërtimit dhe akomodimit dhe ushqimit.

Turizmi është me pak i zhvilluar, edhe pse Rahoveci është njeri ndër qytetet me të vjetra të Kosovës, me relikte të vendbanimeve të dikurshme antike, të cilat rrjedhin nga epoka e hershme romako-ilire. Turizmi kulturor kryesisht mund të jetë i bazuar në trashëgimi kulturore/arkitekturore: shtëpi të tradicionale, turizëm kulturor arkeologjik, shpella, hamame, trashëgimi arkitekturore dhe fetare. Poashtu duhet për të cekur se të Ura e Fshejte është zonë turistike me kanjonin atraktiv Eupegjenik të lumit Drini i Bardhe.

Në aspektin mjedisor, në komunën e Rahovecit nuk ka ndonjë industri që veprimtarinë e saj e ka të bazuar në djegje të burimeve fosile dhe që karakterizohet me emetime të larta në ajër.

Tabela 3: Bizneset në Komunën e Rahovecit

Përshkrimi	Numri
Biznese të regjistruara 2000-2021	3390
Biznese aktive	2966

Biznese pasive	249
Biznese të shuara	384

3.2. Sektori minerar

Në territorin e Komunës së Rahovecit ka rezerva të gurit dekorativ, gurit gwlqeror dhe minerale si krom, azbest, nikel, kobalt, bakër dhe qymyr guri (thëngjilli).

Gurët dekorative - gjendet në afërsi të fshatit Drenovc, në një largësi prej 5,5 km nga qyteti i Rahovecit. Rezervat për këtë material ndërtimor dekorativ mendohet të jenë rreth 207.386 m³. Shtresat e lezolitit dekorativ janë sipërfaqësore të mbuluara me një shtresë humusi prej 0,5 m.

Gurët gëlqerorë - gjenden në Hudhrat e Danit, një vend në veri-perëndim të qytetit të Rahovecit 8 km larg tij. Ato shtrihen në formë blloqesh me trashësi që varion nga 0,3 në 2 metra, dhe janë 1,5 metra poshtë sipërfaqes së tokës. Gurët gëlqerore paraqiten në ato të kuq dhe murrëm. Gëlqerorët e kuq paraqesin më shumë interes ekonomik. Rezerva e gurëve gëlqerorëve mendohet të ketë një volum prej 382.913 m³.

Azbesti -Shtresat e lezolitit të azbestit janë të përqendruara në afërsi të fshatit Rudin/Pastasel në perëndim të Rahovecit, në një largësi prej 8 km. Në bazë të hulumtimeve (janë bërë 4 shpuarje) është përcaktuar sipërfaqja e shtresës prej 100.000 m² dhe mendohet që rezerva të kapë shifrën prej 10.000.000 Ton. Kjo e dhënë është e përafërt dhe kërkon hulumtime të hollësishme gjeologjike.

Kobalti, Nikeli dhe Bakri -Në rrethinën e Gurit të Kuq janë konstatuar shtresa e xeheroreve të Nikeli-Kobaltit. Përbërja mesatare e këtij xeherori sipas hulumtimeve të bëra vite më parë për mineralin në formë të ngurtë është (Nikeli 0,18 %, Kobalti 0,13 % dhe Bakri 2,73 %). Sasia e rezervave të këtij xeherori nuk dihet.

Kromi-mendohet që ky mineral të gjendet përgjatë luginës së Drinit të Bardhë në një sipërfaqe rreth 60 km² dhe përkatësisht në lokalitetet Qëndresë, Gradisht, lugina e proit Rimnik, Delja, Shipi në Zadriq, Sharnica mbi Qëndresë, Drenovci, Guri i kuq, Kanzniku, etj.

Thëngjilli- gjendet në lokalitetet e Hoçës së Madhe, Krushës, proit të Nagavcit, Drinasi, etj. Për të përcaktuar sasine e rezervave dhe cilësitë kalorifike të thëngjillit duhen bërë hulumtime të thella gjeologjike.

Në territorin e Komunës së Rahovecit, veprojnë disa operatorë që kanë si veprimtari shfrytëzimin e gurit, rërës dhe zhavorrit dhe disa të tjera që kanë si veprimtari hulumtimin e rezervave të gurit, rërës dhe zhavorrit (tabela 4). Disa nga këto veprimtari sidomos ato të shfrytëzimi të rërës dhe zhavorrit janë ilegale ose janë në procedurë në gjykatë. Këto veprimtari krahas dëmtimit estetik të peisazhit dhe shtretërëve të lumenjëve karakterizohen edhe me emetime të pluhurit në ajër.

Në vecanti operatorët e shfrytëzimit të gurit të fortë ndërtimorë gjatë procesit të thërmimit dhe bluarjes janë burim i emetimit të grimcave të pluhurit.

Tabela 4: Operatorët ekonomik në sektorin minerar në komunën e Rahovecit¹

Operatorët sipas kategorive	Nr. i operatorëve
Shfrytëzimi i gurit të fortë ndërtimorë	3 operatorë
Hulumtim i rezervave të gurit të fortë ndërtimorë	2 operatorë
Shfrytëzim i rërës dhe zhavorrit	20 operatorë

3.3. Transporti

Pozita gjeografike e komunës së Rahovecit në të cilën kalojnë rrugë të rëndësishme i mundësojnë komunikim të mirë dhe mjaft efikas, ku në nivel të komunës administrative të komunës janë të shtrira gjithsejtë 297.6 km rrugë të të gjitha kategorive. Nëse analizohet niveli i mbulushmërisë së sipërfaqes së komunës me rrugë të të gjitha kategorive del se ato janë të shtrira në gjithsejtë 157.1 ha.

Komuna e Rahovecit karakterizohet me lidhje shumë të mira të komunikacionit rrugor të cilat ndihmojnë zhvillimin e transportit të udhëtareve dhe të mallrave. Shtrirja e rrugëve Regjionale kryesisht në pjesën qendrore dhe perëndimore të komunës ia ka shtuar rëndësinë kësaj hapësirë. Në komunën e Rahovecit ekziston niveli i katër kategorive të rrugëve (të klasifikuara në Kosovë), duke filluar prej rrugëve magjistrale e deri tek ato të pa kategorizuara.

Rrjeta e rrugëve në komunën e Rahovecit përbehet nga:

- Rrugët magjistrale – M9.1 (Gjakovë - Prishtinë)
- Rrugë regjionale - (R107 Prizren-Gjakovë, R117 Rahovec-Suharekë, R111 Xerxë Ratkoc-Kramovik, R204 Rahovec- Krushë e Madhe, R110 Malishevë- Rahovec – Xerxë)
- Rrugë lokale (rrugët të cilat i lidhin 34 komuna kadastrale me gjithsej 36 vendbanime, duke përfshirë edhe rrugët që lidhin lagjet më të rëndësishme të vendbanimeve)

¹ <http://opendata.cohu.org/sq/degradimi-mjedisit>

- Rrugë të pa kategorizuara (të cilat lidhin lagjet e fshatit si dhe i lidhin të gjitha hapësirat në të cilat zhvillohen aktivitete socio-ekonomike).

Nga totali i përgjithshëm i rrugëve 297.6 km, sa janë në komunën e Rahovecit sipas gjatësisë, rrugë magjistrale janë 6.2 km (2.1%), rrugë regjionale 64.3 km (21.6%), rrugë lokale 114 km (38.3%), rrugë urbane 30.6 km (10.3%) dhe rrugë të pa kategorizuara janë gjithsej 82.5 km (27.7%). Duke iu referuar analizave të bëra në nivel të komunës, janë nxjerr edhe sipërfaqet e mbuluara me rrugë dhe aktivitete të tjera përcjellëse sipas kategorisë së tyre (tabela 5).

Tabela 5: Rrjeta e rrugëve në komunën e Rahovecit

Nr.	Pershkrimi	Gjatësia në km	%
1	Rruge magjistrale	62	2.1
2	Rruge regjionale	64.3	12.6
3	Rruge urbane	30.6	10.3
4	Rruge lokale	114	38.3
5	Rruge e pakategorizuar	82.5	27.7
Total		297.6	100

3.4. Bujqësia

Duke marrë parasysh kushtet e favorshme topografike, klimatike dhe agro-ekologjike puna në bujqësi, vreshtari dhe verari përbën aktivitetin themelor ekonomik në Rahovec në të gjitha aspektet duke përfshirë prodhimin, burimin e të ardhurave dhe punësimin. Pjesa më e madhe e tokës së komunës së Rahovecit përdoret si tokë punuese për bujqësi, e sidomos tokat kodrinore që përdoren si territore vreshtare.

Sipërfaqet bujqësore, si sipërfaqet të rëndësishme ekonomike paraqesin bazën të rëndësishme natyrore për Komunën e Rahovecit. Kushtet të volitshme klimatike, sidomos numri i madh i ditëve me diell gjatë sezonit veror si dhe ujitja me anë të pipave për kulturat lavëtare (speca, domate, patate, bostan, qepë etj) si dhe kultivimi i hardhisë së rrushit dhe pemëve. Sipërfaqet më pjellore janë rrafshirat e Anadrinis duke filluar prej Mrasorit e gjerë në Krushë të Madhe e që më së shumti në këto toka kultivohen perimet, ndërsa në pjesët tjera kultivohen hardhia e rrushit (vreshtat) dhe pemë të ndryshme si që janë: molla dardha, kumbulla, pjeshka, arra, kajsia etj.

Komuna e Rahovecit ka 12.626 ha sipërfaqe tokë punuese e prej te cilave 3.500 ha i ka në sistemin e ujitjes. Rreth 70% e popullsisë së komunës sigurojnë ekzistencën nga aktivitetet bujqësore si në vreshtari dhe perimtari, etj. Duke pasur klimën e përshtatshme si dhe llojet e tokave

në këtë territor më së miri kultivohet hardhia e rrushit. Prodhimi i rrushit dhe verës ka qenë industria kryesore strategjike në Komunë. Duhet të theksohet se Komuna e Rahovecit ka 50% të vreshtave dhe kapaciteteve totale të përpunimit të verës në Kosovë. Sipërfaqet e mbjelluar me vreshta janë në sektorin privat 2.500 ha dhe në sektorin shtetëror 993 ha.

Numri i ekonomive familjare apo fermave mendohet të jetë rreth 4815. Sasia e sipërfaqes së tokës bujqësore në pronësi të një ferme sillet prej 0.5 -2 Ha, ku kemi të bëjmë me parcelizimin e tokës, të disfavorshme për zhvillimin e një bujqësie intensive. Duke llogaritur që një familje ka mesatarisht 7 anëtarë, numri i përgjithshëm i banorëve që jetojnë vetëm nga të ardhurat nga puna në bujqësi (ekonomi për ekzistencë) rezulton të jetë rreth 33,700 banorë. Prodhimtaria e rrushit dhe produkteve të tij ka traditë mijëvjeqare, Këto të dhëna vërtetojnë ekzistencën e kësaj prodhimitarie që në shekullin e parë të erës së re.

Ndikimi në cilësinë e ajrit nga bujqësia vjen si rezultat i përdorimit të plehrave kimike dhe aktivitetëve bujqësorë që ndërlidhen me përdorimin e lëndëve djegëse. Në tabelën vijuese është prezantuar sasia e vlerësuar e përdorimit të plehrave kimike në komunën e Rahovecit.

Tabela 6. Sasia e plehrave kimike të përdorura dhe përmbajtja e azotit

Lloji i plehut kimik	Sasia e përdorur kg/vit ²	Sipërfaqja e tokës se plehrosur	Sasia totale kg/vit
UREA	139 kg/ha	14687 ha	2,041,498
NPK	259 kg/ha	14687 ha	3,803,933
NAG	74 kg/ha	14687 ha	1,086,172

3.5. Turizmi

Turizmi është me pak i zhvilluar, edhe pse Rahoveci është njeri ndër qytetet me të vjetra të Kosovës, me relikte të vendbanimeve të dikurshme antike, të cilat rrjedhin nga epoka e hershme romako-ilire, por edhe me vlera të rralla natyrore. Rahoveci shquhet për vlera të rralla të trashëgimisë natyrore. Pozita gjeografike, relievi, klima, burimet ujore, peizazhet, grykat e kanionet, bota e pasur bimore dhe shtazore janë parakushte ideale dhe potencial i lartë për zhvillimin e turizmit. Rahoveci veçanërisht ka mundësi të mira të zhvillimit të turizmit kulturor, turizmit të shpellave, turizmit malorë, turizmit rekreativ-sportiv, turizmit verorë, turizmit rural dhe atij edukativ.

² ASK, Regjistrimi i Bujqësisë 2014

Turizmi kulturor- kryesisht mund të jete i bazuar ne trashëgimi kulturore/arkitekture: shtëpите tradicionale, turizëm kulturor arkeologjik, hamame, trashëgimi arkitekture dhe fetare. Lokalitete të tilla në komunën e Rahovecit janë: Lokaliteti arkeologjik në Pozhigë, fshati Bellacerkë, rrënojat e vendbanimit të fortifikuar në fshatin Zatriç, kështjella e urës së gurit në Rahovec dhe kështjella në fshatin Gexhë, varrezat në fshatin Celinë dhe varrezat në fshatin Vranjak, Kisha e Bërnjaçës, Kisha e Shën Nikollës dhe ajo Shën Gjergjit në Hoçë të Madhe, Teqja Halvetie dhe Teqja e Melamive në Rahovec, Xhamia e fshatit në Zatriq, Xhamia e fshatit në Pastasellë, Xhamia e fshatit në Drenoc, Xhamia e fshatit në Xërxe si dhe Xhamia e Kosumit dhe Xhamia e Sokolit, Rahovec, Shtëpia e Qamil Vuçitërnës dhe Kulla e Hajrullah Çantës në Rahovec, Konaku i Manastirit të Deçanit në Hoçën e Madhe, Kulla e Ismet Çmegës në Rahovec dhe Manastiri i Zoçishtës, fshati Zoçishtë.

Turizmi i shpellave - Rahoveci ka disa shpella që nuk janë të njohura për opinionin e gjerë. Ato kanë potencial për të qenë destinacione turistike. Me përmirësimin e infrastrukturës së tyre ato do të ofronte kushte shumë të mira për zhvillimin e turizmit të shpellave. Të tilla janë për shembull Shpella e Peshterrit, Shpella e Bali Agës, Shpella e Plumbave Shpella e Mbretëreshës së Bardhë, Shpella e Banuar (Gërgavica) në Zatriq.

Turizmi malor dhe ecja në natyrë - Në zonat e thella malorë të Rahovecitekzistojnë shumë shtigjet malore të cilat përdorën blegtoret për bagëtitë e tyre dhe të cilat paraqesin mundësi reale për zhvillimin e ecjes në natyrë, shëtitjeve malore me biçikleta por edhe të ekspeditave dhe kampingjeve. Ky lloj i turizmit mundë të zhvillohet edhe në Zatriq, Mrasor dhe në zona tjera malore të Rahovecit.

Turizmi rekreativ dhe sportiv - Në territorin e Komunës së Rahovecit gjenden shumë zaona malore dhe shumë terrene të përshtatshme për zhvillimin e turizmit sportiv. Disa lokacione të tilla si Zatriqi, janë shumë atraktive për zhvillimin e alpinizmit dhe bjeshkatarisë.

Turizmi veror dhe njëditor - Klima e përshtatshme, livadhet e pasura me llojllojshmërinë e bimëve, burimet e shumta ujore, peizazhet piktoreske janë parakusht i mirë edhe për zhvillimin e turizmit veror dhe kampingut. Zatriqi, Kramoviku, Mrasori dhe Kanioni e Drinit të bardhë janë vetëm disa nga zonat që gjatë stinës së verës mundë të jenë destinacion i përhershëm i shumë turistëve dhe adhuruesve të natyrës që dëshirojnë të kalojnë një ditë në natyrë.

Turizmi rural - Në shumë zona rurale të Rahovecit, e sidomos në ato malore ende ruhen shumë zakone, tradita, lojëra, këngë, veshje e ushqime tradicionale. Këto pasuri të jashtëzakonshme kulturore janë një mundësi e mirë e zhvillimit të turizmit rural dhe promovimit të këtyre vlerave. Në veçanti për këto vlera shquhen fshatrat malore por edhe ato që shquhen për traditat e kultivimit të rrushit dhe verës.

Turizmi edukative dhe shkencor - Ekosistemet e paprekura malore, prania e llojeve të rralla bimë e shtazore, shpellat e pa hulumtuara, kanionet, rrjedhat e shumta ujore dhe

pasuritë nëntokësore të Kosovës kanë potencial edhe për zhvillimin e aktiviteteve edukative e kërkimore me nxënës, studentë dhe shkencëtareve nga Rahoveci por edhe për ekspedita të huaja hulumtuese. Lokalitetit Ura e Fshejtë me fenomenin e Kanionit të Drinit të Bardhë mundë të jetë një nga këto destinacione turistike për nxënësit e shkollave dhe studentët për shkak të karakteristikave morfologjike dhe eupejenike dhe për shkak të qasjes së lehtë për vizitorë.

Përkundër këtyre vlerave të jashtëzakonshme dhe mundësive ideale për zhvillimin e turizmit, mungesa e infrastrukturës, mungesa e investimeve, mungesa e planeve dhe projekteve konkrete ka penguar zhvillimin e kapaciteteve turistike. Problem i veçantë është qasja që institucionet qeveritare dhe shoqëria jonë ka ndaj shfrytëzimit të qëndrueshëm të këtij potenciali. Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore, dëmtimi i ekosistemeve, gjuetia ilegale, zgjerimi i vendbanimeve janë kërcënim i vazhdueshëm për këto vlera. Me një promovim më profesionale të zonave turistike, me rritjen e investimeve dhe me përgatitjen e një strategjie lokale për zhvillimin e turizmit Rahoveci mundë të jetë një vend shumë atraktiv turistik.

4. Gjendja e Biodiversitetit

4.1. Resurset ujore dhe menaxhimi i tyre

Në komunën e Rahovecit rrjeti hidrografik është relativisht i mirë. Kjo paraqet pasurinë natyrore të komunës dhe një ndër kushtet për ekzistencën të botës bimore dhe njerëzore. Rrjeti hidrografisë së komunës së Rahovecit e përbëjnë disa qindra burime, pusët, burime rrjedhëse dhe të qëndrueshme dhe proçkat. Në territorin e komunës së Rahovecit ka disa qindra burime periodike dhe të përhershme. Numri i madh i burimeve janë ato burime që burojnë në luginat e proçkave – projeve dhe rrënzë kodrinoro-malor. Më së shumti ka burimet në luginën e Rimnikut, lumit të Hoçës, Apterushës etj. Posaçërisht këto burime janë karstike të cilat paraqiten në fund të shtratit të lumit.

Rëndësi të madhe ekonomike kanë burimet të cilat shtrihen në shpatiet e luginave dhe shtratit të lumit, pastaj burimet të cilat paraqiten në kodrat terciare të neogjenit. Kërkime hidrografike tregojnë se më së shumti kanë burimet karstike periodike dhe të përhershme. Burimet e këtilla gjenden në jug-perëndim, veriut dhe veri-perëndim, në rrënzë të malit Shkozës, Zatriqit dhe Kaznikut. Për hirë të kësaj janë formuar edhe vendbanimet rreth këtyre burimeve si që janë : Rahoveci, Hoça e Madhe, Zaçishti, Apterusha, Zatriqi, Drenoci, Senoci, Pastaselli, Kramaviki e tjerë (shiko tabelën në vijim).

Disa nga burimet më të rëndësishme ujore në territorin e komunës janë prezantuar në tabelën 7:

Tabela 7. Burimet ujore në territorin e komunës së Rahovecit

Emri i burimit	Lartësia mbidetare (m)	Kapaciteti l/s
Burimi i Rahovecit	390	5–8

Burimi i Zatriqit	920	5
Burimi i Apterushës	400	40
Burimi i Zaçishtit	415	15
Burimi i H. Madhe	420	10
Burimi i Sopotit	380	6

Lumi Drini i Bardhë edhe pse nuk buron ne komunën e Rahovecit, por të gjitha përrockat dhe lumenjtë derdhen ne të. Njëpër komunën e Rahovecit, ky lum rrjedhë me një gjatësi prej 30 km.

Lumenjtë-përrockat te cilat derdhen në Drinin e Bardhë janë : lumi Drinas, Rimnik, Palluzhë, Hoçë etj. Për shkak të konfiguracionit të terrenit lugina e Drinit në komunën e Rahovecit sillet 2 deri 5 km. Ndërsa gjërsia mesatare e shtratit të lumit prej 50 deri 100 m., thellësia e shtratit të lumit është 1 deri 5 m. Hapësira e parë shtrihet prej Gradishit (Gexhes) gjerë të Kramovikut në një gjatësi prej 15 km. Hapësira e dytë shtrihet prej Gradishit (Gexhes) gjerë në jug-lindje ndërmjet fshatrave Xerxe, Fortesë, Celinë dhe Krusha e Madhe dhe ndryshe quhet Anadrinia e Ulët.

Lumi Drini i Bardhë në Anadrininë e ka prirë masivin gëlqeror Gradishin ashtu që ka formuar Grukën (Kanjonin) eupegjenik atraktiv në gjatësi prej 450 m. Në kanjonin është ndërtuar Ura e Fshenjtë e cila është e gjatë 70 m. dhe thellësia prej harkut deri te shtrati i ujit është 30 m.

Lumi i Hoçës buron në fshatin Hoçë të Madhe në lartësi mbidetare 420 m dhe rrjedh nëpër fshatra Brestovc, por para fshatit Brestoc bashkohet me procken e Babindollit dhe disa burimet të tjera dhe derdhet në Drinin e Bardhë. Lumi Bellaja është dega e majatë e Drinit të Bardhë dhe është e gjatë 3 km prej fshatit Fortesë deri te fshati Rogovë.

Lumi Duhllo buron në Rahovec dhe është i formuar nga tri burime (Duhllo, Vrella dhe Sopot) nja 4 km bashkohet me lumin e Rimnikut në harta topografike ky lum është i shënuar me emrin Gjegoja që do të thotë për popullin e kësaj ane është i pa njohur.

Lumi Rimnik buron në rrënzë malet Gërgavicë dhe në rrjedhjen e saj i merr disa burim të tjera. Ky lum ka rëndësi të madhe ekonomi për këtë anë. Lumi Rimnik gjatë rrjedhjes së vetë bashkohet me Duhllo dhe në fshatin Fortesë bashkohet me lumin e Sopniqit dhe formojnë lumin Bellaja.

Lumi Sopniq burimin e ka në rrënzë të malit të Drenocit dhe kalon nëpër fshatin Nashpall, Sopniq. Ky lum gjatë stinës së verës shtrati i tij i thatë dhe mund të quhet si lumi i Thatë. Duhet për të cekur janë edhe disa lumenjë-prockat si që janë : Drinasit, Kramovikut, Palluzhës e tjera.

Nga sistemi i distribuimit të ujit. Radoniqi. mundësohet ujitja e 3,500 ha të tokave bujqësore dhe furnizimi me ujë të pijshëm.

Cilësia e ujit sipërfaqësorë (të lumenjve) në territorin e komunës, nga monitorimi që realizohet nga Instituti Hidrometeorologjik matet në një pikë monitoruese në lumin Rimnik në Xërxë, para derdhjes në Lumin Drini i Bardhë. Bazuar në të dhenat e monitorimit mesatarja e sasisë së Oksigjenit të tretur gjatë periudhës 2015-2020 ka qenë rreth 6 mg/l, mesatarja e shpenzimit biokimik i oksigjenit ka qenë rreth 20.6 mg/l, mesatarja e PH ka qenë rreth 7.2, mesatarja e azotit të nitrateve rreth 1.5 mg/l, mesatarja e azotit të nitriteve rreth 0.2 mg/l, mesatarja e azotit të amoniumit rreth 2.5 mg/l dhe mesatarja e fosforit ishte rreth 0.35 mg/l³.

Presionet në ujëra vijnë kryesisht si pasojë e rritjes së vëllimit të ujërave të shkarkuara pa trajtimin adekuat fizik, kimik e biologjik. E gjithë kjo ndikon në rritjen e vlerave të parametrave fizikë, kimik dhe mikrobiologjik në trupat ujorë. Presione të tjera nga reshjet janë shpëlarja e tokave bujqësore dhe sipërfaqeve të tjera ndotëse me ç' rast vije deri te rritja e materieve të suspenduara, materive inorganike dhe atyre organike.

Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve ujore dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve, ende mbetet një nga format e degradimit të resurseve ujore në territorin e Komunës së Rahovecit. Burim i ndotjes së lumenjve në komunën e Rahovecit, janë mbeturinat që hidhen në këta lumenj dhe derdhja e ujërave të zeza direkt në lumenj pa ndonjë trajtim paraprak.

Në territorin e Rahovecit, në lokalitetet Krushë e Madhe, Qiflak, Dobidolë, Dejë dhe Ratkoc, veprojnë disa operatorë që kanë si veprimtari thërrmim dhe seperim i rërës dhe zhavorrit, nga shtrati i lumit Drini i bardhë. Këto aktivitete kanë pasë ndikim në shtratin e lumit duke sjellë mes tjerash: ndryshim fizik të rrjedhës së lumit dhe zgjerimi të pakontrolluar të shtretit, devijim i rrjedhës natyrale të ujërave, krijimi i hendeqe të shumta gjatë rrjedhës së lumit, rritje e shkallës së erozionit të tokës dhe vërshimeve, degradim të sipërfaqeve së tokës përgjatë shtretit të lumit, paqëndrueshmëri dhe prishje e brigjeve të lumit dhe ndryshim natyror të ekosistemit të lumit, florës dhe faunës⁴.

³ Raporti për Gjendjen e ujërave 2020, AMMK

⁴ Raport, Ndikimi i shfrytëzuesve të rërës dhe zhavorit në gjendjen mjedisore të lumenjve, AMMK 2022



Foto: Degradimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë në territorin e Rahovecit

4.2. Shfrytëzimi i tokës dhe cilësia e dheut

Toka është komponent e rëndësishme e mjedisit në të cilën rritet dhe zhvillohet bota bimore dhe shtazore, dhe ku zhvillohet prodhimtaria bujqësore. Shfrytëzimi i tokës bartë me vete edhe mundësin e degradimit dhe ndotjes së saj në mënyrë direkte apo indirekte. Sfida është që të parandalohet degradimi i tokave nëpërmes masave dhe politikave specifike për mbrojtjen e tokave. Ndikimet e vazhdueshme nga aktivitetet njerëzore sjellin deri te degradimi i sipërfaqeve tokësore duke shkaktuar edhe pasoja socio-ekonomike.

Deri te ndotja e tokës vije kryesisht përmes shkarkimit të ujërave të ndotura, përdorimit të plehrave minerale dhe pesticideve, nga deponitë ilegale të mbeturinave, apo edhe formave tjera të shkarkimit të materieve të dëmshme në tokë.

Në komunën e Rahovecit rreth 52% e tokës shfrytëzohet si tokë bujqësore përfshirë edhe vreshtat, rreth 25% është pyje, diku 4.8% është zonë ndërtimore ndërsa rreth 15% është rlivadhe dhe kullosa (tabela 8).

Tabela 8: Destinimi i shfrytëzimit të sipërfaqes së tokës

Destinim i sipërfaqes	ha	%
Pyje	6932	25.2
Kullosa	3921	14.2
Livadhe	252	0.9
Toka të Degraduara	403	1.5
Sipërfaqe bujqësore	12020	43.6
Vreshtat	2415	8.8
Zonat e ndërtimit	1310	4.8
Zona ujore	193	0.7

Varrezat	104	0.4
----------	-----	-----

Një ndër burimet kryesore të ndotjes së tokës janë edhe bujqësia nga përdorimi jo racional i pesticideve dhe plehrave jo minerale dhe deponitë ilegale të mbeturinave. Në komunën e Rahovecit ekzistojnë rreth 10 deponi ilegale të mbeturinave komunale që janë si burime të ndotjes së tokave.

Eksplotimi i resurseve minerare është një dukuri tjetër, e dëmtimit të tokës në komunën e Rovecit. Në bazë të të dhënave të Komisionit të Pavarur të Minierave dhe Mineraleve, në territorin e komunës së Rahovecit operojnë 26 operatorë që si subjekt të veprimtarisë kanë eksploatimin e gurit dhe të rërës. Vetëm disa nga operatorë kanë licenca për veprimtarinë e tyre dhe pjesa me e madhe e operatorëve nuk kanë licenca për veprimtarinë e tyre⁵.

Gjithashtu edhe humbja e shtresës cilësore të tokës nga procese natyrore të erozionit si dhe nga aktivitetet e njeriut sikurse është prerja e pakontrolluar e pyjeve konsiderohet si ndër faktorët kryesor të degradimit të tokave.

Nuk ka informacione të plota për të vlerësuar dëmet e shkaktuara nga erozioni. Një vlerësim i përafërt është bërë në kuadër të procesit të hartimit të Planit Zhvillimorë të Komunës (tabela 9), ku është vlerësuar se 41% e sipërfaqeve janë të ndikuara nga erozioni i mesëm, 29% nga erozioni i dobët dhe 25% nga erozioni shumë i dobët. Ndërsa që 3% e sipërfaqeve nuk janë të ndikuara nga erozioni kurse 2 % e sipërfaqeve janë të ndikuara nga erozioni i fortë.

Tabela 9: Shkalla e erozionit në komunën e Rahovecit sipas kategorive⁶

Kategoritë e erozionit në Komunën e Rahovecit	Sipërfaqja ha	Sipërfaqja %
Sipërfaqe pa erozion	832	3
Erozion shumë i dobët	6905	25
Erozion i dobët	8118	29
Erozion i mesëm	11350	41
Erozion shumë i fortë	582	2

Për parandalimin e erozionit duhet të zbatohen dispozitat e përcaktuara në Ligjin për Ujëra si dhe të implementohen veprimet e përcaktuara në Planin Hapësinor të Kosovës. Në kuadër të veprimeve të nevojshme duhet të përfshihen edhe masat hidroteknike dhe masat për menaxhimin e tokës.

⁵ Burimi i informacionit: <http://opendata.cohu.org/sq/degradimi-mjedisit>

⁶ Plan Zhvillimor i Komunës së Rahovecit

Për parandalimin e erozionit kërkohet një serë masash teknike, programore dhe ligjore sikurse janë: Kufizimi i zonave të rrezikuara nga erozioni dhe zhvillimi i kontrolleve adekuate për secilën zone, përcaktimi ligjor i zonave të rrezikuara nga erozioni dhe informimi i rregullt dhe dhënia e udhëzimeve për të gjitha entitetet e prekura.

Faktorët tjerë që dëmtojnë cilësinë e tokave në Rahovecit janë edhe: ndërtimet e paplanifikuara, dhe përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve.

4.3. Natyra dhe biodiversiteti

Trashëgimia natyrore i referohet biodiversitetit duke përfshirë florën dhe faunën, ekosistemet dhe strukturat gjeologjike. Mbrojtja dhe shfrytëzimi i natyrës është i rregulluar sipas ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës⁷. Sipas këtij ligji, inventarizimin e të gjithë përbërësve të larmisë biologjike, gjeologjike e peizazheve - llojet, tipit të vendbanimeve, gjeolokaliteteve dhe të peizazheve paraqitjen hartografike të llojeve të kërcënuara, gjeolokaliteteve dhe tipat e vendbanimeve etj. bëhet nga ana e Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

4.3.1. Zonat e Mbrojtura

Që nga themelimi i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) janë marrë nën mbrojtje ligjore shumë zona, monumente dhe vlera tjera të natyrës. Ky institucion në

⁷<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2716>

bashkëpunim me Komunën e Rahovecit, kanë evidentuar edhe disa zona të rëndësishme të natyrës në territorin e komunës. Në kuadër të listës së zonave të mbrojtura të natyrës në Komunën e Rahovecit padyshim se Kanioni i Drinit të bardhë, Kanioni i Mirushës (zona që shtrihet në territorin e Rahovecit) dhe Shpella e Peshterrit paraqesin zonat me rëndësi më të madhe natyrore (tabela 10).

Tabela 10: Lista e zonave të mbrojtura në komunën e Rahovecit⁸

Emri i Objektit	Vendi	Sipërfaqja	Viti i mbrojtjes	Kategori a	Përshkrimi
Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë	Ura e Fshajtë Rahovec/ Gjakove	198 ha	1986	III	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe hidrologjik
Ujëvarat e Mirushës	Kline/ Malisheve/ Rahovec	598 ha	2012	III	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik, hidrologjik, speleologjik, botanik, turistike
Trungu i frashërit (Fraxinus excelsior)	Kaznik, Rahovec	8 ari	2016	III	Monument natyror me karakter botanik
Trungu i shpardhit (Quercus frainetto)	Kaznik, Rahovec	3.5 ari	2016	III	Monument natyror me karakter botanik
Trungjet e dushkut (Quercus sp.)	Dobidol, Rahovec	13 ari	2016	III	Monument natyror me karakter botanik
Trungu i shpardhit (Quercus frainetto)	Lagja e Berishajve - Drenoc, Rahovec	4 ari	2016	III	Monument natyror me karakter botanik
Trungu i shpardhit (Quercus frainetto) në	Lagja e Muhocve- Drenoc, Rahovec	4 ari	2016	III	Monument natyror me karakter botanik
Trungu i bungut (Quercus petraea)	Nagavc, Rahovec	5 ari	2016	III	Monument natyror me karakter botanik
Trungu i qarrit (Quercus cerris) dhe Trungu i vidhit (Ulmus minor)	Bratotin, Rahovec	7 ari	2016	III	Monument natyror me karakter botanik
Trungu i shpardhit (Quercus frainetto)	Bratotin, Rahovec	4 ari	2016	III	Monument natyror me karakter botanik
Shpella e “Bali Agës”	Zatriq, Rahovec	1 ha	2016	III	Monument natyror me karakter speleologjik
Shpella e Peshterrit	Zatriq, Rahovec	30 ari	2016	III	Monument natyror me karakter speleologjik

⁸ Regjistri i zonave të Mbrojtura, Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, 2022

Megjithëkëtë përkundër faktit që janë shpallur të mbrojtura komuna ende nuk ka bërë investime në hapjen e këtyre shpellave për vizitorë. Prandaj një ndër aktivitetet e komunës së Rahovecit në të ardhmen duhet të jetë e orientuar në përgatitjen e këtyre shpellave për tu hapur për vizitorë dhe promovimi i vlerave të tyre për aspekte turistike.

Monumenti i Natyrës Ujëvarat e Mirushës- Rajoni i Mirushës është një ndër rajonet më të bukura dhe më interesante të natyrës së Kosovës. Këtë e dokumentojnë të dhënat për diversitetin biologjik në këtë rajon. Ky rajon ka sipërfaqe prej 63.21 km². Lartësia mbidetare e rajonit sillet prej 340 - 1006 m. Lumi Mirusha është një ndër lumenjtë më të bukur të Kosovës. Ai në pjesën përfundimtare të rrjedhës së tij kalon nëpër një grykë e cila njihet si Kanioni i lumit Mirushë. Monumenti i Natyrës Ujëvarat e Mirushës gjendet në të dy anët e rrjedhës së lumit Mirusha që nga fillimi i kanionit deri gati në derdhjen e tij në lumin Drini i Bardhë. Ndodhet në territorin e komunave Klinë, Malishevë dhe Rahovec. Lartësia mbidetare e monumenti sillet prej 340 - 600 m. Sipërfaqja e territorit të mbrojtur është 556 ha.

Përgjatë territorit të Parkut të Mirushës kalon lumi Mirusha i cili gjatë rrjedhës së tij krijon 13 ujëvara dhe 16 liqene të cilët së bashku krijojnë një fenomen të rrallë morfohidrologjik, tepër atraktiv për vizitorë. Liqeni më i madhë është liqeni i 16 (55m X 45m) me thellësi 5m.

Është mjaft i pasur me lloje dhe bashkësi bimore e shtazore. Pjesa më e madhe e rajonit i takon bashkësisë së bungut (Ass. Quercetum farnetto - cerris scardicum Krasniqi 1968) që në të vërtetë është një ndër bashkësitë më të përhapura pyjore në Kosovë. Në territorin e Mirushës gjenden 330 lloje të bimëve vaskulare, duke mos i llogaritur bimët e ulëta dhe myshqet.

Nga bimët e ulëta janë evidentuar 44 specie kërpudhash të larta (makromicetesh), ndërsa në territorin e gjerë të rajonit të Mirushës janë prezente 838 taksone bimore të përfaqësuara me 590 lloje të bimëve vaskulare. Veçanti e florës së rajonit të Mirushës është prania e 14 bashkësive (asociacioneve) bimore, 5 prej të cilave kanë karakter endemik, ndërsa numri i llojeve endemike është 21. Prej tyre lloji *Aristolochia merxmuelleri* është lloj stenoendemik dhe deri tani në nivel botëror është konstatuar vetëm në këtë rajon në disa lokalitete relativisht të ngushta.

Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë- është monument natyre me karakter hidro-geomorfologjik me sipërfaqe prej 199 ha dhe shtrihet në territorin e komunës së Rahovecit (124.96 ha) dhe Gjakovës (73.86 ha). Për shkak të vlerave natyrore është vënë nën mbrojtje në vitin 1986.

Lumi Drini i Bardhë gjatë një procesi të gjatë geomorfologjik - hidrologjik ka krijuar një grykë në mes dy masiveve të shkëmbijve gëlqeror duke formuar një kanion shumë tërheqës dhe interesant. Kanioni është krijuar në periudhën e neogjenit të liqenit të

Dukagjinit. Mirëpo, intensiteti i “prerjes” dhe thellimit të kanionit të epigjjenisë është kushtëzuar dhe nga proceset e lëvizjeve të mëvonshme tektonike. Gryka ka veçori tipike të kanionit dhe është zhvilluar në formacione karbonatike të kretakut të sipërm. Kanioni shtrihet në rrjedhjen e mesme të Drinit të Bardhë, është monument i natyrës me karakter hidro-gjeomorfologjik dhe përfaqëson vlera natyrore gjeomorfologjike, gjeologjike dhe hidrografike, floristike, vegjetative dhe faunistike.

Sipas vlerësimit të Instituit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, gjatë monitorimit të gjendjes së zonës tek Kanioni i Drinit të Bardhë, te Ura e Fshejtë janë konstatuar ndërhyrje në të dy anët e kanionit. Në pjesën e cila menaxhohet nga Komuna e Rahovecit, nga vizitat e më hershme janë konstatuar ndërhyrje të konsiderueshme, sidomos në pjesën poshtë magjistrales.

Në kuadër të projektit për ridefinimin e statusit dhe kufirit të kësaj zone, që është në proces e sipër është propozuar që kjo pjesa poshtë magjistrales të mos përfshihet në brenda kufirit të ri të zonës. Ndërsa në pjesën e sipërme të magjistrales komuna ka ndërtuar Kompleksi Memorial me obeliskun. Ndërhyrjet në këtë zonë edhe më shqetësues i bën fakti se në vendin e njëjtë në të cilin është hapur ky shteg, në pjesën që i takon Komunës së Rahovecit është konstatuar një lloj i ri bimor (*Sternbergia colchiciflora*) dhe gjinie të re (*Amaryllis*) për florën e Kosovës.

Instituti për Mbrojtjen e Natyrës rekomandon që për mbrojtjen e këtij monumenti të ndërmerren këto masa:

- Të gjitha veprimtaritë të cilat realizohen brenda zonës së mbrojtur MN “Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë” të jenë në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L233, Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis,
- Të ndalohen të gjitha ndërtimet dhe aktivitetet ilegale në këtë zonë,
- Çdo ndërhyrje në këtë zonë të jetë me projekte të studiuar dhe analizuar mirë dhe në përputhje me planet dhe programet komunale;
- Inspektorati i MMPHI-së, në bashkëpunim me Inspektoratin e Komunës së Rahovecit të inspektojnë zonën dhe të ndërmarrin masa konform ligjeve në fuqi;
- Të ndalohen të gjitha veprimtaritë që kanë ndikim negativ për vlerat e trashëgimisë natyrore në territorin e Monumentit të Natyrës, dhe të respektohen parimet dhe kriteret e mbrojtjes së natyrës;
- Komuna e Rahovecit të nxjerrë vendim për rikategorizimin e Monumentit të Natyrës “Kanioni i Drinit Dardhë të Ura e Fshejtë” sipas propozimit të grupit punues (nr. prot. 3522/17);
- Zona të promovohet dhe të shfrytëzohet për qëllime edukativo-arsimore.

Shpella e Peshterit në Zatriq - Shpella gjendet rreth një kilometër, në veri të fshatit Zatriq, në pjesën veriperëndimore të malit Okovan (977 m). Hyrja e shpellës ndodhet në fundin e një prerje të thiktë të gëlqerorëve të kretakut të sipërm, në lartësi mbidetare 770

m. Hyrja e shpellës ka dimensione të gjëra ndërsa korridori i saj ka pjerrësi të theksuar. Gjatësia e korridoreve të hulumtuara në shpellë arrin rreth 150 m. Shpella e Peshterit karakterizohet me vlera shkencore, gjeomorfologjike, edukative arsimore dhe turistike⁹.



Foto: Hyrja e Shpellës së Peshterit

Tabela 11: Shpellat në territorin e komunës së Rahovecit¹⁰

Nr.	Emri i shpellës	Lokacioni	Lartësia mbidetare (m)	Gjatësia (m)	Thellësia (m)
1.	Shpella e Peshterit	Zatriq	778	39.90	16.00
2.	Shpella e Bali Agës	Zatriq	910	36.00	6
3.	Shpella e Plumbave	Zatriq	929	22.17	25.93
4.	Shpella e Mbretëreshës së bardhë	Zatriq	828	14.68	48.04
5.	Shpella e banuar (Gërgavica)	Zatriq	848	92.97	3.74

⁹ *Shpellat e Kosovës, F.Bajraktari, S.Behrami dhe F.Katalozi, 2010*

¹⁰ *Speleological exploration of the Akovan mountain, Expedition Report. Bulgarian Caving Society, Kosovo Project 2017*




Figura 2: Harta e shpellave në territorin e komunës së Rahovecit

4.3.2. Flora dhe vegjetacioni

Disa nga bashkësitë bimëre karakteristike për territorin e komunës së Rahovecit të konstatuar keyesisht në rajonin e Zatriqit, Mrasor, Kramovik dhe Kaznik janë:

- Ass.: Salicetum albae fragilis Soo (1930, 1934) 1958,
- Ass.: Salicetum purpurea Wendbg.,
- Ass.: Alnetum glutinosae s. lat.,
- Ass. Quercetum farnetto - cerris scardicum Krasniqi 1968,
- Ass. Polygalo – Genistetum hassertianae Blec. et Krasn. 1969 (endem.),
- Ass. Polygalo – Forsythietum europaea Blec. et Krasn. 1971 (endem.),
- Ass. Onosmo – Scabietosum fumaroides Rexhepi 1978 (endem.),

- Ass.: Hyperico – Euphorbietum glabriflorae Rexhepi 1978, 9. Ass. Potentillo – Fumanetum bonapartei Rexhepi 1979 (endem.),
- Ass.: Echinario – Convolvuletum althaeoides Rexhepi 1979,
- Ass.: Salvio – Scorsoneretum villosae Hundozi 1980,
- Ass.: Quercetum pubescentis – cerris Rexhepi 1985,
- Ass. Astero – Juniperetum Oxycedri Rexhepi 1990 (endem.) dhe
- Ass.: Vitici – Tamaricetum dalmaticae H –ic 1960 (Rexhepi 1994).

Në tabelën 12 janë prezantuar llojet e florës vaskulare të evidentuara në territorin e Komunës së Rahovecit që janë të përfshira në Librin e Kuq të Florës vaskulare së Kosovës. Sikurse shihet në këtë listë janë përfshirë lloje që tashmë janë zhdukur në gjendje të egër si *Salvia officinalis* L., pastaj lloje që janë të rrezikuara në mënyrë kritike si *Lysimachia atropurpurea* L, lloje gati të rrezikuara sikurse *Haplophyllum suaveolens* (De Cand.) G. Don, dhe lloje pak të rrezikuara sikurse *Forsythia europaea* Deg. et Bald.

Tabela 12: Llojet e florës vaskulare të evidentuara në territorin e Komunës së Rahovecit që janë të përfshira në Librin e Kuq të Florës vaskulare së Kosovës¹¹

Lloji	Karaktersitikat
Emri shkencor	<i>Salvia officinalis</i> L.
Emri shqip	Sherbelë mjekësore
KATEGORIA SISTEMATIKE	Familja: Lamiaceae (Labiatae) – Buzore
PËRSHKRIMI BOTANIK	Gjysmëshkurre (Kamefite Ch), 20-40 (60) cm, e hirtë-pushbutë, me kërcell të drunjëzuar në bazë. Kërçelli i përpjetë, cilindrik, poshtë pak a shumë ngjyrë vjollce, me bisqe sterile që dalin nga sqetullat e gjethëve. Gjethet me bisht 10-15 mm dhe llapë heshtore, 2-3 x 1cm, shyte, ura-ura, pushlore të bardha përposhtë, të gjelbra sipër, dendësisht pushlore kur janë të reja. Qerthujt e rremë me 5-10 lule, pak a shumë njëanësore. Kupa me gyp 5-7 mm dhe dhëmbë 4-6 mm. kurora manushaqe (më rrallë e trëndafiltë ose e zbardhur), me gyp 10-15 mm dhe me buzën e sipërme 7-10 mm. V-VII. (Qosja, Xh. et al. 1996).
HABITATI:	Në Kosovë ekzistojnë të dhëna se është rritur në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit (Duvska klisura) në substrat të thatë e shkëmbor, zakonisht gëlqerore e flishore. Gjatë periudhës 2011-2013 nuk kemi arritur ta konstatojmë në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit por kemi konstatuar afro 7 ekzemplar që mund të jenë aksidental ose të kultivuar në rrethinën e Vermicës (Prizren) dhe afro 30 ekzemplar mbi fshatin Syne (Istog). Si bimë mjekësore kultivohet në disa lokalitete (Istog, Prizren, Rahovec).
PËRHAPJA E PËRGJITHSHME	Në pjesën mesdhetare të Evropës nga Spanja, Azi e Vogël, Siri
PËRHAPJA NË KOSOVË	Sipas Saric et al. (1986) ka qenë e përhapur në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit (Duvska Klisura)
POPULACIONET:	Nuk kemi arritur të konstatojmë ndonjë populacion të egër në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit (Duvska klisura) dhe as në ndonjë lokalitet tjetër të

¹¹ *Librin e Kuq të Florës vaskulare së Kosovës, MMPH/AMMK/GIZ*

	Kosovës. Në natyrë si bimë te egër i kemi konstatuar disa individë në rrethinën e Prizrenit (Vermicë) dhe mbi fshatin Syne që sipas konstatimeve tona janë të kultivuara ose të mbira në mënyrë aksidentale.
KATEGORIA E KËRCËNUESHMERISË NË KOSOVË SIPAS IUCN	I zhdukur si gjendje spontane ose në të egër. Nuk është konstatuar ndonjë populacion të egër të këtij lloji në Kosovë.
VITI I VLERESIMIT	2013
STATUTI NDËRKOMBËTAR	Taksoni nuk është përfshirë në Listën e Kuqe të florës së Evropës (Bilz, M., et al. 2011) dhe as të botës (Walter, K.S., Gillett, H.J. 1998). Sipas Vangjeli, J. et al. (1995) është lloj i rrezikuar i florës shqiptare (E), Sipas MMPAU (2007) është lloj i rrezikuar dhe i takon kategorisë VU A1b.
SHKAQET E RREZIKIMIT	Konsiderojmë së populacioni i këtij lloji që ka ekzistuar në Grykën e Lumëbardhit të Prizrenit është zhdukur si pasojë e grumbullimit si bimë mjekësore ose është determinuar gabimisht sepse në lokalitetin ku ceket në literatura të ndryshme rriten disa lloje të gjinisë Salvia; ndër to edhe Salvia ringens që është mjaft aromatike
NDËRMARRJA E MASAVE MBROJTËSE	Në Republikën e Kosovës ky takson është nën mbrojtje (Ky lloj nuk është konstatuar i egër në natyrë)
MASAT MBROJTËSE	Për mes shoqatave mjedisore dhe institucioneve përkatëse duhet të tentohet që të kultivohet ky lloj në grykën e Lumëbardhit të Prizrenit ose rrëzë Pashtrikut pasi që këto dy lokalitete i plotësojnë kërkesat e nevojshme për tu zhvilluar ky lloj
Emri shkencor:	<i>Forsythia europaea</i> Deg. et Bald
Emri shqip	Boshtër
KATEGORIA SISTEMATIKE	Oleaceae – Ullinjore
PËRSHKRIMI BOTANIK	Bimë durore-shkurre (Fanerofite P), e lartë deri 3m. Degëzat dhe nyjet janë me palcë dhe kthina. Gjethet të thjeshta dhe eliptike ose vezake të shogëta. Gjethet e degëve pa lule të dhëmbëzuara deri në ura, ato të degëve me lule buzëplota, 5-8 cm të gjata. Lulet të verdha me kupë rreth 3 mm dhe me kurorë -15 mm të gjatë. Kapsula 1.2-1.5 cm. Riprodhohet me farë, Lulëzon IV-V, Frytton VIII-IX. (Rexhepi, F. 2000)
HABITATI	Ky lloj në Kosovë rritet në vende shkëmbore-serpentinore duke krijuar pyje të rralla ose shkurre. Zakonisht rritet në shoqërim me llojet: <i>Cornus mas</i> , <i>Quercus pubescens</i> , <i>Quercus cerris</i> , <i>Acer monspessulanum</i> , <i>Fraxinus ornus</i> , <i>Sanguisorba minor</i> , <i>Centaurea montana</i> , <i>Viola sylvestris</i> , <i>Polygala doerfleri</i> , <i>Filipendula hexapetala</i> , <i>Crataegus monogyna</i>
PËRHAPJA E PËRGJITHSHME	Kosovë, Shqipëri.
PËRHAPJA NË KOSOVË	Sipas Deg. et Doerfler (1897), Rexhepi (2000), Josifovic, M. et al. (1973), Blečić et Krasniqi (1971), ky lloj është i përhapur në serpentinet e Shqipërisë veriore (regjioni i Drinit të Bardhë dhe Drinit të Zi dhe në këto lokalitete të Kosovës: Gubavc, Koznik, rajoni i Mirushës deri afër Rahovecit, Qafa e Prushit, Bokati e Morinës dhe Golesh.
POPULACIONET	Populacionet e këtij lloji në Golesh dhe në rrethinën e Koznikut (Zatriq, Mirushë) janë në gjendje më të mirë në krahasim me populacionet e këtij lloji në Qafë Prush, Qafë të Morinës dhe Gubavc. Populacionet më të degraduara dhe

	më me pak individë maturë janë populacionet në Gubavc (Pejë) dhe Bokat e Morinës. Për momentin populacionet e këtij lloji janë stabile.
KATEGORIA E KËRCËNUESHMERISË NË KOSOVË SIPAS IUCN	LC- me pa ki rrezikuar Lloji është vlerësuar si LC (më pak i Rrezikuar) pasi që lloji për momentin nuk është i kërcënuar në atë masë sa që lloji të futet në ndonjë kategori me të lartë
VITI I VLERESIMIT	2013
STATUTI NDËRKOMBËTAR:	Taksoni nuk është përfshirë në Listën e Kuqe të florës së Evropës (Bilz, M., et al. 2011) dhe as të botës (Walter, K.S., Gillett, H.J. 1998). Në Listën e Kuqe të Shqipërisë (MMPAU 2007) ky lloj kategorizohet si (NE) – Jo i vlerësuar
SHKAQET E RREZIKIMIT	1. Humbja dhe degradim i habitatit (i nxitur prej njeriut) , 1.3.1. Minierat, 1.3.3.2. Prerja selektive e drunjtëve, 1.3.3.3. Prerja për pastrim, 10.5. Zjarret.
NDËRMARRJA E MASAVE MBROJTËSE	Ky lloj ka qenë i mbrojtur në bazë të vendimit nr. 239/86 (IKMN).Në bazë të udhëzimit administrativ Nr. 18/2012 për shpalljen e llojeve të egra të mbrojtura dhe strikt të mbrojtura (MMPH) të Republikës së Kosovës ky takson nuk është nën mbrojtje
MASAT MBROJTËSE:	Përmes institucioneve dhe shoqatave mjedisore duhet të monitorohen populacionet e këtij lloji në Kosovë. Habitatet ku rritet ky lloj janë të pasura edhe me lloje tjera endemike dhe relikte që kanë rëndësi shkencore. Ky lloj duhet të futet në Listën e Kuqe të florës vaskulare të Kosovës dhe të shpallet si lloj strikt i mbrojtur.
Emri shkencor:	Lysimachia atropurpurea L
Emri shqip	Lisimake e purpurtë e errët
KATEGORIA SISTEMATIKE	Primulaceae – Aguliqore
PËRSHKRIMI BOTANIK	Bimë barishtore me pak push, me rizomë (Hemikriptofite H). Kërcejtë janë të ngritur, 25- 65 cm me pak degë në bazë. Gjethet janë 3.5-8 (-10)×0.5-1 (-1.5) cm, vizake, heshtore deri pallake, të këmbëra, të imta, të poshtmet me një bisht të shkurtër, të sipërmet pa bisht. Lulesat janë në kallinj skajorë. Kupa është rreth 4 mm. Kurora është 6-7 mm e purpurt e errët me vriguj të zgjatur, pallake. Thekët janë më të gjatë se kurora. Kapsula është 3-5 mm, shtyllëza është 3-5 mm e qëndrueshme. Riprodhohet me farë. Lulëzon V-VII. Frytton VI-VIII. (Entemofilia)
HABITATI	Ky lloj rritet në vende të thata mbi substrat serpentini në kuadër të asociacionit Potentillo-Fumanetum bonapartei, Rexhepi, F. (1979), Krasniqi, E. (2003). Shoqërohet nga llojet: Potentilla arenaria, Dianthus sylvestris, Alyssum markgraffi, Bromus fibrosus, Plantago subulata, Poa badensis, Halascya sendtneri, Sedum serpentini etj
PËRHAPJA E PËRGJITHSHME	Ballkan
PËRHAPJA NË KOSOVË	Zatriq, Koznik.
POPULACIONET	Ky lloj në Kosovë formon dy subpopulacione: në Zatriq dhe Koznik. Këto subpopulacione kanë areal shumë të kufizuar (dhjetëra hektar) dhe numri i individëve maturë brenda këtyre subpopulacioneve është shumë i vogël.
KATEGORIA E KËRCËNUESHMERISË NË KOSOVË SIPAS IUCN	CR - B1ab(i,iii) + 2ab(i,iii) - I Rrezikuar në mënyrë kritike. Vlerësimi është bazuar në Sipërfaqen e Përhapjes (EOO), në Zonën e Zënë (AOO) dhe në numrin e individëve maturë. Sipërfaqja e Përhapjes (EOO) është <100

VITI I VLERESIMIT	2013
STATUTI NDËRKOMBËTAR:	Taksoni nuk është përfshirë në Listën e Kuqe të florës së Evropës (Bilz, M., et al. 2011) dhe as të botës (Walter, K.S., Gillett, H.J. 1998).
SHKAQET E RREZIKIMIT	9. Faktorët e brendshëm , 9.1. Shpërndarja e kufizuar, 9.5. Dendësia e ulët , 9.7. Shkallët e ulëta të rritjes, 9.9. Shtrirja e kufizuar, 10.5. Zjarret.
NDËRMARRJA E MASAVE MBROJTËSE	Në bazë të udhëzimit administrativ Nr. 18/2012 për shpalljen e llojeve të egra të mbrojtura dhe strikt të mbrojtura (MMPH) të Republikës së Kosovës ky takson nuk është nën mbrojtje
MASAT MBROJTËSE:	Meqenëse është bimë endemike e Ballkanit dhe në Kosovë gjendet vetëm një populacion i këtij lloji (dy subpopulacione) me përhapje shumë të kufizuar, nga ana institucioneve mjedisore dhe shoqatave mjedisore, duhet bërë konservimi i këtij lloji dhe duhet mbrojtur habitat i këtij lloji në Zatriq dhe Koznik. Ky lloj duhet të futet në Listën e Kuqe të florës vaskulare të Kosovës dhe të mbrohet me ligj si lloj i rrallë dhe i rrezikuar.
Emri shkencor:	Haplophyllum suaveolens (De Cand.) G. Don
Emri shqip	Haplofil
KATEGORIA SISTEMATIKE	Rutaceae-Ruzore
PËRSHKRIMI BOTANIK	Shumëvjeçare (Kamefite Ch). Kërcejtë barishtor të drejtë ose gati të drejtë, të padegëzuar, me gjatësi 10-40 cm, të gjelbër ose gjelbër-kaltër, të mbuluar ose jo me qime kaçurrele. Gjethet e poshtme me bisht të shkurtër, tjerat të ulura, të shogëta, të mbuluara me qime të shkurtra, heshtore, të ngushta heshtore ose ovale eliptike, në majë kreshtake, me numër të madh të gjëndrave. Lulesa vastak. Bishtat e luleve me qime të shkurtra. Kupa pesë anëtarëshe. Sepalet zakonisht ovale, të dhëmbëzuara ose jo, kreshtake në maje, të shogëta ose të mbuluara me qime, leshtore përgjatë buzëve, të gjata 2-2.5 mm, mbeten në bimë. Kurora qëndron gjatë e lulëzuar, e verdheme. Petalet 7-10 mm, ovale, në maje të rrumbullakëta, buzë të plota, të shogëta ose në anën e jashtme me vija (linja) të zeza dhe të mbuluara me qime dhe gjëndra. Thekë 10, me filamente të lira. Fryti i ndarë në 5 pjesë, në secilën pjesë nga 4 fara. Lulëzon VII. Frynjon VIII (Josifovic, M. et al. 1973)
HABITATI	Në Kosovë rritet në vende të thata me bazë shkëmbore serpentine por edhe gëlqerore. Gjendet në shoqëri me llojet: Convolvulus cantabricus, Sideritis montana, Potentilla tommasiniana, Orlaya grandiflora, Crupina vulgaris, Silene vulgaris, Sedum ochroleucum, Artemisia lobelii, Vincetoxicum huteri, Scleranthus perennis, Fumana bonapartei, Onosma aucherianum, Sedum acre, Sedum serpentini, Sanguisorba minor, Ziziphora capitata, Orlaya grandiflora, Asyneuma limonifolium etj.
PËRHAPJA E PËRGJITHSHME	Evropë Juglindore nga Maqedonia deri në Ukrainën lindore (Tutin, T. G. et al. 1968; Josifovic, M. et al. 1973).
PËRHAPJA NË KOSOVË	Për herë të parë prezenca e këtij lloji në Kosovë (Zatriq) shënohet si H. suaveolens f. ciliatum më 1990 (Krasniqi, F. et al. 1990). Gjendja e një populacioni është vlerësuar në lokalitetin Vojtesh (relacioni Braboniq-Skenderaj) më 25.06.2013 (Q. Pajazitaj dhe E. Krasniqi). Ky lloj është i përhapur edhe në Gërmi dhe Gallushë (Suharekë)
POPULACIONET	Populacionet e këtij lloji kanë përhapje të kufizuar dhe numër të vogël të individëve maturë. Në veçanti numri i individëve është shumë i vogël në

	lokalitetin Vojtesh. Për momentin subpopulacionet e tjera të këtij lloji janë stabile
KATEGORIA E KËRCËNUESHMERISË NË KOSOVË SIPAS IUCN	NT – Gati i rrezikuar Lloji është vlerësuar në kategorinë NT (Gati i rrezikuar) sepse populacionet e këtij lloji gjenden afër vendbanimeve dhe afër rrugëve dhe në disa lokalitete ka ardhur deri te degradimi i habitatit, që ka ndikuar në zvogëlimin e numrit të individëve maturë të këtij lloji
VITI I VLERESIMIT	2013
STATUTI NDËRKOMBËTAR:	Është e përfshirë në Listën e Kuqe të florës së botës (Walter, K.S., Gillett, H.J. 1998)
SHKAQET E RREZIKIMIT	9.1. Shpërndarja e kufizuar, 9.5. Dendësia e ulët, 9.9. Shtrirja e kufizuar; 10.4. Transporti, 10.5. Zjarret
NDËRMARRJA E MASAVE MBROJTËSE	Në Republikën e Kosovës ky takson nuk është nën mbrojtje ligjore (Arkivi i IKMN1986, MMPH-2012).
MASAT MBROJTËSE:	Meqenëse është lloj i rrallë, duhet të mbrohet me ligj dhe të futet në Listën e Kuqe të Florës Vaskulare të Kosovës si lloj i rrallë dhe i rrezikuar. Lloji duhet të ketë mbrojtje individuale dhe ruajtje të habitatit nëpërmjet shoqatave mjedisore dhe institucionet kompetente për mbrojtjen e natyrës të Republikës së Kosovës.

Sipas vlerësimeve të Librit të Kuq të Florës Vaskulare të Kosovës, faktorët që e dëmtojnë florën dhe vegjetacionin janë:

- Prerja e pakontrolluar e pyjeve sidomos në sektorin publik;
- Ndërrimi i destinimit të tokave pyjore në forma të tjera të shfrytëzimit të tokave (vendbanime, toka bujqësore etj);
- Shpërlarja dhe gryerja e tokës nga erozioni;
- Pyllëzimi i kufizuar i sipërfaqëve të sgpyllëzuara;
- Mbishfrytëzimi i llojeve mjekësorë dhe aromatike.

Në territorin e komunës së Rahovecit, janë identifikuar edhe **disa lloje të florës vaskulare me karakter endemik**. Të tilla janë llojet:

- **Aster albanicus** Deg. subsp. albanicus (Aster shqipëtar), endemike e Kosovës dhe Shqipërisë, e cila sipas të dhenave në territorin e komunës së Rahovecit është identifikuar në Kramovik dhe Koznik.
- **Forsythia europaea Deg. et Bald (boshtra)**, endemike e Kosovës dhe Shqipërisë, e cila sipas të dhenave në territorin e komunës së Rahovecit është identifikuar në Rajonin e Mirushës (Mrasor) dhe në Koznik.
- **Lysimachia atropurpurea L (Lisimake e purpurtë e errët)** endemike e Ballkanit, që në territorin e komunës së Rahovecit është identifikuar në Zatriq dhe në Koznik.
- **Fumana bonapartei Maire et Petit. (Fumanë e Bonapartit)**, endemike e Ballkanit, që në territorin e komunës së Rahovecit është identifikuar në Mrasor, Rajoni i Mirushës.

- **Polygala doerfleri (Plygallë e dorflerit)**, endemike e Ballkanit, e cila në bazë të dhënave nga literatura (Krasniqi, F. 1969, Rexhepi, F. 1994, 2000, Krasniqi, E. 2003) është identifikuar edhe në territorin e Komunës së Rahovecit, përkatësisht në lokalitetet Koznik dhe Mrasor;
- **Sedum serpentini** Janch. (Rrushqyqe serpentine), endemike e Ballkanit që është hasur në Zatriq dhe Rajonin e Mirushës.



Foto: Forsythia europaea Deg. et Bald (boshtra)

Një lloj i rëndësishëm i identifikuar në territorin e komunës së Rahovecit është edhe **Sternbergia colchiciflora Waldst. et Kit.** (Amaryllidaceae), një gjini dhe specie e re në florën e Kosovës. Rreth 30 individë të rritur të kësaj specie u regjistruan për herë të parë në Kosovën jugperëndimore gjatë vitit 2015, në lokalitetin e Kanionit të Drinit të Bardhë afër Urës së Fshajt. Duke marrë parasysh numrin e ulët të individëve dhe shpërndarjen shumë të kufizuar, kjo specie duhet të trajtohet si takson i rrezikuar në mënyrë kritike në Kosovë. *Sternbergia colchiciflora* është lloj në Listat e Kuqe të specieve të rrezikuara, të prekshme dhe gati të kërcënuara në shumë vende të Evropës (Republika Çeke, Republika Sllovaqe, Rumania, Hungaria etj.). Në rajonin e Kaukazit, ajo ka statusin e taksonit të rrezikuar në mënyrë kritike në Listën e Kuqe të bimëve endemike. Kjo specie është renditur gjithashtu

në Shtojcën II të Konventës për Tregtinë Ndërkombëtare të Specieve të Rrezikuara të Faunës dhe Florës së Egër (CITES)¹².



Foto: Lloji Sternbergia colchiciflora Waldst. et Kit.

Disa lloje tjera të rëndësishme të florës së Kosovës, që gjenden në territorin e Komunës së Rahovecit janë:

- Cheilanthes maranthae (L.) Domin. [Notholaena maranthae (L.) Desv.] (Keilant i Marantës), që është hasur në Koznik dhe Zatriq.
- Chaerophyllum coloratum L. (Stërpujë e ngjyrosur), që është hasur në Malet e Zatriqit dhe Mirushë.
- Trinia glauca (L.) Dumort. subsp. corniolica (A. Kerner ex. Janchen) H. Wolff. (Netërz e rimtë) që është hasur në rrethinat e Zatriqit dhe Rajonin e Mirushës.
- Scorsonera austriaca Willd. (Skorzonerë austriake), që është hasur në Zatriq dhe Rajonin e Mirushës.

¹² www.ammk-rks.net

- *Xeranthemum annuum* L. (Kserantemë njëvjeqare). që është hasur në rrethinat e Zatriqit, dhe Rajonin e Mirushës.
- *Rorippa lippizensis* (Wulfen) Reichenb. (Roripe e Lipizës). që është hasur në bokat e Zatriqit dhe Rajonin e Mirushës.
- *Minuartia hamata* (Hauskn.) Mattf. [*Queria hispanica* L.] (Minuartie gremçake), që është hasur në rrethinat e Zatriqit dhe Rajonin e Mirushës (Koznik).
- *Minuartia verna* (L.) Hiern. subsp. *collina* (Neilr.) Halliday [*Alsine verna* (L.) Wahlenb.] (Minuartie pranverore), që është hasur në Zatriq dhe Rajonin e Mirushës (Koznik me rrethinë).
- *Silene otites* (L.) Wibel. [*S. pseudotites* Besser.] (Klokëz veshtake), që është hasur në Zatriq.
- *Calystegia sylvatica* (Kit.) Griseb. [*Convolvulus sylvaticus* Waldst.] (Përshëllizë), që është hasur në Malet e Zatriqit.
- *Convolvulus althaeoides* L. subsp. *tenuissimus* (Sibth. et Sm.) Stace (Dredhje mullagëngjashme), që është hasur në rrethinat e Zatriqit, dhe Rajonin e Mirushës.
- *Sedum hispanicum* L. var. *bauxbaumii* Gris. (Rrushqyqe e Spanjës), që është hasur në Zatriq dhe Rajonin e Mirushës.
- *Sedum ochroleucum* Chaix. [*S. anopetalum* DC.] (Rrushqyqe e bardhërreme që është hasur në Zatriq).
- *Sedum serpentinii* Janch. (Rrushqyqe serpentine), që është hasur në Zatriq dhe Rajonin e Mirushës.
- *Coronilla emerus* L. subsp. *emeroides* (Boiss. et Sprun.) Hayek (Milëz emerus) që është hasur në Zatriq dhe Rajonin e Mirushës.
- *Dorycnium pentaphyllum* Scop. (Doriknë pesëgjethesh) subsp. *germanicum* (Gremli) Gams. in Hegi, që është hasur në Zatriq dhe Rajonin e Mirushës.
- *Ononis spinosa* L. subsp. *antiquarum* (L.) Arcangeli (Kalmuth gjëmbor), që është hasur në Zatriq dhe Rajonin e Mirushës.
- *Trifolium pignanii* Feuche et Chaub. (Trifil i Pinjantit), që është hasur në rrethinat e Zatriqit dhe Rajonin e Mirushës.
- *Linum tenuifolium* L. f. *pubescens* Wohlf. (Lin gjethehollë), që është hasur në Zatriq dhe Rajonin e Mirushës.
- *Arcethobium oxycedri* (De Cand.) M. Bieb. [*Viscum oxycedri* DC.] (Velli), që është hasur në Zatriq, Rajonin e Mirushës, Koznik dhe Kramavik.
- *Orobancha elatior* Sutt. [*O. major* L.] (Sparqë e lartë), që është hasur rrethinat e Zatriqit dhe të Koznikut.
- *Plantago argentea* Chaix. (Gjethedell i argjentë), që është hasur në bokat e Zatriqit, Rajoni i Mirushës (boka e Koznikut).
- *Polygala comosa* Schkuhr. (Poligalë me baluke). Përhapja në Kosovë: Alpet Shqiptare, Mali Mokna, Zatriq, Koznik, Gërmi, Rajoni i Mirushës. Përhapja e përgjithshme: Evropë, Azi. El. Fl. Evroaziatik. H.

- *Lysimachia punctata* L. (Lisimake pikaloshe), që është hasur në Zatriq dhe në Rajonin e Mirushës.
- *Ranunculus ficaria* L. [*Ficaria ranunculoides* Roth., *Ficaris verna* Huds.] (Lular). Përhapja në Kosovë që është hasur në rrethinat e Zatriqi dhe në Rajonin e Mirushës.
- *Ranunculus millefoliatus* Vahl. (Zhabinë mijëgjethëshe) subsp. *garganicus* (Ten.) Penev. [*R. garganicus* Ten.], që është hasur në rrethinat e Zatriqit.
- *Ranunculus psilostachys* Griseb. (Zhabinë kallivogël), që është hasur në rrethinat e Zatriqit.
- *Pyrus eleagrifolia* Pallas subsp. *eleagrifolia* (Dardhë gjethehunapi), që është hasur në rrethinat Zatriqit dhe në Rajonin e Mirushës.
- *Galium verum* L. (Ngjitës pranveror), që është hasur në Zatriq dhe në Rajonin e Mirushës.
- *Verbascum nigrum* L. (Netull e zezë), që është hasur në Zatriq.
- *Scirpus holoschoenus* L. [*Holoschoenus vulgaris* Link.] (Zubë), që është hasur në Zatriq, Koznik dhe në Rajonin e Mirushës.
- *Iris reichenbachii* Heuff. var. *bosniaca* (Beck) Beck, që është hasur në Malet e Zatriqit dhe Rajonin e Mirushës.
- *Anacamptis pyramidalis* (L.) C. M. Rich. [*Orchis pyramidalis* L.] (Anakampte piramidore), që është hasur në Zatriq dhe në Rajonin e Mirushës.
- *Orchis tridentata* Scop. (Salep tredhëmbësh), që është hasur në rrethinat e Zatriqit dhe në Rajonin e Mirushës.
- *Stipa pulcherrima* C. Koch. [*S. pennata* subsp. *mediterranae* (Trin. et Rupr.)], që është hasur në Zatriq, Koznik dhe në Rajonin e Mirushës.

4.3.3. Fauna

Në territorin e komunës janë vërejtur këto lloje të shtazëve: ujku (*canis lupus*), dhelpra, derri i egër (*Sus scrofa*), vjedulla (*Meles meles*), lepur (Lepus europaeus), ketri (*Scirius vulgaris*), ujku (*Canis lupus*), maca e egër (*Felis silvestris*), Sqarhi (*Martes Martes*), miu bizam (*Ondatra zibethica*), miu i verdhë malor (*Apodemus flavicollis*), iriqi (*Erinaceus concolor* L.), breshka e tokës (*Testudo* sp.). gjarpëri helmues i gurit (*Vipera amodytes*). etj.

Përgjatë rrjedhave lumore ekzistojnë kushte të volitshme për jetën e ujëtokësorëve dhe peshqve.

Për gjatë komunës së Rahovecit në gjatësi prej 30 km rrjedh shtrati i lumit Drini Bardhë si dhe shumë proje dhe proçkat që derdhen në këtë lumë që ka rëndësi të madhe ekonomike dhe në të gjenden numri i madh i llojeve të peshqive. Në Drinin e Bardhë janë identifikuar 18 lloje të peshqëve ndërsa më të përhapur janë: bërcaku, mustaku, krapi, trofta dhe ngjala cila lajmërohet kohë pas kohe.

Prej shpezëve jetojnë mjaft lloje si: trishtili kokëzi (parus major), zogu i malit, pëllumbi i egër (columbia livia), qukapikthi (dryobates major), laraska (pica pica) qyqja (cuculus canorus), etj. Shpezët grabitqarë që jetojnë në këtë territor janë shqiponja e zezë (aquilachyretos), petriti (malco tinnunculus). Shpezët shtegtare që jetojnë janë dallëndyshja dhe lejleku i cili gjatë stinës verore e posëqërisht përgjatë rrjedhjes së lumit Drini Bardhë.

Në territorin e Komunës së Rahovecit janë evidentuar edhe disa lloje që janë përfshira në Librin e Kuq të Faunës së Kosovës, për shkak të statusit të tyre të rrezikushmerisë. Karakteristikat e këtyre llojeve janë prezantuar në tabelën 13.

Tabela 13: Llojet e faunës së egër të evidentuara në territorin e Komunës së Rahovecit që janë të përfshira në Librin e Kuq të Faunës së Kosovës¹³

Lloji	Karaktersitikat
Emri shkencor	Testudo hermanni Gmelin, 1789
Emri shqip	Breshka e zakonshme
KATEGORIA SISTEMATIKE	Testudines: Testudinidae
PËRSHKRIMI	Është lloj bimëngrënës, por nganjëherë ushqehet edhe me insekte. Gjatësia e trupit është midis 20 dhe 25 cm. Ngjyra e trupit nga ana shpinore është e verdhë me njolla të zeza. Femrat janë më të mëdha se meshkujt. Ato prodhojnë 6 – 8 vezë prej majit e deri në korrik, kurse koha e inkubimit është prej 60 deri në 90 ditë.
HABITATI	Lloji i habitatit: 1. Pyje; 3. Shkurre; 14. Artiçiale/tokësore. Ky lloj mund të gjendet kryesisht në habitate të thata dhe shkëmbore, të mbuluara me bar dhe me shkurre, pastaj pranë rrugëve, arave dhe pemishteve në lartësi deri në 500 m. Në Ballkan, ky lloj, megjithatë mund të gjendet edhe në mbi 1300 m (Bertolero et al. 2011).
PËRHAPJA E PËRGJITHSHME	Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Francë, Greqi, Itali, Kosovë, Kroaci, Mali i Zi, Rumani, Serbi, Spanjë, Shqipëri, Turqi.
PËRHAPJA NË KOSOVË	Potok, Batushë, Morinë, Firajë, Mramor, Marec, Qabiq, Gjurgjevik i Madh, Veriq, Osojan, Zhur, Krushë e Vogël, Malishevë, Tifek, Gajre, Rahovec, Nerodime e Epërme, Nerodime e Poshtme, Malishevë, Lipa, Zhazhë, Baks, Prejlep
POPULACIONET	Trendi i popullatës: Në rënie Trendi i popullatave në nivel global është në rënie. Në Kosovë, gjithashtu, gjendja e nënpopullatave të këtij lloji është në rënie

¹³ Libri i Kuq i Faunës së Kosovës, MMPH/AMMK/KEP 2020

KATEGORIA E KËRCËNUESHMERISË NË KOSOVË SIPAS IUCN	Gati i Kërcënuar, NT Trendi i popullatës së këtij lloji është në rënie në Kosovë. Megjithatë, numri i nënpopullatave pritet të jetë më i madh. Tash për tash, ky lloj nuk kualifikohet për kategoritë më të larta të rrezikshmërisë, por në qoftë se intensifikohen aktivitetet kërcënuese, atëherë mund të rrezikohet ndjeshëm. Për këto arsye, lloji vlerësohet si: Gati i Kërcënuar.
VITI I VLERESIMIT	2017
STATUTI NDËRKOMBËTAR	Gati i Kërcënuar, NT
SHKAQET E RREZIKIMIT	Lista e kërcënimeve: 1 Zhvillimi rezidencial dhe komercial (1.1 Strehimi dhe zonat urbane, 1.3 Zonat e turizmit dhe rekreacionit); 2 Bujqësia dhe akuakultura (2.1 Bimët vjetore dhe shumëvjeçare jodrusore: 2.1.1 Zhvendosja e bujqësisë); 4 Korridoret e transportit dhe shërbimit (4.1 Rrugët dhe hekurudhat); 5 Përdorimi i burimeve biologjike (5.1 Gjuetia dhe grumbullimi i kafshëve tokësore: 5.1.2 Efektet e padëshiruara (llojet që vlerësohen nuk janë të synuara), 5.1.3 Përndjekja/kontrolli); 6 Ndërhijje dhe shqetësime njerëzore (6.1 Aktivitetet rekreative); 7 Modiikimet e sistemeve natyrore (7.1 Zjarret dhe luftimi i tyre); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër.
NDËRMARRJA E MASAVE MBROJTËSE	Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).
MASAT MBROJTËSE	Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtuueshmëria dhe zbatimi i ligjit). Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit). Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera
Emri shkencor	Rhinolophus hipposideros (Bechstein, 1800)
Emri shqip	Lakuriq nate, hundëpaktua i vogël
KATEGORIA SISTEMATIKE	Chiroptera: Rhinolophidae
PËRSHKRIMI	Ky lloj është një nga llojet më të vogla të lakuriqëve, peshon 5 deri në 9 g, me një gjerësi krahësh prej 192-254 mm dhe një gjatësi trupi prej 35-45 mm. Lloji i preferuar i presë janë grupe të ndryshme të insekteve, si luturat e natës dhe Diptera të familjes Tipulidae. (Lino et al. 2014; Zahn et al. 2008). Çiftëzimi ndodh në vjeshtë, kurse femrat lindin gjatë periudhës qershor-korrik. Kolonitë mbarështuese gjenden në vende nëntokësore natyrore dhe artiiciale, si dhe në nënkulme dhe ndërtesa. Hibernojnë gjatë dimrit në vende nëntokësore (Taylor 2016).
HABITATI	: 1. Pyje, 3. Shkurre, 4. Kullosa 7. Shpella dhe habitate nëntokësore (joujore), 14. Artiiciale/tokësore.
PËRHAPJA E PËRGJITHSHME	Evropë, Afrikë, Azi
PËRHAPJA NË KOSOVË	Disa lokalitete në: Malishevë, Istog, Prizren, Rahovec , Drenas, Pejë, Lipjan (Dundarova 2017; Paunović 2016; Presetnik et al. 2018)
POPULACIONET	Trendi i popullatës: I panjohur Nuk ka të dhëna të mjaftueshme për trendet e nënpopullatave të këtij lloji në Kosovë. Trendi i popullatave në Evropë është në

	rënie.
KATEGORIA E KËRCËNUESHMERISË NË KOSOVË SIPAS IUCN	Gati i Kërcënuar, NT Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të trendit të popullatave në nivel evropian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Aktualisht, ky lloj nuk kualifikohet për kategoritë e rrezikshmërisë, por në qoftë se intensifikohen aktivitetet kërcënuese, atëherë mund të rrezikohet ndjeshëm.
VITI I VLERESIMIT	2018
STATUTI NDËRKOMBËTAR	Gati i Kërcënuar, NT
SHKAQET E RREZIKIMIT	Lista e kërcënimeve: 2. Bujqësia dhe akuakultura; 7. Modifikimet e sistemeve natyrore; 8. Specie invazive dhe të tjera problematike, gjenet dhe sëmundjet; 9. Ndotja. Kërcënimet kryesore, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me fragmentimin dhe izolimin e habitateve, ndryshimet në regjimin menaxhues të pyjeve gjethëgjera dhe tokave bujqësore, humbjen e popullatave të insekteve si rezultat i përdorimit të pesticideve, si dhe prishjen dhe humbjen e habitateve nëntokësore dhe nënkulmeve
NDËRMARRJA E MASAVE MBROJTËSE	loji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura)
MASAT MBROJTËSE	Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtueshmëria dhe zbatimi i ligjit). Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit). Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmëndtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lloje të tjera dhe lokalitetin/lokalitetet ku gjendet
Emri shkencor	Anguilla anguilla (Linnaeus, 1758)
Emri shqip	Ngjala
KATEGORIA SISTEMATIKE	Actinopterygii: Anguilliformes: Anguillidae
PËRSHKRIMI	Ky lloj është tipik migrator, me migrim katadromik. Është lloj territorial dhe vetmitar. Është peshk grabitqar, që ushqehet me një spektër të gjerë të ushqimit dhe kjo i mundëson të jetojë në kushte të ndryshme ekologjike dhe me një përhapje të madhe gjeografike. Mund të arrijë gjatësinë deri në 122 cm. Është raportuar se mund të arrijë moshën deri në 88 vjet (Freyhof and Kottelat 2008).
HABITATI	Lloji i habitatit: 5.Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat]). Ky lloj është karakteristik për ujërat e ëmbla, por mund të haset edhe në mjedise detare. Zakonisht gjendet vetëm në ato ujëra të ëmbla të cilat janë të lidhura me sistemet detare, ku migron për t'u shumuar.
PËRHAPJA E PËRGJITHSHME	Evropë, Afrikë Veriore
PËRHAPJA NË KOSOVË	Lumi Drini i Bardhë në Mirushë, Drini i Bardhë tek Ura e Shenjtë.
POPULACIONET	Trendi i popullatës: Në rënie.
KATEGORIA E KËRCËNUESHMERISË NË KOSOVË SIPAS IUCN	Skajshmërisht i Rrezikuar, CR A2ac; B2ab(iii,iv) Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Skajshmërisht i Rrezikuar, për shkak të reduktimit të vëzhguar të popullatës në të kaluarën, ku shkaktarët e rënies mund

	të mos kenë pushuar ende, bazuar në vëzhgimin direkt dhe rënien e cilësisë së habitateve të përshtatshme për llojin. Ky lloj është i njohur nga vetëm 2 lokacione, me zonën e pranisë ZP = 8 km ² . Dikur popullata e ngjalës ka qenë mjaft e dendur në lumin Drini i Bardhë, ndërsa sot, për shkak të ndërtimit të pendës në anën e Shqipërisë, si dhe për shkak të ndryshimeve klimatike, është në rënie rapide.
VITI I VLERESIMIT	2018
STATUTI NDËRKOMBËTAR	Skajshmërisht i Rrezikuar, CR
SHKAQET E RREZIKIMIT	Lista e kërcënimeve: 7 Modiikimet e sistemeve natyrore (7.2 Digat dhe menaxhimi/përdorimi i ujit: 7.2.10 Diga të mëdha)); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, 9.4 Mbeturinat dhe mbetjet e ngurta); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 Thatësitrat). Faktorët kryesorë, që e kërcënojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me ndërtimin e pendave, menaxhimin dhe përdorimin e ujit, ndotjen me mbeturina të ngurta dhe thatësitë.
NDËRMARRJA E MASAVE MBROJTËSE	Lloji është i mbrojtur (Udhëzimi Administrativ Nr. 18/2012 Për Shpalljen e Llojeve të Egra të Mbrojtura dhe Strikt të Mbrojtura).
MASAT MBROJTËSE	Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtuueshmëria dhe zbatimi i ligjit). Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit). Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin/lokalitetet ku gjendet dhe për llojet e tjera të pranishme
Emri shkencor	Eudontomyzon stankokaramani Karaman, 1974
Emri shqip	Lampetra e Drinit, Kavalli i Drinit
KATEGORIA SISTEMATIKE	Cyclostomata: Petromyzontiformes: Petromyzontidae
PËRSHKRIMI	Ky lloj i banon kryesisht ujërat e pastra. Është lloj jograbitqar. Madhësia e individëve të rritur është përafërsisht 20 cm (Holčik and Šorić 2004). Metamorfozën e kryen prej nëntorit deri në prill. Nuk ka ndonjë rëndësi në aspektin e peshkimit (Freyhof and Kottelat 2007).
HABITATI	Lloji i habitatit: 5 Vende ujore (kontinentale) (5.1 Lumenj, përrenj, përroska, të përhershme [përfshirë ujëvarat], 5.9 Burime të ujërave të ëmbla dhe oaza). Kryesisht gjendet në zonat pranëmalore dhe malore, në rrjedha të vogla ujore, të pasura me shumë oksigjen. Larvat e këtij lloji, amocitet, jetojnë në fundin e shtratit të pasur me detritus dhe zhavor të imët
PËRHAPJA E PËRGJITHSHME	Lloj endemik i Ballkanit. Deri më tani është konstatuar vetëm në Liqenin e Ohrit, Liqenin e Shkodrës dhe Drinin e Bardhë.
PËRHAPJA NË KOSOVË	Drinin e Bardhë.
POPULACIONET	Trendi i popullatës: I panjohur Në Kosovë është konstatuar në vetëm disa lokalitete, por me numër të konsiderueshëm të individëve. Megjithatë, në disa prej lokaliteteve ku është konstatuar janë vërejtur aktivitete që e rrezikojnë dukshëm habitatin e këtij lloji.
KATEGORIA E KËRCËNUESHMERISË	Gati i Kërcënuar, NT Ky lloj është vlerësuar në kategorinë: Gati i Kërcënuar, për shkak të rëndësisë dhe

NË KOSOVË SIPAS IUCN	rrallësisë së llojit në nivel evropian, si dhe tendencës në rritje të aktiviteteve, të cilat mund ta çojnë këtë lloj drejt zhdukjes në Kosovë. Numri momental i njohur i lokacioneve (3), zona e pranisë ZP = 12 km ² dhe shtrirja e përhapjes SHP = 121 km ² e kualifikojnë këtë lloj për kategoritë e zhdukjes, megjithatë, presim që lloji të jetë më shumë i përhapur në Kosovë. Ndikimi nga pendat e vogla në pellgun e Drinit të Bardhë në nënpopullatat e këtij lloji, duhet të vlerësohet.
VITI I VLERESIMIT	2017
STATUTI NDËRKOMBËTAR	Gati i Kërcënuar, NT
SHKAQET E RREZIKIMIT	Lista e kërcënimeve: 7 Modiikimet e sistemeve natyrore (7.2. Digat dhe menaxhimi/ përdorimi i ujit: 7.2.9 Digat e vogla, 7.3 Modiikime të tjera të ekosistemit); 9 Ndotja (9.1 Ujërat e zeza shtëpiake dhe urbane, 9.4 Mbeturinat dhe mbetjet e ngurta); 11 Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër (11.2 Thatësitrat). Faktorët kryesorë, që e rrezikojnë këtë lloj, kanë të bëjnë me ndërtimin e pendave, modiikimet e ndryshme të ekosistemeve, ndotjen nga ujërat e zeza, ndotjen nga mbeturinat e ngurta dhe të tjera, si dhe me thatësinë.
NDËRMARRJA E MASAVE MBROJTËSE	Aktualisht, nuk ekziston ndonjë masë mbrojtëse
MASAT MBROJTËSE	Veprimet e nevojshme për konservim: 1. Mbrojtja e tokës/ujit (1.1 Mbrojtja e lokalitetit/zonës); 5. Ligji dhe politikat (5.2 Politikat dhe rregulloret, 5.4 Pajtuëshmëria dhe zbatimi i ligjit). Hulumtimi i nevojshëm: 1. Hulumtimi (1.2 Madhësia, përhapja dhe trendet e popullatës, 1.3 Historia e jetës dhe ekologjia); 3. Monitorimi (3.1 Trendet e popullatës, 3.4 Trendet e habitatit). Prania e këtij lloji është tregues i cilësisë së njëmendtë të habitatit dhe mbrojtja eventuale e llojit siguron efekt mbrojtës për lokalitetin ku gjendet dhe llojet e tjera prezente.

Llojet shtazore që janë hasur në shpellat e Zatriqit, gjatë ekspeditave të speologëve ndërkombëtarë¹⁴:

- **Insektet:** Lloji *Diphyus quadripunctorius* (Müller, 1776); Coleoptera: family Curculionidae, Hymenoptera, familja Ichneumonidae ; Lloji *Megaphyllum sp.* Verhoeff, 1894, Diplopoda (dykëmbëshat): Llojet *Tegenaria animata* Kratochvíl & Miller, 1940, (Lloji i ri për Kosovën), *Nesticus cellulanus* (Clerck, 1757), *Metellina merianae* (Scopoli, 1763), Lloji *Porrhomma convexum* (Westring, 1851), Araneae (Merimangat), Lloji *Troglophilus neglectus* Krauss, 1879, Chilopoda, dhe Lloji *Lithobius sp.* Leach, 1814 - Orthoptera:
- **Butakët, Gastropoda** (kërmijtë): Llojet *Zebrina detrita* (Müller, 1774), dhe *Jaminia quadridens* (O.F. Muller, 1774), familja Clausiliidae,
- **Ujëtokësorët:** Lloji *Salamandra salamandra* (Tritoni);
- **Zvarranikët:** *Lacerta viridis* (hardhuca e gjelbër);
- **Gjitarët:** Llojet e lakuriqëve: *Myotis blythii*, *Myotis capaccinii* and *Rhinolophus hipposideros*.

¹⁴ *Speleological exploration of the Akovan mountain, Expedition Report. Bulgarian Caving Society, Kosovo Project 2017*

4.3.4. Pyjet dhe kullosat

Pyjet e komunës së Rahovecit janë kryesosh pyje të ulëta gjethërënëse. Në pjesën kodrinore dominojnë pyjet me mjaft lloje dhe janë të përziera me rreth 80 %. Prej drunjëve dallohen pyjet gjethërënëse si: qarri (*quercus cerris*), spardhi (*quercus fraineto*), dushku, bungëbuta por ka edhe shkoza (*carpinus orientalis*) dhe ahu (*fagus sylvatica*). Përhapje më të kufizuar kanë llojet tjera që paraqiten si të vetmuara si: brekia, bliri (*tilia kordata*), frashri, etj.

Janë prezentë edhe tipet tjera që janë të ulëta, lloji i shkurreve, si: thana (*cornus mas*), murrizi (*crataegus monogyna*), kaça (*rosa canina*), manaferra e egër (*rubus fruticosus*), shtogu (*sambucus nigra*), kulumbria (*prunus spicosa*), lajthia (*corylus avellana*), në vise të larta fieri shqiponje (*pteridium aquilinum*), etj. Në territorin e kësaj komune ka fare pakë pyje gjethembajtëse, në disa lokalitete haset dëllinja (*Astero- Juniperetum oxycedri*).

Hapësira e rrafshët e komunës është shumë pak e mbuluar me drunjë. Zakonisht në zonën e luginave të lumenjëve rriten Shelgu (*salix alba*) Shelgu i bardhë (*Salicetum albae fragilis*), Shelgu i kuq (*Salicetum purpurea*), Verri i zi (*Alnetum glutinosae*).

Ka sipërfaqe të mëdha të tokave të zhveshura e në të ardhmen duhet ti kushtohet kujdes në pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura të komunës. Me këto masa do të forcohet funksionimi i pyjeve në procesin e mbrojtjes së natyrës dhe në mbajtjen e ekuilibrit ekologjik të këtij territori. Këto sipërfaqe mundë të planifikohet për pyllëzim, duke rritur kështu sipërfaqen e pyjeve por njëkohësisht do të kishte ndikim pozitiv edhe në parandalimin e dukurisë së erozionit.

Ndër problemet kryesore mbetet prerja ilegale e pyjeve që është një dukuri shqetësuese dhe që kërkon vëmendje dhe ndërmarrjen e masave nga komuna dhe nga Agjencia e Pyjeve.

Në kuadër të përmirësimit të menaxhimit të pyjeve Komuna e Rahovecit në bashkëpunim me shoqatat e pronarëve të pyjeve private dhe të Agjencisë së Pyjeve dhe me mbështetje të donatorëve ka pasur disa iniciativa për menaxhimin e përbashkët të pyjeve. Me qëllim të përmirësimit të gjendjes së pyjeve këto iniciativa duhet të përkrahen dhe vazhdojnë edhe në të ardhmen. Po ashtu është e nevojshme që të mbështeten dhe të ngriten kapacitetet e shoqatave të pyjeve private dhe shoqatave dhe grupeve tjera që kanë në fokus të angazhimit të tyre mbrojtjen e pyjeve, natyrës dhe biodiversitetit.

5. Problemet kryesore

- Bashkëpunimi jo i mjaftueshëm i institucionet në nivel qendror dhe lokal për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit;
- Mungesa e një inventari të plotë dhe të detajuar për vlerave natyrore në territorin e komunës;
- Korniza ligjore dhe programore për mbrojtjen e biodiversitetit në komunën e Rahovecit dhe integrimi i mbrojtjes së natyrës në planifikime sektoriale e pamjaftueshme;
- Numri i vogël i projekteve dhe aktiviteteve për promovimi e vlerave natyrore të komunës dhe
- Numri i vogël i aktiviteteve dhe fushatave për rritjen e edukimit dhe ndërgjegjësimit për mbrojtjen e tyre;
- Shkatërrimit të ekosistemeve natyrore si rezultat i mbishfrytëzimit dhe prerjeve ilegale dhe aktiviteteve natyrore;
- Numri i vogël i projekteve dhe aktiviteteve për rehabilitimi dhe restaurimi i ekosistemeve të degraduara natyrore;
- Kapacitet e limituara të komunës për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave;
- Numri i vogël i informatave, hulumtimeve dhe raporteve për gjendjen e natyrës dhe biodiversitetit në territorin e komunës;
- Mungesa e infrastrukturës së nevojshme në funksion të mbrojtjes së natyrës dhe biodiversitetit;

6. Prioritetet për periudhën 2023-2028

- Forcimi i bashkëpunimit me institucionet tjera në nivel qendror dhe lokal për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit;
- Identifikimi i vlerave natyrore në territorin e komunës dhe marrja në mbrojtje e këtyre zonave;
- Kompletimi i kornizës ligjore dhe programore për mbrojtjen e biodiversitetit në komunën e Rahovecit dhe integrimi i mbrojtjes së natyrës në planifikime sektoriale;
- Promovimi i vlerave natyrore të komunës dhe rritja e edukimit dhe ndërgjegjësimit për mbrojtjen e tyre;
- Parandalimi i shkatërrimit të ekosistemeve natyrore;
- Rehabilitimi dhe restaurimi i ekosistemeve të degraduara natyrore;
- Fuqizimi i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave;
- Informimi dhe raportimi për natyrën dhe biodiversitetin;
- Rregullimi i infrastrukturës në funksion të mbrojtjes së natyrës, biodiversitetit dhe promovimin e ekoturizmit.

7. Plani i aktiviteteve dhe veprimeve për periudhën 2023-2027

Tabela 14: Prioriteteve dhe aktiviteteve për përmbushjen e prioriteteve për PLVB për Komunën e Rahovecit

Prioritetet	Aktivitetet e propozuara për përmbushjen e prioriteteve	Bartësi i aktivitetit dhe institucionet tjera të përfshira	Koha e planifikuar për implementim	Buxheti i planifikuar (EURO)	Ndërlidhja me dokumentet tjera programore
1. Forcimi i bashkëpunimit me institucionet tjera në nivel qendror dhe lokal për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit	1.1. Rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe OJQ-të për ngritjen e vetëdijesimit dhe edukimit për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit;	DUPMM, DSHPK, DA, DKRS, IKMN, MMPHI, OJQ Mjedisore	K1 2024-K4 2027	10.000	PLVM, Strategjia e Biodiversitetit
	1.2. Bashkëpunimi me gjykatat, policinë dhe institucionet tjera relevante për parandalimin e gjuetisë ilegale;	DUPMM, DSHPK, DEZHT, APK, PK, Gjykata, Prokuroria Shoq. e Gjuetareve	K1 2024-K4 2027	Kosto administrative	PLVM, Strategjia e Biodiversitetit
	1.3. Përmirësimi i bashkëpunimit me gjykatat, policinë dhe institucionet tjera relevante për parandalimin e prerjeve ilegale;	DUPMM, DSHPK, DEZHT, APK, PK, Gjykata, Prokuroria	K1 2024-K4 2027	Kosto administrative	PLVM, Strategjia e Biodiversitetit
	1.4. Përmirësimi i bashkëpunimit me institucione qendrore dhe lokale për administrimin me vlerat e natyrës dhe me vlerat e mbrojtura të natyrës;	DUPMM, DSHPK, DA, DKRS, IKMN,	K1 2024-K4 2027	Kosto administrative	PLVM, Strategjia e Biodiversitetit
	1.5. Formimi i rrjetit lokal të organizatave për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve;	DUPMM, DSHPK, DA, DKRS, OJQ, Shoq. e Gjuetareve	K1 2025-K4 2025	10.000	PLVM, Strategjia e Biodiversitetit
2. Identifikimi i vlerave natyrore në territorin e komunës dhe marrja në mbrojtje e këtyre zonave	2.1. Marrja në mbrojtje e zonave të reja të natyrës;	DSHPK, IKMN, DEZHT, DKRS	K1 2025-K4 2025	10.000	PLVM, Strategjia e Biodiversitetit
	2.2. Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i habitateve të llojeve të florës se qe shtrihen ne territorin e Komunës se Rahovecit qe janë pjese e librit te kuq te florës vaskulare te Kosovës;	DUPMM, DSHPK, IKMN, DEZHT, APK	K1 2025-K4 2025	10.000	PLVM, Strategjia e Biodiversitetit

	2.3. Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm habitateve të llojeve faunës së qe shtrihen në territorin e Komunës së Rahovecit që janë pjesë e librit të kuq të faunës së Kosovës;	DUPMM, DSHPK, IKMN, DEZHT, APK	K1 2025-K4 2025	10.000	PLVM, Strategjia e Biodiversitetit
	2.4. Mbrojtja e zonave me karakteristika reprezentative të vendbanimeve natyrore duke aplikuar bujqësinë tradicionale;	DUPMM, DSHPK, DEZHT, MBPZHR	K1 2025-K4 2025	10.000	PLVM, PZHK
3. Kompletimi i kornizës ligjore dhe programore për mbrojtjen e biodiversitetit në komunën e Rahovecit dhe integrimi i mbrojtjes së natyrës në planifikime sektoriale	3.1. Hartimi i Planit Menaxhues për zonën e mbrojtur “Kanioni Ura e fshajt”;	DUPMM, DSHPK, DEZHT, IKMN	K1 2026-K4 2026	10.000	PLVM
	3.2. Hartimi i Planit Lokal për Mbrojtjen e Pyjeve dhe Zonave Natyrore nga zjarret;	DUPMM, DSHP, DEZHT, DPSH, APK	K1 2026-K4 2026	10.000	PLVM Strategjia e Pyjeve Plani për menaxhimin e emergjencave
	3.3. Sigurimi i mbrojtjes së integruar të natyrës përmes bashkëpunimit me sektorët tjerë, shfrytëzimi i qëndrueshëm i biodiversitetit;	DUPMM, DSHPK, DEZHT	K1 2024-K4 2027	Kosto administrative	PLVM Strategjia e Pyjeve
	3.4. Hartimi i planeve menaxhuese për zonat e mbrojtura të Komunës së Rahovecit duke respektuar kushtet për mbrojtjen e natyrës;	DUPMM, DSHPK, DEZHT, IKMN	K1 2026-K4 2026	10.000	PLVM, PZHK
	3.5. Vendosja e kushteve dhe masave të mbrojtjes së natyrës në dokumentet e planifikimit hapësinor dhe planet e menaxhimit në sektorët dhe veprimtaritë që kanë ndikim në natyrë;	DUPMM, DSHPK, DEZHT, MMPHI	K1 2024-K4 2027	Kosto administrative	PLVM, PZHK
4. Promovimi i vlerave natyrore të komunës dhe rritja e edukimit dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e tyre	4.1. Promovimi prodhimtarisë ekologjike dhe bujqësis organike përmes shtimit të sipërfaqeve me bujqësi dhe numrit të fermave që merren me këtë veprimtari;	DUPMM, DZHE, MBPZHR	K1 2025-K4 2025	10.000	PZHK
	4.2. Fushatë edukim për rendësin e ruajtjes së biodiversitetit me fermerët dhe popullatën rurale lidhur me përdorimin e plehrave kimike dhe pesticideve me spektër të gjerë;	DUPMM, DEZHT DSHPK, MBPZHR	K1 2026-K4 2026	10.000	PLVM, PZHK

	4.3. Aplikimi i procedurave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisit dhe parimeve të mbrojtjes së natyrës gjatë planifikimit të ndërtimit të infrastrukturës turistike;	DUPMM, DSHPK, DEZHT, MMPHI	K1 2024-K4 2027	Kosto administrative	PLVM, PZHK, Strategjia e Biodiversitetit
	4.4. Fushatë vetëdijesimi për mbrojtjen e natyrës dhe promovimin e ekoturizmit;	DSHPK, DEZHT MMPHI	K1 2027-K4 2027	10.000	PLVM, PZHK, Strategjia e Biodiversitetit
	4.5. Përfshirja e publikut dhe Organizatave të Shoqërisë Civile në procesin e vendim marrjes për mbrojtjen e natyrës;	DUPMM, DSHPK, DEZHT, MMPHI OJQ Mjedisore	K1 2024-K4 2027	10.000	PLVM, PZHK,
	4.6. Organizimi i fushatave vetëdijesuese në shkollat fillore për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit;	DUPMM, DSHPK, DA, DKRS	K1 2025-K4 2025	10.000	PLVM, PZHK
5. Parandalimi i shkatërrimit të ekosistemeve natyrore	5.1. Parandalimi i shkatërrimit të ekosistemeve lumore nga shfrytëzimi i zhavorrit dhe degradimi i shtretërve të lumenjve;	DUPMM, DSHPK, MMPHI	K1 2024-K4 2027	20.000	PLVM, PZHK
	5.2. Pastrimi i deponive ilegale të mbeturinave në lumenj dhe në ekosisteme tjera natyrore;	DUPMM, DSHP, KRM Pastrimi	K1 2024-K4 2027	20.000	PLVM, PLMM
	5.3. Hartimi dhe implementimi i masave për parandalimin e zjarreve në pyje;	DSHP, AME	K1 2026-K4 2026	10.000	PLVM, PZHK
6. Rehabilitimi dhe restaurimi i ekosistemeve të degraduara natyrore	6.1. Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura të ndikuara nga erozioni;	DUPMM, DSHPK, DEZHT, APK	K1 2024-K4 2027	20.000	PLVM, PZHK, Strategjia e pyjeve
	6.2. Aplikimi i subvencioneve dhe stimulimeve për pyllëzimin e ekosistemeve të degraduara;	DUPMM, DSHPK, DEZHT, APK	K1 2024-K4 2027	15.000	PLVM, PZHK, Strategjia e pyjeve
	6.3. Zbatimi i pyllëzimeve në toka të zhveshura pyjore me lloje autoktone;	DUPMM, DSHPK, DEZHT, APK	K1 2024-K4 2027	20.000	PLVM, PZHK, Strategjia e pyjeve
7. Fuqizimi i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave	7.1. Hartimi i programeve për përkujdesje ndaj pyjeve dhe për përmirësimin e strukturave të pyjeve;	DUPMM, DSHP, DEZHT, APK	K1 2025-K4 2025	10.000	PLVM, PZHK, Strategjia e pyjeve
	7.2. Zbatimi i rrallimit të pyjeve dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i mbetjeve pyjore;	DUPMM, DSHPK, DEZHT, APK	K1 2024-K4 2027	15.000	PLVM, PZHK, Strategjia e pyjeve

	7.3. Thellimi i bashkëpunimit me pronarët e pyjeve privatë për menaxhimin e përbashkët të pyjeve;	DUPMM, DSHPK, DEZHT, APK, CNVP	K1 2024-K4 2027	Donatoret	PLVM, PZHK, Strategjia e pyjeve
8. Informimi dhe raportimi për natyrën dhe biodiversitetin	8.1. Hartimi i raportit për gjendjen e natyrës dhe biodiversitetit në Komunën e Rahovecit;	DUPMM, DSHP, IKMN	K1 2024-K4 2027	Kosto administrative	PLVM, Strategjia e biodiversitetit
	8.2. Informimi i rregullt i publikut për gjendjen e natyrës dhe biodiversitetit dhe aktivitetet e komunës për mbrojtjen e tyre;	DUPMM, DSHPK, IKMN	K1 2024-K4 2027	Kosto administrative	PLVM, Strategjia e biodiversitetit
	8.3. Publikimi i broshurës informuese për Shpellat e Rahovecit	DUPMM, DSHPK, IKMN	K1 2026-K4 2026	10.000	PLVM, Strategjia e biodiversitetit
	8.4. Inkurajimi i hulumtimeve shkencore në lëmin e mbrojtjes së natyrës;	DUPMM, DSHPK, IKMN, MMPHI	K1 2025-K4 2025	10.000	Strategjia e biodiversitetit
9. Rregullimi i infrastrukturës në funksion të mbrojtjes së natyrës, biodiversitetit dhe zhvillimit të ekoturizmit	9.1. Rregullimi i infrastrukturës në Zonat e Mbrojtura	DUPMM, DSHP, DZHE	K1 2025-K4 2025	50.000	PZHK, KASH
	9.2. Shenjëzimi i zonave të mbrojtura dhe vlerave të tjera natyrore me rëndësi të veçantë;	DUPMM, DSHPK, DEZHT, IKMN	K1 2027-K4 2027	5.000	PLVM
	9.3. Shenjëzimi i zonave turistike dhe shtigjeve për turistë;	DUPMM, DSHPK, DEZHT, IKMN	K1 2026-K4 2026	15.000	PLVM, PZHK
	9.4. Rregullimi i infrastrukturës në zonat turistike të Rahovecit.	DUPMM, DSHPK	K1 2027-K4 2027	50.000	KASH, PZHK

8. Plani i monitorimit të zbatimit të PLVB

Tabela 15: Plani i monitorimit për zbatimin e PLVB, indikatorët e suksesit dhe ndikimi i pritshëm

Nr.	Prioriteti	Aktivitetet	Indikatorët e Suksesit	Ndikimi i pritshëm
1.	Forcimi i bashkëpunimit me institucionet tjera në nivel qendror dhe lokal për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit	- Rritja e bashkëpunimit me OJQ-të për ngritjen e vetëdijesimit dhe edukimit për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit; - Bashkëpunimi me gjykatat, policinë dhe institucionet tjera relevante për parandalimin e gjuetisë ilegale; - Përmirësimi i bashkëpunimit me gjykatat, policinë dhe institucionet tjera relevante për parandalimin e prerjeve ilegale; - Përmirësimi i bashkëpunimit me institucione qendrore dhe lokale për administrimin me vlerat e natyrës dhe me vlerat e mbrojtura të natyrës; - Formimi i rrjetit lokal të organizatave për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve;	- Numri i OJQ të përfshira në procesin e bashkëpunimit; - Numri i rasteve të proceduara në gjykata për gjueti ilegale; - Numri i rasteve të proceduara në gjykata për prerje ilegale; - Numri i institucioneve lokale dhe qendrore të përfshira në procesin e bashkëpunimit dhe numri i takimeve koordinuese të mbajtura; - Numri i organizatave të përfshira në rrjetin lokal për mbrojtjen e natyrës dhe numri i takimeve të mbajtura;	- Bashkëpunimi me OJQ i përmirësuar; - Gjuetia ilegale e llojeve të egra e zvogëluar; - Prerjeje ilegale e pyjeve e zvogëluar; - Bashkëpunimi ndërinstitucional me nivelin lokal dhe qendror i përmirësuar; - Rrjeti lokal i organizatave për mbrojtjen e natyrës funksional;
2.	Identifikimi i vlerave natyrore në territorin e komunës dhe marrja në mbrojtje e këtyre zonave	- Marrja në mbrojtje e zonave të reja të natyrës; - Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i habitateve të llojeve të florës se që shtrihen në territorin e Komunës së Rahovecit që janë pjesë e librit të kuq të florës vaskulare të Kosovës; - Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i habitateve të llojeve faunës se që shtrihen në territorin e Komunës së Rahovecit që janë pjesë e librit të kuq të faunës së Kosovës; - Mbrojtja e zonave me karakteristika reprezentative të vendbanimeve	- Numri i zonave të reja të natyrës të marra nën mbrojtje; - Numri i masave mbrojtëse për habitatet e llojeve të florës që janë pjesë e librit të kuq të florës vaskulare; - Numri i masave mbrojtëse për habitatet e llojeve të faunës që janë pjesë e librit të kuq të faunës; - Sipërfaqet e zonave me bujqësi tradicionale;	- Zonat me vlera natyrore të mbrojtura; - Masat mbrojtëse për habitatet e llojeve të florës që janë pjesë e librit të kuq të florës vaskulare të zbatuara; - Masat mbrojtëse për habitatet e llojeve të faunës që janë pjesë e librit të kuq të faunës të zbatuara; - Bujqësia tradicionale e ruajtur;

		natyrore duke aplikuar bujqësinë tradicionale;		
3.	Kompletimi i kornizës ligjore dhe programore për mbrojtjen e biodiversitetit në komunën e Rahovecit dhe integrimi i mbrojtjes së natyrës në planifikime sektoriale	- Hartimi i Planit Menaxhues për zonën e mbrojtur “Kanioni i Drinit te Bardhe”; - Hartimi i Planit Lokal për Mbrojtjen e Pyjeve dhe Zonave Natyrore nga zjarret; - Sigurimi i mbrojtjes së integruar të natyrës përmes bashkëpunimit me sektorët tjerë, shfrytëzimi i qëndrueshëm i biodiversitetit; - Hartimi i planeve menaxhuese për zonat e mbrojtura të Komunës së Rahovecit duke respektuar kushtet për mbrojtjen e natyrës; - Vendosja e kushteve dhe masave të mbrojtjes së natyrës në dokumentet e planifikimit hapësinor dhe planet e menaxhimit në sektorët dhe veprimtaritë që kanë ndikim në natyrë;	- Plani Menaxhues për zonën e mbrojtur “Kanioni i Drinit” i hartuar; - Planit Lokal për Mbrojtjen e Pyjeve dhe Zonave Natyrore nga zjarret i hartuar; - Numri i dokumenteve sektoriale ku është përfshirë mbrojtja e integruar e natyrës; - Planet menaxhuese për zonat e mbrojtura të Komunës së Rahovecit të hartuara; - Numri i dokumenteve të planifikimit hapësinorë ku janë vendosur kushtet dhe masat për mbrojtjen e natyrës;	- Plani Menaxhues për zonën e mbrojtur “Kanioni i Drinit” i zbatuar; - Planit Lokal për Mbrojtjen e Pyjeve dhe Zonave Natyrore nga zjarret i zbatuar; - Mbrojtja e integruar e natyrës përmes bashkëpunimit me sektorët tjerë, shfrytëzimi i qëndrueshëm i biodiversitetit; - Planet menaxhuese për zonat e mbrojtura të Komunës së Rahovecit të zbatuara; - Kushtet dhe masat për mbrojtjen e natyrës në dokumentet e planifikimit hapësinor të zbatuara;
4.	Promovimi i vlerave natyrore të komunës dhe rritja e edukimit dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e tyre	- Promovimi prodhimtarisë ekologjike dhe bujqësia organike përmes shtimit të sipërfaqeve me bujqësi dhe numrit të fermave që merren me këtë veprimtari; - Fushatë edukim për rendësin e ruajtjes së biodiversitetit me fermerët dhe popullatën rurale lidhur me përdorimin e plehrave kimike dhe pesticideve me spektër të gjerë; - Aplikimi i procedurave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisit dhe parimeve të mbrojtjes së natyrës gjatë planifikimit të ndërtimit të infrastrukturës turistike; - Fushatë vetëdijesimi për mbrojtjen e natyrës dhe promovimin e ekoturizmit; - Përfshirja e publikut dhe Organizatave të Shoqërisë Civile në procesin e vendim marrjes për mbrojtjen e natyrës; - Organizimi i fushatave vetëdijesuese në	- Sipërfaqet me prodhimtari ekologjike dhe bujqësia organike dhe numri i fermerëve që merren me këtë veprimtari; - Numri i fushatave të edukimit dhe i materialeve promovuese me fermerë; - Numri i rasteve të zbatimit të procedurave për VNM gjatë planifikimit të ndërtimit të infrastrukturës turistike; - Numri i fushatave të vetëdijesimi dhe materialeve promovuese për mbrojtjen e natyrës dhe ekoturizmit; - Përfshirja e publikut dhe Organizatave të Shoqërisë Civile në procesin e vendim marrjes për mbrojtjen e natyrës;	- Prodhimtaria ekologjike dhe bujqësia organike e promovuar dhe e rritur. - Fermerët të edukuar për përdorimin e pesticideve dhe ndikimin e tyre në biodiversitet; - VNM e zbatuar gjatë planifikimit të ndërtimit të infrastrukturës turistike; - Mbrojtja e natyrës dhe ekotuizmi të promovuara; - Publiku dhe OSHC të përfshira në procesin e vendimmarrjes për natyrën. - Nxënësit e shkollave fillore të vetëdijesuar për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit;

		shkollat fillore për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit;	Organizimi i fushatave vetëdijesuese në shkollat fillore për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit;	
5.	Parandalimi i shkatërrimit të ekosistemeve natyrore	- Parandalimi i shkatërrimit të ekosistemeve lumore nga shfrytëzimi i zhavorrit dhe degradimi i shtretërve të lumenjve; - Pastrimi i deponive ilegale të mbeturinave në lumenj dhe në ekosisteme tjera natyrore; - Hartimi dhe implementimi i masave për parandalimin e zjarreve në pyje;	- Numri i inspektimeve dhe gjobave për shkatërrim të shtretërve të lumenjve; - Numri apo sipërfaqeje i deponive ilegale të mbeturinave të pastruara; - Numri i masave për parandalim të zjarreve të hartuara;	- Gjendja e shtretërve të lumenjve e përmirësuar; - Numri i deponive ilegale të mbeturinave të zvogëluar; - Masat për parandalimin e zjarreve në pyje të implementuara;
6.	Rehabilitimi dhe restaurimi i ekosistemeve të degraduara natyrore	- Pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura të ndikuara nga erozioni; - Aplikimi i subvencioneve dhe stimulimeve për pyllëzimin e ekosistemeve të degraduara; - Zbatimi i pyllëzimeve në toka të zhveshura pyjore me lloje autoktone;	- Sipërfaqet e pyjeve të zhveshura dhe atyre të ndikuara nga erozioni të pyllëzuara; - Numri i subvencioneve dhe stimulimeve të ndara për pyllëzime të sipërfaqe të degraduara; - Numri i fidanëve me lloje autoktone të mbjella;	- Shtimi i sipërfaqeve të pyllëzuara në territorin e komunës; - Ekosistemet e degraduara të përmirësuara përmes pyllëzimit; - Ruajtja dhe kultivimi i llojeve autoktone të fidanëve;
7.	Fuqizimi i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave	- Hartimi i programeve për përkujdesje ndaj pyjeve dhe për përmirësimin e strukturave të pyjeve; - Zbatimi i rrallimit të pyjeve dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i mbetjeve pyjore; - Thellimi i bashkëpunimit me pronarët e pyjeve private për menaxhimin e përbashkët të pyjeve;	- Programet për përkujdesje ndaj pyjeve për përmirësimin e strukturave pyjore të hartuara; - Sipërfaqet e pyjeve të rralluara dhe sasia e biomasës në dispozicion; - Numri i pronarëve të pyjeve private të përfshirë në procesin e bashkëpunimit;	- Struktura e pyjeve e përmirësuar; - Pyjet e rralluara dhe të përmirësuara, biomasa e shfrytëzuar për sistemet e ngrohjes qendrore; - Sipërfaqet e pyjeve me menaxhim të përbashkët të përmirësuara;
8.	Informimi dhe raportimi për natyrën dhe biodiversitetin	- Hartimi i raportit për gjendjen e natyrës dhe biodiversitetit në Komunën e Rahovecit; - Informimi i rregullt i publikut për gjendjen e natyrës dhe biodiversitetit	- Përgatitja dhe publikimi i raportit për gjendjen e natyrës dhe biodiversitetit. - Numri i njoftimeve në ueb faqe	- Publiku i informuar për gjendjen e natyrës dhe biodiversitetit përmes raportit; - Publiku i informuar për gjendjen

		dhe aktiviteteve të komunës për mbrojtjen e tyre; • Publikimi i broshurës informuese për Shpellat e Rahovecit; • Inkurajimi i hulumtimeve shkencore në lëmin e mbrojtjes së natyrës;	dhe numri i broshurave informative të publikuara; • Përgatitja dhe publikimi i broshurës për shpellat e Rahovecit;	e natyrës dhe biodiversitetit përmes njoftimeve dhe broshurave; • Publiku i informuar për shpellat e komunës së Rahovecit.
9.	Rregullimi i infrastrukturës në funksion të mbrojtjes së natyrës, biodiversitetit dhe zhvillimin e ekoturizmit.	• Rregullimi i infrastrukturës në Zonat e Mbrojtura të Natyrës • Shenjëzimi i zonave të mbrojtura dhe vlerave të tjera natyrore me rëndësi të veçantë; • Shenjëzimi i zonave turistike dhe shtigjeve për turistë; • Rregullimi i infrastrukturës në zonat turistike të Rahovecit;	• Kilometrat e trotuareve, numri i ulëseve dhe numri i shportave për mbeturina të vendosura; • Numri i zonave të mbrojtura dhe vlerave tjera të shenjëzuara; • Numri i zonave turistike dhe shtigjeve për turistë të shenjëzuara; • Sipërfaqja e rregulluar, sipërfaqja e rrethuar, numri i ulëseve të vendosura.	• Infrastruktura në zonat e mbrojtura e rregulluar. • Zonat e mbrojtura dhe vlerat tjera natyrore të shenjëzuara; • Zonat turistike dhe shtigjet për turistë të shenjëzuara; • Infrastruktura në zonën turistike në Llanishtë e rregulluar.

9. Referencat dhe burimet e informacionit

1. ASK, Regjistrimi i Bujqësisë 2014
2. Degradimi i mjedisit (<http://opendata.cohu.org/sq/degradimi-mjedisit>) Organizata Cohu.
3. Libri i Kuq i Faunës së Kosovës, MMPH/AMMK/KEP 2020
4. Librin e Kuq të Florës vaskulare së Kosovës, MMPH/AMMK/GIZ
5. Ligji nr. 02/L-53 për Gjuetinë
6. Ligji nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale
7. Ligji nr.03/L-153 për pyjet e Kosovës
8. Ligji nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës
9. Ligjin Nr. 03/L-233 për mbrojtjen e natyrës
10. Lista e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme, MKRS 2019
11. Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2021-2027 i Komunës së Rahovecit
12. Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Rahovecit 2010-2020
13. Raport, Ndikimi i shfrytëzuesve të rërës dhe zhavorit në gjendjen mjedisore të lumenjve, AMMK 2022
14. Raporti për Gjendjen e ujërave 2020, AMMK
15. Regjistri i zonave të mbrojtura, IKMN/AMMK (www.ammk-rks.net)
16. Regjistrimi i Bujqësisë, ASK 2015
17. Speleological exploration of the Akovan mountain, Expedition Report. Bulgarian Caving Society, Kosovo Project 2017
18. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2011-2021/MMPH.
19. Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2010-2020/MBPZH
20. Vlerat e Trashëgimisë Natyrore të Kosovës, IKMN

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.168/23

Datë:27.12.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PLANI I PUNËS PËR KËSHILLIN KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI
JANAR-DHJETOR 2024

Dhjetor - 2023

Hyrje

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) funksionon duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Plani Vjetor i Punës së KKSB-së, përcakton objektivat dhe aktivitetet të cilat do të ushtrohen nga anëtarët e KKSB-së në përmbushje të qëllimit të funksionimit të këtij mekanizmi. Ky plan synon që të identifikojë qëllimet, aktivitetet dhe rezultatet, përkatësisht caktimin e përgjegjësisë për kryerjen e detyrave të përcaktuara me udhëzimin administrativ për KKSB-në.

Roli i KKSB-së në komunën e Rahovecit është i rëndësishëm sepse grumbullon shqetësimet e qytetarëve nëpërmjet përfaqësuesve të bashkësive etnike, fetare, sociale, profesionale dhe ato shqyrtohen bashkë me përfaqësuesit institucional të komunës dhe të organeve të sigurisë dhe tentohet të zgjidhen në dobi të qytetarëve.

KKSB-ja në Rahovec drejtohet nga kryetari i Komunës së Rahovecit, **z. Smajl Latifi**, në bashkëpunim të ngushtë me komandantin e policisë së Stacionit Policor në Rahovec dhe në bashkëveprim të vazhdueshëm me përfaqësuesit e bashkësive fetare myslimane, përfaqësues të organizatave joqeveritare, të biznesit dhe ekipe për siguri publike në bashkësi, nën monitorim të autoriteteve nacionale, siç janë Departamenti i Sigurisë Publike dhe autoriteti i inspektoratit të policisë, si dhe të organizatave ndërkombëtare, si OSBE-ja, KFOR-i dhe UN-i.

Nëpërmjet KKSB-së arrihet të kuptohen shqetësimet e të gjithë qytetarëve në komunën e Rahovecit dhe të ndërmerren hapa konkretë për zgjidhjen e atyre problemeve. Duke qenë të bindur në rolin e rëndësishëm që ka KKSB-ja, Komuna e Rahovecit është në maksimum e përkushtuar që plani i punës së KKSB-së të zbatohet me përpikëri.

Çdo komunë është e obliguar të themelojë Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. Plani i punës së KKSB-së kalon përmes mbledhjes së KKSB-së, më pas themelohet me vendim të Kuvendit të Komunës dhe kryesohet nga Kryetari i Komunës. Mandati i KKSB-së është 4 vjet dhe korrespondon me periudhën e mandatit të Kuvendit të Komunës. Në mënyrë që me sukses të kryejë misionin e vet, duke u bazuar në udhëzimin administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL.

Qëllimi i planit të punës

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi nuk do të kufizohet vetëm në detyrat e përcaktuara me këtë plan, por do të jetë aktiv edhe në përcjelljen e zhvillimeve të përditshme shoqërore, për t'i identifikuar dhe adresuar problemet e qytetarëve nga fusha e sigurisë së përgjithshme dhe trajtimin e kërkesave të tyre të kësaj natyre.

Plani i punës i KKSB-së ka për qëllim përmirësimin e sigurisë së qytetarëve duke u kujdesur për problematika të cilat e prekin drejtpërdrejt jetën e tyre. Plani i punës ofron qartësi në veprim, definon problematikat dhe afatet që do të trajtohen gjatë vitit, paraqet rezultatet e pritura, tregon se kush janë autoritetet përgjegjëse për të marrë masa në zgjidhjen e problemeve.

Objektivat

Duke u bazuar në udhëzimin administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL KKSB duhet të mbajë së paku 6 mbledhje gjatë vitit. Në këto mbledhje shqyrtohen problemet të cilat synojnë përmirësimin e sigurisë së qytetarëve. Duke u bazuar në këto udhëzime, KKSB-ja në Rahovec për vitin 2024, përveç mbajtjes së 6 mbledhjeve të obligueshme, synon që të shqyrtojë këto çështje të sigurisë:

Aktivitetet

Për t'i arritur këto objektiva, anëtarët e KKSBB-së do të ndërmarrin këto aktivitete:

1. Do të monitorojnë në vazhdimësi gjendjen e sigurisë në të gjithë territorin e komunës;
2. Do të mbledhin shënime, fakte dhe do të raportojnë në mbledhjet e KKSBB-së për secilin problem të vëzhguar, dëgjuar apo supozuar;
3. Do të mbajnë takime me qytetarë, këshilla shkollore, grupe qytetarësh, organizata joqeveritare (OJQ) dhe do të dëgjojnë problemet e tyre;
4. Do të adresojnë problemet në organet kompetente, si dhe krijimin e partneritetit dhe të iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi;
5. Do të mbajnë evidenca për problemet e shqyrtuara dhe për progresin e arritur në zgjidhjen e problemit.

Rezultatet e pritura

Duke vepruar siç është cekur më sipër dhe duke u përqendruar në objektivat e shënuara më sipër, situata do të ndryshojë në të mirë të qytetarëve. Për qytetarët do të sigurohet më shumë siguri në të gjitha fushat.

Përmbledhje

Në këtë plan të punës janë paraqitur informacione për KKSBB-në, aktet që e rregullojnë veprimtarinë e saj. Po ashtu është paraqitur qëllimi i planit të punës, objektivat e planit, aktivitetet që do të ndërmerren nga anëtarët e KKSBB-së për t'i arritur objektivat, si dhe janë paraqitur rezultatet e pritura dhe afatet kohore.

Afati kohor

Plani i Punës janar deri më dhjetor 2024.

**PLANI VJETOR I PUNËS PËR KËSHILLIN KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI
PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR 2024**

Nr .	Muaji	Çështjet që shqyrtohen	Përgatit	Shqyrton	Informon	Vërejtje
1.	JANAR	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Analizë e sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit për vitin paraprak 2023, 3. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit; - Siguria në trafik, - Ushtrimi i kontrollit më të shpeshtë të trafikut rrugor për të zvogëluar aksidentet me fatalitet. - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit. 4. Trajtimi i qenve endacakë. 4. Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje; 5. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme; 6. Organizimi i trajnimit për mbrojtje nga zjarri me nxënësit e shkollave. 7. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat, 8. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore. 9. Të ndryshme.	Koordinatori i KKSBB-së Kryetari i Komunës Policia e Kosovës Drejtoria për Arsim Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim Drejtoria për Urbanizëm, për Inspektorat, për Bujqësi dhe për Mbrojtje dhe Shpëtim	Anëtarët e KKSBB-së	Kuvendin e Komunës	

2.	MARS	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit; - Siguria në trafik; - Analizimi i vjedhjeve në territorin e Komunës së Rahovecit. - Vetëdijesimi i nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyer nga lufta. - Trotuaret dhe shenjat sinjalizuese në territorin e Komunës - Identifikimi dhe lirimi i hapësirave publike konkretisht trotuareve. 3. Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla, përdorimi i substancave narkotike dhe bartja e mjeteve të rrezikshme; 4. Sensibilizimi i qytetarëve për rëndësinë e promovimit të bashkëpunimit ndëretnik, multikulturor dhe ndërfetar. 5. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat. 6. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore. 7. Të ndryshme.	Koordinatori KKSB-së Kryetari i Komunës Policia e Kosovës dhe Drejtoria për Arsim Drejtoria për Shërbime Publike Drejtoria për Arsim, Policia e Kosovës Komuna, OJQ-të Drejtoria për Urbanizmit, për Inspektorat, për Bujqësi dhe për Mbrojtje dhe Shpëtim	Anëtarët e KKSB-së	Kuvendin e Komunës	
----	------	--	--	--------------------	--------------------	--

3	QERSHOR	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, - Siguria në trafik; - Identifikimi i çështjeve problematike që ndikojnë në sigurinë publike ndëretnike, - Prishja e rendit dhe e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm. - Plani operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe të dasmave. - Vendosja dhe funksionalizimi i kamareve shtesë të sigurisë në hapësirat publike në rrugët kryesore; 3. Diskutim për aktivitetet e organizuara nga Drejtoria për Arsim për maturantet. 4. Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror. 5. Trajtimi i objekteve të braktisura dhe objekteve të vjetra, jo të sigurta; 6. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat, 7. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore. Të ndryshme.	Koordinatori i KKSBB-së Kryetari i Komunës Policia e Kosovës Drejtoria për Shërbime Publike Drejtoria për Arsim Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim Drejtoria për Inspektorat Drejtoria për Urbanizëm, për Inspektorat, për Bujqësi dhe për Mbrojtje dhe Shpëtim	Anëtarët e KKSBB-së	Kuvendin e Komunës	
---	---------	--	---	---------------------	--------------------	--

4.	Gusht	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, - Siguria në trafik; - Masat për parandalimin e lëmshëkërkuesve, - Informatë dhe analizë nga policia e Komunës për çështjen e vjedhjeve dhe të sigurisë së përgjithshme. 3. Informatë për fillimin e procesit mësimor 2024-2025 dhe çështja e sigurisë nëpër shkolla. 4. Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta. 5. Trajtimi dhe mbrojtja e pyjeve nga dëmtuesit ilegalë. 6. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat. 7. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore. 8. Të Ndryshme.	Koordinatori i KKSBB-së Kryetari i Komunës Policia e Kosovës Drejtoria për Arsim Drejtoria për Shërbime Publike Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim Drejtoria për Urbanizmit, për Inspektorat, për Bujqësi dhe për Mbrojtje dhe Shpëtim	Kryetari i Komunës KKSBB-ja	Kuvendin e Komunës	
5.	Tetor	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, - Siguria në trafik. - Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje; 3. Organizimi i fushatave vetëdijesuese përmes aktiviteteve rekreative, kulturore për	Koordinatori i KKSBB-së Kryetari Komunës Policia e Kosovës Komuna, OJQ-të	Kryetari i Komunës KKSBB-ja DSHPSE-ja, DUPH-ja	Kuvendin e Komunës	

		përmirësimin e komunikimit ndëretnik dhe ndërftetar 4. Informatë nga Drejtoria për Shërbimeve publike lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve dhe të trotuareve për sezonin e dimrit. 5. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat. 6. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore. 7. Të Ndryshme.	Drejtoria për Shërbime Publike Drejtoria për Urbanizëm, për Inspektorat, për Bujqësi dhe për Mbrojtje dhe Shpëtim			
6.	Dhjetor	1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit, - Parandalimi i dhunës në familje; - Marrja e masave dhe vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike. - Identifikimi i vendeve ku dyshohet se të rinjtë tanë përdorin substanca narkotike. - Masat për parandalimin e lëmshëkërkuesve, - Rreth parkingjeve në qytet dhe ndriçimi publik. 3. Njoftimi rreth takimit të anëtarëve të KKSB-së me kryetarët e këshillave të lagjeve dhe të fshatrave të Komunës së Rahovecit; 4. Njoftimi i anëtarëve të KKSB-së rreth përgatitjes së planit të veprim për KKSB-në për vitin 2025. 5. Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit, deponitë dhe mbeturinat. 6. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore. 7. Të Ndryshme.	Koordinatori i KKSB-së Kryetari i Komunës Policia e Kosovës Drejtoria për Shërbime Publike Kryetari i Komunës Kryetari Komunës, Koordinator i KKSB-së Drejtoria për Urbanizëm, për Inspektorat, për Bujqësi dhe për Mbrojtje dhe Shpëtim	Policia KKSB-ja	Kuvendin Komunës	

Përveç këtyre temave, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, do të shqyrtojë edhe tema të tjera të cilat janë me rëndësi dhe në interes për qytetarët, Policinë e Kosovës dhe Komunën e Rahovecit

01 Nr.166/23

Datë:27.12.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit

Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo



Komuna Rahovec
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kuvendi Komunal – Skupština Opštine – Municipal Rahovec



PLANI I PUNËS
I KUVENDIT TË KOMUNËS SË RAHOVECIT PËR VITIN
2024

Pasqyra e planit 2024

Parathënie.....
Janar
Shkurt.....
Mars
Prill.....
Maj
Qershor.....
Korrik.....
Gusht.....
Shtator
Tetor.....
Nëntor.....
Dhjetor

Parathënie

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në Komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët dhe funksionon në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore.

Kuvendi i Komunës nuk i delegon përgjegjësitë e tij lidhur me marrjen e vendimeve për:

- Statutin dhe Rregulloren e punës, rregulloret komunale dhe miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre;
- Miratimin e buxhetit dhe të planeve investuese;
- Miratimin e çështjeve të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas statutit apo Rregullores së punës;
- Planin vjetor të punës dhe raportin vjetor;
- Themelimin e komisioneve të kërkuara sipas Ligjit;
- Nivelin e tarifave dhe të ngarkesave;
- Krijimin dhe përdorimin e simboleve, të dekoratave dhe të titujve të nderit të Komunës, në pajtim me ligjin në fuqi;
- Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, të rrugicave dhe të vendeve të tjera publike;
- Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale;
- Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës, dhe
- Përgjegjësi të tjera që kërkojnë me ligj.

Për marrjen e vendimeve, Kuvendi i Komunës mund t'ia delegojë pushtetin e tij komiteteve të përhershme të Kuvendit të Komunës, apo kryetarit të Komunës. Kuvendi i Komunës mund të tërheqë delegimin në çdo kohë.

Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, të dokumenteve fiskale dhe financiare, të planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifën dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Kuvendi i Komunës siguron kushte të punës për mbajtje të seancave të Kuvendit të Komunës, si dhe pjesëmarrje për qytetarë gjatë seancave. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe për çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që, përmes formave të ndryshme, të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Përveç këtyre akteve, Kuvendi i Komunës, kryen edhe aktivitete të tjera që janë të domosdoshme për realizimin e përgjegjësisë së saj, përfshirë edhe funksione të tjera, detyra dhe përgjegjësi të padeleguara, si:

- Vendimet që kanë të bëjnë me pronën e Komunës;
- Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal (PZHK), Planit Zhvillimor Urban (PZHU), dhe Planet Rregulluese Urbane (PRRU), si dhe ndryshimin e tyre, dhe
- Themelimin e ndërmarrjeve publike të Komunës.

Plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Rahovecit, është dokument i mbështetur në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe aktet e tjera nënligjore.

Plani është i hartuar në bazë të një kornize logjike, i cili planifikon etapat e realizimit të punëve dhe të detyrave të Kuvendit të bazuara në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti dhe aktet e tjera nënligjore.

Me këtë plan, synohet arritja e objektivave për vitin 2024, ku Kuvendi i Komunës së

Rahovecit planifikon t'i mbajë minimum 12 (dymbëdhjetë) seanca të rregullta, 6 (gjashtë) prej të cilave në gjashtëmujorin e parë dhe 6 (gjashtë) në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2024, në të cilat do të trajtohen të gjitha çështjet që janë në interes të Komunës dhe të qytetarëve të Rahovecit, e të cilat janë të proceduara sipas akteve në fuqi:

- Cakton datën e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit sipas rregullores së punës së Kuvendit;
- Planifikon shqyrtimin e raporteve të rregullta të punës së Kryetarit të Komunës sipas ligjit;
- Inkorporon planin e tubimeve me qytetarë të Kryetarit të Komunës;
- Miraton buxhetin, planet investuese, planin vjetor të prokurimit, planin vjetor të punës së Auditorit të Brendshëm, planet rregullative etj.
- Miraton çështje të tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin, sipas Statutit apo të Rregullores së punës;
- Nxjerr rregullore të reja dhe bën harmonizimin e rregulloreve ekzistuese me ligjet në fuqi;
- Inkorporon planin e kryetarit për festa shtetërore e kombëtare.
- Mbikëqyr, diskuton, analizon dhe vlerëson punën e ekzekutivit.

Përfundim

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës, do të ndihmojë dhe të lehtësojë punimet e mbledhjeve të Kuvendit, duke iu ofruar anëtarëve të Kuvendit këtë plan, ata do të kenë një pasqyrë për punët dhe aktivitetet e parapara për vitin 2024, e që kanë të bëjnë me interesat e qytetarëve.

Me planin e punës janë paraparë të mbahen 12 (dymbëdhjetë) seanca të rregullta, por sipas nevojës mund të mbahen edhe seanca të tjera, përfshirë edhe seanca të jashtëzakonshme, solemne, siç parashihet, me LVL-në dhe Statutin e Komunës.

Për përmbushjen e Programit të punës, Ekzekutivi ofron mbështetje profesionale dhe administrative organeve të Kuvendit, duke përshtatur organizimin e brendshëm për realizimin e objektivave dhe të agjendës sipas këtij plani.

Për mbarëvajtjen e zbatimit të të gjitha aktiviteteve, sipas dinamikës së përcaktuar me këtë program - plan, do të përkujdesen kryetari dhe kryesuesi i Kuvendit.

Realizimi i programit të Punës së Kuvendit kërkon bashkërenditje dhe koordinim të aktiviteteve me Ekzekutivin e Komunës, e cila duhet t'i përmbahet Planit të Kuvendit për vitin 2024.

Plani i Punës së Kuvendit, sipas dinamikës mujore, përfshin: emërtimin e aktit, propozuesin, afatin e dërgimit nga propozuesi, afatet e shqyrtimeve nga komitetet funksionale përgjegjëse për shqyrtim.

Programi i Punës së Kuvendit për vitin 2024, do të plotësohet edhe me:

- Miratimin e iniciativave për bashkëpunim ndërkomunal dhe ndërkombëtar.
- Propozime për debate dhe propozime përmbajtjesore,
- Propozime për raportime dhe informata,
- Peticione,
- Pyetje të anëtarëve të Kuvendit.

Shtojcë: *Plani i punës sipas muajve*

Plani i punë së kuvendit të komunës për vitin 2024					
JANAR	Rend dite	Organi Përgjegjës	Afati i Procedimit	Shqyrton	Miraton
	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Shqyrtimi i Raportit për realizim e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi K.K /S.K	KPF/KK	
	Shqyrtimi Raportit vjetor financiar 2023	Drejtori për Buxhet dhe Financa	Kryetari i Komunës/kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i implementimit të planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm sipas planit të veprimit për vitin 2023	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i Raportit të punës të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2023	Kryetari i Këshillit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i Raportit rreth aktiviteteve të KKS-së për vitin 2023	Anëtarët e KKS-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i Raportit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023	Kryesuesi i K. Komunitete	Kryesuesi i K.K-së	KPF/KK	
	Shqyrtimi i Raportit të punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2023	Kryesuesi i K. Për Shëndetësi	Kryesuesi i K.K-së	KPF/KK	
	Shqyrtimi i Raportit të punës së Komitetit për Arsim për vitin 2023	Kryesuesi i K. Arsim	Kryesuesi i K.K-së	KPF/KK	
	Raport mbi planin e veprimit të transparencës për vitin 2023				
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
SHKURT	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Bartja (rialokim) i buxhetit të pashpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual	Drejtori për Financa dhe Buxhet	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Zhvillimor Komunal PZHK	D. Urbanizmit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Raport nga Komiteti për Auditim të Brendshëm për vitin 2023	Kryesuesi i Komitetit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Informatë rreth Planit për Banim Social 3-vjeçar	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Informatë rreth përfundimit të gjysmëvjetorit të parë arsimor	DKA	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Informatë mbi kontratat publike të Komunës së Rahovecit	Zyra e Prokurimit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës	KPF/KK	Kuvendi

MARS	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Raport mbi menaxhimin e aseteve komunale (inventari) për vitin 2023	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari I Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Informatë mbi listën e pronave komunale dhe menaxhimi i tyre	Sektori i pronës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari I Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
PRILL	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Shqyrtimi i raportit tre mujor financiar janar - mars 2024	Drejtori për Buxhet dhe Financa	Kuvendi i Komunës/Kryetari	KPF/KK	
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Informatë mbi menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimëror				
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari I Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
MAJ	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Informatë mbi Qarkoren 1-rë të MF-së	Drejtorja për Buxhet	Kryetari I Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari I Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
QERSHOR	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2027	Ekzekutivi i Komunës	Kuvendi i Komunës/Kryetari	KPF/KK	Kuvendi
	Rishikimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2024	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi dhe miratimi i Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit	D. Urbanizmit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për gjashtë mujorin e parë të vitit 2024	Ekzekutivi komunës	Kryetari i komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Raporti i Performancës komunale për vitin 2023	Koordinatorë për performancë komunale	Kryetari i komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Informatë mbi menaxhimin e mbeturinave në komunën e Rahovecit	Dr. e Sh. Publike	KPF/KK	KPF/KK	
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari I Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi

KORRIK	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Informatë për Qarkoren e 2-të buxhetore	Anëtarët e KK-së	Anëtarët e KK-së	KPF/KK	
	Shqyrtimi i raportit financiar janar – qershor 2024	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Raport nga DKA-ja rreth përfundimit të vitit mësimor 2023/2024	Drejtori i DKA-së	Kryetari I Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Informatë nga Drejtoria e Bujqësisë	Drejtoria për bujqësi	Kryetari i komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Informatë nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale	Drejtori i DSHPS-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i Raportit të ZAP-it për vitin 2023 dhe Plani i Veprimit (Para datës 30 shtator)	ZAP	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Informatë mbi realizimin e planit për mirëmbajtjen e Hapësirave të Hapura Publike në komunën e Rahovecit	Drejtori i Shërbimeve Publike	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Informatë mbi realizimin e planit të punës së Zyrës së Prokurimit janar – qershor 2024	Zyra e Prokurimit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari I Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
GUSHT	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Informatë mbi implementimin e Planit për Investime në Hapësirat e Hapura Publike në komunën e Rahovecit	Dr. Shërbimeve Publike Dhe urbanizmi	Kuvendi i Komunës/Kryetari	KPF/KK	
	Informatë mbi implementimin e Planit për Menaxhimin e Mbeturinave në komunën e Rahovecit	Dr. Shërbimeve Publike	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal Vizitë studimore me kuvendarë jashtë territorit të Republikës së Kosovës	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari I Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi

SHTATOR	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Shqyrtimi dhe miratimi i Buxhetit të Komunës për vitin 2025	Drejtori për Buxhet dhe Financa	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për tatimin në pronë	Drejtori për Buxhet dhe Financa	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Informatë për përgatitjen e viti shkollor 2024/2025	Drejtori i DKA-së	Kuvendi i Komunës/Kryetari	KPF/KK	
	Informatë rreth muajit të mërgimtarëve për vitin 2024	D. e Kulturës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
TETOR	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Shqyrtimi i Raportit financiare për periudhën janar – shtator 2024	Drejtori i Financave dhe Buxhet	Kuvendi i Komunës/Kryetari	KPF/KK	
	Shqyrtimi i Planit për menaxhim të mbeturinave	Drejtorja e shërbimeve publike	Kryetari i komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari I Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendit
NËNTOR	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Raport për punën e bujqve të komunës së Rahovecit				
	Shqyrtimi i informatave mbi çështje të caktuara sipas kërkesave të anëtarëve të Kuvendit	Anëtarët e KK-së	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i propozim vendimeve dhe rregulloreve nga ekzekutivi komunal	Ekzekutivi i Komunës	Kryetari I Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
DHJETOR	Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar	Zyra e Kuvendit	Kryesuesi i KK-së	KPF/KK	Kuvendi
	Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve	Anëtarët e Kuvendit	Anëtarët e Kuvendit	Ekzekutivi	
	Raporti mbi realizimin e Planit për vitin 2024 si dhe informatë mbi Planin vjetor të prokurimit publik 2025	Zyra e Prokurimit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Shqyrtimi i Raportit të punës së Ekzekutivit për vitin 2024				
	Informatë mbi Planin e punës të kryetari të komunës për vitin 2025	Zyra e Kryetarit	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	Kuvendi
	Shqyrtimi dhe miratimi i Plantit të punë së kuvendit komunal për vitin 2025	Zyra e Kuvendit	Kryetari i komunës/Kuvendi	KPF/KK	kuvendi
	Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2025	Kryetari i Komunës	Kryetari i Komunës/Kuvendi	KPF/KK	
	Raportimi I Planit të Integritetit për Komunën e Rahovecit	Kryetari i Komunës	Zyrtari përgjegjës	KPF/KK	
	Zgjedhja e kuvendarit/es më të mirë për vitin 2024	K. Kuvendit/Z.K	K. Kuvendit	KPF/KK	Kuvendi

01 Nr. 165/23
Rahovec, 27.12.2023

Kryesuesi i Kuvendit

Arbër Zenuni



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



PLANI I PUNËS I KRYETARIT TË KOMUNËS DHE I QEVERISË KOMUNALE 2024



PËRMBAJTJA

HYRJE.....2

ZOTIMET2

PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISËS2

PRIORITETET PËR VITIN 20242

SYNIMET PËR VITIN 20243

SFIDAT KRYESORE PËR VITIN 20244

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS - PLANET E PUNËS 20244

Drejtoria për Administratë.....13

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale13

Drejtoria për Arsim13

Drejtoria për Buxhet dhe Financa14

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit14

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm15

Drejtoria për Shërbime Publike.....15

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.....16

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë16

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.....17

Drejtoria për Punë Inspektuese17

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim.....19

PËRFUNDIM.....20

HYRJE

Komuna e Rahovecit dhe Qeveria Komunale, prezanton planin e saj qeverisës për vitin 2024, duke e bërë një studim të detajuar të të arriturve, por edhe e nevojave dhe e pritjeve të qytetarëve nga Komuna e Rahovecit për të ardhmen.

Plani që po paraqesim është sfidues dhe është pjesë e procesit të përmirësimit të kushteve të punës e të jetës për qytetarët e Rahovecit, e që duhet të zbatohet në praktikë. Megjithatë, për zbatimin e këtij plani, kërkohet ndërmarrja e një seri masash dhe veprimesh konkrete në terren, duke u konsultuar vazhdimisht me ekspertë të fushave të ndryshme dhe profesionistë të dëshmuar. Bazuar në përvojën tonë pozitive për qytetarët e komunës së Rahovecit, mund të konstatojmë se ekzistojnë parakushtet për zbatim efikas të këtij plani.

ZOTIMET

- Komunë e hapur për qytetarët, transparencë e plotë dhe llogaridhënie;
- Komunë që qeveriset drejt dhe mirë, ligjshëm dhe me performancë të lartë;
- Komunë që u shërben qytetarëve pa dallim;
- Komunë me shërbime gjithnjë e më bashkëkohore;
- Komunë ku promovohen politikat dhe praktikat më të mira, si dhe standardet e larta të qeverisjes;
- Komunë ku respektohen vlerat njerëzore e qytetare;
- Komunë pa diskriminim, e që qytetarët i trajton barabartë;
- Komunë ku respektohen vlerat kombëtare, historike, vlerat e luftës dhe të lirisë;
- Komunë që nderon sakrificën dhe gjakun e derdhur për liri;
- Komunë që trajton dhe mbështet qytetarët që kanë nevoja të veçanta;
- Komunë që nderon, promovon e i jep përkrahje traditës, trashëgimisë dhe gjithë pasurisë sonë të përbashkët, gjithë asaj që është vlerë dhe identitet i Rahovecit;
- Komunë ku përfaqësohet, mbrohet dhe punohet për interesin publik;
- Komunë ku përkushtimi për të vepruar ndershëm dhe në pajtim me ligjin, veçse vullnet, përcaktim i të zgjedhurve, jetësohet edhe si detyrim moral ndaj zgjedhësve si dhe ndaj ligjit;
- Komunë ku respektohet mozaiku i vlerave njerëzore, demokratike, kulturore, të trashëgimisë e të besimit në Zot;
- Komunë ku respektohen pakicat dhe promovohen vlerat e tyre.

PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISËS

- Bujqësia;
- Ekonomia, agroturizmi dhe punësimi;
- Administratë bashkëkohore me shërbime të shpejta dhe cilësore;
- Arsimi, shëndetësia dhe përkujdesja sociale;
- Infrastrukturë publike të rregulluar dhe të mirëmbajtur;
- Investime nga fondi i eficiencës së energjisë në sektorin publik dhe privat;
- Investime në infrastrukturë kulturore, sportive dhe hapësira për të rinjtë si dhe rritja e përkrahjes për këta sektorë;
- Promovimi i potencialit dhe i mundësive për investime nga mërgata jonë;
- Trashëgimia kulturore, historike dhe investime për ta nderuar hartën e sakrificës dhe të lirisë.

PRIORITETET PËR VITIN 2024

- Sheshi Qendror i Qytetit;
- Ndërtimi i Qendrës për Kulturë, Rini, Art dhe Inovacion;
- Funksionalizimi i Shtëpisë për të Moshuar;
- Funksionalizim, mirëmbajtje dhe menaxhim të Maja e Shkodranit;
- Mirëmbajtje dhe menaxhim i vlerave kombëtare historike dhe të luftës çlirimtare |(komplekset përkujtimore, muzetë, monumentet e trashëgimisë kulturore historike, lapidarët, varrezat e dëshmorëve dhe të martirëve etj.
- Edukim dinjitoz i brezave të rinj, duke iu ofruar mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore bashkëkohore, mjedis të përshtatshëm mësimor me infrastrukturë adekuate dhe gjithëpërfshirëse;
- Përmirësim i infrastrukturës së institucioneve shkollore
- Bursa për studentë;

- Bibliotekat – kujdes i shtuar për bibliotekat, duke u përkujdesur për blerjen e titujve të rinj, por edhe duke i mirëmbajtur dhe investuar në objektet e bibliotekave ekzistuese;
- Laboratorë dhe kabinete – do të investojmë në zhvillimin dhe krijimin e laboratorëve të rinj për shkencat natyrore dhe në kabinete;
- Përkrahje e fermerëve me serra, inpute bujqësore dhe farëra;
- Rrugë fushore;
- Përkrahje për pikat grumbulluese të qumështit;
- Kanale të kullimit të tokave bujqësore;
- Shërbime veterinarë periodike, falas;
- Konsulencë dhe hartim të projekteve falas për bujq dhe biznese;
- Ndërtim i rrugëve të reja dhe mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese;
- Në bashkëpunim me KEDS-in, angazhim për furnizim stabil me energji, ndërrim i rrjetit, i shtyllave, instalime nëntokësore etj.;
- Bashkëpunim me KRU “Gjakova” dhe donatorë të tjerë për furnizim më të mirë me ujë të pijshëm;
- Efienca e energjisë në objekte publike dhe në sektorin privat, përmes fondit të EE dhe të mileniumit;
- Mirëmbajtje e rregullt e hapësirave publike, e objekteve publike dhe e të gjitha llojeve të investimeve publike në komunën e Rahovecit;
- Legalizimi i parkingjeve ekzistuese dhe krijimi i parkingjeve të reja;
- Rregullimi i mëtejshëm i infrastrukturës për persona me nevojë të veçanta;
- Investime të tjera në kanalizimin e ujërave të zeza dhe në disa rrugë në pjesë problematike të qytetit;
- Mjedisë të bukura dhe hapësira për të rinjtë;
- Kënde lojërash për fëmijë;
- Rritje e numrit dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes menaxhimit sa më të mirë dhe profesional.
- Rritje e përkrahjes në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit, përmes përkrahjes së të rinjve, shoqatave kulturoro-artistike dhe klubeve sportive;
- Rritje e subvencionimit për projekte kulturoro-artistike dhe sportive, që janë në interes të komunitetit;
- Vazhdim i zbatimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal për komunën e Rahovecit 2021-2025;
- Përkrahje dhe lehtësira për prodhuesit, tregtinë, zejet e veçanta, artizanalet, etj.;
- Trajtim dhe rregullim i shtretërve të lumenjve dhe përrenjve;
- HZK - do të miratohet Harta Zonale e komunës, pas shqyrtimit publik;
- Rritja e kapaciteteve inspektuese për mbrojtjen e mjedisit, për të parandaluar e mbrojtur nga ndotësit e shkatërruesit e tij, me shqiptim të gjobave mandatore;
- Investim në Stacionin e Autobusëve në Rahovec, faza e dytë - instalimi i kabinave inovative në stacionet e pritjes, në qytet dhe fshatra;
- Administratë efikase, e përgjegjshme dhe me shërbime moderne,
- Qeverisje energjike, vepruese dhe vendimmarrje pa vonesë,
- Realizim i suksesshëm i projekteve dhe i buxhetit,
- Realizim i planit të të hyrave komunale,
- Promovimi dhe përmirësimi i mjedisit të Rahovecit si qytet lider për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve ekzistuese, zgjerimin e tyre si dhe për ato të reja;
- Bashkëpunim i mirë me donatorët e jashtëm,
- Komunikim dhe bashkëpunim me OJQ - të.

SYNIME PËR VITIN 2024

- Bujqësi të përkrahur;
- Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore;
- Intervenimi në ndërtimin e kanaleve të kullimit dhe drenazhimit të tokave bujqësore;
- Në bashkëpunim me donatorët do të anagazhohemi për zgjerimin e sistemit të ujitjes në pjesët ku mungon;
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e përrenjve;
- Barna esenciale për qytetarët në nevojë nga buxheti i komunës;
- Investime në rritjen e cilësisë së shërbimeve, zgjerimin e tyre, pajisje mjekësore dhe inventarizim për QKMF-në dhe rrjetin e shërbimeve parësore shëndetësore;
- Arsim cilësor dhe biblioteka, pajisje bashkëkohore, laboratorë, më shumë teknologji informative dhe mjete konkretizimi në shkolla;
- Hartimi i planeve specifike komunale;

- Zhvillim ekonomik dhe punësim nëpërmjet fuqizimit dhe mbështetjes së sektorit privat;
- Investime për zhvillimin e planifikuar të agroturizmit;
- Rritjen e të hyrave vetanake përmes lëshimit të lejeve ndërtimore, procesit të legalizimit dhe lejeve mjedisore komunale;
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit dhe me Drejtorinë për Punë inspektuese, legalizimi i objekteve pa leje dhe respektimi i ligjit të ri për trajtimin e objekteve pa leje;
- Mbikëqyrje aktive dhe rritje e cilësisë në investimet publike;
- Vazhdimi i evidentimit dhe lirimit të pronave të uzurpuara;
- Dyfishim i përpjekjeve për mbrojtje të mjedisit, mbrojtjen e tokave bujqësore, mbrojtjen e pronës publike, parandalimi i ndërtimeve pa leje;
- Planifikimi i masave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, në rast të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera;
- Projekte me partneritet publiko-privat;
- Hartimi i planeve, nxjerrja e akteve dhe i rregulloreve të tjera;
- Zhvillimi i Rahovecit në përputhje me planet zhvillimore komunale dhe menaxhimi i burimeve fizike bazuar mbi parimet e shëndosha mjedisore si dhe mbi parimet e partneritetit me mekanizma vendor e ndërkombëtar, për realizimin e vizionit për komunë model me një qeverisje cilësore, efikase dhe llogaridhënëse;
- Vazhdimin e trajtimit të shtretërve të lumenjve dhe të përrenjve, përmes investimeve kapitale nga komuna e Rahovecit dhe mbështetjes nga Qeveria e Kosovës, me qëllim të mbrojtjes nga vërshimet dhe ruajtjen e mjedisit.

SFIDAT KRYESORE PËR VITIN 2024

- Buxheti i ulët i Qeverisë së Kosovës, mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare nga qeveria qendrore, si trend i vazhdueshëm në Kosovë, që i bën investimet edhe më të vështira (angazhime të shtuara në kërkesa nga qeveria qendrore);
- Integrimi i sa më shumë qytetarëve dhe thellimi i bashkëpunimit të ngushtë me organizatat joqeveritare (OJQ-të), bizneset, zanatlinjtë, tregtarët, bujqit, shoqërinë civile etj.;
- Mungesa e hapësirave publike në territorin e komunës së Rahovecit;
- Mungesa e burimeve të nevojshme njerëzore dhe profesionale;
- Përfshirja më e madhe e qytetarëve tanë në aktivitetet tona dhe duke i mbajtur ata të informuar për zhvillimet në komunën tonë.

Plani Vjetor i Punës, siç është paraqitur më poshtë, përkufizon synimin me qëllim të realizimit të objektivave të përcaktuara, si dhe njëkohësisht liston të gjithë zyrtarët përgjegjës për mbarëvajtjen e punëve për secilën pikë. Personat përgjegjës obligohen që për çfarëdo shtyrje eventuale të afatit kohor të përfundimit të punëve, apo mospërmbytje të tij, të raportojnë me shkrim te kryetari i Komunës. Ndryshimet eventuale, për arsye kuptimplota apo të faktorëve të jashtëm, do të harmonizohen me kryetarin e Komunës, si dhe ekipin përgjegjës për realizimin e tërësishëm të këtij plani.

Pjesë përbërëse e planit të punës së ekzekutivit komunal për vitin 2024, do të jenë planet e punës të të gjitha drejtorive komunale në komunën e Rahovecit, si dhe të njësive të cilat veprojnë në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit.

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS - PLANET E PUNËS 2024

Zyra Ligjore

Ofrimi i këshillave juridike të rregullta për organet komunale dhe trupave të formuara nga organet komunale, Kryetarin e Komunës, Kuvendin Komunal, drejtorët e Drejtorive, Komiteteve, Zyrës së Prokurimit, komisioneve etj.)

1. Harton (përpilon) vendime, aktvendime, pëlqime, urdhëresa, memorandume mirëkuptimi, kontrata, marrëveshje, leje pune, leje ndërtimi dhe shkresa të tjera për organet komunale dhe trupat e formuara nga organet komunale.
2. Hartimi i Rregulloreve dhe i Planeve Komunale me kërkesë të Kryetarit apo të drejtorive përkatëse.
3. Pjesëmarrja e rregullt në seancat e Kuvendit të Komunës së Rahovecit.
4. Pjesëmarrja në Komisionet e ndryshme të formuara nga Kryetari i Komunës për çështjet e caktuara.

Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit

1. Mbajtja e nivelit të efektivitetit të shërbimeve të Njesisë së Personelit.
2. Implementimi i ndryshimeve të reja ligjore (ligjit të ri Nr.08/L-197, si dhe rregulloreve përkatëse) në fushën e resurseve njerëzore.
3. Implementimi dhe menaxhimi me programin HRMIS (përshtatja me ndryshimin e ligjit të ri sa u përket konkurseve, përgatitja e sallës së mbajtjes së testit me shkrim në lokacionet e Komunës për kandidatët që do të pranohen në punë).
4. Monitorimi i prezencës së punëtorëve në punë.
5. Përkujdesja për pajisjen e punëtorëve me kartela identifikimi.
6. Menaxhimi efikas me dosjet e personelit.

Zyra e Prokurimit

Plani i punës së Zyrës së Prokurimit është i ndikuar nga planet e punës së drejtorive komunale. Përmes këtij plani, synim i Zyrës së Prokurimit është që të kryejë të gjitha veprimet me kohë, pa vonesa, duke u bazuar në planifikimet e drejtorive komunale për projektet kapitale dhe në pajtim me ligjin e prokurimit publik.

Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura

Nr.	Përshkrimi i objektivave të punës	Plani i veprimit	Bartësit e aktivitetit	Afati
1.	Seancat gjyqësore	Mirëmbajtja e regjistrit elektronik të seancave të caktuara; Pjesëmarrja në seancat gjyqësore sipas ftesave të pranuar nga gjykata; Përgatitja e lëndës për të marrë pjesë në seancë gjyqësore; Përgatitja paraprake e materialit për mbrojtje dhe përpunimi i provave materiale për dorëzim.	Përfaqësuesi i autorizuar / zyrtari ligjor	Janar-dhjetor
2.	Përgatitja për seancat gjyqësore	Analizimi i lëndës, konsultimi i bazës ligjore; Sigurimi i të dhënave dhe dokumentacionit nga drejtoritë përkatëse; Përgatitja e materialit provues për mbrojtje; Përgatitja e mbrojtjes me shkrim.	Përfaqësuesi i autorizuar	Janar-dhjetor
3.	Ushtrimi i mjeteve të rregullta juridike	Kujdesi ndaj afateve ligjore dhe gjyqësore; Sigurimi i mbështjetjes dhe informacioneve të bazuara; Fotokopjimi, përpunimi dhe bashkëngjitja e provave materiale; Ushtrimi i mjeteve të rregullta juridike të bazuara në prova dhe gjendjen faktike.	Përfaqësuesi i autorizuar	Janar-dhjetor
4.	Ushtrimi i mjeteve të jashtëzakonshme juridike	Kujdesi ndaj afateve ligjore dhe gjyqësore; Sigurimi i mbështjetjes dhe informacioneve të bazuara; Fotokopjimi, përpunimi dhe bashkëngjitja e provave materiale; Ushtrimi i mjeteve të rregullta juridike të bazuara në prova dhe gjendjen faktike.	Përfaqësuesi i autorizuar	Janar-dhjetor
5.	Ushtrimi i mjeteve të rregullta në procedurë përmbartimore	Kujdesi ndaj afateve ligjore dhe gjyqësore; Sigurimi i mbështjetjes dhe informacioneve të bazuara; Fotokopjimi, përpunimi dhe bashkëngjitja e provave materiale; Ushtrimi i mjeteve të rregullta juridike të bazuara në prova dhe gjendjen faktike.	Përfaqësuesi i autorizuar	Janar-dhjetor
6.	Takime konsultuese dhe informuese me Kryetarin e Komunës	Konsultime të rregullta mbi bazën e përgjegjësisë; Takime informuese për lëndë dhe procedurën e caktuar.	Përfaqësuesi i autorizuar	Janar-dhjetor

7.	Këshillimi	Përgatitja e këshillave ligjore, të rekomandimeve, të udhëzimeve dhe të opinioneve brenda fushëveprimit të Komunës dhe me kërkesë të drejtorive apo të organeve të Komunës	Përfaqësuesi i autorizuar	Janar-dhjetor
8.	Mbajtja e regjistrave të lëndëve	Regjistrimi i lëndëve të reja; Bartja e evidencave dhe e shënimeve për lëndë të caktuara; Çregjistrimi i lëndëve, Bartja e regjistrave, e lëndëve aktive në regjistër të vitit vijues etj.	Përfaqësuesi i autorizuar / zyrtari ligjor	Janar-dhjetor
9.	Pranim/dorëzimi i shkresave dhe klasifikimi	Pranimi i shkresave gjyqësore, etj.; Regjistrimi i shkresave; Vendosja e shkresave në lëndë të referuara.	Përfaqësuesi i autorizuar / zyrtari ligjor	Janar-dhjetor
10.	Pranimi i ftesave për seanca gjyqësore	Pranimi dhe regjistrimi i ftesave për seanca; Përgatitja e lëndës për seancë.	Përfaqësuesi i autorizuar / zyrtari ligjor	Janar-dhjetor
11.	Punë të daktilografimit	Përgatit parashtresa të ndryshme; Shkruan sipas diktimit të Avokatit; Përgatit shkresat bashkëngjitur provave.	Përfaqësuesi i autorizuar / zyrtari ligjor	Janar-dhjetor
12.	Evidenca për punë, lëndë në procedurë dhe të kryera	Mbajtja e evidencave të lëndëve në punë; Mbajtja e evidencave për lëndë të kryera.	Përfaqësuesi i autorizuar / zyrtari ligjor	Janar-dhjetor
13.	Shënime dhe të dhëna statistikore	Mbajtja e shënimeve statistikore për të gjitha lëndët; Nxjerrja e të dhënave statistikore të përgjithshme për punën e Zyrës së Përfaqësimeve.	Përfaqësuesi i autorizuar / zyrtari ligjor	Janar-dhjetor
14.	Parashtrimi i kërkesave për furnizim	Planifikimi i furnizimit të zyrës me material administrativ; Parashtrimi i kërkesave.	Përfaqësuesi i autorizuar / zyrtari ligjor	Janar-dhjetor

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

Nr.	Muaji	Aktiviteti	Realizimi
1	Janar		
1.1.		Publikimi në ueb-faqe i vendimeve të kryetarit	
1.2.		Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL	
1.3.		Publikimi i Planit të Punës së Komunës për vitin 2024	
1.4.		Publikimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024	
1.5.		Publikimi i raportit vjetor financiar (janar-dhjetor 2023)	
1.6.		Publikimi i lajmeve, i njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, të drejtorëve dhe të KK-së	
1.7.		Publikimi i njoftimeve për mbajtjen e konsultimeve dhe të takimeve publike	
1.8.		Publikimi i raportit për organizimin e konsultimeve publike	
1.9.		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe të KK-së	
1.10.		Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSBS-së	
1.11.		Publikimi i njoftimit për “Flakën e Janarit”	
1.12.		Publikimi i rregulloreve, planeve dhe strategjive pas marrjes së miratimit nga MAPL, në ueb-faqe	
1.13.		Publikimi i raportit për Qasje në Dokumente Publike	
1.14.		Publikimi i raporteve mujore financiare	
2	Shkurt		
2.1.		Publikimi në ueb-faqe i vendimeve të kryetarit	
2.2.		Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL	
2.3.		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e konsultimeve dhe të takimeve publike	
2.4.		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe të KK-së	
2.5.		Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSBS-së	
2.6.		Publikimi i lajmeve, i njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, të drejtorëve dhe të KK-së	
2.7.		Publikimi i rregulloreve-planeve dhe i strategjive pas marrjes së miratimit nga MAPL-ja, në ueb-faqe	
2.8.		Publikimi i raporteve mujore financiare	
2.9.		Përgatitja dhe publikimi i njoftimit për 17 Shkurtin - Ditën e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës	
3.	Mars		
3.1.		Publikimi në ueb-faqe i vendimeve të kryetarit	
3.2.		Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL	
3.3.		Publikimi i njoftimit për ditët përkujtimore të marsit.	
3.4.		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe të Kuvendit Komunal	
3.5.		Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSBS-së	
3.6.		Publikimi i lajmeve, i njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, të drejtorëve dhe të Zyrës së Kuvendit Komunal	
3.7.		Publikimi i rregulloreve, i planeve dhe i strategjive, pas marrjes së miratimit nga MAPL-ja, në ueb-faqe	
3.8.		Publikimi i raporteve mujore financiare	
3.9.		Publikimi i njoftimeve - lajmeve për mbajtjen e konsultimeve dhe të takimeve publike	
4.	Prill		
4.1.		Publikimi në ueb-faqe i vendimeve të kryetarit	

4.2.		Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL	
4.3.		Publikimi i raporteve mujore financiare	
4.4.		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e konsultimeve dhe të takimeve publike	
4.5.		Publikimi i raportit 3-mujor financiar (janar-mars)	
4.6.		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe të KK-së	
4.7.		Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSBB-së	
4.8.		Publikimi i lajmeve, i njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, të drejtorëve dhe të KK-së	
4.9.		Publikimi i rregulloreve-planeve dhe i strategjive, pas marrjes së miratimit nga MAPL-ja, në ueb-faqe	
5.	Maj		
5.1.		Publikimi në ueb-faqe i vendimeve të kryetarit	
5.2.		Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL	
5.3.		Publikimi i raporteve mujore financiare	
5.4.		Përgatitja dhe publikimi i njoftimit për fillimin e Festivalit “Anadrinia Jehon”	
5.5.		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe të Kuvendit Komunal	
5.6.		Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSBB-së	
5.7.		Publikimi i lajmeve, i njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, të drejtorëve dhe të Zyrës së Kuvendit Komunal	
5.8.		Publikimi i rregulloreve, i planeve dhe i strategjive, pas marrjes së miratimit nga MAPL-ja, në ueb-faqe	
5.9.		Publikimi i njoftimeve - lajmeve për mbajtjen e konsultimeve dhe të takimeve publike	
6.	Qershor		
6.1.		Publikimi në ueb-faqe i vendimeve të kryetarit	
6.2.		Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL	
6.3.		Publikimi i njoftimit dhe i lajmit për mbajtjen e takimit të parë të punës 6-mujore të kryetarit të komunës	
6.4.		Publikimi i raporteve mujore financiare	
6.5.		Përgatitja dhe publikimi i njoftimit për 14 Qershorin - Ditën e Çlirimit të Rahovecit	
6.6.		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe të KK-së	
6.7.		Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSBB-së	
6.8.		Publikimi i lajmeve, i njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, të drejtorëve dhe të KK-së	
6.9.		Publikimi i rregulloreve, i planeve dhe i strategjive, pas miratimit nga MAPL-ja, në ueb-faqe	
6.10.		Publikimi i raportit 6-mujor për qasje në dokumente publike	
6.11.		Publikimi i raportit të punës së kryetarit për 6-mujorin e parë të vitit 2024	
6.12.		Publikimi i njoftimit për mbajtjen e konsultimit publik me qytetarë për projekt-buxhetin e Komunës - KAB-in	
6.13.		Publikimi i raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2024	
6.14.		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e konsultimeve dhe të takimeve publike	
7.	Korrik		
7.1.		Publikimi në ueb-faqe i vendimeve të kryetarit	
7.2.		Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL	
7.3.		Raporti 6-mujor financiar (janar-qershor 2024)	
7.4.		Publikimi i raporteve mujore financiare	
7.5.		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e konsultimeve dhe të takimeve publike	
7.6.		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe të KK-së	
7.7.		Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSBB-së	
7.8.		Publikimi i lajmeve, i njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, të drejtorëve dhe të KK-së	
7.9.		Organizimi dhe publikimi i kalendarit për dëgjimet buxhetore	
8.	Gusht		
8.1.		Publikimi në ueb-faqe i vendimeve të kryetarit	
8.2.		Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL	
8.3.		Publikimi i kalendarit për organizimin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2025	
8.4.		Publikimi i raporteve mujore financiare	
8.5.		Publikimi i njoftimeve - lajmeve për mbajtjen e konsultimeve dhe të takimeve publike	
8.6.		Publikimi i njoftimeve - lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe të Kuvendit Komunal	
8.7.		Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSBB-së	
8.8.		Publikimi i lajmeve, i njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, të drejtorëve dhe të Zyrës së Kuvendit Komunal	
8.9.		Publikimi i rregulloreve, i planeve dhe i strategjive, pas marrjes së miratimit nga MAPL-ja, në ueb-faqe	
9.	Shtator		
9.1.		Publikimi në ueb-faqe i vendimeve të kryetarit	
9.2.		Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL	
9.3.		Publikimi i raporteve mujore financiare	
9.4.		Publikimi i njoftimeve - lajmeve për mbajtjen e konsultimeve dhe të takimeve publike	
9.5.		Publikimi i njoftimeve - lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe të KK-së	
9.6.		Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSBB-së	
9.7.		Publikimi i lajmeve, i njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, të drejtorëve dhe të Zyrës së Kuvendit Komunal	
9.8.		Publikimi i rregulloreve, i planeve dhe i strategjive - pas marrjes së miratimit nga MAPL-ja, në ueb-faqe	

9.9.		Publikimi i raportit të Performancës komunale për vitin 2023 (Nëse përgatitet nga MAPL-ja)	
9.10.		Publikimi i njoftimit për dëgjime buxhetore nga ana e KPF-së	
10.	Tetor		
10.1.		Publikimi në ueb-faqe i vendimeve të kryetarit	
10.2.		Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL	
10.3.		Publikimi i raporteve mujore financiare	
10.4.		Publikimi i raportit 9-mujor financiar (janar-shtator 2024)	
10.5.		Publikimi i njoftimeve - lajmeve për mbajtjen e konsultimeve dhe të takimeve publike	
10.6.		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe të Kuvendit Komunal	
10.7.		Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSBB-së	
10.8.		Publikimi i lajmeve, i njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, të drejtorëve dhe të Zyrës së Kuvendit Komunal	
10.9.		Publikimi i rregulloreve, i planeve dhe i strategjive - pas marrjes së miratimit nga MAPL-ja, në ueb-faqe	
11.	Nëntor		
11.1.		Publikimi në ueb-faqe i vendimeve të kryetarit	
11.2.		Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL	
11.3.		Publikimi i njoftimeve - lajmeve për mbajtjen e konsultimeve dhe të takimeve publike	
11.4.		Publikimi i njoftimeve-lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe të Kuvendit Komunal	
11.5.		Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSBB-së	
11.6.		Publikimi i lajmeve, i njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, të drejtorëve dhe të Zyrës së Kuvendit Komunal	
11.7.		Publikimi i rregulloreve, i planeve dhe strategjive, pas marrjes së miratimit nga MAPL-ja, në ueb-faqe	
11.8.		Përgatitja dhe publikimi i njoftimit për festat e Nëntorit	
12.	Dhjetor		
12.1.		Publikimi në ueb-faqe i vendimeve të kryetarit	
12.2.		Dërgimi i vendimeve të kryetarit në MAPL	
12.3.		Publikimi i njoftimeve - lajmeve për mbajtjen e konsultimeve dhe të takimeve publike	
12.4.		Publikimi i njoftimeve - lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të KPF-së dhe të Kuvendit Komunal	
12.5.		Përgatitja e njoftimit për mbajtjen e mbledhjes së KKSBB-së	
12.6.		Publikimi i lajmeve, i njoftimeve për aktivitetet e kryetarit, të drejtorëve dhe të Zyrës së Kuvendit Komunal	
12.7.		Publikimi i rregulloreve, i planeve dhe i strategjive, pas marrjes së miratimit nga MAPL-ja, në ueb-faqe	
12.8.		Publikimi i raportit për qasje në dokumente publike	
12.9.		Publikimi i Planit të Punës së Zyrës për Informim për vitin 2025	

Zyra e Auditimit të Brendshëm

Nr.	Objektivi/detyra e punës	Aktiviteti	Periodha e planifikuar e aktivitetit 2024
1	Detyra audituese: Rishikimi periodik dhe vjetor i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e Auditorit të Brendshëm.	1.1. Përgatitja e auditimit dhe caktimi i fushëveprimit; 1.2. Rishikimi dhe vlerësimi i proceseve (puna në terren); 1.3. Raportimi te Kryetari i Komunës dhe njësitë e audituara.	janar, dhjetor 2024
2	Detyra audituese (auditimet) Për vitin 2024, kemi paraparë pesë (5) detyra audituese (auditime) me qëllim të përcaktimit nëse veprimet dhe rezultatet e proceseve të audituara, janë në pajtim me ligjet, udhëzimet dhe rregulloret përkatëse.	2.1. Planifikimi dhe përgatitja e secilit auditim sipas metodologjisë së auditimit, të përcaktuar nga Ministria e Financave; 2.2. Auditimi dhe vlerësimi i proceseve (puna në terren) për secilën detyrë audituese; 2.3. Monitorimi i punës së stafit të njësisë për detyrat audituese të caktuara - vlen nëse ka staf në njësi; 2.4. Përgatitja e raporteve për detyrat audituese dhe raportimi te Kryetari i Komunës dhe njësitë e audituara.	detyra audituese - 1 mars - prill detyra audituese - 2 maj-qershor detyra audituese - 3 qershor - korrik detyra audituese -4 shtator - tetor detyra audituese - 5 nëntor - dhjetor
3	Raportimi periodik dhe vjetor për: Kryetarin e Komunës, Komitetin e Auditimit dhe Njësinë Qendrore Harmonizuese në Ministrinë e Financave.	3.1. Përgatitja dhe dorëzimi i raportit përmbledhës për periudhën janar-qershor (raporti gjashtëmujor i 1-rë). 3.2. Përgatitja dhe dorëzimi i raportit përmbledhës për periudhën korrik-dhjetor (gjashtëmujori i 2-të). 3.3. Përgatitja dhe dorëzimi i raportit përmbledhës vjetor (janar-dhjetor).	Koha e raportimit: 1-15 korrik 2024 1-15 janar 2025 30 janar 2025

4	Përgatitja e planit strategjik për NjAB për vitin 2024-2026 dhe planit vjetor të punës për vitin 2025.	4.1 Përgatitja e planit nga ekipi i NjAB-ës 4.2 Dërgimi i planit për shqyrtimi nga Kryetari i Komunës dhe Komiteti i Auditimit; 4.3 Procesi i miratimi të planit nga Kryetari dhe Komiteti i Auditimit, dërgimi i planit të miratuara në NJQH/AB në Ministrin e Financave.	dhjetor 2024
5	Bashkërendimi i aktiviteteve me NJQHAB/MF, detyrat e këshillëdhënies.	5.1 Detyrat këshilluese me zyrtarë dhe menaxhmentin e lartë për proceset të cilat i mbulon auditimi i brendshëm.	gjatë vitit 2024

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

Nr.	Përshkrimi i punëve dhe i detyrave të punës	PERIUDHA KOHORE (Muaji) E REALIZIMIT													VËREJTJE
		I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	TOTAL:	
1	Takime të rregullta me stafin	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	24 TAKIME.	
2	Takime të rregullta me Kryetarin e Komunës (mbledhja e bordit)	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	48 TAKIME ME MUNDËSI SHITESË SIPAS NEVOJËS.	
3	Takimet me Komisionin për Kthim të Komuniteteve													6 TAKIME TË OBLIGUESHME.	
4	Monitorimi dhe realizimi i projekteve për të kthyerit													VARËSISHT NGA NEVOJA.	
5	Vizita në Kampet (e Maqedonisë, Malit të Zi, Serbisë) ku jetojnë të zhvendosurit e komunës së Rahovecit					X				X				2 VIZITA ZYRTARE. 2 ZVANIČNE POSETE	Varësisht nga kërkesat për kthim.
6	Implementimi i Planit Lokal të Veprimit për përfshirjen e komunitetit Rom dhe Ashkali 2023-2025.													GJATË TËRË VITIT.	
7	Implementimi i Planit Lokal për Personat e Riatdhesuar dhe kthim të Qëndrueshëm 2022-2025													GJATË TËRË VITIT.	
8	Takimet me përfaqësuesit e komuniteteve nëpër të gjitha lokacionet.		X				X		X					3 TAKIME KONSULTATIVE VARËSISHT NGA NEVOJA.	
9	Monitorimi dhe realizimi i projekteve për komunitete														VARËSISHT NGA PROJEKTET NË REALIZIM.
11	Takimet me OJQ dhe OQ	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	GJATË TËRË VITIT. TOKOM ČELE GODINE	
12	Takimet me Policinë e Kosovës dhe KFOR-in	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	2 TAKIME KONSULTATIVE.	
13		X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X		VARËSISHT NGA

14	Pjesëmarrja në takime të Komisionit Komunal për Riatdhesim					X		VARËSISHT NGA RASTET E KTHIMIT.			
15	Bashkëpunim me Ministrinë për Kthim dhe Komunitete dhe Ministrinë e tjera të Linjës.	X	X	X	X	X	X	X	X	I VAZHDUESHËM GJATË TËRË VITIT.	
16	Përgatitja dhe dalja me Raport mbi gjendjen e komuniteteve joshumicë në komunën e Rahovecit.						X			1 HERË NË VIT.	
17.	Manifestimi i ditëve memoriale të komuniteteve në Komunën e Rahovecit.		X		X		X			MANIFESTIMI I DITËVE TË KOMUNITETIT ROM, ASHKALI, EGJIPTIAN.	
18.	Fushatë /Kampanjë për regjistrim me kohë në shkollë									QERSHOR 2024.	
19.	Bashkëpunim me drejtori të tjera në Komunë.	X	X	X	X	X	X	X	X	GJATE TËRË VITIT.	

20.	Takimi 2 herë në vit mbi gjendjen e komunitetit SERB në HOÇË TË MADHE.										
21.	Hartimi i Buxheti, planifikimi dhe propozimi në Komunë.				X		X			PROPOZIMI I BUXHETIT NË AFATET KOHORE.	
22.	Krijimi i data-bazës me gjendjen në bujqësi, shëndetësi, arsim, banim dhe gjendjes sociale ndaj komuniteteve.	X	X	X	X	X	X	X	X	PËRDITËSIMI I INFORMATAVE NË MENYRË TË VAZHDUESHME.	
23.	Promovimi i aktiviteteve që kanë të bëjnë me fëmijët dhe barazinë gjinore te pjesëtarët e komuniteteve.		X	X	X	X	X	X	X	GJATE TËRË VITIT.	

Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut

Objektivat	Aktiviteti	Aktorët përgjegjës	Rezultatet	Afati kohor	Burimet financiare
Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut në Komunë bëhet konform kornizës ligjore për të drejtat e njeriut.	Organizimi i fushatave sensibilizuese për të drejtat e njeriut, përgatitja, publikimi i doracakëve dhe i broshurave informative.	NJKDNJ	Përfshirja e të drejtave dhe e lirive themelore të njeriut në të gjitha sferat shoqërore.	Janar – dhjetor (gjatë gjithë vitit)	Buxheti komunal, qeveritar, donatorët
Ngritja e vetëdijes së qytetarëve në proceset që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, në proceset e bërjes së politikave vendimmarrëse	Organizimi i tryezave, i debatave të ndryshme për gjendjen aktuale të të drejtave të njeriut sipas fushëveprimtarisë (numri i tryezave nuk është i caktuar). Ligjërata me nxënësit e shkollave fillore të komunës sonë përfshirë tema të rrafshve të mbrojtjes së fëmijëve.	NJKDNJ në bashkëpunim me drejtoritë komunale dhe akterët e tjerë institucional.	Respektimi i të drejtave të qytetarëve dhe ngritja e nivelit të pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, duke përfshirë fëmijët dhe të rinjtë, bëhet në bashkëveprim me akterët komunalë: drejtoritë përkatëse.	Janar – dhjetor (gjatë gjithë vitit)	////////
Shkurt – Dita Ndërkombëtare kundër Kancerit	Shënim i Ditës Ndërkombëtare kundër Kancerit. Fushatë sensibilizuese, takime me qytetarë dhe informim sa i përket sëmundjes së kancerit.	NJKDNJ, ZBGJ Drejtoria e Shëndetësisë dhe akterët e tjerë institucional.	Vetëdijësimi i popullatës sa i përket parandalimit të sëmundjes së kancerit. Kontrolltet e vazhdueshme të parapara sipas profesionistëve shëndetësorë, mund të shpëtojnë jetë.	Shkurt tetor	Buxheti komunal, qeveritar, nga donatorët
Ngritja e vetëdijes së popullatës dhe të institucioneve nëpërmjet shënimit të ditëve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut e veçmas të fëmijëve me aftësi të kufizuar	Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Personave me Sindromin DOWN.	NJKNDNJ, në bashkëpunim me akterët institucional dhe OJQ-të.	Kjo ditë shënohet me një mori aktiviteteesh vetëdijesuese, rekreative, kulturore e sportive. Synimi i kësaj do të jetë ndërgjegjësimi, informimi si dhe promovimi për personat që kanë këtë sindromë, në mënyrë që të jetojnë me dinjitet dhe për të qenë aktiv e pjesëmarrës në komunitetin dhe shoqërinë ku jetojnë.	21 mars	Buxheti komunal, donatorët

7 Prill – Dita Botërore e Shëndetësisë	Shënimi i Ditës Botërore të Shëndetësisë.	NJKDNJ, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe të Mirëqenies Sociale.	Fushatë sensibilizuese, tryeza, debate, përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjeve te qytetarët etj. Kjo ditë shënohet me qëllim të ndërgjegjësimit të qytetarëve lidhur me rëndësinë e shëndetit dhe kontrollet që duhet bërë për të parandaluar sëmundjet e ndryshme.	7 prill	////////
Dita Ndërkombëtare kundër Duhanit	Shënimi i 31 Majit – Ditës Ndërkombëtare kundër Duhanit.	NJKDNJ Drejtoria e Shëndetësisë	Fushatë sensibilizuese me qytetarë të grupmoshave të ndryshme, bashkëbisedim dhe shpërndarje e fletëpalosjeve me informacione sa i përket duhanit dhe pasojave të tij.	31 maj	Buxheti komunal, donatorët
1 Qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve	Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve.	NJKDNJ në bashkëpunim me akterët institucional dhe OJQ.	Me rastin e Ditës Ndëkombëtare të fëmijëve NJKDNJ në bashkëpunim me akterët tjerë institucional dhe OJQ organizon aktivitete të ndryshme kulturo-artistike.	1 qeshor	Buxheti komunal, donatorët
Dita Ndërkombëtare kundër Punëve të Rënda të Fëmijëve	Shënimi i Ditës Ndërkombëtare kundër Punëve të Rënda të Fëmijëve, me aktivitete sensibilizuese.	NJKDNJ OJQ-të.	Fushatë sensibilizuese, takime me qytetarë dhe informimi i tyre sa i përket punëve të rënda të fëmijëve dhe pasojave të cilat i shkaktojnë punët e rrezikshme krahas moshës që kanë.	Qershor	Buxheti komunal, donatorët
1 Tetor – Dita Ndërkombëtare e Njerëzve të Moshuar	Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Njerëzve të Moshuar.	NJKDNJ OJQ	NJKDNJ, në bashkëpunim me Shoqatën e Pensionistëve të Komunës, organizon një tryezë diskutimi me personat e moshuar. Shpërndarja e fletëpalosjeve te qytetarët.	Tetor	Buxheti komunal, donatorët
Muaji tetor – Muaji i ndërgjegjësimit të Kancerit të Gjirit	Fushatë ndërgjegjësuere për parandalimin e Kancerit të Gjirit.	NJKDNJ, ZBGJ, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe të Mirëqenies Sociale, GGK, OJQ	Organizim i takimeve me gra në fshatra dhe qytet, bashkëbisedim lidhur me parandalimin e sëmundjes së kancerit të gjirit, rëndësia e kontrolleve mjekësore dhe informimi i tyre se në QKUK në Rahovec ekziston Mamografi, të cilin mund ta shfrytëzojnë për diagnostikimin e kancerit të gjirit.	Tetor	Buxheti komunal, donatorët
15 Tetor – Dita Ndërkombëtare e Ecjes në Natyrë	Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Ecjes në Natyrë.	NJKDNJ, në bashkëpunim me akterët e tjerë institucional dhe OJQ-të.	Organizim i ecjes në natyrë të atyre të cilët shprehin gatishmëri dhe interesim për t’u bashkëngjitur në këtë aktivitet.	Tetor	Buxheti komunal, donatorët
10 Tetor – Dita Botërore e Shëndetit Mendor	Shënimi i Ditës Botërore e Shëndetit Mendor me aktivitete të ndryshme sensibilizuese.	NJKDNJ, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe të Mirëqenies Sociale dhe Këshillat e Bashkësive Lokale.	Duke marrë parasysh se Pandemia me COVID-19 ka lënë pasoja shendetësore psikologjike, organizohen ligjërata vetëdijesuese dhe seanca psikologjike lidhur me rëndësinë e shëndetit mendor.	Tetor	Buxheti komunal, donatorët
18 Tetor – Dita Ndërkombëtare kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore	Shënimi i Ditës Ndërkombëtare kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore me aktivitete të ndryshme.	NJKDNJ, në bashkëpunim me Policinë në Komunitet, DKA	Organizim i takimeve dhe i tryezave të rrumbullakëta me nxënës (të rinj) në shkolla fillore dhe të mesme. Në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës, organizohet mbledhja e sigurisë ku do të marrin pjesë përfaqësues nga Insituconet e Nivelit Qendror për Antitrafikim nga Policia e Kosovës, nga MAPL-ja etj.. për të diskutuar për gjendjen e sigurisë në komunë dhe Trafikimin me Qenie Njerëzore.	Tetor	Buxheti komunal, donatorët
20 Nëntor – Përvjetori i Konventës për të drejtat e fëmijëve	Shënimi i Përvjetorit të Konventës për të drejtat e fëmijëve. Ndërgjegjësim i fëmijëve sa i përket legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar për mbrojtjen e tyre.	NJKDNJ, DKA	Në bashkëpunim me DKA-në dhe drejtorët e shkollave fillore të komunës sonë, të organizohet që ora e parë mësimore t’i kushtohet Konventës për të Drejtat e Fëmijëve. Vizitë në shkolla - monitorim i zbatueshmërisë së këtij aktiviteti.	20 nëntor	////////

16 ditë aktivizëm	Fushatë vetëdijesuese sa i përket parandalimit të dhunës ndaj grave.	NJKDNJ, ZBGJ, GGK	Organizim i aktiviteteve të përbashkëta me të gjithë akterët institucionale dhe OJQ-të, me qëllim të vetëdijesimit të popullatës që dhuna nuk është zgjidhje. Me anë të këtyre aktiviteteve iu bëjnë thirrje që gratë duhet të ngrenë zërin dhe të mos heshtin për dhunën që ushtrohet ndaj tyre. Qasja ndaj dhunës mbi gratë e vajzat si shkelje e të drejtave dhe e lirive themelore të njeriut është një komponent kyç i 16 Ditëve të Aktivizmit.	25 nëntor - 10 dhjetor	Buxheti komunal, donatorët
25 Nëntori - Dita Ndërkombëtare kundër Dhunës ndaj Gruas	Fushata e 16 ditëve organizohet në mbarë botën nga aktivistë të të drejtave të njeriut për të bërë thirrje për eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave. Fillon më 25 nëntor dhe përfundon më 10 dhjetor pikërisht në ditën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.				
3 Dhjetori – Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara	Shënim i Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara me një mori aktivitësh për PAK.	NJKDNJ, Drejtoria e Shëndetësisë, Handikos	Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi te Kufizuar me aktivitete të ndryshme kulturore e rekreative.	3 dhjetor	Buxheti komunal, donatorët
10 dhjetori – Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut	Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të të të Drejtave të Njeriut.	NJKDNJ Institucioni i Avokatit të Popullit	Tryezë diskutimi me qytetarë, nxënës dhe mësimmhënës lidhur me të drejtat e Njeriut.	10 dhjetor	Buxheti komunal, donatorët
Dyert e hapura me qytetarë	NJKDNJ, në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit çdo muaj, organizon aktivitetin “Dyert e hapura me qytetarë”.	NJKDNJ, Institucioni i Avokatit të Popullit	Qytetarët kanë mundësinë që një herë në muaj të parashtrojnë ankesat e tyre (të cilat mendojnë se po iu shkelen të drejtat e njeriut) te Avokatit i Popullit dhe zyrtarët e NJKDNJ-së.	Një herë brenda muajit gjatë gjithë vitit	//////

Zyra për Integritime Evropiane

Zyra për Integritime Evropiane do të kryejë funksionin dhe detyrat e veta, duke u bazuar në rregulloren nr. 08/2011 për organizimin dhe përgjegjësitë e zyrtarit komunal për Integrim Evropian në monitorimin, bashkëpunimin dhe raportimin e rregullt për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Departamentin për Integritime Evropiane.

Bashkërendimi i aktiviteteve me Asociaconin e Komunave me ministritë e linjës (MAPL/ MIE), avancimi i sistemit të riintegritimit të qëndrueshëm për personat e riatdhesuar, përmirësimi i bashkëpunimit dhe i dialogut civil me shoqërinë civile lokale dhe palët e tjera të interesuara, organizimi i këshillimit të përbashkët me ZKIE-të për finalizimin e planeve individuale nga obligimet e agjendës evropiane, raportet periodike (raporti vjetor janar-dhjetor 2024 për përmbushjen e obligimeve nga Agjenda Evropiane për komuna, raportimet 6-mujore për raportin e vendit dhe (MSA), raportimet vjetore për Planin Komunal të Veprimit për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit - MSA , janë disa nga aktivitetet kyçe të planifikuara për vitin 2024 në kuadër të ZIE-së.

Zyra për Barazi Gjinore

Objektivat	Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Treguesit e suksesit - rezultatet	Afati kohorë	Resurset-Burimet financiare
Vetëdijësim në çështjen e Barazisë Gjinore	Ligjërata – vetëdijësim nëpër shkolla të viseve rurale për barazi gjinore. Tryezë e rumbullakët	Z.B.GJ. K. Rahovec	Përfutimi i njohurive në çështjen e barazisë gjinore nëpër vise rurale. Pjesëmarrja në debat	Janar-prill	Buxheti i Kuvendit Komunal dhe donatorë të tjerë.
Shënimi i ditës së 8 Marsit - Ditës së Gruas	Implementimi i rregullore nga Institucionet e Komunës	Z.B.GJ. Institucionet Komunale	Implementimi dhe zbatimi i saj	Mars	Buxheti i Kuvendit Komunal dhe donatorë të tjerë.
Implementimi i rregullore për Barazi Gjinore	Mbajtja e ligjëratave debative, tryezave për pjesëmarrjen e grave në hartimin e politikave dhe në planifikim të buxhetit; Seminar njëditor për drejtorët dhe Komitetin për Politikë dhe Financa; Hulumtim për vlerësim të përfshirjes së nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve (grave dhe burrave) në buxhetin e drejtorive të Komunës së Rahovecit.	Z.B.GJ. OSCE	Pjesëmarrja në hartim të planifikimit buxhetor	Janar-qershor-shtator	Buxheti i Kuvendit Komunal dhe donatorë të tjerë.
Takime përgatitore me gratë e viseve rurale dhe kryesuesit e fshatrave për identifikimin e prioriteteve të grave, me qëllim të përfshirjes së perspektivës gjinore në rishikimin dhe planifikimin e buxhetit të Komunës					
Konferenca, seminare trajnime dhe tryeza të rumbullakëta që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve dhe profesionaliz-min në lidhje me të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore.	Vetëdijësimi në fushën e legjislacioinit; Ligji për barazi gjinore; Ligji kundër diskriminimit; Ligji për familjen; Ligji mbi trashëgiminë; Ligji kundër dhunës në familje, si dhe ligjeve të tjera që kanë të bëjnë me barazi gjinore.	ZKM/VQM NJDNJ ABGJ Kuvendi komunal, OJQ vendore ndërkombëtare; Shoqëria civile	Përkrahja institucionale; Transporti Buxheti	Janar-dhjetor	Buxheti i Kuvendit Komunal dhe donatorë të tjerë
Përkrahja dhe zbatueshmëria e ligjeve në lidhje me barazinë gjinore, zbatimi, monitorimi i tyre dhe raportimi mbi zbatueshmërinë e tyre.	Identifikimi i mangësive të vendimeve të marra dhe legjislacioneve lidhur me të drejtat e njeriut, krahasuar me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.	ZKM/VQM NJDNJ Kuvendi komunal, OJQ vendore ndërkombëtare.	Rritja e nivelit të respektimit të të drejtave të njeriut të qytetarëve; Legjislacioni vendor në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.	Janar-dhjetor	Buxheti i Kuvendit Komunal dhe donatorë të tjerë
Sensibilizimi, vetëdijësimi i gruas në përfaqësim-zgjedhje.	Ligjërata, tryeza, debate për ngritjen e grave dhe rëndësinë e pjesëmarrjeve në zgjedhje – tema Vota juaj - përfaqësimi juaj.	Kuvendi Komunal; Z.B.GJ., OJQ vendore dhe ndërkombëtare.	Rritja e nivelit të zbatimit të ligjeve të aplikuara të cilat flasin për barazi gjinore.	Korrik-nëntor	Buxheti i Kuvendit Komunal dhe donatorë të tjerë
Fushatë vetëdijesuse për kancerin e gjirit në kuadër të shënimit të Ditës ndërkombëtare	Ligjërata, shpërndarja e fletushkave informative, testi i mamografisë.	Z.B.GJ. QKMF OJQ vendore	Vetëdijësimi i komunitetit nëpër vise rurale dhe urbane.	Tetor-nëntor	Buxheti i Kuvendit Komunal dhe donatorë të tjerë.

Drejtoria për Administratë

- Ngritja e nivelit të përgjegjësisë dhe e disiplinës në punë, shtimi i efikasitetit në shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave/parashtresave të parashtruara nga ana e qytetarëve/bizneset, si dhe subjektet e tjera;
- Përmes Qendrës për Shërbime me Qytetarë, synohet ngritja e bashkëpunimit me të gjitha drejtoritë e administratës komunale, organet e komunës dhe njësitë e tjera për shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesave/lëndëve brenda afateve ligjore;
- Mbikëqyrja e rrjetit, serverëve, kompjuterëve, pajisjeve të tjera të teknologjisë informative;
- Përgatitja dhe organizimi i seancave të rregullta, seancat e jashtëzakonshme dhe seancat emergjente (gjatë tërë vitit);
- Përgatitja e materialit për mbledhjet e Kuvendit, dërgimi i materialit dhe ftesës MAPL-së dhe kuvendarëve me anë të e-mailit (gjatë tërë vitit);
- Përgatitja e procedurave për inventarë dhe nevoja të tjera për administratën komunale;
- Të gjitha vendimet e nxjerra nga Kuvendi do të procedohen më tutje sipas rregulloreve dhe ligjeve në fuqi, do të kujdesemi që të arkivohen në mënyrën më të mirë të mundshme.
- Vendosja e ashensorit në objektin e Komunës;
- Renovimi i objekteve të gjendjes civile;
- Mirëmbajtja e serverëve;
- Përgatitja profesionale dhe teknike e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komiteteve të tjera të parapara me Statutin e Komunës, bazuar në kalendarin vjetor për mbajtjen e mbledhjeve të Komiteteve (gjatë tërë vitit);
- Përkthimi i të gjitha materialeve të Kuvendit, Komiteteve, Bordit të drejtorëve dhe organeve të tjera komunale, si dhe përkthimi simulant i seancave të rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit, të Komiteteve dhe të takimeve të tjera të institucioneve komunale (gjatë tërë vitit).
- Muajtë korrik dhe gusht do të shpallen si muajtë e mërgimtarëve, ku përveç aktiviteteve kulturore artistike, në Administratë do të rriten shërbimet për qytetarë, dhe zyrtarët komunalë të Administratës do të punojnë me orar të zgjatur. Në kuadër të “Muajit të Mërgimtarëve”, do të hapet edhe një sportel i veçantë për mërgimtarë, gjithashtu do të kujdesemi për parking të veturave, që të ketë vend të mjaftueshëm për mërgimtarët tanë;
- Në sektorin e arkivit do të bëhet pranimi dhe arkivimi i lëndëve të përfunduara nga ana e drejtorisë, të gjitha lëndët do të arkivohen në depo të komunës, në pajtim me ligjin (gjatë tërë vitit);
- Organizimi i punëve të arkivit komunal përmes një protokollit hyrës, si dhe shpërndarja e lëndëve nëpër organet e komunës, drejtoritë e Administratës, si dhe njësitë e tjera.
- Do të vizitohen të gjitha zyrat e gjendjeve civile në bashkësi lokale, në mënyrë që të evidentohet çdo nevojë ose kërkesë e zyrave të vendit për shërbime sa më cilësore për qytetarët tanë;
- Kontrollimi i kablllove dhe i pajisjeve të rrjetit, pastrimi i rregullt i serverëve, bartja e incizimeve të mbledhjeve;
- Koordinimi me ASHl-në për licenca, instalimi i printerëve, instalimi i pajisjeve transmetuese;
- Servisimi i radiatorëve me rreze infra të kuqe;
- Mirëmbajtja e objekteve të komunës;
- Servisimi i automjeteve zyrtare;
- Sigurimi i automjeteve zyrtare.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

Qysh në janar, DShPS-ja, do të përgatitet që të jetë e gatshme të përballojë fluksin e pacientëve në raste të gripave virusale, po ashtu, dy QMF-të, në dy lokalitete të mëdha në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, do të vazhdojmë me dy ndërrime, duke ofruar shërbime mjekësore qytetarëve në nevojë, po ashtu në këto dy QMF, do të bëjmë përpjekje për modernizim të shërbimeve, me analizat laboratorike dhe të shërbimeve të rëntgenit, do të ofrohen shërbimet e rëntgenit edhe në dy QMF, në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, si dhe ofrimin e shërbimeve stomatologjike në QMF, në Çifllak.

Duke u bazuar në planin e prokurimit, do të iniciohen edhe procedurat e shpalljes së tenderëve për zbatimin e projekteve kapitale, si dhe përcjellja e projekteve që janë në vazhdim, me theks të veçantë renovimi i QKMF-së, po ashtu do të bëjmë zgjidhjen e problemit të QMF-së në Fortesë, ndërtimin e objektit të ri për shkak se objekti aktual është jashtë funksionit, si pasojë e vërshimeve të muajit shtator 2022 (sipas vlerësimit të komisionit të formuar me vendim të kryetarit për vlerësim të dëmeve të shkaktuara në objektin ekzistues në QMF, Fortesë), po ashtu, fokus do të jetë edhe mirëmbajtja e mjeteve mjekësore dhe e objekteve shëndetësore.

Në këtë tremujor të parë të vitit planifikohet edhe takimi i rregullt me punëtorët shëndetësorë.

Duke shpresuar që të jemi në një vijë me Ministrinë e linjës ku kemi aktivitetet e ndërlydhura, përgatitja e stafit për emergjencë – do të trajnohen ekipet e veçanta për njësinë e emergjencës.

Periudha kyçe në këtë vit është kjo: funksionalizimi i plotë i renovimit të objektit të QKMF-së, në të cilën

qytetarët e komunës sonë do të kenë mundësi të shfrytëzojnë të drejtën e marrjes së shërbimeve mjekësore në të gjithë sektorët e shëndetësisë, si: sektori për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, si në gjinekologji, stomatologji, vaksinim e shërbime të tjera.

Përcjellja e projekteve kapitale në terren, duke shpresuar në përmirësimin e kushteve atmosferike, do të vazhdojë ta përcjellë këtë periudhë tremujore.

Në këtë periudhë, do të ndërmarrim masa parandaluese për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve të komunës sonë, dezinfektim, deratizim dhe dezinfektim të hapësirave, me qëllim të mbrojtjes nga pickimi i rriqrave, duke ditur se shumë herë si komunë kemi qenë si vatër e infeksionit nga rriqrat.

Në këtë tremujor të dytë të vitit, planifikohet edhe takimi i rregullt me punëtorët shëndetësorë.

Periudha e tretë e vitit do të jetë periudha ku do të jetë në funksion të plotë objekti i rinovuar i QKMF-së dhe ofrimi i shërbimeve më cilësore për qytetarët në nevojë, furnizimi me vaksina kundër gripit sezonal për të moshuarit, po ashtu, nuk do të mungojë përcjellja e projekteve të investimeve kapitale në këtë tremujor, si dhe shpërndarja në mënyrë të drejtë të subvencioneve për ndihma momentale.

Në këtë tremujor të tretë të vitit, planifikohet edhe takimi i rregullt me punëtorët shëndetësorë.

Fokusi i periudhës së fundit të vitit do të jetë përcjellja e punimeve në investime kapitale. Sigurisht se prioritet do të jetë realizimi i buxhetit, do të kujdesemi që punët e kryera të mbikëqyren dhe të shpenzohet buxheti në përpikëri, si dhe planifikimi i buxhetit për vitin paraprak.

Në këtë tremujor të katërt të vitit, planifikohet edhe takimi i rregullt me punëtorët shëndetësorë.

Drejtoria për Arsim

Prioritetet e DKA-së për vitin 2024 janë:

Zbatimi i projektit të riparimeve në shkolla;

Eficienca e energjisë në disa shkolla;

Gara komunale;

Shpërndarje e librave në biblioteka dhe në shkolla, si dhe mjete konkretizuese;

Planifikimi i kuadrit mësimor për vitin shkollor 2024/2025;

Furnizimi me lëndë djegëse për ngrohje për të gjitha shkollat dhe institucionet edukativo-arsimore;

Do të përcillet vazhdimisht realizimi i projekteve kapitale në fushën e arsimit;

Do të përcjellim në mënyrë të vazhdueshme funksionimin e qendrave mësimore, në të cilat zhvillohet mësimi plotësues e po ashtu do të zhvillohen aktivitete të ndryshme inovative nga qendrat e karrierës. Drejtori i DKA-së, do të realizojë takime të njëpasnjëshme me këshillat e arsimtarëve të çdo shkolle.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Përgatitja e Pasqyrave Financiare;

Përgatitja e raportit vjetor financiar për Kuvend;

Përgatitja e rrjedha e parasë (cash planit);

Shpërndarja e faturave të tatimit në pronë;

Përgatitja e planit-strategjisë për inkasim më të madh të të hyrave;

Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2023, në vitin 2024;

Regjistrimi dhe verifikimi i objekteve;

Përgatitja e raportit tremujor financiar 2024 për Kuvend dhe për publikim;

Përgatitja e KAB-it komunal 2024-2027, sipas qarkoreve buxhetore I dhe II;

Dërgimi i raportit të auditimit për vitin 2023 në kuvend, i audituar nga ana e Zyrës së Auditimit Kombëtar;

Përgatitja e raportit gjashtëmujor financiar 2024 për kuvend dhe për publikim;

Dorëzimi i KAB-it komunal 2024-2027, i përgatitur për votim në Kuvend;

Dëgjimet buxhetore me qytetarë nga ekzekutivi dhe nga KPF-ja, periudha gusht-shtator;

Futja e të dhënave buxhetore në sistemin PIP dhe BDMS;

Përgatitja e raportit nëntëmujor financiar 2024 për Kuvend dhe për publikim;

Mbyllja e vitit fiskal 2024, me përqindje të lartë të shpenzimit të buxhetit dhe me një përqindje të lartë të realizimit të të hyrave.

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, planifikon të bëjë shqyrtimin e të gjitha kërkesave nga qytetarët në afatin minimal ligjor, siç janë: leje ndërtimore, leje të rrënit, kushte ndërtimore, leje mjedisore komunale, vërtetimet urbanistike, certifikata të përdorimit.

Rritja e të hyrave vetanake përmes lëshimit të lejeve ndërtimore, lejeve mjedisore komunale dhe legalizimin e objekteve pa leje.

Gjatë kësaj periudhe, planifikojmë:

Miratimin e Hartës Zonale të Komunës si dokument strategjik hapësinor;

Shqyrtimi i të gjithë kërkesave nga qytetarët në afatin minimal ligjor, siç janë: leje ndërtimore, leje të rrënit, kushte ndërtimore, leje mjedisore komunale, vërtetimet urbanistike, certifikata të përdorimit.

Shqyrtimi i të gjitha kërkesave nga qytetarët në afatin minimal ligjor, siç janë: leje ndërtimore, leje të rrënit, kushte ndërtimore, leje mjedisore komunale, vërtetime urbanistike, certifikata të përdorimit. Menaxhimi sa më efektiv i projekteve kapitale të menaxhuara nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtja e Mjedisit, në bashkëpunim me organin mbikëqyrës të punimeve. Prioritet do jetë realizimi i buxhetit dhe i projekteve të planifikuara për vitin 2024.

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

- Shpërndarja e të gjitha aktvendimeve dhe ngarkesave në taksa afariste për bizneset të cilat ngarkohen sipas rregullores për taksa komunale 01 NR 80/20;
- Në bashkëpunim me AZhR-në, do të organizohen sesione informuese për të aplikuar në thirrjet e granteve në ministri të ndryshme;
- Takim i këshillit publiko-privat, shqyrtimi i kërkesave të bizneseve të cilat operojnë në komunën e Rahovecit;
- Vazhdim i angazhimit të të rinjve për praktikë me pagesë në tregun e punës, përmes marrëveshjeve të veçanta me ndërmarrjet private;
- Funksionalizimi i plotë i shtëpisë për të moshuar;
- Përfundimi i projektit “Ndërtimi i Lokaleve Afariste Zejtare”;
- Zhvillimi i agroturizmit përmes realizimit të projektit: “Investime në Turizëm”, ku planifikohet të ndërtohen 3 bujtina në fshatin Zoqisht, meremetimi i “Kroit të Demirit” në fshatin Drenoc, ndërtimi shtigjeve të ecjes në Zatriq dhe Zoqisht, investime të “Shpella e Dagonit”, si dhe sinjalizimi vertikal i të gjitha pikave turistike në komunën e Rahovecit.
- Organizimi i ankandeve publike për pronat e lira komunale;
- Mbikëqyrja dhe inkasimi i të hyrave në qira dhe inkasimi i të hyrave në taksa afariste komunale;
- Zbatimi i politikave zhvillimore përmes ndarjes së subvencioneve për bizneset e vogla dhe të mesme;
- Ofrimi i shërbimeve për regjistrimin e bizneseve, si dhe ofrimi i shërbimeve sipas kërkesave të bizneseve
- Aplikimi për projekte investive në MZhR, për grantet e vitit 2025;
- Vizita dhe promovim i bizneseve të komunës së Rahovecit;
- Takim në mes të bizneseve në Rahovec dhe atyre në mërgim - mundësia e rritjes së bashkëpunimit mes tyre.
- Regjistrimi i të gjitha aseteve komunale;
- Festa e Vjeljes së Rrushit 2024.
- Në periudhën e katërt të vitit, pa dyshim që prioritet i DEZHT-it mbetet realizimi i buxhetit në përpikëri, si dhe rritja e të hyrave komunale nëpërmjet inkasimit të të hyrave nga taksat dhe qiraja.
- **Prioritet i lartë:**
Zbatimi i memorandumit të bashkëpunimit me MINT, për projektin “Parku Industrial në Opterushë” në vlerë: 1,688,216.52€, si dhe mundësia e lidhjes së marrëveshjeve të reja me MINT-in, deri në funksionalizimin e plotë të këtij projekti;
- Krijimi i hapësirave të reja për biznese;
- Do të ofrohet konsulencë falas në përgatitjen e aplikacioneve për të gjitha bizneset të cilat dëshirojnë të aplikojnë për grante në ministri të ndryshme.

Drejtoria për Shërbime Publike

Prioritetet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike

- Pastrimi i rrugëve dhe i trotuareve nga bora dhe intervenimet e tjera emergjente (janar-shkurt-mars 2024);
- Ndërtime dhe intervenime sipas nevojës, në infrastrukturë (janar-shkurt-mars 2024)
- Heqja e deponive ilegale të inerteve (gjatë tërë vitit 2024);
- Analizimi i kontratave dhe përmbushja e tyre në projektet, si: trotuare, rrugë, rreth-rrotullime, hapësira publike, mbikëqyrja dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve, të martirëve, të civilëve, po ashtu, të shesheve, të pllakave përkujtimore, të hapësirave të gjelbëruara etj. (gjatë tërë vitit 2024);
- Vazhdimi i projekteve të reja për ndërtimin e rrjeteve të kanalizimit, të rrugëve, të trotuareve, etj.,
- Mbledhja e të hyrave nga sipërfaqet publike sipas rregullores së DShP-së;
- Mirëmbajtja e rregullt e kanaleve të ujërave fekale nga kompania KRU “Gjakova”, si dhe investime të reja në ndërrim të gypave të ujit, zgjerime në ujësjellës dhe investime të reja në bashkëfinancim me komunën;
- Fillimi i procedurave për mbledhjen e taksës për mbeturina nga ana e Komunës.
- Ndërtimi i rrugëve në qytet dhe fshatrat e komunës, sipas prioriteteve dhe Planit të Prokurimit (2024);
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e kanalizimeve dhe ndërhyrjet emergjente në disa vendbanime të komunës së Rahovecit (2024);

- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e gropave septike dhe ndërhyrjet emergjente në disa vendbanime të komunës së Rahovecit (2024);
- Ndërtimi i trotuareve në qytet dhe fshatrat e komunës, sipas prioriteteve (gjatë tërë vitit 2024);
- Hapja e procedurave për disa punë, si: përmirësimi me furnizim me ujë të pijshëm për zonën III në Rahovec, duke përfshirë fshatrat Hoçë e Madhe, Zoqisht dhe Opterushë, pastaj fshatrat Zatriq, Mrasor dhe Kaznik, në bashkëfinancim me KRU “Gjakovën”, mirëmbajtja e rrugëve lokale dhe e atyre në qytet, muret mbrojtëse sipas prioriteteve etj.;
- Pas kategorizimit të rrugës qarkore në Rahovec, do të angazhohemi në shpronësimin e pronave përmes departamentit për shpronësime në MMPH;
- Fillimi i punëve me projektin për sinjalizim horizontal dhe vertikal të rrugëve (gjatë tërë vitit 2024);
- Vendosja e disa pengesave në rrugë, sipas standardeve të përcaktuara;
- Inicimi, analizimi i madhësisë dhe i dendësisë së qarkullimit në rrugët e qytetit për verifikimin e senseve të lëvizjes;
- Digjitalizimi i infrastrukturës publike;
- Vendosja e pritoreve të reja për pritjen e udhëtarëve;
- Krijimi i shtigjeve të reja për biçikleta dhe këmbësorë në zonën urbane;
- Krijimi i infrastrukturës së nevojshme për personat me nevoja të veçanta;
- Në bashkëpunim me policinë e Kosovës dhe kompaninë për autobartje të veturave, do të ketë angazhim gjatë gjithë vitit 2024.
- Vazhdimi i projektit të ndërtimit të rrugës 4-korsi, Rahovec-Xërxë, faza përfundimtare;
- Vazhdimi i ndërtimit të rrugëve lokale në qytet dhe në të gjitha vendbanimet e komunës sonë;
- Vazhdimi i ndërtimit të 6 segmenteve rrugore në qytet, bashkëfinancim me Ministrinë e Infrastrukturës.
- Menaxhimi i deponive për mbeturina nga demolimet dhe ndërtimet;
- Eliminimi i të gjitha deponive ilegale - inerteve;
- Në bashkëpunim me KEDS-in, do të caktojmë prioritet për shtrirjen e rrjetit elektrik, si dhe vendosjes së trafave, sipas kërkesave të qytetarëve;
- Në bashkëpunim me KRU “Gjakova” do të implementojmë projekte kapitale në zgjerimin dhe ndërrimin e gypave për ujë të pijshëm;
- Përmbyllja e disa projekteve kapitale,
- Përgatitja në fundvit për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit dimëror;
- Raporti vjetor i drejtorisë, plani vjetor i prokurimit, plani vjetor i drejtorisë për vitin që vjen.

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Përkushtim i veçantë i DBPZhR-së do të jetë përmirësimi i infrastrukturës bujqësore për fermerët e vyeshtë të komunës sonë. Në kuadër të infrastrukturës parashihet që vëmendje kryesore do të kenë:

- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore
- Ndërtimi i kanaleve të kullimit dhe të drenazhimit të tokave bujqësore
- Zgjerimi i sistemit të ujitjes në bashkëpunim me kompaninë publike “KRU Dukagjini-Radoniqi”
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e përroskave
- Rritja e sipërfaqeve me pyje të reja
- Shfrytëzimi racional i tokave bujqësore dhe pyjore që janë dhënë në shfrytëzim
- Ruajtja dhe mbrojtja e pyjeve nga zjarret

Thirrje për aplikim për subvencione për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë, therjet e raportuara të gjedhit, viçat për majmëri dhe akuakulturë për gjashtëmuorin e dytë të vitit 2023.

Shpërndarja e plehut për fermerët, të cilët i plotësojnë kriteret të cilat do të paraqiten në aplikacion.

Vaksinimi i bagëtive të trasha dhe të imta, në këtë mënyrë synojmë që ta parandalojmë përhapjen e sëmundjeve të ndryshme në këtë sektor.

Shpallja e ankandit publik për dhënie të tokës bujqësore komunale me qira.

Përgjigje në kërkesat për damkosje të drunjve në pronat e pyjeve private, aktivitet që është i rregulluar me Ligjin e Pylltarisë.

Hapja e thirrjes për aplikim nga ana e MBPZhR-së për pagesa direkte - subvencione, ne si staf i drejtorisë synojmë të jemi të gatshëm të përballojmë fluksin e fermerëve gjatë kryerjes së procesit të aplikimit, synojmë të mobilizohemi me kapacitete të plota, si me staf, po ashtu edhe me mjete logjistike, duke e ditur se komuna jonë ka numrin më të madh të fermerëve në nivel vendi.

Shpërndarja e preparateve për luftimin e sëmundjes së Hardhisë së Rrushit – luftimin e insektit cikadia, për fermerët të cilët do t’i plotësojnë kriteret e paraqitura në aplikacion. Spërkatja me këtë preparat planifikohet të bëhet gjatë muajit qershor.

Projektet:

Ndërtimi i urave në vendbanimet e komunës së Rahovecit (sipas kërkesave që i kemi pranuar nga fermerët)

Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore.

Rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore, ndërtimi i kanaleve të kullimit dhe i drenazhimit të tokave bujqësore, ndërtimi i infrastrukturës në tregun e rrushit, ndërtimi i objektit - depos bujqësore, e projekte të tjera, do të jetë fokusi kryesor i zyrtarëve të drejtorisë.

Përcjellja e mbjelljeve pranverore për të parë më afër ecurinë e punëve agroteknike, duke iu ofruar këshillat e nevojshme fermerëve për mbjelljet, në mënyrë që të kenë rendiment dhe cilësi të kënaqshme.

Rritja 25 hektarë me pyje të reja në njësinë menaxhuese: Kaznik-Kramovik.

Thirrja publike për aplikim për sipërfaqet me serra nga 3, deri në 10 ari. Fermerët do të aplikojnë sipas thirrjes publike dhe do të përzgjidhen fermerët të cilët do t'i plotësojnë kriteret.

Thirrja për aplikim për subvencione për qumësht/litër, sipas kategorive të cilësisë, therjet e raportuara të gjedhit, viçat për majmëri dhe akuakulturë për gjashtëmujorin e parë të vitit 2024 dhe për sigurime bujqësore, thirrje kjo që hapet nga Ministria e BPZHR-së.

Thirrja për aplikim për subvencionim nga MBPZHR-ja për sasi të kg të grurit dhe dëshmime të faturave të plehut. Për shkak të temperaturave angazhim maksimal për parandalim të zjarreve në bashkëpunim me Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Prioritet që është edhe për tërë vitin, do të jetë realizimi i buxhetit të drejtorisë, i ndarë për vitin 2024, do të kujdesemi që punët e kryera të mbikëqyren dhe të shpenzohet buxheti në përpikëri duke zbatuar projektet kapitale që shërbejnë për zhvillimin më të hovshëm të bujqësisë në komunën tonë.

Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

- Rirregullimi i vektorit në të gjitha zonat kadastrale në nivel komune;
- Vazhdimi i evidentimit dhe i lirit të pronave të uzurpuara në nivel të komunës;
- Vazhdimi i inventarizimit të dokumentacionit dhe skenimi masiv i dokumentacionit të paskenuar;
- Shpronësimi i pronave private për hapje të rrugëve publike në nivel të komunës.
- **Spektori për Kadastër dhe Pronë**, gjatë periudhës njëvjeçare, parashihet që të pranojë dhe të kryejë me shumë se 1300 lëndë.

- **Spektori për Gjeodezi** parashihet që të pranojë dhe të zgjidhë mbi 610 lëndë.

Do të vazhdojmë me përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm në lidhje me evidentimin e pronave, si ato komunale dhe ato private që janë vëndrëniet e dëshmorëve të kombit, me qëllim që këto parcela t'i shpallim zona me interes të veçantë. Kjo mbetet sfidë që të përfundohet deri në fund të vitit 2024. Gjatë vitit 2024, nuk do të mungojë edhe qasja ndaj detyrave të tjera, si në Spektorin e Gjeodezisë ashtu edhe në atë të Kadastrës dhe të Pronës, ku vlen të cekën:

- Propozim-vendimet për seancat e Kuvendit Komunal;
- Përgatitja e lëndëve për gjykatë dhe e subjekteve të tjera të përfshira në zbatimin e ligjit;
- Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe të personave juridikë;
- Punët e gjeodezisë, inxhinierisë për nevojat e Kuvendit Komunal dhe të palëve të tjera;
- Matjet kadastrale për vërtetimin e uzurpimeve arbitrare;
- Përgatitja e aktvendimeve për uzurpimet arbitrare;
- Punë të tjera sipas planit.
- **Me propozim të Kryetarit të Komunës, drejtuar Kuvendit të Komunës, do të bëhet shpallja e interesit të përgjithshëm të pronave komunale për zhvillim ekonomik të Komunës.**
- Përgatitja e akteve ndaj uzurpatorëve në nivel të Komunës;
- Dalja në terren e Shërbimit pronëso-ro-juridik, me kërkesë të Drejtorisë për Inspeksion;
- Dalja e gjeodetëve në terren për matjen e rrugëve në nivel komune.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

Trajtimi dhe shfrytëzimi i objekteve dhe i institucioneve ekzistuese kulturore e sportive në komunën e Rahovecit. Objektet që ofrohen për këto aktivitete, janë:

- Shtëpia e Kulturës në Rahovec, Krushë të Madhe, Ratkoc, Xerxë, Drenoc, amfiteatri i festivalit në Dejnë, amfiteatri në Gradish;
- Biblioteka komunale "Sulejman Krasniqi" në Rahovec, Krushë të Madhe dhe Hoçë të Madhe;
- Stadiumi "Jahja Danuza" dhe fushat sportive;
- Fusha e futbollit në Dejnë;
- Fusha e Futbollit në Xërxë;
- Palestra "Mizahir Isma".

Gjatë muajve të parë të vitit 2024, DKRS-ja do të përkushtohet maksimalisht në arritjen e objektivave në kuadër të kompetencave të drejtorisë, duke e përmbushur planin e punës.

Sektori i Kulturës:

➤ Aktivitetet kulturore, sportive dhe ngjarjet historike për vitin 2024 të DKRS -së

Lloji i aktivitetit Data dhe koha	Aktivitetet e planifikuara
27 janar 2024 Manifestimi kulturor dhe përkujtimor “Flaka e Janarit”	1.Konkurs letrar për fëmijë dhe të rinj (propozim); 2.Homazhe në Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagavc, Celinë dhe Krushë e Madhe; 3.Akademi kulturore e përkujtimore.
Dita e Pavarësisë – 17 Shkurt 2024	1.Homazhe dhe nderime për dëshmorët; 2. Kros për fëmijë dhe të rinj; 3. Gara në futboll të vogël (tradicional); 4. Manifestimi festiv.
Epopeja e UÇK-së - 5, 6, mars 2024	Nderime
Dita e Shkollës Shqipe (Mësuesit) - 7 Mars 2024	DKA&DKRS
Dita e Gruas - 8 Mars 2024	DKA dhe OJQ-të
Dita e Poezisë - 21 Mars 2024	Orë poetike
Dita Ndërkombëtare e të Burgosurve Politikë	Tryezë diskutimi me të burgosur politikë
Dita Ndërkombëtare e Monamenteve Kulturore - 18 Prill 2024	Tryezë historike me historianë dhe njohës të trashëgimisë kulturore
Dita Ndërkombëtare e Librit dhe e të Drejtave Autoriale - 23 Prill 2024	Diskutime dhe promovime
Dita Botërore e Lirisë së Shtypit - 3 Maj 2024	Debat&Tryezë
Manifestimet kulturore e përkujtimore “Java e Dëshmorëve”, 5 – 12 maj 2024	Nderime për dëshmorët; Aktivitete kulturore e sportive.
Dita Botërore e Muzeve - 18 Maj 2024	Diskutime dhe vizitë muzeve
Festivalit folklorit “Anadrinia jehon” - 11, 12, 13 maj 2024	1.Promovimi i vlerave kulturore të rajonit të Rahovecit dhe trevave shqiptare.
Dita e Qendrës së Kulturës “Mensur Zyberaj” - 27 Maj 2024	1. Shfaqje teatrale për të rinj dhe fëmijë; 2. Program artistik&kulturor.
Dita Olimpike	Gara sportive dhe argëtuese
Dita Botërore e Fëmijëve - 1 Qershor 2024	Aktivitete argëtuese e festive
Java e Ukshin Hotit, 11-16 maj 2024	Akademi politike
Dita e Çlirimit të Komunës së Rahovecit - 14 Qershor 2024	1.Aktivitete kulturore e përkujtimore; 2.Koncert festiv; 3.Gara në futboll të vogël (tradicional).
17 qershor 2024 – ditëlindja e Ukshin Hotit	Dhënia e medaljes “Ukshin Hoti”
Epopeja e Rahovecit, 17 – 21 korrik 2024	Nderime për të rënë
Muaji i mërgimtarëve, 15 korrik - 15 gusht 2024	Aktivitete kulturore, sportive, argëtuese, takime e tryeza me mërgimtarë
Dita Botërore e Rinisë - 12 Gusht 2024	Aktivitete me të rinj nga mërgimi
Shfaqje teatrale (tetor)	Bashkëpunim me teatro profesionale
Krosi vjeshtor, lojrëat sportive tradicionale	Vrapim dhe gara sportive me nxënës të shkollave të mesme e fillore
Festat e nëntorit - 28 Nëntor 2024	Aktivitete përkujtimore, kulturore
Dita e Bibliotekës “Sulejman Krasniqi” 7 Dhjetor 2024	1.Konkursi letrar për çmimin letrar “Sulejman Krasniqi”
Sportisti i vitit - 28 dhjetor 2024	Aktivitet solemn

Biblioteka Komunale “Sulejman Krasniqi”

Projektet dhe planifikimet vjetore në Bibliotekë do të fokusohen në këto tema:

- Furnizimi me libra i bibliotekës dhe hulumtimi për dhurues të librave.
- Përgatitja e raporteve mujore dhe vjetore.
- Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare.
- Klasifikimi dhe katalogimi i librit.
- Anëtarësimi/huazime të reja në Bibliotekë.
- Evidentimi i punës përmes kartelave të librit.

- Përgatitja e informatave lidhur me ecurinë e lexuesve në bibliotekë.
- Ngritja e grupeve të leximit në shkolla.
- Java e Bibliotekarisë në Kosovë.
- Dita e Bibliotekës “Sulejman Krasniqi”.
- Çmimi letrar “Sulejman Krasniqi”.
- Dita Ndërkombëtare e Librit.
- Dita Ndërkombëtare e Poezisë.
- Aktivitete për fëmijë "Rëndësia e bibliotekës për një të ardhme".
- Fuqizimi i librit përmes vizitave nëpër ShFMU dhe aktivitete të ndryshme.
- Organizimi i aktiviteteve edukativo-arsimore me nxënës.
- Pjesëmarrja në trajnime/konferenca lidhur me librin, në nivel regional dhe qendror.
- Hapja e këndit librar.

Sektori i Rinisë:

Prioritete në Sektorin e Rinisë për vitin 2024:

- Bashkëpunimi me OJQ-të rinore është një nevojë e domosdoshme për përmirësimin e rolit të rinisë dhe për të arritur rezultate konkrete në fushën e rinisë.
- Përkrahja dhe nxitja e punës vullnetare të të rinjve dhe bashkëpunimi me OJQ-të në Rahovec, të cilët e kanë fokus punën me të rinj.
- Ndërtimi i qendrës rinore dhe kulturore në Rahovec
- Krijimi i programeve që kanë qëllim promovimin më të madh në punësimin e të rinjve.
- Gjallërimi i jetës kulturore- artistike, si edhe nxitja, promovimi i talenteve të reja dhe inkurajimi i krijuesve të rinj të shkollave të mesme.
- Nxitja e të rinjve nga zonat rurale që të përfshihen në sa më shumë aktivitete.
- Organizimi i forumeve dhe konferenca me fokus rininë
- Fuqizimi dhe përkrahja e rrjeteve dhe e qendrave rinore
- Përfshirja e minoriteteve dhe e grupeve të marginalizuara në aktivitete rinore
- Organizimi i datave të rëndësishme që ndërlidhen me rininë

Sektori i Sportit:

Projektet dhe planifikimet vjetore në sport, do të fokusohen në këto tema:

- Promovimi i sportit në mesin e të rinjve, si dhe identifikimi dhe përkrahja e talenteve të reja
- Forcimi i rolit të mjeteve të informimit në promovimin e idesë për marrjen me sport
- Do të vazhdojë rregullimi i terreneve sportive në të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit
- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme
- Masivizimi i sportit
- Përfshirja e minoriteteve në aktivitetet sportive
- Dita Ndërkombëtare e Sportit për Zhvillim dhe Paqe
- Dita Ndërkombëtare e Sportit për të rinj
- Sportisti i vitit “2024”
- Java Olimpikë
- Kros vjeshtor
- Përmirësimi, ndërtimi i terreneve sportive dhe mirëmbajtja e këtyre objekteve.

Ndjekja e të gjitha procedurave të nevojshme për fillim të punimeve të tri projekteve për komunën e Rahovecit, nga memorandum bashkëpunimi me MKRS-në.

1. Ndërtimi i stadiumit të futbollit të kategorisë së dytë, në qytet, sipas standardeve të FIFA-s;
2. Ndërtimi i palestrës sportive në Krushë të Madhe;
3. Ndërtimi i stadiumit të futbollit të kategorisë së dytë me standardet e Superligës së Kosovës, në Ratkoc.
4. Vazhdim-ndërtimi i kompleksit sportiv në zonën turistike në Rahovec.

Drejtoria për Punë Inspektuese

- Ndalimi dhe asgjësimi i mallrave që shkaktojnë dëme dhe rrezik për shëndetin, jetën dhe mjedisin e konsumatorëve, kontrole të vazhdueshme në transportim dhe bartje të mallit;
- Kontrollimi i objekteve shkollore dhe parashkollore, shëndetësore, të kulturës fizike, sportit dhe rekreacionit, objektet e mbajtjes së higjienës personale, objektet publike, objekteve për furnizim me ujë të pijshëm etj.;
- Detyrimi i bizneseve për legalizimin e veprimtarisë, në zyrën e bizneseve në Rahovec;
- Inspektimi për ruajtjen e tokës bujqësore nga degradimet joligjore dhe inspektimi i barnatoreve veterinare dhe bujqësore.
- **Do të merremi me lëndët e plotfuqishme, me qëllim që t'i ekzekutojmë këto lëndë, duke u përqendruar në vendbanimet e komunës së Rahovecit, aty ku janë evidentuar uzurpues të pronave publike;**
- Kontrollime mbi cilësitë, çmimet dhe kushtet e shitjes me çmime në aksion në të gjitha lokalitetet;

- Mbikëqyrja e kycjeve në sistemin e rrjetit të ujësjellësit publik nga personat fizikë dhe juridikë, mënyra e shfrytëzimit dhe keqpërdorimet eventuale të ujit të pijshëm (larja e rrugëve, sipërfaqeve të hapura publike, autolarjet, ujitja e kopshteve etj.), mbikëqyrja e ndërhyrjeve eventuale mbi infrastrukturën rrugore (ekzekutimi i punëve publike apo private), mbikëqyrja e hedhjes së mbeturinave jashtë vendeve të caktuara;
- Realizimi i buxhetit, rritja e presionit në mënyrë të vazhdueshme në gjykata, me qëllim shqyrtimin e lëndëve të dërguara nga inspektorati, informimi i qytetarëve për domosdoshmërinë e pajisjes me leje të ndryshme që lëshohen nga komuna, pranim-shqyrtimi i kërkesave dhe i ankesave të qytetarëve, shqiptimi i gjobave ndaj kundërvajtësve.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

- Inspektimi i lumenjve, i përroskave dhe i kanaleve të hapura;
- Hartimi i Planit Operativ Emergjent;
- Planifikimi i masave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera;
- Ndërmarrja e masave të menjëhershme në ofrimin e ndihmës me rastin e shfaqjes së fatkeqësive elementare dhe aksidenteve;
- Konstatimi dhe evidentimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë elementare dhe ndërmarrja e masave adekuate për sanimin e gjendjes;
- Planifikimi i pjesëmarrjes së zyrtarëve të Njësisë profesionale për zjarrfikje dhe shpëtim, në trajnime.
- Servisimi i aparateve kundër zjarrit;
- Angazhimi në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi;
- Verifikimi i përgatitjeve për intervenim të forcave dhe të mjeteve për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë;
- Regjistrimi i mjeteve teknike të nevojshme për intervenime në raste Emergjente.
- Zhvillimi i aktiviteteve propagandistike në edukimin dhe vetëdijesimin e qytetarëve- nxënësve të shkollave nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri;
- Bashkëpunim me sektorë, shërbime e zyra të ndryshme të cilat janë përgjegjëse për planifikim dhe veprim në raste emergjente;
- Ngritja e nivelit të gatishmërisë emergjente në Komunë;
- Përcjellja e gjendjes së gatishmërisë dhe organizimi në hapësirën e mbrojtjes dhe shpëtimit.
- Planifikimi, evidentimi dhe sistemimi i resurseve njerëzore dhe mjeteve materialo-teknike për nevojat emergjente;
- Inspektimi i lumenjve, i përroskave dhe i kanaleve të hapura;
- Inspektimi i rregullt i objekteve publike, ekonomike dhe private;
- Inspektimet verifikuese, kontrolli i eliminimit të mangësive;
- Koordinimi i punëve rreth dhënies së pëlqimeve në dokumentacion investivo-teknik dhe në lokacion, respektimi i standardeve për raste emergjente.

PËRFUNDIM

Në bazë të Statutit të Komunës së Rahovecit dhe rregulloreve në fuqi, Komuna e Rahovecit ka hartuar Planin Vjetor të Punës për vitin 2024, duke u bazuar në prioritetet strategjike dhe të nevojave të adresuara nga qytetarët e komunës sonë.

Zbatimi i këtij plani, kërkon mjete materiale, ekspertizë dhe përkushtim të madh intelektual e fizik. Mbi bazën e përvojës pozitive të kaluar, mund të thuhet se shumica e këtyre sfidave do të jenë të përballueshme.

Ky plan është punuar me pjesëmarrjen e të gjithë drejtorëve të drejtorive përkatëse, po ashtu, edhe të udhëheqësve të njësive në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit. Planin Dinamik i Punës, ka përcaktuar, jo vetëm përgjegjësitë për punët e projektet e caktuara, por edhe afatet kohore për t'i përfunduar.

Po ashtu, siç është shtjelluar shkurtimisht edhe më lart, Planin i Punës, shprehimisht ndërlidh edhe vlerat, synimet e qeverisjes, objektivat strategjike dhe prioritetet që dalin nga programi zgjedhor fitues në komunën tonë.

Në planin vjetor të punës për vitin 2024, reflektohen qartë nevojat e qytetarëve të komunës së Rahovecit të identifikuar nga shumë takime, që janë bërë në të gjitha lokalitetet e komunës.

Mirëpresim kontributin e secilit që përmes vërejtjeve, këshillave, plotësimeve apo të dobësive eventuale, t'i bëjmë bashkërisht përmirësimet e nevojshme, në mënyrë që në të ardhmen ta bëjmë sa më mirë punën tonë!

Ju faleminderit!

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.164/23

Datë:27.12.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



RAPORTI VJETOR I PUNËS I KRYETARIT

(janar – dhjetor 2023)



DHJETOR 2023

• **TABELA E PËRMBAJTJES**

• TABELA E PËRMBAJTJES.....	1
• KRYETARI I KOMUNËS	2
• PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISËS.....	2
• ZOTIMET.....	2
• PRIORITETET PËR VITIN 2024.....	3
• SFIDAT KRYESORE PËR VITIN 2023.....	5
• ZYRA E KRYETARIT	5
• DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET	15
• DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE	17
• DREJTORIA PËR ARSIM	18
• DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM	18
• DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	20
• DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE.....	22
• DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL	22
• DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË	26
• DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	26
• DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE	27
• DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM	28

• KRYETARI I KOMUNËS

FJALAHYRËSE

Qytetarë të komunës së Rahovecit,

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe Statutin e Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, si dhe në Planin e Punës së Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale 2023, kemi kënaqësinë të paraqesim para jush raportin vjetor për punët, angazhimet dhe arritjet e Komunës së Rahovecit për periudhën: janar – dhjetor 2023.

Raporti pasqyron aktivitetet dhe angazhimet Kryetarit, të drejtorive komunale në Komunën e Rahovecit si dhe njësive të cilat veprojnë në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit, njëkohësisht reflekton angazhimin dhe rezultatet e shënuara në këtë periudhë.

Ky raport gjithëpërfshirës ka për qëllim të nënvizojë, përparimin e arritur në realizimin e prioritetëve të Komunës, ballafaqimeve me vështirësitë dhe përpjekjet për t'u dhënë zgjidhje një sërë çështjesh me interes publik dhe ka si pikë reference Programin Qeverisës.

Jemi angazhuar fuqishëm që të arrijmë nivel më të lartë të transparencës komunale dhe në vazhdimësi jemi përkujdesur që praktikat më të përparuara demokratike, të aplikohen gjatë vendimmarrjes në Qeverinë Komunale. Raporti vjetor i punës është mjet i komunikimit i të arriturave të pushtetit lokal, përkushtimit, angazhimit dhe vendosmërisë së treguar në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve, me qëllim të rritjes së cilësisë së jetës dhe mirëqenies së qytetarëve të Komunës së Rahovecit.

• PRIORITETET E PROGRAMIT QEVERISËS

- Bujqësia;
- Ekonomia, agroturizmi dhe punësimi;
- Administratë bashkëkohore me shërbime të shpejta dhe cilësore;
- Arsimi, shëndetësia dhe përkujdesja sociale;
- Infrastrukturë publike të rregulluar dhe të mirëmbajtur;
- Investime nga fondi i eficiencës së energjisë në sektorin publik dhe privat;
- Investime në infrastrukturë kulturore, sportive dhe hapësira për të rinjtë si dhe rritja e përkrahjes për këta sektorë;
- Promovimi i potencialit dhe i mundësive për investime nga mërgata jonë;
- Trashëgimia kulturore, historike dhe investime për ta nderuar hartën e sakrificës dhe të lirisë.

• ZOTIMET

- Komunë e hapur për qytetarët, transparencë e plotë dhe llogaridhënie;
- Komunë që qeveriset drejt dhe mirë, ligjshëm dhe me performancë të lartë;
- Komunë që u shërben qytetarëve pa dallim;
- Komunë me shërbime gjithnjë e më bashkëkohore;
- Komunë ku promovohen politikat dhe praktikat më të mira, si dhe standardet e larta të qeverisjes;
- Komunë ku respektohen vlerat njerëzore e qytetare;
- Komunë pa diskriminim, e që qytetarët i trajton barabartë;
- Komunë ku respektohen vlerat kombëtare, historike, vlerat e luftës dhe të lirisë;
- Komunë që nderon sakrificën dhe gjakun e derdhur për liri;
- Komunë që trajton dhe mbështet qytetarët që kanë nevojë të veçanta;

- Komunë që nderon, promovon e i jep përkrahje traditës, trashëgimisë dhe gjithë pasurisë sonë të përbashkët, gjithë asaj që është vlerë dhe identitet i Rahovecit;
- Komunë ku përfaqësohet, mbrohet dhe punohet për interesin publik;
- Komunë ku përkushtimi për të vepruar ndershëm dhe në pajtim me ligjin, veçse vullnet, përcaktim i të zgjedhurve, jetësohet edhe si detyrim moral ndaj zgjedhësve si dhe ndaj ligjit;
- Komunë ku respektohet mozaiku i vlerave njerëzore, demokratike, kulturore, të trashëgimisë e të besimit në Zot;
- Komunë ku respektohen pakicat dhe promovohen vlerat e tyre.

• **PRIORITETET PËR VITIN 2024**

- Sheshi Qendror i Qytetit;
- Ndërtimi i Qendrës për Kulturë, Rini, Art dhe Inovacion;
- Funksionalizimi i Shtëpisë për të Moshuar;
- Funksionalizim, mirëmbajtje dhe menaxhim të Maja e Shkodranit;
- Mirëmbajtje dhe menaxhim i vlerave kombëtare historike dhe të luftës çlirimtare |(komplekset përkujtimore, muzetë, monumentet e trashëgimisë kulturore historike, lapidarët, varrezat e dëshmorëve dhe të martirëve etj.
- Edukim dinjitar i brezave të rinj, duke iu ofruar mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore bashkëkohore, mjedis të përshtatshëm mësimor me infrastrukturë adekuate dhe gjithëpërfshirëse;
- Përmirësim i infrastrukturës së institucioneve shkollore
- Bursa për studentë;
- Bibliotekat – kujdes i shtuar për bibliotekat, duke u përkujdesur për blerjen e titujve të rinj, por edhe duke i mirëmbajtur dhe investuar në objektet e bibliotekave ekzistuese;
- Laboratorë dhe kabinete – do të investojmë në zhvillimin dhe krijimin e laboratorëve të rinj për shkencat natyrore dhe në kabinete;
- Përkrahje e fermerëve me serra, inpute bujqësore dhe farëra;
- Rugë fushore;
- Përkrahje për pikat grumbulluese të qumështit;
- Kanale të kullimit të tokave bujqësore;
- Shërbime veterinarë periodike, falas;
- Konsulencë dhe hartim të projekteve falas për bujq dhe biznese;
- Ndërtim i rrugëve të reja dhe mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese;
- Në bashkëpunim me KEDS-in, angazhim për furnizim stabil me energji, ndërrim i rrjetit, i shtyllave, instalime nëntokësore etj.;
- Bashkëpunim me KRU “Gjakova” dhe donatorë të tjerë për furnizim më të mirë me ujë të pijshëm;
- Eficienca e energjisë në objekte publike dhe në sektorin privat, përmes fondit të EE dhe të mileniumit;
- Mirëmbajtje e rregullt e hapësirave publike, e objekteve publike dhe e të gjitha llojeve të investimeve publike në komunën e Rahovecit;
- Legalizimi i parkingjeve ekzistuese dhe krijimi i parkingjeve të reja;
- Rregullimi i mëtejshëm i infrastrukturës për persona me nevojë të veçanta;
- Investime të tjera në kanalizimin e ujërave të zeza dhe në disa rrugë në pjesë problematike të qytetit;
- Mjedisë të bukura dhe hapësira për të rinjtë;
- Kënde lojërash për fëmijë;

- Rritje e numrit dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përmes menaxhimit sa më të mirë dhe profesional.
- Rritje e përkrahjes në sektorin e kulturës, rinisë dhe sportit, përmes përkrahjes së të rinjve, shoqatave kulturore-artistike dhe klubeve sportive;
- Rritje e subvencionimit për projekte kulturore-artistike dhe sportive, që janë në interes të komunitetit;
- Vazhdim i zbatimit të strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal për komunën e Rahovecit 2021-2025;
- Përkrahje dhe lehtësira për prodhuesit, tregtinë, zejet e veçanta, artizanalet, etj.;
- Trajtim dhe rregullim i shtretërve të lumenjve dhe përrenjve;
- HZK - do të miratohet Harta Zonale e komunës, pas shqyrtimit publik;
- Rritja e kapaciteteve inspektuese për mbrojtjen e mjedisit, për të parandaluar e mbrojtur nga ndotësit e shkatërruesit e tij, me shqiptim të gjobave mandatore;
- Investim në Stacionin e Autobusëve në Rahovec, faza e dytë - instalimi i kabinave inovative në stacionet e pritjes, në qytet dhe fshatra;
- Administratë efikase, e përgjegjshme dhe me shërbime moderne,
- Qeverisje energjike, vepruese dhe vendimmarrje pa vonesë,
- Realizim i suksesshëm i projekteve dhe i buxhetit,
- Realizim i planit të të hyrave komunale,
- Promovimi dhe përmirësimi i mjedisit të Rahovecit si qytet lider për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve ekzistuese, zgjerimin e tyre si dhe për ato të reja;
- Bashkëpunim i mirë me donatorët e jashtëm,
- Komunikim dhe bashkëpunim me OJQ - të.

SYNIME PËR VITIN 2024

- Bujqësi të përkrahur;
- Riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore;
- Intervenimi në ndërtimin e kanaleve të kullimit dhe drenazhimit të tokave bujqësore;
- Në bashkëpunim me donatorët do të angazhohemi për zgjerimin e sistemit të ujitjes në pjesët ku mungon;
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e përrenjve;
- Barna esenciale për qytetarët në nevojë nga buxheti i komunës;
- Investime në rritjen e cilësisë së shërbimeve, zgjerimin e tyre, pajisje mjekësore dhe inventarizim për QKMF-në dhe rrjetin e shërbimeve parësore shëndetësore;
- Arsim cilësor dhe biblioteka, pajisje bashkëkohore, laboratorë, më shumë teknologji informative dhe mjete konkretizimi në shkolla;
- Hartimi i planeve specifike komunale;
- Zhvillim ekonomik dhe punësim nëpërmjet fuqizimit dhe mbështetjes së sektorit privat;
- Investime për zhvillimin e planifikuar të agroturizmit;
- Rritjen e të hyrave vetanake përmes lëshimit të lejeve ndërtimore, procesit të legalizimit dhe lejeve mjedisore komunale;
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit dhe me Drejtorinë për Punë inspektuese, legalizimi i objekteve pa leje dhe respektimi i ligjit të ri për trajtimin e objekteve pa leje;
- Mbikëqyrje aktive dhe rritje e cilësisë në investimet publike;
- Vazhdimi i evidentimit dhe lirimit të pronave të uzurpuara;
- Dyfishim i përpjekjeve për mbrojtje të mjedisit, mbrojtjen e tokave bujqësore, mbrojtjen e pronës publike, parandalimi i ndërtimeve pa leje;
- Planifikimi i masave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, në rast të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera;

- Projekte me partneritet publiko-privat;
- Hartimi i planeve, nxjerrja e akteve dhe i rregulloreve të tjera;
- Zhvillimi i Rahovecit në përputhje me planet zhvillimore komunale dhe menaxhimi i burimeve fizike bazuar mbi parimet e shëndosha mjedisore si dhe mbi parimet e partneritetit me mekanizma vendor e ndërkombëtar, për realizimin e vizionit për komunë model me një qeverisje cilësore, efikase dhe llogaridhënëse;
- Vazhdimin e trajtimit të shtretërve të lumenjve dhe të përrenjve, përmes investimeve kapitale nga komuna e Rahovecit dhe mbështetjes nga Qeveria e Kosovës, me qëllim të mbrojtjes nga vërshimet dhe ruajtjen e mjedisit.

• **SFIDAT KRYESORE PËR VITIN 2024**

- Buxheti i ulët i Qeverisë së Kosovës, mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare nga qeveria qendrore, si trend i vazhdueshëm në Kosovë, që i bën investimet edhe më të vështira (angazhime të shtuara në kërkesa nga qeveria qendrore);
- Integrimi i sa më shumë qytetarëve dhe thellimi i bashkëpunimit të ngushtë me organizatat joqeveritare (OJQ-të), bizneset, zanatlinjtë, tregtarët, bujqit, shoqërinë civile etj.;
- Mungesa e hapësirave publike në territorin e komunës së Rahovecit;
- Mungesa e burimeve të nevojshme njerëzore dhe profesionale;
- Përfshirja më e madhe e qytetarëve tanë në aktivitetet tona dhe duke i mbajtur ata të informuar për zhvillimet në komunën tonë.

• **ZYRA E KRYETARIT**

Zyra Ligjore

Në periudhën janar – dhjetor 2023, Zyra Ligjore në Komunën e Rahovecit, ka arritur këto objektiva:

Rregullore	1
Plotësim dhe ndryshim i rregulloreve	1
Vendime për Kryetarin e Komunës	556
Vendime për Kuvendin e Komunës	95
Kërkesa nga Kryetari i Komunës	5
Akte administrative përcjellëse	14
Urdhëresa	82
Autorizime	15
Mendim juridik	1
Marrëveshje	11
Propozime për Kuvend	52
Kontrata	28
Konsultime	permanente
Përgjigje në kërkesa	7
Njoftime	9
Vendime për drejtori	41
Punë në komisione	49
Totali i akteve të hartuara për periudhën janar-dhjetor 2023 nga Zyra Ligjore, është:	967

Zyra e Burimeve Njerëzore - Njësia e Personelit

1. REKRUTIMET (Lëvizjet paralele dhe Ngritjet në detyrë) - Pranim

Gjatë kësaj periudhe janë shpallur 48 konkurse publike, prej të cilave 15 në shërbimin civil, 31 konkurse në Drejtorinë për Arsim, si dhe 6 në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Njësia e Personelit i shpall konkurset publike edhe për sektorin e arsimit dhe sektorin e shëndetësisë në programin elektronik: hrms.rks-gov.net.

3. LËSHIMI I AKTEVE ADMINISTRATIVE

Njësia e Personelit gjatë kësaj periudhe ka hartuar gjithsej 250 shkresa administrative, si në vijim: Kontrata, vërtetime, vendime, draft-vendime, propozim, akt-emërime, informata, njoftime, kërkesa, raporte dhe shkresa të tjera, si dhe ka dërguar mbi 120 emaille zyrtare.

4. TABELAT STATISTIKORE

Të dhënat statistikore të personelit, Njësia e Personelit, i procedon drejtpërdrejt në programin elektronik HRMIS, sipas kërkesës së MPB/DMZP-së, që bëhet rregullisht.

Njësia e Personelit, të dhënat statistikore për sektorët e arsimit dhe të shëndetësisë i siguron nga zyrtarët e atyre dy sektorëve.

5. VLËRËSIMI I PUNËS PROVUESE

Gjatë kësaj periudhe kohore, kemi pasur 17 raste të vlerësimit të punës provuese për punëtorët që i kanë bërë një vit pune në Komunë.

6. VIJUESHMËRIA E PUNËTORËVE NË PUNË

Funksionon Sistemi i mbikëqyrjes së vijueshmërisë së punëtorëve në punë-SMVP.

Njësia e Personelit, rregullisht, në çdo muaj, u dërgon drejtorive komunale dhe zyrave raportin e vijueshmërisë së punës, dhe kërkon nga menaxhmenti që të verifikojë mungesat e punëtorëve në punë.

7. NDËRPRERJA E MARRËDHËNIES SË PUNËS

Gjatë kësaj periudhe, tetë (8) punëtorëve iu ka pushuar marrëdhënia e punës, prej tyre 5 janë pensionuar, ndërsa 3 të tjerë kanë dhënë dorëheqje nga puna.

8. PLANI I TRAJNIMEVE TË NËPUNËSVE CIVILË

Ushtruesi i detyrës së Menaxherit të personelit, e ka përgatitur planin e trajnimeve për vitin 2024 dhe e ka dërguar për aprovim në DMZP

9. VENDIMET NGA KPMSHCK

Nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës kemi 7 vendime.

10. TË DHËNAT NGA KOMISIONET E SHËRBIMIT CIVIL TË ADMINISTRATËS KOMUNALE

I. Komisioni Disiplinor

Gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur asnjë rast për ndjekje disiplinore.

Njësia e Personelit i kryen punët e sekretarisë për Komisionin Disiplinor, duke i lëshuar shkresat administrative, përveç vendimeve, të cilat nuk ka të drejtë.

11. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE SIPAS PROGRAMIT “HRMIS”

Në vazhdimësi, Njësia e Personelit menaxhon me programin elektronik HRMIS, duke e populluar dhe freskuar me të dhëna këtë program, sipas kërkesave që parashtron MPB-ja.

12. ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE ELEKTRONIKE

Njësia e Personelit menaxhon dhe monitoron disa programe elektronike, që kanë të bëjnë me burimet njerëzore, si në vijim:

Menaxhon me programin elektronik hrms.rks-gov-net, ku realizohen procedurat e rekrutimit.

- Monitoron sistemin e prezencës (vijueshmërisë) në punë, të punëtorëve – pra programin SMVP.

- Menaxhon (një pjesë) me programin SMAED, që në nivel shtetëror është kompetent AShI- Agjencioni i Shoqërisë së Informacionit/MAP.

- Monitoron me programin elektronik PYROLL, pra programi i listave të pagave dhe i pagesave të komunës.

Zyra për Përfaqësim Ligjor - Avokatura

Zyra për Përfaqësim Ligjor (ZPL) e Komunës së Rahovecit, kryen detyrat dhe punët në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës.

Regjistrat:

1. Regjistri për lëndë (procedure) civile “C”;
 2. Regjistri për lëndë (procedurë) civile përmbare “CP”;
 3. Regjistri për lëndë (procedurë) konfliktet administrative “KA”;
 4. Regjistri për lëndë (procedurë) të ndryshme “CN”;
 5. Regjistri për lëndë (procedurë) at-hezionit “PA” dhe
 6. Regjistri për lëndë të brendshme administrative “ZPL”.
1. PASQYRA TABELARE (SI MË POSHTË) PËR TË GJITHË REGJISTRAT, PARAQET LËNDË NË PUNË, TË PRANUARA, TË KRYERA, TË PAKRYERA DHE LËNDË TË MBETURA, SI DHE PASQYRA PËR AKTIVITETET E NDËRMARRA.

PASQYRA TABELARE E LËNDËVE SIPAS REGJISTRAVE – PERIUDHA RAPORTUESE								
	Sipas regjistrave të ZPL	Civile	Përmbare	Konflikt administrativ	CN Ndryshme	Proc.At_hezionit	Komerciale Ekonomike	Gjithsej lëndë të administruara:
1	Lëndë të pazgjidhura-të bartura	1573	206	12	35	17	5	1848
2	Lëndë të pranuar	421	530	2	1	0	2	956
3	Të gjitha lëndë në punë	1994	736	14	36	17	7	2804
4	Lëndë të zgjidhura	255	314	1	2	0	2	574
5	Lëndë të mbetura	1739	422	13	34	17	5	2230

2. LËNDË TË REJA TË PRANUARA GJATË VITIT 2023:

PADI TË REJA SIPAS REGJISTRAVE – PERIUDHA RAPORTUESE								
	Lëndë të reja të pranuar gjatë periudhës raportuese	Civile	Përmbare	Konflikte administrative	Civile Ndryshme	Proc.At_hezionit	Komerciale Ekonomike	Gjithsej lëndë të pranuar
1	Vërtetim i pronësisë	10						10
2	Kompensimet sipas Kontratës Kolektive	401	523					924
3	Konteste pune	4						4
4	Lëndë të tjera	6	7	2	1	0	7	23
	Gjithsej:	421	530	2	1	0	7	961

3. PASQYRA E AKTIVITETEVE SIPAS REGJISTRAVE PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

PARASHTRESA TË PRANUARA	CIVILE	PËRMBARIMORE	KONFLIKTE ADMINISTRATIVE	CIVILE NDRYSHME	P_Athezionit	Komerciale Ekonomike	GJITHSEJ
Aktvendim+Aktgjykim I	299	8	1	0	0	2	310
Aktvendim+Aktgjykim II	61	3	0	0			64
Atkvendim+Aktgjykim III	9		0	1			10
Aktgjykim+Aktvendim DHPGJS	0						0
Urdhër përmbarimor		417					417
Aktvendim E për lejin e përmbarimit		94					94
Aktvendim për 180 ditë	0						0
Padi me prova	421		1	0			422
Aktvendim për përgjigje në padi	421		1	0			422
Përgjigje në ankesë C	180		0	0			180
Përgjigje në ankesë P		0					0
Përgjigje në prapësim		0					0
Përgjigje në revizion	0						0
Përgjigje në propozim për ML	0						
Precizimi i padisë	0		0				0
Prapësim i debitorit		0					0
Ankesë C e paditësit	4						4
Ankesë P e kreditorit		0					0
Revizion C i paditësit	0			0			
Ekspertizat	185	92		0			277
Aktakuzë					0		0
Parashtresat e tjera	220	52		0			272
	1800	666	3	1	0	2	2472

Të gjitha shkresat e pranuar janë sistemuar nëpër lëndë përkatëse dhe është vepruar në interes të Komunës, varësisht nga rasti. Vendimet e pranuar gjyqësore të shkallës së parë, të dytë dhe të tretë, pas analizimit të tyre, ato të cilat kanë qenë në dëm të Komunës, janë ankimuar në shkallë tjetër gjyqësore.

Të gjitha vendimet gjyqësore të shkallës së parë, ku e paditur ka qenë Komuna e Rahovecit, janë ankimuar në afat ligjor, përjashtim bëjnë lëndët sipas KKAK-së.

PARASHTRESA TË DËRGUARA	CIVILE	PËRMBARIMOR E	KONFLIKTE ADMINISTRATIV E	CIVILE NDRYSHME	P_Athezionit	Departamenti Ekonomik	GJITHSEJ
Ankesat	65	26	0	0	0	1	92
Përgjigje në ankesë	0		0	0			0
Përgjigje në padi	461		0	0			461
Mbrojtje në padi DHP GJS	0						0
Revizion	1						1
Përgjigje në revizion	0		0				0
Propozim për ML	1		0				1
Përgjigje në ML	0						0
Prapësimet		6					6
Përgjigje në prapësim		0					0
Ushtrimi i kundërpërbarimit		1					
Ushtrimi i padisë	0						0
Kundërpadi	4						4
Kallëzim penal					0		0
Ushtrimi i propoz. për përbarim	1	1					2
Parashtresat e tjera	8	4	0	0	0	0	12
Gjithsej:	541	38	0	0	0	1	579

Seancat eaktuara nga kontestet civile, përmbaremore, etj. nga gjykatat për periudhën raportuese

Për të gjitha lëndët aktive, gjykatat kanë caktuar dhe janë mbajtur seancat gjyqësore në të cilat Komuna është e paditur ose paditëse, si në vijim:

<i>Seancat gjyqësore gjatë vitit 2023</i>	<i>Janar</i>	<i>Shkurt</i>	<i>Mars</i>	<i>Prill</i>	<i>Maj</i>	<i>Qershor</i>	<i>Korrik</i>	<i>Gusht</i>	<i>Shtator</i>	<i>Tetor</i>	<i>Nëntor</i>	<i>Dhjetor</i>	<i>Gjithsej</i>
<i>Nr. i seancave të mbajtura:</i>	5	13	14	9	13	11	7	12	14	21	5	5	129
<i>Sipas kontesteve - seanca të caktuara/mbajtura</i>													
<i>Civile</i>	127												
<i>Përmbaremore</i>	0												
<i>Konflikte administrative</i>	0												
<i>Civile Ndryshme</i>	2												
<i>Proc.At_hezionit</i>	0												
<i>Gjithsej:</i>	129												

• ZYRA PËR INFORMIM DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun, gjatë periudhës raportuese, janar-dhjetor 2023, ka vazhduar me përcjelljen e aktiviteteve ditore të Komunës së Rahovecit. Përmes vegëzës zyrtare: <http://kk.rks-gov.net/rahovec>.

Në faqen ueb të Komunës, janë publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtuara dhe janë publikuar të gjitha vendimet, rregulloret, raportet, njoftimet, konkurset dhe dokumente të tjera në interes të të gjithë qytetarëve të Komunës. Ka mbajtur kontakte të rregullta me medie, ku u ka përcjellë njoftime e lajme ditore për aktivitetet e zhvilluara në Komunë, ftesa etj. Gjithsej janë përgatitur dhe publikuar 329 lajme, 90 njoftime, 41 ftesa, 15 thirrje, 20 ankande, 7 rregullore/ plane-strategji dhe 49 konkurse.

• QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE

Janë pranuar gjithsej 23 kërkesa për Qasje në Dokumente Publike dhe të gjitha kërkesave u është dhënë qasje dhe të gjitha kanë marrë përgjigje pozitive.

Të gjitha vendimet e nënshkuara nga kryetari i Komunës janë dërguar te zyrtarët përkatës në MAPL dhe janë publikuar në faqen ueb zyrtare të Komunës. Kryetari ka nënshkruar 659 vendime.

Është bërë plotësimi i dokumenteve-raporteve si nga ministritë edhe nga OJQ-të, e që kanë pasur të bëjnë me transparencë, performancë dhe llogaridhënie komunale.

Gjatë muajve janar- dhjetor 2023, janë publikuar: aktivitete-dokumente, detajet mund t'i shihni në tabelën e mëposhtme:

Muajtë	Lajme	Njoftime	Ftesa	Thirrje	Konkurse	Ankande	Rregullor e/Plane/St rategji	Takime/Dë gjime/ Konsultime	Raporte- procesver bale	Kërkesa QDP	Vendimet e Kryetarit	Aktivitet e për muaj
janar	3	1	2	2	5	0	1	1	2	1	22	40
shkurt	18	3	3	5	7	10	1	4	14	2	63	130
mars	36	6	4	0	5	3	0	0	4	3	55	116
prill	23	12	5	1	7	0	0	1	1	5	60	115
maj	43	7	2	1	6	0	0	0	1	5	47	112
qershor	21	1	4	0	1	0	0	6	6	2	92	133
korrik	37	9	5	0	7	0	1	1	6	1	37	104
gusht	35	13	2	3	3	1	0	11	8	0	58	134
shtator	28	8	5	2	2	2	1	1	8	2	37	96
tetor	36	9	6	1	1	1	1	0	4	2	88	149
nëntor	39	18	3		5	3	2	2	1		100	173
dhjetor	10	3						1	2	1		17
gjithsej	329	90	41	15	49	20	7	28	57	24	659	1319

LEKTORIMI

Zyrtarja për lektorim, ka redaktuar gjuhësisht dokumentet e nxjerra nga Kryetari i Komunës, që ka lëshuar Zyra Ligjore, të tjera që kanë ardhur nga drejtoritë, nga Kuvendi Komunal dhe nga komitetet e Kuvendit (procesverbale dhe vendime), si dhe dokumente të tjera të adresuara.

Gjatë njëvjeçarit 2023:

Vendime	512
Urdhëresa	40
Propozime	39
Marrëveshje	6
Raporte	9
Kontrata	32
Drejtoritë	100
Zyra e personelit	23
KKSB (procesverbal)	9
KPF (procesverbal dhe rend dite)	14
Kuvendi (procesverbal dhe rend dite)	12
Kuvendi Komunal (vendime)	21
Komiteti për Komunitete (procesverbal dhe rend dite)	8
Komiteti për Shëndetësi (procesverbal dhe rend dite)	6
Autorizime	9
Kërkesa nga Zyra e Kryetarit	50
Shkresa	6
Thirrje	10
Buletine mujore (redaktim gjuhësor dhe përpilime për publikim	4
Vërejtje	1
Gjithsej:	911

Përpilimi dhe përgatitja për publikim i Gazetës zyrtare të Rahovecit nga muaji gusht-dhjetor.

Zyra e Auditimit të Brendshëm

Kemi arritur të kryejmë 5 auditime dhe 1 është në proces.

Drejtoritë e audituara të planifikuara dhe të realizuara për periudhën janar – dhjetor të vitit 2023

1. Auditimi i Brendshëm në Drejtorinë për Shërbime Publike;
2. Auditimi i Brendshëm në Drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm;
3. Auditimi i Brendshëm në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
4. Auditimi i Brendshëm në Drejtorinë për Administratë të Përgjithshme;
5. Auditimi i Brendshëm i Performancës për projektin: Ndërtimi i Parqeve në Komunën e Rahovecit;

6. Auditimi i Brendshëm në Drejtorinë për Financa dhe Buxhet është në proces.

Zyra e Prokurimit

Zyra e Prokurimit ka proceduar **78** Aktivitete të Prokurimit.

Vlera e parashikuar e këtyre aktiviteteve është: **16,076,600.70 €**.

Deri më tani, zyra jonë ka nënshkruar, shtatëdhjetë e një (**71**) kontrata të gjitha prokurimeve, punë, furnizime, shërbime, ku vlera e kontratave të nënshkruara është: **11,597,357.09 €**.

Tri (**3**) aktivitete të prokurimit janë anuluar;

Gjashtëmbëdhjetë (**16**) aktivitete të prokurimit janë në procedurë të prokurimit.

Personeli i Zyrës së Prokurimit ka proceduar: **1524** urdhërblerja, pagesa të ndryshme të investimeve kapitale dhe mallra dhe shërbime, vlera e të cilave është: **8,705,200.17 €**.

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

- Programi "QENDRA MËSIMORE ME BAZË NË KOMUNITET/shkollë";
- Fasilitimi i aplikimeve për bursa për shkolla të mesme dhe universitete;
- Fasilitimi i përdorimit të shërbimeve të E-Kosovës;
- Trajnimi për ngritjen e kapaciteteve në arsimin gjithëpërfshirës "INCLUDE" në kuadër të Këshillit të Evropës;
- Fushata sensibilizuese për regjistrimin me kohë të fëmijëve të komuniteteve joshumicë në klasë të parë;
- Lehtësimi i koordinimit ndërmjet institucioneve të nivelit qeveritar dhe komunal për procesin e kthimit dhe të riintegrit të qëndrueshëm në rajonin e Prizrenit;
- Vaksinimi i rregullt i fëmijëve;
- Fushata vetëdijesuese mbi mbrojtjen nga sëmundjet kronike;
- Inspektimi procesit të të riadhesuarve;
- Aprovimi i Planit të Veprimit për Kthim të Qëndrueshëm 2023-2025;
- Takime me UNHCR-në dhe Ministrinë për Komunitete dhe Kthim;
- Projekti i rregullimit të terrenit sportiv në Lagjen e Epërme, në shkollën "Gëzim Hamza-Piktori";
- Kontrollë gjinekologjike dhe mamografi falas për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Rahovec dhe Gjakovë.

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË

Sektori i Gjendjes Civile

Certifikatë e Lindjes	29994
Deklaratë për bashkësinë familjare	4181
Certifikatë e gjendjes martesore	1463
Certifikatë e martesës	5549
Certifikatë e shtetësisë	192
Certifikatë e vendbanimit	2195
Certifikatë e vdekjes	1180
Vërtetim nga arkivi	1195

Lindjet vendore	37
Lindjet e jashtme	382
Martestat vendore	584
Martestat e jashtme	92
Vdekjet vendore	248
Vdekjet e jashtme	53
Aktvdekjet	269
Pranimi i atësisë	36
Aktvendimet e korrigjimit të emrit ose të mbiemrit	43
Aktvendimet e regjistrimit të mëvonshëm të të lindurve	43
Aktvendimet e regjistrimit të mëvonshëm të të vdekurve	14
Aktvendimet e ndërrimit të emrit dhe të mbiemrit	28

SEKTORI PËR PUNË TË KUVENDIT DHE KOMITETEVE

Për të gjitha takimet e mbajtura të Kuvendit Komunal dhe Komiteteve, kemi bërë përgatitjen profesionale të dokumenteve, përkthimin, lekturimin, kemi asistuar në mbarëvajtjen e seancave, kemi bashkëpunuar me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal ku kemi dërguar aktet e miratuara në Kuvendit e Komunës.

Më poshtë janë të detajuara në mënyrë tabelare numri i mbledhjeve të Kuvendit dhe të Komiteteve të dala nga Kuvendi i Komunës për vitin 2023.

Mbledhje të rregullta të Kuvendit	11
Komiteti për Politikë dhe Financa	11
Komiteti për Komunitete	6
Mbledhjet e KKSBB-së	6
Komiteti për Shëndetësi	5
Komiteti për Arsim	0
Komiteti për Auditim	4
Mbledhje të jashtëzakonshme	1
Mbledhje emergjente	0
Mbledhje solemne	2
Mbledhje Komemorative	2

Në vijim, në mënyrë tabelore, paraqesim edhe numrin e vendimeve, të rregulloreve, të planeve dhe të informatave që janë shqyrtuar dhe aprovuar në mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal Rahovec, në periudhën janar-nëntor 2023.

	Emërtimet	Nr. i Vendi meve	Nr. i rregulloreve	Nr. i Informatave	Nr. i Raporteve	Nr. i Statuteve	Konf. i Ligjshmërisë nga MAPL	Rishqyrtim i Ligjshmërisë nga KK
1.	Mbledhjet e Kuvendit - të rregullta dhe të jashtëzakonshme	102	2	6	13	1	63	61

SEKTORI PËR IT

Më datë 23 maj 2023, është lansuar në objektin e Komunës Sistemi i Menaxhimit të Radhës (One Stop Shop), i cili do të lehtësojë punën e zyrtarëve të Administratës, si dhe qytetarët do të marrin shërbime më të shpejta. Kemi bërë rikonfigurimin e disa kompjuterëve, kemi bërë inspektimin e kompjuterëve, kemi monitoruar

vazhdimisht ecurinë e punëve në sistemin e intranetit, kemi monitoruar funksionimin e faqes ueb, po ashtu me kërkesa të ndryshme, edhe kemi publikuar materiale në faqen ueb.

Në kuadër të projektit “Furnizimi me teknologji informative”, jemi pajisur me kompjuterë të rinj për zyrtarët të cilët kanë pasur nevojë, në mënyrë që punët të kryhen më lehtë nga ana e zyrtarëve.

Gjatë kësaj periudhe, të gjitha takimet e mbajtura në sallën e kuvendit komunal (mbledhjet e kuvendit komunal, KPF, KKSBB dhe të të gjitha komiteteve të tjera), i kemi përkrahur dhe sipas nevojës i kemi transmetuar në faqen ueb të komunës.

Kemi monitoruar edhe zyrat e gjendjes civile në terren, jemi marrë me përgatitjen e specifikacioneve për projektet që ndërlihen me teknologjinë informative, siç janë: Furnizimi me pajisje të teknologjisë informative, furnizimi me *digjital sender* dhe pajisjeve të teknologjisë informative, furnizimi dhe instalimi i kamerave në objektet e komunës, është nënshkruar kontrata për ndërtimin e dy E-Kiosqeve në komunën e Rahovecit

Kemi pasur edhe kërkesa për krijimin e llogarive të reja për përdorimin e sistemeve qeveritare të cilat i kemi krijuar dhe, në bashkëpunim me AHI-në, i kemi autorizuar për përdorim.

Vazhdimisht kemi kërkesa AD-HOC nga zyrtarë komunalë, nga shkollat e komunës së Rahovecit, nga institucionet shëndetësore (QKMF, QMF, AMF) për intervenime në pajisjet e teknologjisë informative, të cilave po përpiqemi në maksimum t’u përgjigjemi.

Gjatë këtij viti, janë vendosur dy E-kiosqe një në Rahovec tek posta dhe një në Ratkoc.

• QENDRA PËR SHËRBIME ME QYTETARË

Qendra për Shërbime me Qytetarë është pjesë e strukturës organizative të administratës. Përbëhet nga zyrtarët e qendrës për shërbim me qytetarë, të cilët kryejnë veprime të shërbimit administrativ, si: pranimin e kërkesave/parashtresave nga qytetarët dhe subjektet e tjera. Këto kërkesa/parashtresa, të kompletuara përcillen në drejtoritë e administratës komunale, varësisht ku pala parashton për shqyrtim dhe vendosje.

Kërkesat e pranuar gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023

Në drejtorinë e Administratës së përgjithshme gjatë kësaj periudhe raportuese janë pranuar kryesisht kërkesa që kanë të bëjnë me kërkesat që janë drejtuar në drejtoritë e tjera e që, sipas rregullores për taksa, tarifa gjoba dhe ngarkesa, kanalizohen përmes drejtorisë sonë.

Drejtoria e Administratës	Shenja e klasifikimit	Nr. I kërkesave	Te paguara	Te liruar	gjithsej
Kërkesa/Ankesa	320/04	5008	5508	530	5538
Mbajtës familjeje	320/04	725/10euro	725	//	7250
Vërtetime të ndryshe	320/04	185	185	//	185
Totali					12973

SEKTORI PËR MIRËMBAJTJE, LOGJISTIKË DHE SIGURIM TË OBJEKTEVE

Është marrë me rregullimin e çështjeve logjistike (pastrim, kujdes për gjelbërim etj...). Kemi përfunduar procedurat për projektin “Sigurimi fizik i objekteve të Komunës”.

Kemi menaxhuar me përkushtim të plotë fushën e logjistikës, ku përfshihet menaxhimi i automjeteve, titullar pronësor i të cilëve është Komuna e Rahovecit, duke ushtruar me përkushtim të plotë sipas legjislacionit në fuqi, mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare, servisimin, sigurimin dhe regjistrimin e tyre, furnizimin transparent me derivate etj.

SEKTORI PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Gjatë vitit 2023, sektori për të Drejtat e Njeriut është angazhuar me të gjitha kapacitetet e saj për të afirmuar sektorin, ka bashkëpunuar me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, ka këshilluar qytetarët të cilët janë paraqitur në zyrë. Bashkëpunim të ngushtë sektori ka pasur me Zyrën e Avokatit të Popullit, me të cilët është punuar me theks të veçantë kundër diskriminimit të të gjithë qytetarëve të komunës së Rahovecit, pa dallim

etnie e gjinie. Sektori për të Drejtat e Njeriut, si objektiv parësor ka mbikëqyrjen e legjislacionit vendor e ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut.

SEKTORI PËR BARAZI GJINORE

Në kuadër të Administratës, funksion sektori për Barazi Gjinore.

Gjatë këtij viti, zyrtari për barazi gjinore është angazhuar në promovimin dhe të drejtat e grave, për mosdiskriminim në baza gjinore në asnjë fushë, për të drejta dhe detyrime të barabarta të gruas, ashtu siç parashihen me Ligjet tona në fuqi dhe me konventa ndërkombëtare.

Përgjatë këtij viti, zyrtari ka bashkëpunuar me organizata vendore dhe të huaja, ka marrë pjesë në punëtori për avancimin e rolit të gruas në shoqëri, si dhe me shënimin e ditëve të shënuara ndërkombëtare, siç është Dita Ndërkombëtare e Gruas, 8 Marsi.

Sektori për Barazi Gjinore, ka objektiv rritjen e rolit të gruas në shoqëri, avancimin e saj në të drejtat që i takojnë, synim i cili do ta përcjellë punën e këtij sektori.

Të hyrat në Drejtorinë e Administratës për vitin 2023 janë: 94,407.50€.

• DREJTORIA PËR FINANCA DHE BUXHET

SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

Bazuar në obligimet ligjore të cilat dalin nga Ligji mbi Financat Publike dhe Përgjegjësitë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ka kryer të gjitha detyrat dhe obligimet që i takojnë kësaj drejtorie.

Në Drejtorinë e Financave është arritur që detyrat dhe përgjegjësitë janë kryer në afate ligjore dhe në kohë, dhe çdo e hyrë dhe shpenzim është evidentuar në sistemin e SIMFK-së .

Gjate kësaj periudhe të punës kemi mbajtur disa takime me Ministrinë e Financave, me AKK-në dhe organizata të ndryshme, apo donatorë, që kryesisht janë trajtuar çështjet financiare.

Te shpenzimet operative, kemi arritur të kursejmë disa shpenzime pa e dëmtuar procesin e punës, kujdes të veçantë respektimi i rregulloreve dhe udhëzimeve administrative, në mënyrë që mos të krijojmë keqklasifikime në buxhet, duke respektuar edhe afate ligjore, të cilat janë të rregulluara me ligjet për Financat Publike. Deri në këtë periudhë raportuese, shpenzimi i buxhetit është arritur në 95%, ndërsa të hyrat e përgjithshme janë tejkaluar në raport me planin, në 30,56%.

2. BUXHETI 2023

➤ **Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2023 ndahet në dy fonde burimore:**

• Grandi qeveritar	16,112,029.69 €
• Të hyrat vetanake	1,445,603.00 €
	Gjithsej 17,557,632.69 €

➤ **Buxheti për vitin 2023, i shpërndarë sipas kategorive ekonomike:**

• Paga dhe Mëditje	8,512,480.69 €
• Mallra dhe Shërbime	2,203,829.00 €
• Shpenzime Komunale	370,000.00 €
• Subvencione dhe Transfere	820,000.00 €
• Investime Kapitale	5,651,323.00 €
• Rezerva	000.000.00 €
• Donacion	637,974.75.00 €

3. PUNËT E REALIZUARA JANAR-DHJETOR

➤ **Gjatë kësaj periudhe, janë realizuar këto detyra:**


- Zotime, pranime, shpenzime për Mallra dhe Shërbime, shërbime komunale, subvencione dhe transfere, dhe investime kapitale.
- Përgatitja dhe dorëzimi i pasqyrave financiare për vitin 2022, në Ministrinë e Punës dhe Transfereve.
- Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2022 në vitin 2023.
- Shpërndarja e faturave të tatimit në pronë.
- Shpërndarja e vërejtjeve të tatimit në pronë.
- Raportimi i obligimeve financiare dhe kontraktuale në baza mujore në Ministrinë e Financave.
- Përgatitja e raporteve mujore dhe tremujore (shpenzimet dhe të hyrat) për publikim në faqen ueb të Komunës

4. JANAR-DHJETOR BUXHET, ALOKIM, SHPENZIM

Përshkrimi	Lëndët e kryera	Buxheti fillestar	Buxheti final	Alokimet	Shpenzimet	Shpenzim Buxhet fillestar %	Shpenzim Buxheti final %	Shpenzim Alokim %
Paga dhe Mëditje	-	8,503,088.00	8,512,480.69	7,703,455.84	6,603,701.52	107.52	107.41	118.69
Mallra dhe Shërbime	2436	2,203,829.00	2,279,829.00	2,279,829.00	1,718,707.77	97.83	94.57	94.57
Shpenzime Komunale	624	370,000.00	370,000.00	370,000.00	262,889.40	87.93	87.93	87.93
Subvencione dhe Transfere	160	820,000.00	837,268.39	837,268.39	688,403.22	92.77	90.85	90.85
Investime Kapitale	229	5,651,323.00	6,048,470.62	6,048,470.62	3,577,616.20	109.53	102.34	102.34
Donacione	-	0	696,524.75	696,524.75	461,083.43	0.00	66.20	66.20
Totali	3449	17,548,240.00	18,744,573.45	17,935,548.60	13,312,401.54	108.48	101.55	106.14

- Sqarim: Dallimi ndërmjet buxhetit fillestar dhe final është për arsye të bartjes së mjeteve të mbetura nga viti 2022 në kategorinë e Investimeve kapitale, Donacionet, Grandi i Performancës, Alokimi i huamarrjes në Arsim dhe Shëndetësi në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve.

4.1. Paraqitja grafike



5. TË HYRAT VETANAKE

- Të hyrat e përgjithshme vetanake, të planifikuara për vitin 2023, janë 1,445,603.00 euro, për këtë periudhë janë realizuar në shumë **1,887,320.82€**, apo 130.56 % të planifikimit vjetor.

6. SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

- Gjatë periudhës janar-dhjetor 2023, Sektori i Tatimit në Pronë ka realizuar të hyra në shumë prej 988,474.03€, apo 125.04 % të planifikimit vjetor (planifikimi vjetor 790,514.00€). Regjistrimet e reja janë 820 objekte, ose 181,800 m². Verifikimi i objekteve 4169 ose 718,754 m².

-Vërejtje: Të gjitha të dhënat që janë të paraqitura janë përgatitura në bazë të raporteve deri më 4.12.2023

• DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

- Angazhimi rreth përmirësimit të kushteve për punë të nëpunësve dhe të stafit në përgjithësi, në kuadër të DSHPS-së;
- Është bërë shqyrtimi dhe përgjigjja me kohë në kërkesat e ndryshme të qytetarëve, kryesisht për ndihma momentale.
- Edhe gjatë kësaj periudhe raportuese ka vazhduar ofrimi i shërbimeve mjekësore në dy ndërrime, në dy QMF-të, në Krushë të Madhe dhe Ratkoc, shërbimet mjekësore me dy ndërrime tanimë janë të përhershme, përrurimi i objektit të AMF-së, në Lagjen nr.3,
- Është duke funksionuar shërbimi mjekësor "Kujdesi Shtëpiak", i cili do ta lehtësojë marrjen e trajtimit shëndetësor për të moshuarit dhe ata me sëmundje të rënda, të cilët e kanë të vështirë mobilitetin deri te QKMF-ja apo QMF-të. Një mjek dhe dy infermierë janë në lëvizje për të ofruar shërbime mjekësore nga ora 7:00 deri në 21:00. Janë kryer 191 vizita mjekësore shtëpiake nga ekipi mobil;
- Në fshatrat Dejnë dhe Ratkoc, Krushë e Madhe, Sapniq dhe Dobidol – dhurimi vullnetar i gjakut;
- Janë mbajtur ligjëratat vetëdijesuese në QKMF në Rahovec;
- Është themeluar Këshilli i Pacientëve në Komunën e Rahovecit, i përbërë nga 5 anëtarë, mandati i anëtarëve të Këshillit të Pacientëve është 3(tre)-vjeçar;
- Në kuadër të marrëveshjes me AQH – në, po trajtohen mjekët dhe infermierët në QKMF –në në Rahovec, po ashtu AQH-ja asiston në implementimin e mjekësisë familjare;
- Një veturë donacion kemi pranuar nga UNICEF-i për shërbimin për vizitat në shtëpi për nëna dhe fëmijë nga mosha 0 deri në 3 vjeç;
- Janë kryer vizitat sistematike të nxënësve në shkollat e komunës së Rahovecit.
- Jemi duke punuar në funksion të avancimit të shërbimeve shëndetësore dhe për këtë qëllim kemi pranuar personel shëndetësor për 42 vende të reja të punës, për: mjekë, stomatologë dhe infermierë;
- Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare "Fahredin Hoti" në Rahovec, kemi vënë në funksion aparatën e mamografisë, i cili shërben për ta identifikuar dhe diagnostikuar me kohë kancerin e gjirit. Aparati i mamografit vlerësohet të jetë një prej aseteve më me rëndësi për mjekësinë primare, sidomos në aspektin shëndetësor, në parandalimin me kohë të sëmundjes së kancerit të gjirit. Komuna e Rahovecit me një investim si ky, ka investuar direkt në shëndetin e grave-nënave, si shtyllë kryesore e familjes dhe e mirëqenies së saj;
- Janë evidentuar dhe shpërndarë thirrjet-ftesat për vaksinimin e fëmijëve në komunën tonë.

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

Është bërë përrurimi i Objektit të vjetër të QKMF – së në Rahovec;

Jemi pajisur me dy Auto Ambulanca për nevojat e QKMF-së.

Vazhdon furnizimi me barna nga lista esenciale nga buxheti i komunës.

Nga donacion është pajisur me mjete laboratorike laboratorike në QMF në Krushë të Madhe

Kemi pranuar një donacion nga mërgimtarët pajisje mjekësore për nevojat e QKMF-së, në vlerë prej 200,000.00euro.

Është bërë përrurimi i objektit të ri të AMF-së, në Lagje të Epërme, lagja nr.3

Ka filluar renovimi i të gjitha objekteve të QMF-ve, dhe AMF-ve.

Mirëqenia Sociale:

Komisionet kanë punuar vazhdimisht në terren për evidentimin e familjeve në kushte të rënda sociale, dhe këto

nevoja janë adresuar vazhdimisht në Qeverinë e Kosovës, donatorë vendor dhe të huaj, janë kontaktuar shoqata të ndryshme dhe OJQ vendore dhe ndërkombëtare, është intervenuar në të gjitha rastet që është krijuar mundësia.

• DREJTORIA PËR ARSIM

PERIUDHA E TREMUJORIT TË PARË (JANAR – MARS)

Punime në eficiencë;

Projekti i furnizimit të shkollave me pako pedagogjike dhe projekti i furnizimit të bibliotekave të shkollave me libra;

Riparimet e brendshme në shkollën “Bekim Sylka”;

Punë në projektin e ndërtimit të objektit të ri të aneksit në ShFMU “Katër Dëshmorët”;

Riparimet e nyjeve sanitare të shkollës në fshatin Sapniq;

Punime në projektin e zbatimit të masave të eficiencës së energjisë në objektin e ShFMU “Dëshmorët e Zatriqit” në Zatriq.

PERIUDHA E TREMUJORIT TË DYTË (PRILL-QERSHOR)

Punime për instalimin e ndriçimit të brendshëm në objektin e ShFMU “Bekim Sylka”;

Dhënia e bursave për studentë dhe për nxënës;

Punime të eficiencës në objektin e Shfmu “Rilindja” në Çifllak;

U bë furnizimi me libra për bibliotekat e shkollave dhe me mjete konkretizimi;

Kyçja e rrymës në çerdhen për fëmijë në Krushë të Madhe;

U përrua themelimi i Qendrës për Zhvillimin e Karrierës në këtë Institucion të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional;

U përrua objekti i shkollës “Bajram Curri”.

PERIUDHA E TREMUJORIT TË TRETË (KORRIK – SHTATOR)

Është mbajtur pjesa e parë e Testit të Arritshmërisë për nxënësit e klasave të nënta

Punime në projektet e zbatimit të masave të eficiencës së energjisë në objektin e ShFMU “Gëzim Hamza-Piktori”.

Kemi nënshkruar marrëveshjen për fillimin e zbatimit të projektit për pajisjen e secilës shkollë fillore me nga 4 robotë edukativ, me ç’ rast, për 25 shkolla fillore do të ndahen 100 robotë të tillë.

Punime në riparimet e brendshme në objektin e ShFMU “Rilindja” në Çifllak

PERIUDHA E TREMUJORIT TË KATËRT (TETOR – DHJETOR)

Furnizimi me pelet në të gjitha shkollat të cilat e kanë në përdorim këtë lëndë djegëse për ngrohje.

Në objektin e ShFMU “Dëshmorët e Zatriqit”, është punuar në ndarjen fizike të 3 dhomave të mësimi.

Në objektin e ShFMU “Dëshmorët e Lirisë” në Pataqan të Poshtëm, kemi filluar të bëjmë ndarje fizike të 3 klasave.

Përruam projektin “Ndikimi i rinisë në mjedis”, të cilin e realizuan nxënësit e Klubit Ekologjik të ShML “12 Maji” në bashkëpunim me Karitasin Zvicëran dhe organizatën “Ec ma ndryshe”.

• DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Gjatë periudhës janar-mars të 2023, DEZHT-i ka bërë regjistrimin e të gjitha subjekteve afariste prej librit kryesor të vitit 2022 në librin e ri të vitit 2023, po ashtu është bërë edhe kalkulimi i ngarkesave për vitin 2023.

Për periudhën raportuese, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, ka përgatitur disa pika drejtuar Kuvendit Komunal në Rahovec:

- Informatë mbi menaxhimin e aseteve komunale për vitin 2022;

- Plotësim-ndryshimi i rregullores për taksa komunale 01 Nr. 80/20;
- Shfuqizimi i vendimit për fabrikën e kartonit, si dhe vendimi për dhënien në shfrytëzim përmes shprehjes së interesit;
- Falja e borxheve të vjetra në taksa afariste për periudhën 1.1.2000 - 31.12.2017;
- Vendimi për dhënien në shfrytëzim përmes ankandit publik të 4 parcelave te depot e Matreksit në Xërxë;
- Vendimi për dhënien në shfrytëzim të lokaleve te palestra “Mizahir;
- Vendimi për dhënien në shfrytëzim të tregut ditor në fshatin Raktkoc;
- Vendimi për këmbim të dy parcelave të cilat gjenden te Parku Industrial në Opterushë, për të cilat jemi në pritje të ligjshmërisë nga MAPL.

Janë mbajtur 3 sesione informuese:

- Sesion informues rreth aplikimit për grante në fondet të IPA-së;
- Sesion informues për grante. Ky sesion informues është organizuar nga Syri Vizion në bashkëpunim me DEZht-in;
- Sesion informues për thirrjen e granteve për bizneset të cilën e ka hapur Ministria e Zhvillimit Rajonal. Ky sesion informues u organizua nga DEZht-i, në bashkëpunim me Agjencionin Zhvillimor Rajonal;
- Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) në bashkëpunim me DEZht-in, ka ndarë 66 kuponë me vlerë nga 100.00€ deri në 300.00€, për familjet e prekura nga vërshimet, të cilat janë në kushte jo të mira ekonomike;
- Është iniciuar ankandi publik për shitjen e aseteve të papërdorshme të komunës. Vlera e aseteve të shitura është 12,950.00€.
- Kemi hapur thirrje për praktikantë, me pagesë, në partneritet publiko-privat.
- Kemi aplikuar në thirrjen për grante të cilën e ka hapur Ministria e Zhvillimit Rajonal. Në këtë thirrje Komuna e Rahovecit ka aplikuar me dy projekte:
 1. Ballkoni Panoramik dhe
 2. Terrenet sportive.
- Është hapur thirrja për subvencionimin e bizneseve të cilat merren me: Punë artizanale, ushqime tradicionale, përpunues të drurit dhe të metalit. Në këtë thirrje kanë përfituar gjithsej 19 biznese të Komunës së Rahovecit.

Investimet Kapitale:

- Ka filluar faza e parë e ndërtimit të Parkut Industrial në Opterushë, ky projekt bashkëfinancohet nga MINT dhe Komuna e Rahovecit, i cili arrin shumën 1,688,216.52€;
- Është përfunduar projekti: “Rregullimi i Oborrit te Depot e Matreksit në Xërxë”;
- Është bërë përfundimi i Shtëpisë për të Moshuar.

Sektori për Ekonomi:

Në tremujorin e parë të vitit 2023, janë përgatitur aktvendimet për të gjitha bizneset që janë të ngarkuara me taksë afariste komunale dhe po ashtu kemi vazhduar me inkasimin e të hyrave në këtë sektor.

Të hyrat dhe ngarkesa në taksë komunale

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat në taksë komunale, periudha janar-shtator 2023	78,598.50€

Sektori për Zhvillim:

Evidenca e të hyrave dhe e ngarkesës së qirasë të lokaleve afariste dhe të pronës së paluajtshme të Komunës së

Rahovecit, sipas bazës së shfrytëzimit si pasuri e paluajtshme komunale me të cilat disponon komuna e Rahovecit, mbahet në mënyrë të rregullt.

Në periudhën janar-shtator 2023, janë lëshuar gjithsej 105 pëlqime të punës.

Të hyrat nga qiraja:

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat nga qiraja për periudhën janar- shtator 2023	95,125.76 €

Zyra e QKRB-së:

Evidenca e regjistrimit të bizneseve të komunës së Rahovecit, sipas bazës së programit online të ARBK-së, mbahet në mënyrë të rregullt.

Tabela e kërkesave dhe e regjistrimit të bizneseve për periudhën janar-shtator 2023:

Nr.	Përshkrimi	Nr.
1	Biznese të reja	164
2	Informata të ndryshme	151
3	Vërtetim individual	47
4	Biznese të njësisë	12
5	Shuarje të biznesit	47
6	N.U.I.	59
7	Ndryshim-statuti nga B.I. në Sh.P.K.	03
8	Ndërrim të emrit tregtar dhe informata të tjera	12
9	Ndërrim i pronarit, shtim i pronarëve	99
10	Certifikata të dëmtuara	10
	Gjithsej lëndë të përfunduara	604

Menaxhimi i aseteve komunale

Të gjitha transaksionet që kanë ndodhur gjatë vitit 2023, janë regjistruar me kohë në sistemin e-pasuria dhe SMFK dhe regjistrimi i tyre bëhet në vazhdimësi.

Sektori i Turizmit

Zyra për Informacione Turistike, gjegjësisht Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, i ka zbatuar detyrat dhe obligimet e muajit janar-shtator 2023, si në vijim:

Është lansuar Harta Turistike Digjitale në komunën e Rahovecit.

Ka përfunduar thirrja e dytë e projektit të Reload2, në kuadër të UNDP-së dhe Komunës së Rahovecit.

• DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Të hyrat buxhetore në DUPMM për vitet 2023

Viti	2023
Të hyra janar- dhjetor	66,284.61

Kërkesat për vitet 2023

Janar- dhjetor	2023
Leje ndërtimore	70
Leje mjedisore	29

SEKTORI I URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT

Në sektorin e Urbanizmit dhe Planifikimit janë shqyrtuar:

Viti	2023				
Kërkesat	Nr.	Ap.	Re.	Sh.	Hidhet
Leje ndërtimi	70	53	1	13	2
Leje rrënimi	9	8		1	
Leje përdorimi	4	4			
Kushte ndërtimore	113	80	8	10	15
Shkresa	52	52			
Pëlqim, ndërrim-destinim	85	72	6	2	4 hidhet 1 cedohet
Ankesa	1			1	
Referenca	1	1			
Vërtetim	2	2			
Legalizim	4	4			
Gjithsej	341	276	15	27	22

Të hyrat e përgjithshme 2023

Parallogaria	55,197.52 €
Leje përdorimi	80 €
Leje rrënimi	30 €
Vendim	30 €
Vërtetim – pëlqim	2,185 €
Legalizim	1,972.52 €
Totali i të hyrave	59,495.04 €

SEKTORI I MJEDISIT

Në bazë të Sektorit të Mjedisit lëshojmë leje mjedisore komunale dhe leje ujore komunale.

Kërkesat	Nr.	Ap	Re	Sh	Hidhet
Leje Mjedisore	29	27	1	1	

Të hyrat e përgjithshme në Sektorin e Mjedisit 2023

Leje mjedisore	6,789.57
-----------------------	-----------------

Sistemi i Adresave

Harmonizimi i emrave të rrugëve në ARIS, ndryshimi i formave të rrugëve (ndarje/bashkim kodesh), kontrolli i hyrjeve sipas metodologjisë së caktuar dhe përgatitja në statusin “gati për aprovim” për t’i paraqitur në Gjeoportali dhe shfrytëzim nga qytetarët dhe institucionet.

Në gjashtëmujorin e parë janë mbledhur të dhëna për këto vendbanime: Fortesë, Celinë, Krushë e Madhe, Hoçë e Vogël, Brestoc, Nagavc, Nashpall, Zoqisht, Hoçë e Madhe, Opterushë, Retijë, Retijë e Poshtme, Bërnjak, Pataqan i Epërm, Pataqan i Ulët, Sapniq, Xërxe, Gexhë, Malësi e Vogël, Bratotin, Vrajakë, Ratkoc, Dejnë, Çifllak, Kramovik, Gur i Kuq, Mrasor, Dobidol, Nashpall, Kaznik dhe Pastasel.

Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal 2023-2031

Ndërtimi i Sheshit Qendror në Qytet

Ecuria e realizimit të projekteve kapitale

Objekti i banimit social;

Rregullimi i shtratit të përroit në lagjen e Kelmendëve në Kramovik;

Vazhdimi i rregullimit dhe ristrukturimi i Lumit Rimmik në Fortesë;

Ndërtimi i parqeve në Komunën e Rahovecit: Kramovik, Guri i Kuq, Brestoc, Xërxë, Pataqan i Epërm, Çifllak, Drenoc, Krushë e Madhe, Ratkoc, Opterushë, Retijë e Poshtme, Dejnë dhe kolektori për ujëra të zeza në Ratkoc dhe Rahovec.

Sheshi Republika.

• DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE

Aktivitetet në periudhën: janar, shkurt, mars

- Është bërë marrëveshja e re me K.R.U. “Gjakova”, për investime publike, si dhe trajtim të ujërave të zeza;
- Janë sanuar dy segmente rrugore në fshatin Çifllak, Hoçë e Vogël, Polluzhë, Pastasel;
- Punimet në rrugën “Ali Sokoli”;
- Kanë filluar punimet në ndërtimin dhe rregullimin e përroskës në fshatin Celinë;
- Ka pasur aktivitete në rrugën 4-korsi, Lot 3.

Aktivitetet në periudhën: prill, maj, qershor

- 6 segmente rrugore në rrugën “Sadedin Hajda” kanë përfunduar;
- Ka përfunduar ndriçimi publik sipas kontratës me ESCO, në fshatrat Vrajak, Bratatin, Senoc, Pastasel, Zatriq, Opterushë, Nagac, Celinë, Zoqisht, Pataqan i Poshtëm, Pataqan i Epërm, Rahovec;
- Ndërtimi i trotuareve në fshatrat Pataqan i Poshtëm dhe Nashpall.

Aktivitetet në periudhën: korrik, gusht, shtator

- Gjatë kësaj periudhe kanë filluar punimet me ndërtimin e rrjeteve të kanalizimit;
- Kanë përfunduar punimet në ndërtimin e rrugëve lokale, dy rrugë në Pataqan të Epërm, dy rrugë në Nashpall dhe dy 4 rrugë në fshatin Pataqan i Poshtëm;
- Ka filluar trajtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve me asfalt - rruga “Gëzim Hamza”, “Mulla Cufa” dhe “Xhelal Hajda”;
- Është fituar projekti nga IPA 2019-2022 - Programi ndërkufitar Kosovë-Maqedoni e Veriut (Rahovec-Haraqinë) i gropave septike Rahovec, Retijë, Polluzhë, Pataqan i Epërm, Pataqan i Poshtëm dhe Pastasel, vlera e projektit për komunën tonë është 282,958.06, si dhe për participim 42,443.72 euro;
- Është përfunduar një segment rrugor në Fortesë - 150 metra;
- Është përfunduar puna në asfaltimin e një rruge në fshatin Celinë, me gjatësi 400 metra.

Aktivitetet në periudhën: tetor, nëntor, dhjetor

- 21 rrugë janë përruruar në qytet, me gjatësi prej mbi 2 km rrugë, janë në ndërtim e sipër 7 rrugë në Çifllak, 2 rrugë në Senoc, janë përfunduar 5 rrugë në Pastasel, 2 rrugë në Nashpall, 5 rrugë në Pataqan të Poshtëm, 2 rrugë në Pataqan të Epërm;
- Ndërtimi i rrugës “Shejh Myhedini”, instalimet nëntokësore për vendosjen e kablllove për energjinë.

Aktivitetet në gjashtëmujorin e parë

Për fermerët blegtorë, MBPZhR-ja hap thirrjen për aplikim, Drejtoria e BPZhR-së pranon aplikacionet dhe i dorëzon në Ministri për pagesë. Kjo thirrje ka qenë e hapur nga 12 janar deri, më 10 shkurt 2023. Gjithsej kanë aplikuar 81 blegtorë, prej të cilëve: 73 blegtorë kanë qenë aplikues vetëm për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë, me rreth 1.862.692 litra, ndërsa 16 prej tyre kanë aplikuar edhe për viça për majmëri, gjithsej për 278 krerë.

Si rezultat i fatkeqësive natyrore, kanë ndodhur vërshime në tokat bujqësore si pasojë e prurjeve të mëdha të ujit dhe daljes nga shtrati të lumit Drini i Bardhë, kemi pranuar kërkesa për vlerësim të dëmeve, ku pas daljes në terren është përpiluar edhe raporti final.

Kemi pranuar nga MBPZhR-ja listat e fermerëve të dëmtuar nga vërshimet dhe breshëri gjatë vitit 2022, për të cilët ne kemi dërguar dy ankesa, të cilëve u është aprovuar ankesa, dhe atyre u që janë refuzuar.

- Ankesa u është aprovuar gjithsej 243 fermerëve në vlerë rreth 1,060,000€
- Ndërsa të refuzuar gjithsej 83 fermerë, në vlerë rreth 254,000€.

Kemi përgatitur një ankesë tjetër dhe e kemi dërguar në MBPZhR-ja për fermerët që janë refuzuar, të cilët gjithsej janë 83 fermerë në vlerë rreth 254,000€, ankesën e kemi dërguar për fermerët të cilët kanë siguruar dëshmi dhe janë paraqitur në zyrat e DBPZhR-së, mirëpo përmes një emaili nga MBPZhR-ja jemi njoftuar se ankesën që e kemi dërguar për 83 fermerët, është refuzuar. Listën me emrat e këtyre fermerëve dhe të dhënat e tjera, i kemi përcjellë te organizata FAO, ku kemi kërkuar që të kompensohen fermerët e dëmtuar gjatë muajit janar nga dalja e shtratit të lumit Drini i Bardhë, si dhe nga erërat e forta, dhe për fermerët e refuzuar nga komisioni në kuadër të Ministrisë.

Në bashkëpunim me MBPZhR-në dhe IFC-në është mbajtur sesion Informues lidhur me Sigurimet Bujqësore

Janë vaksinuar rreth 1940 krerë.

Ka filluar të zbatohet kontrata “Trajtim i Qenve Endacakë”.

SIGURIMET BUJQËSORE

Për fermerët të cilët kanë shprehur gatishmërinë për sigurimin e kulturave bujqësore në kompanitë e sigurimit për: vreshta, grurë, misër, fasule, patate etj. Komuna e Rahovecit, ashtu sikurse vitin e kaluar, ka marrë përsipër të mbulojë 15% të vlerës, ndërsa 75% subvencionohet nga Ministria e Bujqësisë.

SUBVENCIONET 2023

Jemi angazhuar të mobilizohemi me zyrat në Krushë të Madhe dhe Ratkoc që aplikimin të kenë mundësi ta kryejnë edhe në këto dy qendra të mëdha.

Numri total i fermerëve që kanë aplikuar për vitin 2023 është 3,119, ku, krahasuar me vitin 2022, kemi 141 aplikacione më shumë.

Në tabelat dhe grafikonet më poshtë janë paraqitur të dhënat sipas sektorëve, të shprehura në sipërfaqe (ha), si dhe në vlera monetare (€), që nënkupton se Komuna e Rahovecit do të përfitojë mbi 5,7 milion euro në vitin 2023, rreth 270,818 € më shumë se në vitin 2022.

Tabela 1. Të dhënat sipas aplikacioneve të fermerëve dhe diferenca mes vitit 2022/2023 të shprehura në sipërfaqe

VITET			2022	2023
Sektorët	Lloji	nj. matëse	sip. ose nr.	sip. ose nr.
Sektori i lavërtarisë	Drithërat	ha	3,711.24	4,768.34
	Grurë - KG	kg	0.00	0.00
Sektori i vreshtarisë	Rrush	ha	2,322.21	2,274.57
	Verë	litër	7,274,876.45	7,654,411.00

	Fidanë të hardhisë	copë	149,900.00	
Sektori i perimekulturës	Perime	ha	1,213.94	1,114.97
	Kungullore	ha	579.58	423.16
Sektori i pemëtarisë		ha	165.23	194.31
Sektori i blegtorisë dhe i shpezërisë	Bletë	koshere	4,245.00	4,793.00
	Lopë	krerë	1,938.00	1,953.00
	Dhi	krerë	248.00	167.00
	Dele	krerë	7,226.00	7,396.00
	Pula vojëse	copë	59,100.00	60,260.00
Bimë mjekësore dhe aromatike - BMA			16.51	8.54
Perime në serra			Të ndryshme	ha
			24.26	27.21

VITET		2022	2023	Diferenca
Sektorët		Vlera në €	Vlera në €	Vlera në €
Sektori i lavërtarisë	Drithërat	1,255,391.96 €	1,627,232.86 €	371,840.90 €
	Grurë - KG	0.00 €		0.00 €
Sektori i vreshtarisë	Rrush	2,447,609.34 €	2,397,396.78 €	-50,212.56 €
	Verë	290,995.06 €	290,995.06 €	0.00 €
	Fidanë të hardhisë	22,485.00 €	18,600.00 €	-3,885.00 €
Sektori i perimekulturës	Perime	689,203.76 €	636,805.38 €	-52,398.38 €
	Kungullore	210,956.32 €	175,984.14 €	-34,972.18 €
Sektori i pemëtarisë		74,353.50 €	97,932.24 €	23,578.74 €
Sektori i blegtorisë dhe i shpezërisë	Bletë	84,900.00 €	95,860.00 €	10,960.00 €
	Lopë	174,420.00 €	175,770.00 €	1,350.00 €
	Dhi	6,200.00 €	4,175.00 €	-2,025.00 €
	Dele	180,650.00 €	184,900.00 €	4,250.00 €
	Pula vojëse	27,339.66 €	30,130.00 €	2,790.34 €
Bimë mjekësore dhe aromatike - BMA		7,429.50 €	4,304.16 €	-3,125.34 €
Perime ne Serra		21,931.04 €	24,597.84 €	2,666.80 €
Gjithsej		5,493,865.14 €	5,764,683.46 €	270,818.32 €

Tabela 3. Të dhënat sipas aplikacioneve të fermerëve dhe diferenca mes vitit 2022/2023, të shprehura në EURO

SHPERNDARJA E PAJISJEVE BUJQËSORE

Është bërë shpërndarja e **42** plugjeve 5-brazësh.

Është bërë shpërndarja e **149** motokultivatorëve dhe **5** plugjeve 5-brazësh.

Aktivitetet në gjashtëmujorin e dytë

Kemi pranuar kërkesa për vlerësim të dëmeve në kultura bujqësore, të dëmtuara nga breshëri, erërat e forta dhe vërshimet, gjithsej **393** kërkesa.

Është formuar shtabi komunal për **korrije – shirjet** e vitit 2023, i cili e ka përcjellë vazhdimisht procesin e korrije-shirjeve, dhe ka hartuar një raport përfundimtar sipas të cilit këtë vit rendimenti i grurit është më i ulët për shkak të kushteve jo të mira klimatike. Sipërfaqet e korrura me grurë janë rreth **2.650 -2.690 ha** ndërsa rendimenti mesatar i grurit është rreth **3.500 – 4500 kg/ha**.

Ministria e Bujqësisë ka hapur thirrje për pranim të aplikacioneve për subvencionim të litrit të qumështit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023 për fermerët blegtorë dhe për sigurime bujqësore. Drejtoria e BPZhR-së ka pranuar aplikacionet e fermerëve dhe i ka dorëzuar në Ministri për pagesë.

Gjithsej kanë aplikuar **113 blegtorë** për qumësht dhe për viça për majmëri, me gjithsej **2.010.439 litra** qumësht.

- **81** aplikues për qumësht,
- **32** për viça,
- **16** për sigurime bujqësore.

Gjatë kësaj periudhe është kryer edhe aplikimi për kilogram të grurit të dorëzuar në mullinj, për faturat e plehut artificial. Pas një angazhimi rreth mundësisë së kompensimit të dëmeve për fermer, u mbajt ceremonia solemne e shpërndarjes së kuponëve nga organizata FAO, për fermerët të dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore, vërshimet dhe erërat e forta në janar të këtij viti, gjithsej kanë përfituar **91 fermerë**. Këta kuponë kishin vlerën e **300€** dhe do t’ju mundësojnë fermerëve të blejnë inpute të domosdoshme për fermat e tyre, si: farë, pleh, vegla pune, aparate ujitjeje, pjesë rezervë dhe mallra të tjera të domosdoshme sipas nevojave të tyre.

SHPËRNDARJA E PAJISJEVE BUJQËSORE

Komisioni për ankesa i ka shqyrtuar ankesat e fermerëve për motokultivatorë, ka publikuar listën ,është kryer participimi 20% i pagesës dhe nënshkrimi i kontratave, dhe është bërë shpërndarja e **61** motokultivatorëve.

Është bërë shpërndarja e pajisjeve bujqësore - freza, gjithsej **25**.

FESTAT ME KARAKTER BUJQËSOR: AGROFESTA DHE HARDHFEST 2023

Agrofest - janë promovuar prodhimet bujqësore, produktet e ndryshme bujqësore, ushqimet tradicionale etj.

Hardhfest - janë zhvilluar shumë aktivitete dhe ka pasur vizitorë nga vende të ndryshme.

Projektet e investimeve kapitale

RREGULLIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRUGËVE FUSHORE:

Punime në Krushë të Madhe në segmentin Vija e Rrasës dhe në rrugën ‘‘Udhë Nalli’’, në rrugën që lidh dy vendbanime Gur i Kuq-Polluzhë si dhe një segment brenda fshatit, në Rahovec, konkretisht në vendin e quajtur Sejan.

KANALET E KULLIMIT

Kanali i kullimit në Ratkoc; nga Shtavica deri në Fortesë; në Çifllak; Fortesë – Celinë.

PASTRIMI I PËRRENJVE

Punimet janë zhvilluar në zonat më të ndieshme dhe që janë më të rrezikuara, në Fortesë, Celinë, Krushë e Madhe, Ratkoc, Vrajakë etj.

Është punuar në hapjen dhe pastrimin e përroit ‘‘Bellaja’’, e përroit në fshatin Zoqisht, Nagavc, si dhe lumit Rimnik nga Rr. Rahovec – Xërxë, në drejtim të vendit të quajtur *Maqina*.

Është kryer pastrimi i përrenjve në segmentin Ratkoc - Baboc, është pastruar edhe shtrati i përroit në Nushpal.

Dhënia në shfrytëzim e tokave të komunës-bujqësore

TË HYRAT VJETORE TË DBPZHR-SË

Taksa për Ndërrimi i Destinimit të Tokës	105.85 €
Taksa tjera Administrative	830.00 €
Shfrytëzim i Pronës Publike	61.00 €
Qiraja nga Objektet Publike	3,924.14 €
Participimet	25,939.30 €
TOTALI	30,860.29 €

• DREJTORIA PËR GJEODEZI, KADASTËR DHE PRONË

Sektori:	Lëndët	Shuma në €
Kadastër dhe pronë	470	35,000.00 €
Gjeodezi	315	22,208.50 €
Referenti	3,900+99 L.Z.	18,800.00 €
Totali	4,685+99 L.Z.	76,008.50 €

Pranimi i aplikacioneve të qytetarëve dhe të gjeodetëve privat për ndarje të parcelave, bashkim të parcelave, regjistrim të pjesës së ndarjes, regjistrim të hipotekave, çregjistrim të hipotekave, shitblerje, trashëgimi, falje, ndërrim i paluajtshmërisë, ndarje e bashkësisë familjare etj.

Kërkesa për certifikatat e pronës dhe kopje plani.

Pranimi i lëndëve për ndarje fizike, produkte si koordinata, modifikime.

Kemi përgatitur materialin për propozim-ndryshim të rregullores për taksa dhe tarifa, vendim për dhënien e pronës me qira, interes i përgjithshëm, vendim për këmbim etj.

Përgjigje në kërkesat e personave juridikë dhe fizikë.

Me kërkesë të qytetarëve për falje të pronës private në pronë publike, në të gjitha zonat kadastrale për hapje të rrugëve publike, në interes të përgjithshëm, gjeodetët kanë dalë në terren dhe kanë përgatitur dokumentacione të nevojshme për zhvillimin e këtyre procedurave.

Kemi mbajtur takime të rregullta me Agjencionin Kadastral të Kosovës.

Përgjigje në kërkesat e Zyrës Ligjore sipas nevojës për përfaqësime në procese gjyqësore.

Me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, kemi zbatuar vendimin për zonat kadastrale në Kramovik dhe Gur i Kuq, si zona për destinim solar.

• DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Organizimi i manifestimeve përkujtimore e kulturore - 27 Janar “Flaka e Janarit”, me ç’rast është shpallur konkursi letrar “Pena e Flakës”.

Aktivitete kulturore e sportive në shënim të Ditës së Pavarësisë, më 17 Shkurt.

Aktivitete për nder të Epopesë së UÇK-së.

Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport ka vazhduar me mbështetjen e projekteve të OJQ-ve, të cilat veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në komunën tone, këtë vit përfitues nga subvencionet kanë qenë 23 OJQ në shumë prej **157.100eu**, gjatë viti 2023 OJQ-të kanë përfituar **30%** më shumë se vitin e kaluar.

Java e Dëshmorëve; Festivali i folklorit “Anadrinia jehon”.

Shënimi i 1 Qershorit - Ditës së fëmijëve.

Aktivitete më 14 Qershor - Dita e Çlirimit; Më 17 Qershor - shënimi i ditëlindjes Ukshin Hotit dhe ndarja e Dekorates për shkrimtarin Ismail Kadare.

Aktivitete për nder të 28 Nëntorit “Ditës së Flamurit Kombëtar”.

Më 7 dhjetor, shënimi i Ditës së Bibliotekës Komunale “Sulejman Krasniqi”, dhënia e çmimit letrar “Sulejman Krasniqi”

Investimet Kapitale:

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport është duke punuar në ndërtimin e terreneve sportive në të gjitha vendbanimet e Komunës sonë,

Përrurimi i fushës sportive në fshatin Gexhë, Malësi të Vogël.

Përrurimi i kompleksit muzeor “UKSHIN HOTI” në Krushë të Madhe

Ndërtimi i aneksit të Shtëpia e Kulturës në Krushë të Madhe.

Punimet për rregullimin e Shtëpisë së Kulturës në Celinë.

Ndërtimi i Qendrës Rinore dhe Kulturore në Rahovec.

Ndërtimi i Shtëpisë-muze “Bajram Curri” në Krushë të Madhe.

Në kuadër të projektit “Ndërtimi i parqeve dhe këndeve rekreative për fëmijë” është bërë rregullimi i Parkut te stacioni i autobusëve.

BIBLIOTEKA KOMUNALE “SULEJMAN KRASNIQI”-RAHOVEC

Përpunimi fizik i materialeve bibliotekare; Klasifikimi dhe katalogimi i librit.

Këndi Shkencor “Sabahajdin Cena”.

Anëtarësia dhe libra të lexuara

Janar - dhjetor	Anëtarë	Meshkuj	Femra	Me pagesë	Falas	Lib. të lex.	Meshkuj	Femra
Rahovec	733	315	418	721	12	6464	2581	3883
Krushë	63	21	42	63	0	954	314	640
Ratkoc	78	31	47	77	1	521	180	341
Gjithsej	874	367	507	861	13	7939	3075	4864

Salla e leximit - Pasurimi i fondit librar - Fondi librar në biblioteka

Janar - dhjetor	Salla e leximit	Pasurimi i fondit librar	Fondi librar në biblioteka
Rahovec	173	829	21527
Krushë	68	212	4551
Ratkoc	600	792	1837
Gjithsej	841	1833	27915

Palestra sportive “Mizahir Isma”

Në palestrën sportive “Mizahir Isma”, janë realizuar aktivitete të shumta sportive, si nga klubet e Komunës së Rahovecit, ashtu edhe nga ato ndërkombëtare.

Është mbajtur kupa e Kosovës në Basketboll “Final 8”.

• DREJTORIA PËR PUNË INSPEKTUESE

Në total, janë realizuar 1204 kontrolle inspektuese.

Në fushën e ndërtimit është bërë inspektimi i ndërtimeve pa leje ndërtimore dhe ndalimi këtyre ndërtimeve deri në pajisjen me leje ndërtimore, janë dërguar aktvendime për rrënimin e ndërtimeve pa leje si pasojë e mosrespektimit të urdhrit për ndalim punimi, është bërë mbikëqyrja e zbatimit të ligjit dhe e rregullave të tjera që kanë të bëjnë me ndërtimet (projektet e ndërtimit, planet etj.), mbikëqyrja e standardeve të ndërtimit dhe të produkteve ndërtimore, si dhe konstruksionet që përdoren gjatë ndërtimit, janë shqiptuar edhe 91 gjoba mandatore për ndërtim pa leje;

Janë obliguar 79 subjekte që të pajisen me leje për shfrytëzim të hapësirës publike, prej tyre 65 janë pajisur me leje, ndërkaj edhe ndaj 14 të tjerëve janë ndërmarrë masa ndëshkuese sipas legjislacionit në fuqi;

99 është numri i bizneseve të reja të cilat janë regjistruar në zyrën e ARBK-së, pas urdhëresave nga shërbimi ynë; 99 është numri i lëshuar i pëlqimeve të punës për subjektet afariste të cilat i kanë plotësuar kushtet higjienike – teknike;

Janë inspektuar 200 biznese nga inspektorët e tregut lidhur me identifikimin e produkteve ushqimore, vendosjen e çmimeve në produkte etj.;

Janë inspektuar edhe 35 prej subjekteve afariste, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në komunën e Rahovecit, ku prej tyre është kërkuar pajisja me leje mjedisore;

Në fushën e transportit publik ne në vazhdimësi kemi përcjellë nga afër punën e kompanive të licencuara të autobusëve. Janë kryer inspektime rutinore ku edhe janë urdhëruar autotaksi të bëjnë vazhdimin e lejes për kryerjen e transportit jo të rregullt të udhëtarëve;

Në bashkëpunim me DGJKP-në, kemi identifikuar raste të ndryshme të uzurpimeve arbitrare, si dhe në koordinim me DBF-në, Stacionin Policor në Rahovec, është rrënuar një objekt në pronë publike në fshatin Xërxë.

STATISTIKA – GJOBA MANDATORE DHE REALIZIM I TË HYRAVE

LLOJI I VEPRIMIT	NUMRI I KËRKESAVE	VLERA NË €
KËRKESA PËR KONTROLL INSPEKTUES	39	310 €
PËLQIME PUNE	99	1410€
TOTALI:	116	1720 €
LLOJI I NDËSHKIMIT	NUMRI I GJOBAVE TË SHQIPTUARA	VLERA E GJOBËS NË €
GJOBA MANDATORE PËR NDËRTIM PA LEJE	91	45,880.00 €
GJOBA MANDATORE – ÇËSHITJE KOMUANLE - GËRMIM PA LEJE, EKSPOZIM I MALLRAVE USHQIMORE, SHFRYTËZIM I HAPËSIRËS PUBLIKE	34	4050€
GJOBA MANDATORE PËR MUNGESË DOKUMENTACIONI, MOSPËRPUTHJE ÇMIMESH	8	4000€
GJOBA MANDATORE PËR MOSRESPEKTIM TË ORARIT TË PUNËS	12	600 €
GJOBA MANDATORE PËR MJEDIS	41	1350 €
TOTALI:	186	55,880.00

TOTAL TË HYRA PËR KËTË PERIUDHË RAPORTUESE: 57,602.09€.

• DREJTORIA PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM

Gjatë periudhës janar-dhjetor, janë inspektuar lumenjtë, përroskat dhe kanalet e hapura në të gjithë territorin e komunës.

Kemi bërë Inspektimin e rregullt të objekteve publike, private dhe shëndetësore për verifikimin e gjendjes së aparateve për shuarjen e zjarreve.

Është kryer servisimi i parë për vitin 2023, i aparateve për fikjen e zjarrit në 70 objekte publike të komunës, janë servisuar gjithsej 558 aparate të vendosura në këto objekte: të Komunës së Rahovecit dhe të zyrave të administratës publike, në të gjitha shkollat fillore dhe të mesme, çerdhe, QKMF dhe QMF, shtëpitë e kulturës, muzetë dhe në palestrën e sporteve.

Inspektori për parandalim, në kuadër të DMSH-së, ka pasur 10 verifikime për dhënien e pëlqimit për mbrojtje nga zjarri për ndërtimin e objekteve dhe 18 dalje për verifikimin dhe hulumtimin e shkaqeve të zjarreve të ndodhura. Ekipi i zjarrfikësve gjatë vitit 2023, ka marrë gjithsej 252 kërkesa për intervenime.

PËRFUNDIM

Ky raport përmbledhës paraqet theksat kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Raporti i punës për vitin 2023, është dëshmi e respektit ndaj Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe i dedikohet të zgjedhurve nga qytetarët, monitoruesve dhe publikut të gjerë.

Mirëpresim kontributin e secilit që përmes vërejtjeve, këshillave, plotësimeve apo të dobësive eventuale, që t'i bëjmë bashkërisht përmirësimet e nevojshme, në mënyrë që në të ardhmen ta bëjmë sa më mirë punën tonë.

Bashkërisht me ekipin tim qeverisës, kemi gatishmërinë, energjinë dhe diturinë, të gjitha këto t'i vëmë në dispozicion të qytetarëve, që Komuna e Rahovecit të ofrojë shërbime sa më cilësore.

Të vendosur për menaxhim të mirë të pronës publike, duke krijuar kushte më të mira për zhvillim ekonomik, arsim, shëndetësi, bujqësi, infrastrukturë, mirëqenie sociale, kulturë, rini dhe sport, në të ardhmen na presin angazhime edhe më të mëdha për të mirën e të gjithëve, pa dallim.

Ju faleminderit!

Kryetari i Komunës



Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenin 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 63 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec në mbledhjen e mbajtur me dt. 27.12.2023 miraton këtë:

V E N D I M

Për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2024

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/3655/23 i datës 18.12.2023 dhe merret vendimi me të cilin i lejohej Kryetarit të Komunës, që në interes të qytetarëve, në emër të mbulimit të shpenzimeve të varrimit për vitin 2024, të lidh marrëveshje me të gjitha bashkësitë fetare që veprojnë në territorin e komunës së Rahovecit, konform planit buxhetor afatmesëm.
2. Pakoja e shërbimeve primare do të definohej në marrëveshje të re dhe ajo nuk mund të ketë kosto më të lartë se **220.00 € (dyqind e njëzet euro)** për një rast, ndërsa për shërbimet tjera të cilat nuk janë pjesë e marrëveshjes, qytetarët do t’i sigurojnë ato personalisht.
3. Qytetarët të cilët do të marrin shërbim nëpërmjet bashkësive fetare, do të pajisen me një fletushkë me të cilën do të informohen për shërbimet të cilat janë pjesë e marrëveshjes.
4. Shërbimet të cilat do të jenë pjesë e marrëveshjes, në asnjë rast nuk mund të kushtëzohen me pagesat e anëtarësive fetare apo të tjera.
5. Obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, që në kuadër të implementimit të marrëveshjes t’i respektoj afatet kohore, si dhe të kërkoj prej bashkësisë fetare (palëve nënshkruese të marrëveshjes) që t’i përmbahen të gjitha pikave të marrëveshjes si dhe obligimeve në kompletimin e dokumentacionit konform saj.
6. Mjetet të sigurohen nga kodi **Mallra dhe Shërbime**.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të jetë Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën së Rahovecit
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren

(QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C

01Nr.174/23
Datë:27.12.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja f) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), Ligjin për mbrojtjen e natyrës (Nr. 03/L-233), dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.5 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 27.12.2023 miraton këtë :

V E N D I M

Për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Biodiversitet

1. Me këtë vendim miratohet Plani Lokal i Veprimit për Biodiversitet në Komunën e Rahovecit 2023-2027.
2. Shtojcë e këtij Vendimi është edhe Plani Lokal i Veprimit për Biodiversitet në Komunën e Rahovecit 2023-2027.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Kryetari i Komunës.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

K U V E N D I I K O M U N Ě S N Ě R A H O V E C

01-Nr.168/23
Datë: 27.12.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja f) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), Ligjin për mbrojtjen e natyrës (Nr. 03/L-233), dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.5 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 27.12.2023 miraton këtë :

V E N D I M

Për miratimin e Planit të punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, (janar-dhjetor 2024)

1. Me këtë vendim miratohet Plani i punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, (janar-dhjetor 2024).
2. Shtojcë e këtij Vendimi është edhe Plani i punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, (janar-dhjetor 2024).
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Sekretaria e Kuvendit dhe Kryetari i Komunës.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Sekretarisë së Kuvendit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

K U V E N D I I K O M U N Ě S N Ě R A H O V E C

01-Nr.167/23
Datë: 27.12.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 27.12.2023 miraton këtë :

V E N D I M

Për miratimin e planit të punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2024

1. Me këtë vendim **miratohet** agjenda dhe plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2024.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

K U V E N D I I K O M U N Ě S N Ě R A H O V E C

01-Nr.16623
Datë:27.12.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 pika (d), nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.4 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 27.12.2023 miraton këtë :

V E N D I M

Për miratimin e planit të punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2024

1. Me këtë vendim **miratohet** axhenda dhe plani i punës i Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2024.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është plani i punës i Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **Kryetarit të Komunës,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C

01-Nr.164//23
Datë: 27.12.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, pika (d), nenit 17 dhe nenit 40, paragrafi 2, pika (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 10, paragrafi 2, pika 2.4, nenit 40, paragrafi 2, pika 2.4 dhe nenit 57, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.12.2023, miraton këtë :

V E N D I M

Për miratimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024

1. Me këtë vendim, **miratohet** axhenda dhe Plani i Punës i Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Rahovecit për vitin 2024.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i Punës i Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Rahovecit për vitin 2024.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Anëtarëve të Kuvendit,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

K U V E N D I I K O M U N Ě S N Ě R A H O V E C

01-Nr.165/23
Datë: 27.12.2023

Arber Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja f) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), Ligji Nr. 08/L-025 për mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.5 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 27.12.2023 miraton këtë :

V E N D I M

Për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit

1. Me këtë vendim miratohet Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit në Komunën e Rahovecit 2023-2027.
2. Shtojcë e këtij Vendimi është edhe Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit në Komunën e Rahovecit 2023-2027.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Kryetari i Komunës.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

K U V E N D I I K O M U N Ě S N Ě R A H O V E C

01-Nr.169/23
Datë: 27.12.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me dt.27.12.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafos elektrike

1. Me këtë vendim **caktohet** lokacioni për vendosjen e trafos elektrike.
2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01015-44, në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Rakita, me sipërfaqe të përgjithshme prej 28784m² (njëzetë e tetëmijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër metra katror), e evidentuar në posedim të Kuvendit Komunal dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport;
3. Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës së cekur në nenin 2 të këtij vendimi, të ndahen 50 m² (pesëdhjetë metra katror), për vendosjen e trafos elektrike dhe ti hiqet e drejta e shfrytëzimit në këtë sipërfaqe 50 m² (pesëdhjetë metra katror), Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
4. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barrë tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Kuvendit ,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe*
- *Arkivi.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.172/23
Me datë:27.12.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008*”), nenit 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 27.12.2023 merr këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e vendimit 01 Nr. 303/22 i datës 29.04.2022 për miratimin e Planit komunal për integritet 2022 - 2026

1. Me këtë vendim **shfuqizohet** vendimi me Nr. Prot. 01 Nr. 303/22 i datës 29.04.2022 për miratimin e Planit komunal për integritet 2022 - 2026.
2. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **MAPL-së,**
- **Kryetarit të Komunës,**
- **Shërbimit të Kuvendit, dhe**
- **Arkivit.**

K U V E N D I I K O M U N Ě S Ć Ć R A H O V E C

01Nr.170/23
Datë: 27.12.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit